



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit dhe Shkencës / Ministarstvo za Obrazovanje  
i Nauke / Ministry of Education and Science

# Raporti i vlerësimit të Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017-2021 për vitin 2019



Implemented by:

**giz** Deutsche Gesellschaft  
für Internationale  
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH



# Raporti i vlerësimit të Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017-2021 për vitin 2019

Vlerësimi i realizimit vjetor të Planit Strategjik të Arsimit të Kosovës 2017-2021 dhe objektivave strategjike

Gusht 2020

Ky material është zhvilluar me mbështetjen e Qeverisë Gjermane përmes Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH. Përmbajtja e tekstit original është përgjegjësi e autorëve dhe jo domosdoshmërisht pasqyron opinionin zyrtar të Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH.

© Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH), 2020

Përmbajtja e këtij dokumenti mbrohet me Ligjin për të Drejtën e Autorit. Të dhënat në këtë dokument duhet të referencohen dhe citohen. Ministria nxit shpërndarjen e pjesëve të veçata për përdorim të brendshëm dhe qëllime jofitimprurëse.

# Përmbajtja

Parathënia	6
Mirënjohje dhe falënderime	7
Lista e shkurtesave	8
<b>1. Fushëveprimi dhe Metodologjia</b>	<b>10</b>
1.1 Fushëveprimi	10
1.2 Metodologjia	11
<b>2. Analiza e Mjedisit Arsimit</b>	<b>13</b>
2.1 Zhvillimet politike	13
2.2 Zhvillimet ekonomike	16
2.3 Zhvillimet sociale	19
2.4 Zhvillimet teknologjike	20
<b>3. Fizionomia e Sistemit Arsimit</b>	<b>22</b>
3.1 Fizionomia e sistemit arsimor	22
3.2 Treguesit e performancës në arsim	25
<b>4. Zhvillimet kryesore në arsim 2016-2019</b>	<b>27</b>
4.1 Objektivat kryesore strategjike – analizë krahasimore	27
4.1.1 Pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja	27
4.1.2 Menaxhimi i Sistemit Arsimit	28
4.1.3 Cilësia në arsim	32
4.1.4 Mësimdhënia dhe të nxënit	34
4.1.5 Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve	37
4.1.6 Arsimi Profesional	39
4.1.7 Arsimi i Lartë dhe Shkenca	40
4.2 Treguesit strategjik të performancës	43
4.3 Rekomandime të përgjithshme	45
<b>5. Financimi i Arsimit</b>	<b>48</b>
5.1 Planifikimi buxhetor në arsim	48
5.2 Financimi i përgjithshëm	48
5.3 Financimi i Arsimit Parauniversitar	49
5.4 Financimi i Arsimit të Lartë dhe Shkencës	51
<b>6. Zbatimi i Aktiviteteve të PSAK 2017-2021</b>	<b>53</b>
6.1 Pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja	55
6.1.1 Përfshirja në edukimin parashkollor	56
6.1.2 Përfshirja në edukim parafillor	59
6.1.3 Përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta	60
6.1.4 Përfshirja e komuniteteve	61
6.1.5 Përfshirja e të riatdhesuarve dhe diasporës	63
6.1.6 Parandalimi i braktisjes	64

6.1.7 Përkrahja e fëmijëve me potencial të jashtëzakonshëm	66
6.1.8 Promovimi i diversitetit	66
6.1.9 Treguesit e performancës	67
6.1.10 Matrica e zbatimit të aktiviteteve	69
6.1.11 Rekomandimet	71
6.2 Menaxhimi i Sistemit Arsimor	75
6.2.1 Menaxhimi efektiv në sistemin arsimor	76
6.2.2 Standardet profesionale për udhëheqje në arsim	78
6.2.3 Formula e financimit	79
6.2.4 Informatat dhe statistikat arsimore	80
6.2.5 Legjislacioni në arsim parauniversitar	81
6.2.6 Siguria dhe shëndeti në shkolla	82
6.2.7 Sistemi i menaxhimit të infrastrukturës	83
6.2.8 Investimet kapitale	84
6.2.9 Matrica e Zbatimit të Aktiviteteve	85
6.2.10 Treguesit e Performancës	88
6.2.11 Rekomandimet	90
6.3 Cilësia në arsim	93
6.3.1 Mekanizmat për sigurim të cilësisë	94
6.3.2 Planet zhvillimore të shkollave dhe komunave	95
6.3.3 Sigurimi i jashtëm i cilësisë	95
6.3.4 Vetëdijësimi mbi sigurimin e cilësisë	96
6.3.5 Vlerësimi i jashtëm i nxënësve	96
6.3.6 Matrica e zbatimit të aktiviteteve	99
6.3.7 Treguesit e Sigurimit të Cilësisë	101
6.3.8 Rekomandimet	103
6.4 Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve	107
6.4.1 Ndërtimi i Sistemit për Zhvillim Profesional	109
6.4.2 Vlerësimi i performancës së mësimdhënësve	111
6.4.3 Lincencimi i mësimdhënësve	112
6.4.4 Matrica e zbatimit të aktiviteteve	114
6.4.4 Treguesit e performancës	116
6.4.5 Rekomandimet	118
6.5 Mësimdhënia dhe të Nxënit	121
6.5.1 Zbatimi i kurrikulës së re	121
6.5.2 Tekstet dhe materialet mësimore	123
6.5.3 Mjetet e konkretizimit dhe TIK	124
6.5.4 Matrica e zbatimit të aktiviteteve	126
6.5.5 Treguesit e Performancës	127
6.5.6 Rekomandimet	129
6.6 Arsimi Profesional	133
6.6.1 Harmonizimi i profileve me nevojat e tregut të punës	134
6.6.2 Drejtimet deficitare dhe pjesëmarrja e femrës	140
6.6.3 Materiali mësimor	142
6.6.4 Kurrikula e Arsimit Profesional	143
6.6.5 Praktika profesionale	143
6.6.6 Këshillimi dhe orientimi në karrierë	144
6.6.7 Autonomia financiare dhe menaxhuese	146
6.6.8 Kapaciteti për arsimim të të rriturve	148

6.6.9	Rritja e ofertës së arsimit postsekondar joterciar	148
6.6.10	Matrica e zbatimit të aktiviteteve 2019	150
6.6.11	Treguesit e performancës	152
6.6.12	Rekomandimet	154
6.7	Arsimi i Lartë dhe Shkenca	157
6.7.1	Stafi dhe studentët në arsimin e lartë	158
6.7.2	Zhvillimi profesional në arsimin e lartë	159
6.7.3	Sigurimi i Cilësisë në arsimin e lartë	160
6.7.4	Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsimin e Lartë	161
6.7.5	Ndërlidhja me tregun e punës	162
6.7.6	Infrastruktura	166
6.7.7	Publikimet shkencore	166
6.7.8	Legjislacioni	168
6.7.9	Performanca dhe formula e financimit	169
6.7.10	Mobiliteti i stafit dhe studentëve	170
6.7.11	Pjesëmarrja në programe ndërkombëtare të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor	171
6.7.12	Matrica e zbatimit të aktiviteteve	172
6.7.13	Treguesit e performancës	174
6.7.14	Rekomandimet	176
<b>7.</b>	<b>Konkluzione dhe Rekomandime</b>	<b>178</b>

# Parathënia

Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021 (PSAK), është dokument pesë-vjeçar, i miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, i cili përcakton rrugëtimin e zhvillimit të sistemit të arsimit, objektivat e qarta në të gjitha nivelet bazuar në mësimin gjatë gjithë jetës, duke konceptuar arsimin si një ndër faktorët e rëndësishëm të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit. PSAK ka në fokus gjithë-përfshirjen në arsim si një mundësi të barabartë për arsimimin e të gjitha grup-moshave të etnive që jetojnë në Republikën e Kosovës, pa dallim. Si një dokument bazë për zhvillimin e sektorit të arsimit në Kosovë, PSAK ofron standarde për një arsimim që i përgjigjet nevojave të mësimdhënies cilësore dhe të nxënësve, zhvillimit profesional të bazuar në kompetenca, si dhe plotësimin e kërkesave të tregut të punës. Ky dokument strategjik përmes shtatë fushave tematike: pjesëmarrja dhe gjithë-përfshirja, menaxhimi i sistemit arsimor, sigurimi i cilësisë, zhvillimi profesional i mësimdhënësve, mësimdhënia dhe të nxënësve, arsimi dhe aftësi profesionale dhe arsimi i të rriturve, si dhe arsimi i lartë, e mbulon tërë sistemin arsimor në Kosovë.

Deri më tani, edhe përkundër hartimit të dokumenteve strategjike të standardizuara, raportet vendore dhe ndërkombëtare e rendisin Kosovën të vendet me cilësi jo të mirë të arsimit, e që pasqyrohet edhe në këtë raport. Me qëllim të matjes së zbatimit të politikave, identifikimit të saktë të gjeturave në zbatimin e objektivave, si dhe adresimin e përgjegjësive, MASH është duke përdorur mekanizmin e vlerësimit të brendshëm si një formë standarde e vlerësimit që bazohet në hulumtim përmes mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave, si dhe pasqyrimin e rezultateve në këtë raport. Si burim i të dhënave janë shfrytëzuar dokumentet e MASH, SMIA-s, ASK-së si dhe raportet vendore dhe ndërkombëtare për qëllim krahasimi. Hulumtimi është kryer nga grupi punues i zyrtarëve të MASH, në kuadër të mandatit të Departamentit për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave dhe Çështjeve Ligjore (DIEKPÇL), dhe është mbështetur nga Qeveria Gjermane dhe Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH në sektorin e arsimit fillor në Kosovë - projekti “Ngritja e Kapaciteteve në Arsimin Fillor – CDDBE”. Rezultatet e vlerësimit do të përdoren si mekanizëm për të ngritur llogaridhënien e komunave dhe shkollave për (mos) progresin e nxënësve.

MASH është i angazhuar dhe i përkushtuar në zbatimin e PSAK-ut si një dokument strategjik që garanton reforma të suksesshme dhe ngritje të cilësisë së mësimin dhe studimit në të gjitha nivelet e arsimit në Kosovë, si dhe përgatitjen e kuadrove për tregun e punës. Andaj, duke vlerësuar se fusha e arsimit është një segment i gjerë dhe kompleks që tejkalon kufijtë e MASH, është i domosdoshëm bashkëpunimi i ngushtë edhe me institucionet tjera vendore që lidhen me fushën e arsimit, si dhe një mbështetje më e theksuar e institucioneve ndërkombëtare.

## **Ramë Likaj- Ministër**

Ministria e Arsimit dhe Shkencës



# Mirënjohje dhe falënderime

## **Koordinatori/Grupi bërthamë**

Ferit Idrizi (kryesues), Alush Istogu, Agim Berdyna, Drita Kadriu, Defrim Gashi, Isni Kryeziu, Murtez Zekolli, Fadile Dyla, Valbona Fetiu-Mjeku, Burim Gashi, Kumrije Gagica

## **Grupi koordinues**

Haki Sfishta, Hanëmsha Aliu-Latifi, Afërdita Kryeziu, Fehmi Zylfiu

## **Grupi editorial**

Alush Istogu, Dëfrim Gashi, Valbona Fetiu-Mjeku, Afërdita Kryeziu, Burim Gashi

## **Vlerësimi dhe monitorimi**

Armend Muja, ekspert i jashtëm

## **Mbështetja organizative**

Hanemsha Latifi, Rrezearta Zhinipotoku-Behluli (GIZ), Lirie Lokaj (GIZ), Fjona Hyseni, Xheneta Bajrami

## **Lektura** Myrvete Morina

## **Kontribuesit**

## **Të dhëna të përgjithshme**

Enver Mekolli, Afërdita Kryeziu, Hazbije Lahi, Shqipe Bruqi

## **Gjithëpërfshirja dhe pjesëmarrja**

Lulavere Behluli, Labreri Luzha, Imrane Ramadani, Nazan Safci, Merita Jonuzi, Nuhi Gashi, Shqipe Bruqi, Emine Krasniqi

## **Menaxhimi i Sistemit Arsimor**

Enver Mekolli, Afërdita Kryeziu, Isuf Gashi, Fehmi Zylfiu, Avni Rexha, Leonora Shala, Elhame Shabani, Naxhije Shala, Naim Demiri, Rina Ponosheci

## **Sigurimi i Cilësisë**

Fatmir Elezi, Imer Preteni, Nezir Cocaj, Nebih Behluli

## **Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve**

Luan Sahitaj, Habibe Buzuku, Osman Beka, Valbona Hadri

## **Mësimdhënia dhe Mësimnxënia**

Feime Llapashtica, Arbër Salihu, Ismet Potera, Shqipe Gashi

## **Arsimi Profesional**

Valbona Fetiu-Mjeku, Veton Alihajdari, Ryve Prekorogja, Fikrije Zymberi, Milot Hasangjekaj, Hazbije Lahu, Agim Krasniqi, Afërdita Jaha

## **Arsimi i Lartë**

Burim Gashi, Avni Gashi, Bekim Samadraxha, Qamile Sinanaj, Muhabere Maliqi, Shpresa Mehmeti, Kumrije Gagica, Yllza Mehmeti, Ardiana Shabaj, Minire Gashi

## Lista e shkurtesave

<b>AAP</b>	Arsimi dhe Aftësimi Profesional
<b>AAAPAR</b>	Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe të Rriturve
<b>AKA</b>	Agjencia e Kosovës për Akreditim
<b>AKK</b>	Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
<b>AL</b>	Arsimi i Lartë
<b>APU</b>	Arsimi Parauniversitar
<b>ARKEP</b>	Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
<b>ASK</b>	Agjencia e Statistikave të Kosovës
<b>ASHPA</b>	Agjencia Shtetërore e Provimeve të Kosovës
<b>BB</b>	Banka Botërore
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>BPV</b>	Bruto Produkti Vendor
<b>DIEKP</b>	Departamenti për Integrim Evropian dhe Kordinim të Politikave
<b>DKA</b>	Drejtoria Komunale për Arsim
<b>EJL</b>	Evropa Juglindore
<b>ENQA</b>	Asociacioni Evropian për Sigurim të Cilësisë në Arsim të Lartë
<b>EQAR</b>	Regjistri Evropian i Sigurimit të Cilësisë
<b>ERA</b>	Agjenda e Reformës Evropiane
<b>ESG</b>	Udhëzimet Standarde Evropiane
<b>ETF</b>	Fondacioni Evropian për Trajnim
<b>FNL</b>	Forumi i Nivelit të Lartë
<b>GIZ</b>	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit
<b>GPS</b>	Grupi Punues Sektorial
<b>IA</b>	Inspektorati i Arsimit
<b>IAL</b>	Institucionet e Arsimit të Lartë
<b>IPA</b>	Instrumenti i Para Aderimit
<b>IPK</b>	Instituti Pedagogjik i Kosovës
<b>ISCED</b>	Standardi Ndërkombëtar për Klasifikim të Arsimit
<b>KASH</b>	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
<b>KEPTSH</b>	Këshilli i Ekspertëve për Programe dhe Tekste Shkollore
<b>KKK</b>	Korniza Kombëtare e Kualifikimeve

<b>KKP</b>	Korniza Kombëtare e Pofesioneve
<b>LFS</b>	Anketa e Fuqisë Punëtore
<b>MASHT</b>	Ministria e Arsimit, Shkences dhe Teknologjisë
<b>MAP</b>	Ministria e Administrates Publike
<b>MCIS</b>	Multi Cluster Indicative Survey
<b>MF</b>	Ministria e Financave
<b>MIE</b>	Ministria e Integritimit Evropian
<b>MSA</b>	Marrëveshja për Stabilizim dhe Asocim
<b>NARIC</b>	Qendra Kombëtare për Njohje dhe Informata
<b>NGPS</b>	Nën Grupi Punues Sektorial
<b>OECD</b>	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
<b>OSBE</b>	Organizata për Sigurimi dhe Bashkëpunim në Evropë
<b>PIA</b>	Plani Individual për Arsim
<b>PISA</b>	Programi për Vlerësim Ndërkombëtar të Nxënësve
<b>PKZMSA</b>	Plani Kombëtar për Zbatim të Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asocim
<b>PMN</b>	Platforma e Menaxhimit të Ndhmës
<b>PSAK</b>	Plani Strategjik i Arsimit të Kosovës
<b>RCC</b>	Këshilli për Bashkëpunim Rajonal
<b>SICI</b>	The Standing International Conference of Inspectorates
<b>SMIA</b>	Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim
<b>SMIAL</b>	Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsimin e Lartë
<b>SKZH</b>	Strategjia e Zhvillimit Kombëtar
<b>SPH</b>	Sistemi për Paralajmërim të Hershëm
<b>SPI</b>	Sistemi i Planifikimit të Integruar
<b>TIK</b>	Teknologjia e Informimit dhe Komunikimit
<b>UA</b>	Udhëzim Administrativ
<b>VjPSH</b>	Vlerësimi i jashtëm i performancës së shkollës
<b>VPM</b>	Vlerësimi i performancës së mësimdhënësve
<b>UNDP</b>	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
<b>ZKM</b>	Zyra e Kryeministrit

# 1. Fushëveprimi dhe Metodologjia

## 1.1 Fushëveprimi

Procesi i vlerësimit është realizuar në kuadër të mandatit të Departamentit për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave (DIEKP) dhe me mbështetje të GIZ. Raporti paraqet një vetëvlerësim të zhvillimeve më të rëndësishme në sektorin e arsimit, të ndihmuar nga të dhëna të standardizuara. Qëllimi i vlerësimit ishte që të shërbejë si (i) instrument i llogaridhënies përmes ofrimit të dhënave për arritjen e rezultateve -struktura menaxhuese ka të dhënat objektive për korrektim të kursit dhe (ii) që të shërbejë si material bazë për hartimin e planit vijues strategjik. Fushëveprimi i procesit të vlerësimit të PSAK, do të përqendrohet në ofrimin e përgjigjeve për disa pyetje: (a) cila ka qenë performanca e MASHT dhe akterëve tjerë në krahasim me qëllimet dhe caqet e vendosura në Planin fillestar; (b) sa janë relevante caqet dhe qëllimet e vendosura për kontekstin aktual dhe (c) sa është përdorur PSAK si platformë për avancim të objektivave kombëtare në sferën e arsimit.

Qasja e adoptuar në proces të vlerësimit përfshin vlerësim të realizimit të aktiviteteve, rezultateve dhe objektivave strategjike. Në kuadër të vlerësimit të përmbushjes së aktiviteteve përfshihet dokumenti i realizimit të veprimeve të listuara në Planin Vjetor të Veprimit të MASHT. Si pjesë e qasjes konceptuale është edhe vlerësimi i ndikimit të aktiviteteve në objektivat e synuara strategjike. Baza e vlerësimit të ndikimit mbështetet në Kornizën e Treguesve të Ndikimit dhe vlerësimit të hendekut ndërmjet rezultateve të synuara dhe gjendjes ekzistuese. Në kuadër të qasjes së vlerësimit janë inkorporuar edhe rekomandimet dhe veprimet korrektuese për të ndryshuar në shtegun e veprimit, rezultateve dhe objektivave.

Ka një kërkesë në rritje për efektshmëri, qasje të barabartë dhe cilësisë në arsim si parakushte për të tejkaluar sfida shoqërore dhe ekonomike. Së dyti, trendi i decentralizimit të sistemit arsimor ka kushtëzuar zhvillimin e mekanizmave të vlerësimit – MASHT nuk është zbatues i drejtpërdrejtë dhe përgjegjës primar në arsimin parauniversitar dhe atë universitar, mirëpo është mandatuar të ofroj politika, standarde dhe llogaridhënie në sistemin arsimor. Rezultatet e sistemit arsimor po përdoren si mekanizëm për të ngritur llogaridhënien e komunave, shkollave dhe mësimdhënësve për (mos) progresin e nxënësve. Së treti, sistemi arsimor në Kosovë është komponent i rëndësishëm i strategjive kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare dhe raportimi i arritjeve dhe sfidave drejt shtegut të zbatimit të këtyre strategjive po prioritetizon ndërtimin e kapaciteteve për vlerësim. Sistemet arsimore maten mbi bazën e performancës së tyre, në raport me indikatorë të rëndësishëm ndërkombëtar të monitoruar nga BE (Eurostat), OKB (UNESCO) dhe OECD. Ndërlidhja e treguesve arsimor kombëtar me ata ndërkombëtar është praktikë e zakonshme e sistemeve bashkëkohore arsimore dhe krahasimi i tyre bëhet si shtytës për reformim të praktikave të sistemit.

Realizimi i një vlerësimi gjithëpërfshirës është proces mjaft sfidues dhe kushtëzohet nga disa zhvillime. Realizimi i një vlerësimi gjithëpërfshirës të sistemit arsimor kërkon kapacitete dhe resurse të përshtatshme për të mbuluar këtë proces. Gjatë rrjedhës së planit strategjik kemi zhvillime paralele legjislativë dhe institucionale, që mund të kenë ndikuar në aftësinë e akterëve për t'u akomoduar me procesin. Së treti, praktika e vlerësimit të jashtëm duhet të mbështetet në një metodologji gjithëpërfshirëse që mbulon jo vetëm vlerësimin e jashtëm të sistemit arsimor, por edhe vlerësimin e jashtëm të nxënësve, mësimdhënësve dhe shkollave. Së fundmi, procesi i vlerësimit është relevant në një kontekst arsimor, ku nxënësi është në qendër të vëmendjes dhe ku sistemi arsimor është i ndërlidhur ngushtë me qëllimet ekonomike dhe shoqërore.

## 1.2 Metodologjia

Gjatë procesit të vlerësimit Ekipi për Vlerësim të PSAK ka diskutuar me një numër të madh të palëve të interesuara: zyrtarë të MASHT, zyrtarë komunal të arsimit, agjenci të ndërlidhura me MASHT, përfaqësues të institucioneve universitare, përfaqësues të shkollave, mësimdhënës, organizata të shoqërisë civile, hulumtues shkencor dhe partnerë zhvillimor. Për të ofruar një përfshirje më të gjerë të palëve të interesit, Ekipi në dhjetor 2019 ka organizuar Punëtori Konsultative mbi Rishikimin e PSAK 2019. Në janar 2020 janë organizuar tryeza tematike rreth edukimit parashkollor, arsimit parauniversitar, arsimit profesional, arsimit të të rriturve, arsimit të lartë dhe shkencës, zhvillimit profesional të mësimdhënësve dhe donatorët. Gjatë procesit është diskutuar dhe intervistuar një numër i konsiderueshëm i zyrtarëve me përgjegjësi të drejtpërdrejtë në zbatimin e objektivave. Së fundmi, procesi i vlerësimit mbështetet edhe në vlerësimet e përgjithshme dhe tematike të realizuara nga institucione të tjera të jashtme. Ekipi ka konsultuar një seri të dokumenteve strategjike, dokumenteve analitike, vlerësimeve të jashtme dhe raporteve periodike të ndërlidhura me sistemin arsimor në Kosovë.

Triangulimi i të dhënave 2019

1	Korniza konceptuale/Shqyrtimi dokumenteve	Qasja tërësektoriale
2	Metoda sasiore	
2.1	Të dhënat statike	SMIA/SMIAL/ASK/MAP
2.2	Të dhënat dinamike	LFS/MCIS/MCC LFS/OECD PISA Pyetsori: Kontributet departamentale
3	Metoda cilësore	
3.1	Rastet e studimit	Krahasimore: Kosovo, rajoni, BE, Bota
3.2	Grupet punuese – Fokus Grupet	Kontributet nga grupet punuese dhe akterët kryesor
3.3	Intervistat e gjysëm strukturuara	Intervistat me akterë kyç

Rezultatet dhe konkluzionet e ofruara mbështeten në metoda sasiore dhe metoda cilësore. Treguesit sasior janë harmonizuar me Kornizën e Treguesve të MASHT dhe në përputhje me treguesit ndërkombëtar të sferës së arsimit. Trendet dhe lëvizjet në analizat tematike janë nxjerrë duke u mbështetur në të dhënat e SMIA/SMIAL. Për të mbuluar mungesën e të dhënave në nënsektor të caktuar, janë përdorur edhe të dhënat e ASK. Prosesi i vlerësimit ka hasur disa vështirësi metodologjike. Fillimisht, objektivat dhe caqet ishin vendosur me të dhëna jo të plota – andaj disa nga caqet e vendosura ishin arritur që në kohën e miratimit të planit. Së dyti, korniza e vlerësimit të performancës dhe indikatorët nuk ishin elaboruar në mënyrë adekuate. Së treti, parametrat e matjes së progresit në fushat tematike ndryshojnë varësisht se çfarë kornize e referencës përdoret dhe së katërti, është e evidente që në lexim të parë që ka shumë zhvillime tematike të cilat nuk përfshihen në caqet aktuale.

Indekset e performancës nënsektoriale janë nxjerrë duke përlogaritur shkallën e zbatimit të aktiviteteve. Shkalla e zbatimit të aktiviteteve është standardizuar sipas formulës së përlogaritjes sepse disa nga aktivitetet maten me shifra financiare, disa maten me numra e disa tjerë me % përqindje. Për këtë arsye ishte e nevojshme që ata të standardizohen. Agregimi është bërë duke peshuar edhe ndryshimet në numër të aktiviteteve përmes mesatares së ponderuar. Në kuadër të raportit janë integruar (a) Korniza e Treguesve dhe (b) Matrica e zbatimit e përshkallëzuar sipas aktiviteteve (0-5). Për të përshkallëzuar aktivitetet që nuk kanë parametra matës është përdorur korniza e kritereve të përshkallëzimit.

## INDEKSI I PERFORMANCËS ARSIMORE 2019

1	Indeksi nënsektorial	Gjithëpërfshirja, menaxhimi, cilësia, mësimdhënia, zhvillimi profesional, arsimit profesional, arsimit i lartë	Mesatare e Ponderuar e Nënsektorëve
2	Përshkallëzimi/standardizimi	Përshkallëzimi i performancës	1 - 5
3	Standardizimi i treguesve	Standardizimi i përqindjeve, numrave, decimaleve	$I_i = (D_{ij} - \bar{D}_i) / \sigma_i$
4	Treguesit nënsektorial	Treguesit e Aktiviteteve/Treguesit e Rezultateve/Treguesit e ndikimit	Korniza e Treguesve
5	Agregimi	Metoda e Komponenteve të Pavërejtura (UCM) / Metode të ponderuar	Matrica e Zbatimit

Vlerësimi është proces kompleks, andaj qasja në proces duhet të mbështetet në disa perspektiva dhe modalitete të matjes së rezultateve. Treguesit sasior janë formuluar përmes **indeksit të zbatimit** i cili mbështetet në rankimin e performancës së nënsektorëve të PSAK nga 0-5. Vlerësimet e nënsektorëve duhet inkorporuar edhe në numrin e aktiviteteve që janë paraparë. Për këtë arsye është e nevojshme që të përdoret mesatare e ponderuar që përfshin edhe dallimet në ngarkesë të aktiviteteve. Kriteret për përcaktim të rangut të zbatimit janë si më poshtë:

## KORNIZA E VLERËSIMIT

Vlerësimi	Kriteret	Shkalla	%
Aspak progres	<ul style="list-style-type: none"> <li>Nuk ekzistojnë ligjet primare, udhëzimet, rregullat, strategjitë dhe politikat.</li> <li>Kemi mungesë të hapave për zbatim të ligjeve dhe politikave.</li> <li>Nuk janë alokuar burime për menaxhim, burime njerëzore dhe financiare të nevojshme për zbatim të ligjeve, rregullave, udhëzimeve, strategjive dhe politikave</li> </ul>	1	0-19%
Pak progres	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ekzistojnë ligjet primare, rregullat, udhëzimet, strategjitë dhe politikat</li> <li>Ka vetëm përpjekje të kufizuara për zbatim të praktikave të mira. Mirëpo zbatimi nuk është fenomen i zakonshëm.</li> <li>Nuk janë alokuar burime financiare apo janë të pamjaftueshme</li> </ul>	2	20-39%
Në progres	<ul style="list-style-type: none"> <li>Janë miratuar ligjet dhe politika në kuadër të sektorit apo objektivit.</li> <li>Ekzistojnë praktika të mira dhe legjislacioni ka filluar të zbatohet në dy vitet e fundit. Mirëpo ende ka ngecje në zbatim të praktikave të caktuara, në legjislacion dhe praktika.</li> <li>Janë alokuar mjete modeste financiare për zbatim të pjesëve të caktuara të legjislacionit dhe politikave</li> </ul>	3	40-59%
Progres i ndjeshëm	<ul style="list-style-type: none"> <li>Të gjitha ligjet, udhëzimet dhe politikat janë miratuar.</li> <li>Kemi një praktikë të zhvilluar në zbatim të legjislacionit dhe udhëzimeve. Ligjet janë zbatuar në mënyrë konsistente në katër vitet e fundit.</li> <li>Kapacitetet institucionale janë në funksion mirëpo me shkurtesa financiare.</li> </ul>	4	60-79%
Përmbushur tërësisht	<ul style="list-style-type: none"> <li>Janë miratuar të gjitha ligjet dhe udhëzimet.</li> <li>Kemi zbatim konsistent të legjislacionit në pesë vitet e fundit.</li> <li>Zbatimi është normë dhe pengesat mund të jenë shumë të rralla apo të izoluar.</li> <li>Kapacitetet institucionale janë plotësisht funksionale dhe financimi është adekuat për rrjedhën e zbatimit të legjislacionit dhe praktikave.</li> </ul>	5	80-100%

## 2. Analiza e Mjedisit Arsimor

### 2.1 Zhvillimet politike

PSAK 2017-2021, ka si qëllim të përcaktojë kahjet e zhvillimit të sistemit të arsimit në periudhën 2017-2021, në mënyrë që arsimi të jetë në funksion të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror. Plani Strategjik dhe Plani i Veprimit është unisuar me Planin Vjetor të Punës së MASHT. Plani në masë të madhe paraqet instrumentin kryesor sektorial të vizionit, objektivave, zbatimit, performancës dhe rishikimit të prioritetëve. Strategjia inkorporon elemente të rëndësishme të strategjive nënsektoriale, integritimit evropian dhe dokumente tjera të rëndësishme që burojnë nga Ministritë e linjës.

PSAK 2017-2021, përqendrohet në disa objektiva strategjike : (1) Rritja e përfshirjes dhe mundësitë e barabarta për zhvillim, aftësim dhe arsimim të çdo individi në arsimin parauniversitar, (2) Menaxhimi cilësor dhe efikas i sistemit të arsimit, i bazuar në transparencë dhe në llogaridhënie, (3) Zhvillimi i një sistemi funksional për sigurimin e cilësisë, në përputhje me standardet ndërkombëtare, (4) Ngritja e cilësisë së mësimdhënies përmes sistemit efektiv dhe të qëndrueshëm për përgatitjen dhe zhvillimin profesional të mësimdhënësve, (5) Avancimi i të nxënësve përmes mësimdhënies cilësore, duke zbatuar kurrikulën e bazuar në kompetenca dhe duke shfrytëzuar resurse mësimore të cilësisë së lartë, (6) Harmonizimi i arsimit dhe aftësimin profesional me kërkesat e tregut të punës në vend dhe më gjerë dhe krijimi i një sistemi të hapur të arsimit për të rriturit, (7) Ngritja e cilësisë dhe konkurrueshmërisë së arsimit të lartë përmes nxitjes së përsosmërisë në mësimdhënie, kërkimit shkencor, krijimtarisë artistike, inovacionit dhe ndërkombëtarizimit.

Gjatë përpilimit të PSAK 2017-2021, ishin inkorporuar masat dhe prioritetet që dalin nga disa dokumente strategjike duke përfshirë Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Programin Qeveritar. Sidoqoftë, pas miratimit të PSAK janë hartuar dhe miratuar edhe dokumente tjera të rëndësishme që ndikojnë në sektorin e arsimit: *Strategjia për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave* në Kosovë, Strategjia për Modernizimin e Administratës Publike 2016-2018, Strategjia për Rregullim të Mirë 2017-2018 dhe Strategjia për Reformën e Menaxhimit të Financave Publike. Nëpërmjet zbatimit të Strategjisë për Përmirësim të Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave, Qeveria e Republikës së Kosovës synon që të përmirësoj sistemin e planifikimit, duke evituar fragmentimet dhe dyfishimet ndërmjet proceseve qendrore të planifikimit të politikave dhe atyre financiare. Strategjia përqendrohet në themelim të kornizës institucionale për Sistemin e Planifikimit të Integruar (SPI). Në kuadër të Ministrive të Linjës (e.g MASHT) parashihet themelimi i Komisionit për Menaxhim Strategjik të kryesuar nga Ministri i MASHT dhe koordinuar nga Sekretari. Strategjia përqendrohet në disa objektiva strategjike: (1) Përmirësimi i mëtejshëm i kornizës strategjike, duke përmirësuar ndërlidhjen e dokumenteve strategjike, nëpërmjet koordinimit dhe vendimmarrjes më të mirë.

Qeveria ka miratuar **Programin Qeveritar 2020-2023**. Në kuadër të prioritetit të arsimit dhe shkencës, Qeveria përkushtohet se do të bëjë shumë më tepër, që sistemi arsimor të përgatisë nxënës dhe studentë të aftë për jetën dhe tregun e punës. Qeveria e konsideron prioritet të rëndësishëm riorganizimin e ministrisë, në mënyrë që të rrisë efektshmërinë e ministrisë, si dhe koordinimin e donatorëve në fushën e arsimit. Qeveria do ta ketë prioritet edhe departiakëzimin e institucioneve arsimore. Po ashtu, do të angazhohet në përmirësimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës shkollore, do të bëjë vlerësimin e kurrikulave, si dhe do të hartojë politika për riorganizimin e rrjetit të shkollave në bashkëpunim me komunat.



Gjithashtu, Qeveria përushohet se do të rrisë buxhetin për furnizim me libra, rritja substanciale e përfshirjes së fëmijëve në edukimin parashkollor, në rritjen e cilësisë së mësimdhënies, pajisja me tekste shkollore dhe materiale të tjera mësimore, si dhe furnizimi i shkollave me pajisje adekuate të TIK-ut e mjete të tjera mësimore. Përveç kësaj, Qeveria synon të ndërtoj një sistem efektiv të menaxhimit të shkollës, që i kontribuon krijimit të mjediseve të përshtatshme për mësim. Për të adresuar mospërputhjen, ndërmjet arsimit dhe kërkesave të tregut të punës, posaçërisht të arsimit dhe aftësisë profesionale, Qeveria do të fokusohet në ringjalljen dhe modernizimin e shkollave profesionale me mjete konkretizuese, kurrikula e tekste mësimore adekuate. Qeveria do të rishikojë Ligjin për Arsimin e Lartë, për ta përshtatur atë me nevojat e vendit, si dhe do të sigurohet financim i qëndrueshëm nga burimet shtetërore për institucionet publike, për të mundësuar pavarësi institucionale

Me hyrjen në fuqi të ***Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA)*** ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian më 1 prill 2016, *Programi i parë Kombëtar për Zbatim (PKZMSA)* ishte miratuar nga Qeveria dhe Kuvendi në mars 2016. Ministria e Integritimit Evropian (MIE) është mandatuar si organ kryesor për monitorimin e zbatimit të MSA. Departamentet e Integritimit Evropian dhe Koordinimit të Politikave (DIEKP) në Ministrinë respektive janë përgjegjëse për të ndihmuar në transpozimin dhe koordinimin e politikave që rezultojnë nga MSA. Kontributet kryesore të MASHT ndërlidhen me Kapitullin 3 (E Drejta e Themelimit të Kompanive dhe Liria e Ofrimit të Shërbimeve) Kapitullin 25 (Shkenca dhe kërkimet shkencore) dhe Kapitullin 26 (Arsimi dhe Kultura). Në përgjithësi, arsimi është kompetencë e shteteve dhe nuk ndikohen nga legjislacioni i domosdoshëm evropian. Sidoqoftë, në kuadër të procesit të stabilizim asociimit, vendet kërkohet që të koordinohen në zbatim të Agjendës, Arsimit dhe Trajnimit 2020.

***Agjenda Arsimit 2020*** përfshin katër prioritetet themelore: adresimi i braktisjes së hershme të shkollimit, përmirësimi i përfshirjes dhe cilësisë së arsimit të lartë, përmirësimi i shkathhtësive për punësim përmes arsimit profesional dhe rritja e pjesëmarrjes në arsimin gjatë gjithë jetës. Në kuadër të reformave në adresim të braktisjes së hershme të shkollimit rekomandohen masa si në vijim: adresim të braktisjes së shkollimit tek grupet e ndjeshme shoqërore (RAE) dhe nxënësit të kategorive të ndjeshme ekonomike, themelimi i mekanizmave për monitorim të braktisjes, përmirësim të orientimit në karrierë, mësim kompensues apo shanse të dyta për shkollim, përkrahje të shkollave dhe komunave për zbatim të masave preventive, përmirësim të dritareve të tranzicionit ndërmjet niveleve të shkollimit, përmirësim të relevancës së shkollimit përmes ofrimit të profileve të kërkuara në treg dhe themelim të mekanizmave për përfshirjen e hisedarëve (kompanive, prindërve, komunitetit).

Në kuadër të reformave në adresim të prioritetit përmirësim të arritshmërisë dhe cilësisë së arsimit të lartë, vendet rekomandohet që të përmirësojnë pjesëmarrjen e grupeve të margjinalizuara, përmirësim të shkallës së diplomimit, ofrim të rrugëve alternative për kyçe në arsim të lartë, përmirësim të relevancës së arsimit të lartë përmes profilizimit të programeve sipas kërkesave në treg të punës, përmirësim të orientimit në karrierë për studentët, ofrim të stimujve financiar për kompletim të studimeve brenda afatit. Me qëllim të përmirësimit të relevancës së arsimit të lartë për treg të punës, rekomandohet që të ketë studime mbi parashikimin e shkathhtësive për treg të punës dhe ofrim të financimit publik prioritar për këto fusha.

Në kuadër të reformave të propozuara për të adresuar prioritetin e përmirësimit të arsimit profesional me qëllim të rritjes së punësimit tek të rinjtë, rekomandohet të shqyrtohen skema për garantim të internshipit, garantim të punësimit apo garantim të financimit. Në shumë raste shtetet e BE-së, zbatojnë sistemin dual të shkollimit në kuadër të arsimit profesional. Shumë shtete zbatojnë edhe kërkesa të veçanta për ndërmarrësinë në formë të kushtëzimit të lëndës në kuadër të kurrikulës, ofrimit të trajnimeve shtesë në ndërmarrësi dhe ofrim të fondeve për ndërmarrësi tek nxënësit e arsimit profesional. Tek masat për adresim të prioritetit, përmirësim të arsimit tek të rriturit, rekomandohet adoptimi i strategjisë për mësim gjatë gjithë jetës, ofrimi i programeve fleksibile (mësim në distancë, mësim pasdite), njohja e mësimit paraprak formal dhe informal.



Një pjesë e konsiderueshme e rekomandimeve ndërlidhen me inkurajim të mësimit gjatë gjithë jetës përmes përmirësimit të kuadrit ligjor, institucional dhe financiar për stimulim të mësimit gjatë gjithë jetës.

**Agjenda e Reformës Evropiane** është e ndërlidhur me Programin për Reforma Ekonomike. Prioritetet kryesore përcaktohen në baza vjetore në dialogun Kosovë-BE. Monitorimi dhe vlerësimi bëhet dy herë në vit. Prioritetet tjera pasojnë pas përmbushjes së prioriteteve të përcaktuara më herët. MASHT ka kontribuar në prioritetin e tretë të ERA - Arsimi dhe punësimi. Kontributi ndërlidhet me tri masa kryesore: adoptimi i legjislacionit për reforma në arsim (3.4), përmirësim të cilësisë në arsim (3.5) përmes: (a) rritje të përfshirjes në arsimin parashkollor, zbatim të kurrikulës, teksteve dhe vlerësimit të jashtëm, zhvillim të mekanizmave për cilësi, përmirësoj cilësinë në arsim të lartë, ndërlidhje ndërmjet arsimit të lartë dhe punësimit dhe (3.6) përmirësoj cilësinë e arsimit profesional. Vlerësimi i përmbushjes bazohet në veprime konkrete mujore, tremujore, gjastëmujore dhe vjetore dhe të bazuara në indikator.

Në vitin 2019, MASHT ka ofruar edhe inputet për **Programin për Reforma Ekonomike 2019-2021**. Programi është instrument i vlerësimit dhe mbështetjes së përmbushjes së kriterëve ekonomike për vendet e Ballkanit Perëndimor. Mekanizmi është inspiruar mbi bazën e praktikës së brendshme të BE-së, Semestri Evropian. Qëllimi kryesor është që të mbështes vendet që aspirojnë integrimin evropian të plotësojnë kriteret ekonomike. Vendet e Ballkanit Perëndimor kanë filluar implementimin në vitin 2015. Qeveria e Kosovës ka draftuar Planin e parë për Reforma Ekonomike në vitin 2016. Programi për Reformë Ekonomike 2019-2021, liston masat që marrin Ministrinë e linjës. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, kontribuon në elementet e krijimit të burimeve njerëzore (arsimimit), punësimit, shkencës dhe zhvillimit. Kontributet e MASHT janë administruar përmes Departamentit për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave. MASHT ka kontribuar në diagnostifikim të gjendjes aktuale, identifikim të pengesave strukturore dhe propozim të masave të përmirësimit. Në kuadër të trajtimit të sfidave, MASHT ka propozuar disa masa në kuadër të dy shtyllave: arsimi dhe shkathhtësitë dhe shkencë dhe inovacioni.

Si pjesë e bashkërendimit ndërsektorial dhe ndërshtetëror, MASHT ka kontribuar me raporte edhe në dokumentet strategjike Vizioni për Shkathësi 2020 dhe **Strategjia Evropa Juglindore 2020**. Vizioni është miratuar nga Qeveria e Kosovës në vitin 2014. Për Strategjinë e zhvilluar me mbështetje të ETF/Komisionit Evropian, është ndjek një metodologji e inkorporuar për zhvillim të burimeve njerëzore kombëtare. Metodologjia e strategjisë është mbështetur në konceptin e IPA II (2014-2020) që synon promovimin e një kornize të integruar për zhvillim të shkathhtësive në nivel vendi me qëllim të avancimit të konkurrueshmërisë kombëtare. Strategjia kontribuon në Strategjinë e Evropës Juglindore 2020 dhe është e dizajnuar për të transpozuar Strategjinë e EU 2020. Kjo strategji është zhvilluar nën patronatin e Zyrës së Kryeministrit. Sidoqoftë, MASHT ka kontribuar dhe zbaton elementet thelbësore të saj që ndërlidhen me arsimin profesional, arsimin e lartë, arsimin e të rriturve dhe përfshirjes sociale. MASHT ofron raportimet vjetore në kuadër të Procesit të Torinos. Instituti Pedagogjik është mandatuar për të raportuar në baza vjetore.

Strategjia, Evropa Juglindore 2020, është lansuar në vitin 2011 dhe është modeluar sipas Strategjisë Bashkimi Evropian 2020. Strategjia është hartuar nën kornizën e Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (RCC) në Evropën Juglindore. Iniciativa është marrë në bashkëpunim me Qeveritë e vendeve të EJL. Qëllimi kryesor i strategjisë është përmirësimi i konkurrueshmërisë së ekonomive të vendeve të EJL dhe përmirësimi i bashkëpunimit rajonal. Strategjia mbështetet në disa shtylla të ndërlidhura: Rritje e Integruar, Rritje e Mençur, Rritje e Qëndrueshme, Rritje Gjithëpërfshirëse dhe Qeverisje për Rritje. Në kuadër të Shtyllës II (Rritje e Mençur) përfshihen komponenta e Arsimit dhe Kompetencave dhe Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit. Strategjia monitorohet në baza vjetore. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë është udhëheqës në proces. MASHT raporton në baza vjetore përmes Kornizës së Treguesve të Strategjisë EJL 2020.

## 2.2 Zhvillimet ekonomike

Kosova ka një rritje solide ekonomike viteve të fundit – mesatarisht 4% e BPV. Megjithatë, modeli aktual i rritjes së BPV-së mbështetet kryesisht në remitencat dhe ndihmën e huaj. Kjo varësi, së bashku me mangësitë strukturore të ekonomisë së Kosovës, vë presion mbi konkurrueshmërinë dhe produktivitetin, duke kufizuar krijimin e vendeve të punës dhe zgjerimin e biznesit. Rritja e aktivitetit ekonomik në periudhën e fundit është gjeneruar kryesisht nga rritja e aktivitetit ekonomik në sektorin e industrisë nxjerrëse, sektorin e ndërtimitarisë, aktiviteteteve financiare dhe teknologjisë informative.<sup>1</sup> Raporti “MCC Kosovo Constraints Analysis (Analiza e pengesave të Kosovës - MCC)” (2017) shqyrton diversitetin e produkteve të Kosovës. Raporti arrin në përfundim se “struktura ekzistuese prodhuese e Kosovës është mjaft komplekse dhe mund të mbështesë rritjen pa ndryshime rrënjësore në përbërjen e produktit. Shërbimet e eksportueshme, të tilla si teknologjia e informacionit, duket se kanë më shumë gjasa të shtyjnë përpara kompleksitetin e vendit.

Kosova po vuan nga deficitit tregtar për shkak të një baze shumë të dobët të eksportit. Në sektorin e mallrave, bilanci i tregtisë së jashtme është mjaft negativ nga viti në vit. Shifrat e përgjithshme japin një pasqyrë të qartë të bilancit tregtar të Kosovës, i cili ka një deficit shumë të lartë tregtar, që është mbi 2.5 miliardë euro. Shkëmbimet tregtare në mallra arritën në 3.4 miliardë euro, gjë që rezultoi në një rritje prej 325 milionë euro gjatë vitit të kaluar. Mallrat e eksportuara arritën vlerën prej 378 milionë euro, me rritje prej 22%. Pothuajse gjysma e eksporteve të Kosovës janë metale bazë. Produktet minerare përbëjnë 15%. Pjesa e mbetur prej 35% përfshin ushqimin e përpunuar, plastikën dhe gomën, makineritë, aparaturat, materialet elektrike dhe tekstillin. Më shumë se 70% e eksporteve të Kosovës shkojnë në vendet anëtare të BE-së dhe të CEFTA-së.<sup>2</sup>

Skema e ndërmarrjeve prodhuese në Kosovës dominohet nga ndërmarrjet e vogla, ndërsa pjesa tjetër është e ndarë ndërmjet ndërmarrjeve të vogla, si dhe ndërmarrjeve të mesme dhe të mëdha. Praktikisht, të gjitha industritë janë biznese mikro dhe të vogla. Sektori prodhues në Kosovë vazhdon të përballet me një nivel të ulët të konkurrencës së jashtme për shkak të faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm. Pjesëmarrja e sektorit prodhues në BPV është e krahasueshme me disa vende në rajon, por duke marrë parasysh nevojat e zhvillimit dhe duke përfshirë nevojën për të krijuar vende pune, kjo konsiderohet të jetë e pamjaftueshme. Të dhënat më të fundit tregojnë se sektori me numrin më të madh të punëtorëve dhe me qarkullimin më të lartë në vitin 2016 mbetet industria ushqimore, e ndjekur nga sektori minerar jo-metale (ASK, 2018).

Aktiviteti i startup-eve në Kosovë është në nivel të ulët krahasuar me mesataren për Evropën. Të dhënat e Monitorit Global të Ndërmarrësisë (GEM) tregojnë se aktiviteti total i ndërmarrësisë në fazë të hershme (TEA) dhe treguesit e shkallës së qëllimeve të ndërmarrësisë janë sa gjysma e atyre në Evropë gjë që tregon se shumë më pak njerëz të grupmoshave 18-64 janë ose të përfshirë në fillimin ose fazën e hershme të ndërmarrësisë ose synojnë të hapin biznese. Shërbimet e inkubimit të bizneseve luajnë një rol të rëndësishëm në inkurajimin e startup-eve dhe ndonëse kanë marrë pak vëmendje në të kaluarën me krijimin e inkubatorëve të financuar publikisht në një numër komunash, përkrahja publike për inkubimin e biznesit nuk ka qenë e suksesshme. Përveç ofrimit të hapësirës për biznesin, nuk ka pasur ofrim të duhur të shërbimeve siç janë mentorimi, trajnimi dhe shërbimet tjera të mbështetjes së bizneseve dhe mblesëria (matchmaking).<sup>3</sup>

Mbi 80% e grave janë joaktive në tregun e punës dhe vetëm 10% e bizneseve aktive janë në pronësi të femrave, që është rreth një e treta e përqindjes në krahasim me BE. Gratë përballen me pengesa të shumta në biznes, ndër to, respektimi i kulturës dhe traditave, shqetësimet e biznesit dhe të familjes, qasja në financa, trajnimi, rrjetëzimi me bizneset etj. Mbyllja e boshllëkut gjinor në sektorin privat tanimë po bëhet e domosdoshme. Nëse mbyllet ky boshllëk, numri total i sipërmarrësve do të rritet, duke rezultuar në më

<sup>1</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës, Llogaritë kombëtare dhe qeveritare

<sup>2</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës, Tregtia e Jashtme

<sup>3</sup> Global Entrepreneurship Monitor, Kosovo Country Profile, 2018

shumë punësim dhe produktivitet dhe duke pasur një ndikim pozitiv në rritjen ekonomike. Ajo që është më e rëndësishme, gratë aktive në sektorin privat do të shtojnë diversitetin në spektrin e zërave në zhvillimin e produkteve, hulumtim dhe ide përparimtare.

Prodhimi në shkallë të vogël dhe mungesa e investimeve në teknologjitë moderne ndikojnë në produktivitet. Një krahasim i produktiviteteve të industrive në Kosovë me industritë përkatëse në 28 shtete të BE-së shfaq dallime të konsiderueshme midis produktivitetit të ndërmarrjeve në Kosovë dhe atyre në BE. NVM-të e Kosovës duhet të bëhen më inovative në kuptimin e gjerë të fjalës në mënyrë që të konkurrojnë me sukses në tregjet ndërkombëtare, duke përfshirë investimet në procese dhe teknologji të reja, zhvillimin e llojeve të reja të produkteve dhe adoptimin e qasjeve të reja në tregtim dhe shpërndarje. Baza e dobët akademike dhe institucionale për hulumtim dhe zhvillim (R&D) zvogëlon potencialin për inovacion pasi NVM-të janë të sfiduara në gjetjen e ekspertizës. Indeksi i Monitorit Global të Ndërmarrësisë për transferimin e R&D tregon se Kosova qëndron shumë dobët në këtë aspekt. Inovacioni gjithashtu pengohet si rezultat i mungesës së koordinimit dhe bashkëpunimit midis sektorit privat dhe stafit akademik në fushën e R&D. Ka pak stimuj për t'u angazhuar në mekanizma të mençur që mund të inkurajojnë këtë lloj bashkëpunimi, siç janë grupet industriale.

Vlerësimi i MCC-së për Barrierat, vlerësoi normat e kthimit në arsim në Kosovë dhe erdhi në përfundim se ato janë në përputhje me hipotezën që thotë se cilësia e ulët e arsimit është pengesa që kushtëzon rritjen ekonomike. Kjo tregon që problemi i hendekut të shkathtësive lidhet me nivelet e pjesëmarrjes në arsim, me kompetenca dhe shkathtësi specifike siç janë gjuhët e huaja, shkathtësitë kompjuterike ose të ashtuquajturat shkathtësitë e buta dhe me cilësinë e përgjithshme të arsimit.


Mjedisi i të bërit biznes është përmirësuar ndjeshëm, por ende mbesin sfida. Raporti i Bankës Botërore i vitit 2018-2019 për Të Bërit Biznes, vlerësoi Kosovën si një nga 10 ekonomitë me përmirësimin më të dukshëm në mbarë botën. Që nga viti 2014, renditja e përgjithshme e Kosovës është përmirësuar nga pozita e 86-të në pozitën e 40-të. Progresi më i madh është arritur në fushat e startup-ëve, të marrjes së kredive, të tregtimit ndërkufitar dhe atë të zgjidhjes së insolvensës. Në këtë drejtim, përveç treguesve të raportit të Bankës Botërore të listuar në listën e mëposhtme, çështjet e tjera mbeten po aq sfiduese: adresimi i çështjes së rregullimit të procedurave ligjore të falimentimit të bizneseve, lëshimi i lejeve të ndërtimit në nivel lokal, funksionalizmi i plotë dhe aftësitë e qendrave të shërbimit One Stop Shop, çështja e regjistrimit të pasurisë në regjistrat kadastralë.

Për më tepër, Qeveria e Kosovës ka miratuar tashmë dy ligje specifike për të tërhequr investimet e huaja direkte. Këto ligje përfshijnë: Ligjin për investimet e huaja dhe Ligjin për investimet strategjike në Republikën e Kosovës. IHD-të, janë orientuar kryesisht drejt pasurive të paluajtshme, shërbimeve financiare dhe industrisë. Sidoqoftë, gjatë viteve të fundit vërehet një rritje e konsiderueshme në ndërtimtari, si edhe në sektorin e transportit dhe telekomunikacionit. Kosova po përballet gjithashtu me sfida të natyrës procedurale dhe ligjore. Sa i përket fushës së industrisë, ajo vazhdon të përballet me një nivel të ulët të zhvillimit teknologjik, me njohuritë ('know how') dhe me humbjen e tregjeve. Qeveria ende nuk është në gjendje të ofrojë stimulim të mjaftueshëm për investitorët, startup-et dhe bizneset ekzistuese. Në vendet tjera të rajonit, investitorëve u ofrohen subvencione për investime deri në 50% të financimit dhe u ofrohen lirime tatimore deri në 10 vite. Ekziston edhe mungesa e fuqisë profesionale dhe të kualifikuar punëtore, për kërkesat specifike të tregut të punës.

Arsimi është parakusht themelor për rritje ekonomike dhe përmirësim të standardit të jetesës në ekonominë bashkëkohore. Përpjekja e Kosovës në arritjen e këtyre qëllimeve domosdoshmërisht varet nga shkalla e produktivitetit të fuqisë punëtore. Cilësia, shkalla e përfshirjes dhe numri i viteve të shkollimit, jo vetëm që kanë ndikim të pashmangshëm në përmirësimin e kapitalit njerëzor dhe krijimit të parakushteve për zhvillim


social dhe ekonomik, mirëpo paraqet edhe të hyra “input” esencial për të përmirësuar shanset e punësimit. Fuqia punëtore në vitin 2018 rreth 130,000 individ me shkollim universitar. Sipas përlogaritjes së përafërt të anketës së MCC LFS, në vitin 2018, në Kosovë kishte rreth 2000 persona shumë të kualifikuar me gradën e doktoratës.

### Shkalla e papunësisë (Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2012-2019)



Shkalla e papunësisë ende mbetet e lartë, të dhënat tregojnë se niveli i ulët i edukimit dhe arritshmërisë zbeh shanset e punësimit. Shkalla e papunësisë është e ndërlidhur ngushtë me nivelin arsimor. Shkalla më e ulët e papunësisë është tek të arsimuarit me edukim terciar (21%) dhe ata me arsim profesional (25%). Shkalla e papunësisë tek grupet tjera është mbi mesataren kombëtare. Rreth 49.4 e 5 personave pa shkollim janë të papunë (ASK, 2019). Promovimi i shkollimit të vazhdueshëm është thelbësor për rritje të produktivitetit në ekonomi dhe rritje të shanseve për punësim dhe mirëqenie.

### Shkalla e papunësisë tek të rinjtë dhe NEET 2015-2019




Ekziston një korrelacion i fortë ndërmjet shkollimit dhe indeksit të ardhurave. Personat me arsim superior janë përgjithësisht më të pasur apo shumë të pasur, krahasuar me mesataren kombëtare. Në anën tjetër, personat e varfër me të ardhura nën rrogën mesatare mujore kombëtare kanë edukim kryesisht bazik. Shkalla e pagesës dhe mirëqenia shoqërore, është po ashtu e ndërlidhur me llojin dhe fushat e studimit të fuqisë punëtore. Tregu i punës në Kosovë ka një tendencë më të madhe për të punësuar të diplomuar me shkollim në fushat e shkencave të jetës dhe bujqësi, shërbime, inxhinieri dhe edukim. Në anën tjetër, rreth gjysma e të rinjëve (15-24) janë të papunë dhe rreth 32 % janë jashtë tregut të punës dhe jashtë arsimit (NEET).

## 2.3 Zhvillimet sociale

Në analizat krahasimore ndërkombëtare nxënësit në asistencë sociale zakonisht mbesin prapa në arritshmëri në testin PISA. Në bazë të rezultateve të fundit të PISA në Kosovë arritshmëria e nxënësve që jetojnë në varfëri ishte e ulët, mirëpo jo thelbësisht prapa nxënësve me nivele tjera të të ardhurave. Nxënësit e varfër në Kosovë janë mesatarisht rreth 30 pikë prapa nxënësve tjerë në PISA me ngecje në matematikë dhe shkencë. Ngecja e tyre është ekuivalente me rreth 1 vit shkollim krahasuar me pjesën tjetër të nxënësve (OECD, 2019).

Është shënuar një tendencë në rritje e papunësisë dhe varfërisë tek të diplomuarit me arsim të lartë. Gjatë vitit 2019 janë shënuar rreth 12,000 të papunë me kualifikim universitar. Papunësia tek këto shtresa shoqërore është indikacion i ndërlidhjes së dobët ndërmjet shkollimit dhe punësimit dhe cilësisë së dobët të arsimit. Ka një ndërlidhje ndërmjet kërkesave për azil në vendet e BE-së dhe numrit të të diplomuarve.



Në bazë të projeksioneve të reja 2018-2025 të Bankës Botërore (2019), Kosova pritet të ketë rënie të theksuar të grup-moshave 0-4 (parashkollor) për shkak të rënies së natalitetit të popullsisë. Një trend i ngjashëm parashihet edhe për grup-moshat 5-9 vjeç të edukimit parafillor dhe fillor.

Projeksionet e popullsisë sipas grup-moshave (Banka Botërore) 2018-2025

	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
0-4	147,866	144,968	141,734	140,177	137,523	134,740	131,855	128,859
5-9	149,847	151,284	152,304	151,259	146,969	143,188	140,563	137,331
10-14	144,043	142,396	140,795	140,090	143,958	147,349	148,575	149,597
15-19	170,577	167,928	166,100	153,459	147,068	142,447	140,666	139,080
20-24	154,752	155,886	156,295	166,123	168,314	167,268	164,237	162,296

Numri i nxënësve në arsim të mesëm të lartë parashihet të jetë i qëndrueshëm deri në vitin 2021. Efektet e rënies së natalitetit do të manifestohen vetëm pas vitit 2021. Numri i grup-moshave që korrespondojnë me arsimin e lartë parashihet të rritet. Këto zhvillime do të ndikojnë ndjeshëm në arsimin parauniversitar dhe universitar. MASHT dhe komunat duhet reflektuar këto zhvillime në planifikimin e infrastrukturës, burimeve njerëzore dhe financimit.

## 2.4 Zhvillimet teknologjike

Kosova ka shënuar rritje të shpejtë të qasjes në internet dhe kompjuterë. Rreth 88 % e popullsisë kishte qasje të rregullt në internet gjatë vitit 2019 edhe pse shpejtësia e internetit është dukshëm më e ulët se në vendet e avancuara (Eurostat, 2019). Edhe shkalla e penetrimit të telefonisë mobile është më e lartë sesa numri i popullsisë (103.2 %) <sup>4</sup>. Nga numri i përgjithshëm i përdoruesve të internetit, 1.49 milion apo 78 % qasen në internet përmes telefonisë mobile smartphone. Rreth 770,000 janë përdorues aktiv të rrjeteve sociale. Mbi 90 % e grup-moshave 16-24, rregullisht kanë qasje në rrjete sociale dhe përdorin internetin për komunikim, lexim dhe në raste më të rralla edhe për transaksione ekonomike <sup>5</sup>. Rreth 72.4 % të përdoruesve kanë qasje të shpeshtë ditore ndërsa pjesa tjetër qaset më rrallë.

Shumica e përdoruesve të kompjuterit dhe internetit në Kosovë qaset për të bërë telefonata me zë dhe video (85%), për komunikim në rrjete sociale (64%), lexim të lajmeve (58%). Një pjesë më e vogël 32 % e përdorin atë për komunikim zyrtar, dërgim të shkresave dhe për t'u informuar në lidhje me ofertat në treg dhe konsultime të natyrës civile/politike <sup>6</sup>.

<sup>4</sup> Kosovo Regulatory Authority on Electronic and Postal Services 2019

<sup>5</sup> Kosovo Digital Report 2019, Kosovo Data Reportal

<sup>6</sup> EUROSTAT, ICT Statistics

## Aktivitetet në internet - Kosovë 2018-2019

Telefonata me zë/video	85%
Rrjete sociale	64%
Lexim të lajmeve online	58%
Dërgesa/pranim të email-it	32%
Informacion për shërbime/mallra	31%
Informacion për udhëtim	3%
Shitje të mallrave dhe shërbimeve	3%
Qasje në rrjete profesionale	3%
Pjesëmarrje në konsultime civile/politike	2%
E-Bankim	1%

Burimi: EUROSTAT 2019

Digjitalizimi do të ketë ndikim rrënjësor në procesin mësimor. Ekzistojnë mendime të ndryshme në lidhje me rolin e teknologjisë së informimit dhe komunikimit (TIK) në mësimdhënie dhe rezultate të nxënësve. Megjithatë, shkollat nuk mund të injorojnë transformimin digjital në mjedisin që i rrethojnë ato.



## 3. Fizionomia e Sistemit Arsimor

### 3.1 Fizionomia e sistemit arsimor

Sistemi i arsimit në Kosovë, përfshin një numër të hisedarëve institucional të nivelit qendror dhe lokal. MASHT, është institucioni kyç qeveritar për politikbërje, koordinim dhe vlerësim të sistemit arsimor. Sipas Ligjit për Arsim Parauniversitar, komunat, përmes Drejtorive Komunale për Arsim (DKA) zbatojnë politikat dhe menaxhojnë arsimin parauniversitar. MASHT zhvillon politikat dhe standardet e arsimit parauniversitar përfshirë kornizën e kurrikulës, standardet e mësimdhënies, kualifikimet profesionale dhe sistemet e vlerësimit. Krahas aspektit legjislativ dhe rregullativ, Ministria e Arsimit organizon edhe procesin e vlerësimit të jashtëm të progresit, vlerësimit të jashtëm të studentëve, zhvillimin profesional të mësimdhënësve dhe mbështetjen përmes mjeteve dhe hapësirave shkollore. Komunat menaxhojnë financat e arsimit parauniversitar përmes granteve specifike për arsim të alokuara nga niveli qendror. MASHT organizon dhe përcakton formulën e arsimit për komuna në bashkëpunim me MF, duke u bazuar në parimin e financimit sipas numrit të nxënësve. Formula e financimit përfshin edhe provizione për financim shtesë për shkollimin në zona të larta rurale, arsim të komuniteteve dhe arsimit me nevoja të veçanta.

Tabela: Grup-moshat: nxënësit, mësimdhënësit dhe institucionet sipas niveleve të shkollimit 2019

	Grup-mosha	Obligativ	Nxënës	Mësimdhënës	Staf Adm	Institucione
Edukimi parashkollor (ISCED 0)	0-4	Jo	9393	553	294	44
Edukimi parafillor (ISCED 0)	5	Po	23,650	-	-	-
Shkollimi fillor (ISCED 1)	6-10	Po	229,338	17426	3725	921
Arsimi i mesëm i ulët (ISCED 2)	11-14	Po	-	-	-	-
Arsimi i mesëm i lartë (ISCED 3)	15-17	Jo	74,427	5255	897	123
Arsimi i lartë (ISCED 4b +)	18 +	Jo	104,513	3242		31

Shënime: Shënimet reflektojnë të dhënat e sektorit publik dhe privat (të dhënat e nxënësve janë nga sektori publik dhe privat, ndërsa të dhënat për mësimdhënës dhe staf administrativ janë vetëm nga sektori publik) Burimi: SMIA/MASHT, ASK (2019)

Sistemi arsimor në Kosovë organizohet sipas strukturës së bazuar në katër nivele: edukimi parashkollor (ISCED0), shkollimi fillor (ISCED 1), arsimi i mesëm i ulët (ISCED 2), arsimi i mesëm i lartë (ISCED 3), arsimi passekondar jouniversitar (ISCED 4) dhe dhe arsimi i lartë (ISCED 5/6).



Nivelet sipas KSNA <sup>7</sup>		Nivelet Formale të Arsimit Parauniversitar në Kosovë <sup>8</sup>	Mosha
		Arsimimi i të rriturve/Arsimimi gjatë tërë jetës në shkallë të gjerë (formal dhe joformal)	23/24+
KSNA/ISCED 6		Arsimi pasuniversitar	23/24+
KSNA/ISCED 5		Arsimi universitar	
KSNA/ISCED 4	Niveli 5 sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve	Arsimi passekondar jouniversitar	18 +
	Niveli 4 sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve	Arsimi i mesëm i lartë Gjimnazi klasa X-XII Shkollat profesionale (klasat X-XII)	15-17
KSNA/ISCED 3	Niveli 3 sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve	<b>Matura</b> Arsimi i mesëm i lartë Shkollat profesionale (klasat X-XI)	15-16 Shkollat profesionale
KSNA/ISCED 2		Arsimi i mesëm i ulët Klasat VI-IX	11-14
KSNA/ISCED 1		Arsimi fillor Klasat I-V	6-10
KSNA/ISCED 0		Edukim parafillor	5-6
		Edukimi parashkollor	lindje-5

Korniza kurrikulare është e strukturuar në shtatë shkallë kryesore të cilat paraqesin periudhat me karakteristika të përbashkëta për sa i përket zhvillimit të nxënësve/kandidatëve dhe kërkesave të kurrikulës. Ato përbëhen prej një, dy ose tre viteve/klasave. Shkallët e kurrikulës paraqesin periudha të përbashkëta, karakteristike për sa i përket zhvillimit të nxënësve/kandidatëve dhe kërkesave të kurrikulës. Shkallët e kurrikulës paraqesin pikën referuese për përcaktimin e kompetencave kryesore që duhen zotëruar, kërkesat e progresit të nxënies, organizimin e përvojave mësimore, qasjen dhe kriteret e vlerësimit si dhe institucionin përgjegjës për arritjen e tyre.

<sup>7</sup> Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Arsimit.

<sup>8</sup> Tri pjesët e fundit (KSNA 4, 5 dhe 6) nuk janë pjesë të arsimit parauniversitar.

Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Arsimit	Korniza Kombëtare e Kulifikimeve	Nivelet formale të arsimit parauniversitar	Shkallët kryesore të kurrikulës
KSNA 4	Niveli 5	Arsimi posekondar / jo-universitar <sup>9</sup>	Shkalla 7: Specializim i lartë dhe avancim
	Niveli 4	Arsimi i mesëm i lartë Klasa XII	Shkalla 6: Konsolidim dhe specializim
KSNA 3	Niveli 3	Arsimi i mesëm i lartë Klasat X-XI	Shkalla 5: Zhvillim themelor profesional
	Niveli 2	Arsimi i mesëm i ulët Klasat VIII-IX	Shkalla 4: Përforcim dhe orientim
KSNA 2		Arsimi i mesëm i ulët Klasat VI-VII	Shkalla 3: Zhvillim i mëtejshëm dhe orientim
	Niveli 1	Arsimi fillor Klasat III-V	Shkalla 2: Përforcim dhe zhvillim
KSNA 1		Arsimi fillor Klasat I-II	Shkalla 1: Përforcim dhe zhvillim
	KSNA 0	Klasa përgatitore	Shkalla 1: Përforcim dhe zhvillim
		Edukimi parashkollor	Edukimi në fëmijërinë e hershme

9 Niveli 5 është nivel jo-formal i arsimit.

## 3.2 Treguesit e performancës në arsim

### TREGUESIT KRYESOR TË NDIKIMIT NË ARSIM 2015-2019

	2015	2016	2017	2018	2019
<b>Treguesit kryesor të nxënësve/studentëve</b>					
Numri i nxënësve parauniversitar total	374,407	369,309	365,029	356,270	345,540
Numri i nxënësve në parashkollor (ISCED 0)	26,924	28,986	30,638	32,084	34,042
Numri i nxënësve në ars.fillor/mesëm ulët total	261107	250931	244677	239937	234,590
Numri i nxënësve në ars. e mesëm lartë	86,376	89,392	89,714	84,249	77,907
Numri i nxënësve në ars. e mesëm lartë profesional	42,973	46,090	42,948	43,803	40,817
Numri i nxënësve në ars. e mesëm lartë gjimnaze	43,403	43,302	46766	40,446	37,090
Vijues në arsimin e të rriturve	1,962	1,794	2,270	1,912	1869
Numri i studentëve në arsimin e lartë	120,429	123,988	116,424	104,513	-
Numri i të diplomuarve në arsimin e lartë	12,528	13,969	-	-	-
<b>Treguesit e kuadrit mesimdhënës</b>					
Numri i mesimdhënësve parauniversitar	23,336	23,202	23,281	23,262	23,234
Pariteti gjinor në kuadrin mesimdhënës	1.04	1.07	1.15	1.21	1.31
Raporti nxënës-mësimdhënës APU	15.7	15.5	15.2	14.7	14.9
Shkalla e pjesëmarrjes në zhvillim prof. (CPD)	54	54	47	33.5	24.7
<b>Përfshirja në arsim</b>					
Shkalla bruto e përfshirjes parashkollor (3-5)	30.9	33.9	36	37.4	-
Shkalla bruto e përfshirjes fillor	94.7	96.2	98.4	100.3	-
Shkalla bruto e përfshirjes në ars. e mesëm ulët	96	93.3	91.2	-	90.5
Shkalla bruto e përfshirjes në ars. e mesëm lartë	84.9	88.1	90.2	-	86.8
Shkalla bruto e përfshirjes në arsimin e lartë	62.4	67.2	69.4	66	-
Shkalla e braktisjes së shkollimit obligativ	0.2	0.2	0.1	-	-

## TREGUESIT KRYESOR TË NDIKIMIT NË ARSIM 2015-2019

	2015	2016	2017	2018	2019
<b>Treguesit e cilësisë dhe arritshmërisë</b>					
Arritshmëria mesatare PISA	378	-	-	-	-
PISA arritshmëria në matematikë	362	-	-	366	-
PISA arritshmëria në lexim	347	-	-	355	-
PISA arritshmëria në shkencë	378	-	-	365	-
Arritshmëria në Testin e Semimaturës	-	-	-	-	-
Arritshmëria në Teestin e Maturës	54	62.6	58.4	61	60.9
<b>GDP dhe shpenzime në arsim</b>					
GDP (BPV)	5807	6070.1	6,414	6,761	7,079
Total Shpenzime në Arsim (milion €)	262.9	268	266.7	285.9	303.2
GDP % në arsim	4.5	4.4	4.3	4.2	4.3
GDP % në shkencë (R&D)	-	-	-	-	-
Shpz.qeveritare (%) në arsim	16.3	15.2	14.7	13.7	12.8
Granti Komunal për arsim (milion €)	190.7	191.7	197.2	206.6	205.6
Arsimi parauniversitar (milion €)	215.3	218.3	216.3	234.1	249.5
Edukimi parashkollor (milion €)	18,2	18,3	20.57	23.3	25.9
Edukimi parashkollor 0-4 (milion €)	5,6	5,8	6,4	7,3	9.1
Arsimi fillor (milion €)	75.02	75,16	79.26	84.2	91.6
Arsimi i mesëm i ulët (milion €)	69,55	70.16	63.69	68.9	73.4
Arsimi i mesëm i lartë (milion €)	52,49	54,61	52.77	57.6	58.6
Arsimi i lartë (milion €)	47.6	49.7	50.3	51.8	53.6

Burimi: MASHT/SMIA, Agjencia e Statistikave të Kosovës/Ministria e Financave 2013-2019

## 4. Zhvillimet kryesore në arsim 2016-2019

### 4.1 Objektivat kryesore strategjike – analizë krahasimore

#### 4.1.1 Pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja

Shkalla bruto e regjistrimit (GER) 2015-2019

Viti shkollor	2015/16	2016/17	2017/18	2017/2018	2018/2019
Shkalla bruto e regjistrimit parashkollor (0-5)	15.70%	16.40%	18.00%	19.10%	20%
Shkalla bruto e regjistrimit parashkollor (3-5)	29.60%	30.90%	33.90%	36%	37.50%
Shkalla bruto e regjistrimit parashkollor (0-4)	2.80%	3.50%	4.40%	4.90%	6.20%
Shkalla bruto e regjistrimit parafillor (5 vjeç)	79.60%	81.30%	87.60%	92.40%	92.50%
Shkalla bruto e regjistrimit fillor (ISCED 1)	96.40%	94.70%	96.20%	98.40%	100.30%
Shkalla bruto e regjistrimit mesëm ulët	99.50%	96.00%	93.30%	91.20%	90.50%
Shkalla bruto e regjistrimit mesëm lartë	84.50%	84.90%	88.10%	90.20%	86.80%

Burimi: MASHT 2015-2019

***Kosova ka arritur shkallë të lartë të përfshirjes në arsimin parauniversitar - përfshirja ende nuk është universale dhe ende mbeten grupe të vogla shoqërore që nuk janë përfshirë në sistem. Gjatë vitit të fundit Kosova ka shënuar ngritje të përfshirjes në edukimin parashkollor dhe parafillor.*** Kjo ka ardhur në sajë të integritimit të një numri të theksur të fëmijëve në edukim parashkollor nga sektori jopublik dhe investimet publike në disa komuna. Shkalla bruto e regjistrimit në arsimin parashkollor në vitin shkollor 2018/2019 është rritur në 20% apo për 0.9% ngritje krahasuar me vitin paraprak. Që nga miratimi i PSAK në vitin shkollor 2016/2017, shkalla e përfshirjes në arsim parashkollor është rritur për 3.6%. Ky përparim i lehtë është funksion i rritjes së përfshirjes së fëmijëve (0-5) në sektorin privat dhe rënjes demografike.

Kosova ka arritur progres të theksuar në përfshirje të fëmijëve në edukimin parafillor (5 vjeç). Shkalla e përfshirjes në vitin 2019 (92.5%) është përtej synimit të shprehur në PSAK. Megjithatë, shkalla e përfshirjes të grup-moshave 0-4 vjeç ende mbetet shumë e ulët (6.2%). Shkalla bruto e përfshirjes së fëmijëve në arsimin fillor është 100 % dhe ka rrjedhur sipas dinamikës së planifikimit vjetor. Në anën tjetër, shkalla e përfshirjes së nxënësve në arsimin e mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë ka shënuar regres. Shkalla bruto e regjistrimit në arsimin e mesëm të ulët në vitin shkollor 2018/2019 ishte 90.5 % krahasuar me 96% në vitin shkollor 2016/2017. Nuk është shënuar ndonjë progres në rritje të shkallës së përfshirjes në arsimin e mesëm të lartë.

Shkalla e përfshirjes në vitin 2018/2019 ishte 86.8 % apo një përmirësim prej 1.9% krahasuar me vitin shkollor 2016/2017.


**Rritja e përfshirjes së nxënësve të komuniteteve me nevoja të veçanta në të gjitha nivelet e arsimit mbetet sfidë në arritjen e përfshirjes universale. Janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm në jetësimin dhe funksionalizimin e plotë të ekipeve komunale për parandalim të braktisjes së shkollave.** Përfshirja në edukimin parashkollor mbetet ende e ulët në krahasim me vendet e avancuara të BE dhe OECD. Kosova duhet të synoj për një shkallë më të lartë të përfshirjes në edukimin parashkollor. Në bazë të analizës së rezultateve të PISA 2015-2018, shkalla e arritshmërisë së vendeve është ngushtë e lidhur me numrin e viteve që kalojnë fëmijët në edukimin parashkollor. **Megjithatë, Kosova paraqet një rast të veçantë meqë nxënësit që nuk kanë kaluar asnjë vit në edukim parashkollor apo kanë kaluar fare pak, kanë arritshmëri më të lartë.** Kjo ofron hapësirë shqyrtimi të prioritetit dhe ngjall edhe debat mbi cilësinë e edukimit parashkollor. Kosova duhet të përqëndrohet në dy prioritete rreth përfshirjes në edukim parashkollor – rris shkallën e përfshirjes por edhe adresoj nevojën e cilësisë së edukimit parashkollor.

#### 4.1.2 Menaxhimi i Sistemit Arsimor

**Sfidë kryesore në menaxhimin e sistemit arsimor mbetet koordinimi i planeve dhe prioriteteve brenda një kornize të bashkërenduar të planifikimit dhe monitorimit.** Planet strategjike në arsimin e Kosovës zbatohen në kontekst të përgjegjësi të ndara dhe pjesëmarrjes së institucioneve dhe organeve autonome në punën e tyre. Përfshirja e komunave, institucioneve të arsimit të lartë dhe sektorit privat është thelbësore për avancim të zbatimit të planeve arsimore. Kapaciteti për mbledhje dhe përpunim të dhënave në arsim është rritur dukshëm, mirëpo kërkohet vëmendje më e lartë ndaj nevojës së sigurimit të të dhënave me fokus tek nxënësi dhe studenti, mbledhja dhe raportimi i të dhënave mbi ndikimin e arsimit në punësim dhe rritja e kapaciteteve të nivelit lokal për raportim dhe përpunim të të dhënave.

Sigurimi i një mjedisi shkollor miqësor, me kushte dhe disiplinë optimale është një parashikues i fortë i arritshmërisë së nxënësve në arsimin parauniversitar. **Si drejtorët, mësimdhënësit ashtu edhe nxënësit raportojnë sfida të theksuara me disiplinën në shkollat e Kosovës.** Rreth 62 % e drejtorëve dhe mësimdhënësve raportojnë se mungesat e pajustificuara pengojnë seriozisht procesin e mësimdhënies në shkolla. Rreth 33 % e mësimdhënësve dhe drejtorëve raportojnë se nxënësit ikin nga orë të caktuara. Ngjashëm, 25% e drejtorëve dhe mësimdhënësve nënvizojnë se procesi mësimor pengohet nga mungesa e respektit që nxënësit kanë në klasë. Edhe 35.1 % e nxënësve raportojnë të kenë munguar ndërmjet 1-5 herë gjatë një semestri shkollor (OECD, 2019).

**A keni munguar në mësim gjatë 12 muajve të fundit? Arritshmëria e nxënësve në Testin PISA sipas vijueshmërisë së procesit mësimor në Kosovë (OECD, 2019)**



Asnjëherë




Nganjëherë



Shpesh

Një pjesë e konsiderueshme e nxënësve (20-25) janë subjekt i bulizmit në shkollat e Kosovës. Nxënësit raportojnë që gjatë një viti shkollor të kenë qenë shpesh subjekt i kërcënimeve, rrahjeve, thashethemeve dhe talljeve nga nxënësit tjerë. Rreth 10 % e nxënësve janë subjekt i bulizmit të vazhdueshëm. Bulizmi ka ndikim negativ në të nxënit dhe potencialisht ndikim afatgjatë në zhvillimin personal të fëmijëve.




Nxënësit që raportojnë buliizëm të vazhdueshëm brenda javës performojnë shumë më keq (341 pikë) në lexim, matematikë dhe shkencë krahasuar me mesataren kombëtare. Në anën tjetër, nxënësit që asnjëherë nuk ishin subjekt i kërcënimeve, rrahjeve apo talljeve në shkollë, kanë arritshmëri dukshëm më të lartë (379) në Testin PISA (OECD, 2019).

Modeli i menaxhimit të shkollës në Kosovë ndryshon thelbësisht në krahasim me modelet e vendeve me arritshmëri të lartë të nxënësve në PISA të OECD. Megjithatë, PSAK 2017-2021 nënvizon rëndësinë e decentralizimit dhe janë ndërrëmarrë disa hapa për plotësim të legjislaconit sekondar me qëllim të departizimit të arsimit parauniversitar, mirëpo formula e financimit nuk ka ndryshuar. **Modeli i menaxhimit të shkollës ende karakterizohet nga mungesa e autonomisë, përgjegjësi të kufizuara për menaxhmentin e shkollës dhe mësmdhënsit.** Mësimdhënësit dhe drejtorët e shkollës kanë perceptimin që përgjegjësia e tyre është e kufizuar në mësimdhënie, vlerësim të nxënësve dhe masave disiplinore. Për ndryshim nga vendet e avancuara të OECD, drejtori i shkollës dhe mësimdhënësit nuk kanë përgjegjësi në përcaktim të kurrikulës, përmbajtjes së lëndës dhe teksteve mësimore. Drejtorët e shkollave janë të kufizuar në administrim të shpenzimeve, pranim të nxënësve dhe masave disiplinore. Për dallim nga vendet e OECD, ata nuk përceptojnë se është përgjegjësi e tyre të angazhohen në përmbajtje të lëndëve, rregullat e vlerësimit të nxënësve, planifikim buxhetor, përzgjedhje të stafit, vlerësim të stafit apo shkarkim të tyre. Këshilli drejtues i shkollës është më tepër i kufizuar në planifikim buxhetor, mbikëqyrje të shpenzimeve dhe masave disiplinore.

Një palë e rëndësishme në zhvillimin e shkollës dhe nxënësve janë prindërit. Në bazë të analizës së rezultateve PISA 2018, shumica e prindërve janë të përkushtuar ndaj fëmijëve, janë të interesuar të vështrojnë rezultatet e nxënësve. Megjithatë, qasja e tyre nuk është proaktive. **Mbështetja e prindërve ndaj nxënësve, sfidave të tyre dhe shkollës dhe pjesëmarrja aktive në zhvillim të nxënësve është e lidhur ngushtë me rezultate më të larta në arritshmëri të nxënësve.** Pjesëmarrësit në Testin PISA 2018 që raportojnë se ndihmohen rregullisht


nga prindërit në mësim kanë arritshmërinë më të lartë (379 pikë). Në anën tjetër, ata që nuk mbështeten nga prindërit kanë rezultate tejet të ulëta (326) në lexim, matematikë dhe shkencë.

#### A jeni mbështetur nga prindërit në mësim gjatë 12 muajve të fundit (OECD, PISA 2018)



Ka një ndërlidhje të fortë ndërmjet rritje të financimit në arsim dhe arritshmërisë së nxënësve. Kosova shpenzon rreth 877.5 euro (nominale) apo rreth 2456.8 euro (PPP) për kokë nxënësi. Kjo e rendit Kosovën në fund të tabelës së vendeve anëtare/partnere të OECD-së. Shpenzimet e Kosovës në arsim shprehur si % e BPV/GDP ndërmjet 2016-2019 ishin rreth 4.4 % dhe sipas praktikave rajonale dhe vendeve të avancuara. Megjithatë, janë dy faktorë që ndikojnë në shpenzime më të ulëta nominale – ekonomia e vogël dhe numri i lartë i nxënësve krahasur me vendet tjera. Kosova ka strukturë të ndryshme të popullsisë dhe pjesëmarrje të lartë të popullsisë së re. Numri i nxënësve është pothuajse dyfishi i vendeve me numër të ngjashëm të popullsisë në Evropë. Struktura e shpenzimeve në arsim dominohet nga kategoria e rrogave të personelit (rreth 75%) dhe shpenzimet rrjedhëse. Shpenzimet kapitale vazhdojnë të jenë tejet të ulëta.


#### Shpenzimet në arsim 2016-2019 në milion euro dhe % të GDP/BPV (MASHT, 2019)





**Megjithatë, shkalla e financimit nuk është gjithmonë përcaktues i rezultateve të arritshmërisë së nxënësve në PISA** (OECD, 2019). Estonia dhe Letonia janë në mesin e vendeve që shpenzojnë pak në arsim krahasur me ekonomitë e avancuara të OECD, por rezultatet e arritshërisë në Testin PISA janë ndër më të lartat. Për këtë arsye, Kosova nuk është vështruar vetëm në prioritetin e rritjes së financimit në arsim por edhe në gjetjen e mënyrës më eficiente të alokimit të shpenzimeve. Në anën tjetër, shpenzimet në arsimin parauniversitar ndërmjet 2016-2019 janë rritur për rreth 16 %, mirëpo kjo nuk është përkthyer në rezultate më të larta në arritshmëri të nxënësve në Testin PISA.


**Kosova po ballafaqohet me rënie të shtimit natyror dhe numër më të vogël të nxënësve.** Kjo ka rezultuar me rënie të theksuar të numrit të nxënësve për klasë sidomos në zonat rurale. Rënia e numrit të lindjeve dhe lëvizjet e brendshme dhe të jashtme të popullsisë, kushtëzojnë rimendimin e strategjisë për investime në ndërtim të shkollave të reja. Rreth 60 % për qind të shkollave nën 250 nxënës. Mbi 200 shkolla (paralele të ndara) funksionojnë me nën 50 nxënës apo rreth 4 nxënës për klasë. Operimi i këtyre paraleleve duhet të shqyrtohet, jo vetëm për shkak të jo-efiçencës së theksuar buxhetore, por edhe për shkak të cilësisë së dobët të mësimdhënie. Optimalizimi i numrit të nxënësve në klasë, shkollë dhe riorganizimi i rrjetit të shkollave, do të jetë prioritet që nuk mund të injorohet në vazhdim.



Strategjia në vazhdim duhet të rishikohet në favour të infrastrukturës së brendshme shkollore dhe mjeteve të konkretizimit. Kjo për arsye sepse Kosova listohet në mesin e vendeve me kënaqshmëri më të ulët të mësimdhënësve/drejtorëve të shkollave me resurset mësimore duke përfshirë laboratorët, tekstet mësimore dhe kompjuterët (OECD, 2019).

Rreth 80% e drejtorëve dhe mësimdhënësve në Kosovë nënvizojnë rëndësinë e riorientimit të financimit dhe investimeve në tekstet mësimore, biblioteka, laboratore dhe mjetet digjitale. Mungesa e infrastrukturës fizike dhe infrastruktura jo-adekuate, sidomos mungesa e dhomave të leximit për nxënës, janë po ashtu sfida primare (OECD, 2019).

### % - Sa e Pengojnë procesin mësimor FAKTORËT NË VIJIM? (OECD, 2019)



### 4.1.3 Cilësia në arsim


#### Janë ndërtuar mekanizmat e vlerësimit të jashtëm të nxënësve dhe Kosova ka marrë pjesë në PISA

2015-2018. MASHT organizon vlerësim vjetor të jashtëm të nxënësve përmes testit të maturës dhe testit të semimaturës. Në përgjithësi ekziston një sistem institucional dhe praktikë e vlerësimit të jashtëm të nxënësve.


**Është shënuar përparim i lehtë në arritshmërinë** e nxënësve në testet e semimaturës dhe testin e maturës.

Arritshmëria në testin e maturës ka një trend pozitiv që nga viti 2017. Në disa raste është kontestuar integriteti i vetë sistemit për shkak të praktikave të kopjimit gjatë testimit në të kaluarën. Mirëpo, në dy vitet e fundit (2018-2019), MASHT ka ndërmarrë hapa shtesë për të rikthyer besimin në sistem të vlerësimit.

### Rezultatet e arritshmërisë në Testin e Maturës 2012-2019



Në vitin 2015, Kosova ka marrë pjesë për herë të parë në Programin Ndërkombëtar të Vlerësimit të Studentëve (PISA). Vitin e kaluar janë publikuar edhe rezultatet e PISA 2018. Në bazë të analizës krahasimore të rezultateve të arritshmërisë në PISA, Kosova nuk ka shënuar ndonjë përparim në arritshmëri të nxënësve krahasuar me katër vite më parë.



Nxënësit 15 vjeçar në Kosovë vazhdojnë të kenë arritshmëri të ulët në matematikë, shkencë dhe lexim krahasuar me mesataren e rajonit dhe vendeve të OECD-së. Në vitin 2018, rezultatet e arritshmërisë së nxënësve në matematikë dhe lexim ishin minimalisht më mirë sesa në vitin 2015, ndërsa rezultatet në segmentin e shkencave janë përkeqësuar.

Nxënësit në Kosovë arrijnë norma relativisht të larta të viteve të kaluara në shkollim duke ju përafëruar zhvillimeve në BE. Në vitin 2018, llogaritet se **numri mesatar i viteve të kaluara në shkollim ishte 12.85** (Banka Botërore, 2018). Vitet e kaluara në shkollim në Kosovë janë më të larta sesa në Maqedoninë Veriore, Mal të Zi dhe Bosnje e Hercegovinë. Megjithatë, **vitet e kaluara në shkollim nuk prodhojnë domosdoshmërisht efekt të theksuar në arritshmëri** të nxënësve. Duke inkuorporuar arritshmërinë e nxënësve në teste ndërkombëtare të harmonizuara vlerësohet se vitet e shkollimit të përshtatura për mësim në Kosovë janë 7.7 vjet (Banka Botërore, 2018). Rrjedhimisht nxënësit në Kosovë kanë shkallë të ulët të mësuarit për vitet e kaluara në mësim (60 %).

**Sistemi i sigurimit të cilësisë në arsimin parauniversitar ka filluar të merr formën e sistemeve të avancuara arsimore.** Ndërtimi i sistemit të jashtëm të sigurimit të cilësisë ka shkuar paralelisht me pjesëmarrjen në testet ndërkombëtare të vlerësimit të nxënësve. Në vitin 2018 ka filluar vlerësimi i jashtëm i shkollave dhe vlerësimi i jashtëm i mësimdhënësve. Në aspektin e sigurimit të brendshëm të cilësisë, pjesa më e madhe e komunave dhe shkollat e Kosovës kanë caktuar koordinatorët e Cilësisë dhe kanë filluar pilotimin e procesit të vetëvlerësimit. Pothuajse të gjitha shkollat e Kosovës janë të vetëdijshme mbi nevojën e vetëvlerësimit, vlerësimit të jashtëm të shkollës dhe mësimdhënësve (OECD, 2019).

Nga analiza krahasimore, drejtorët dhe mësimdhënësit në Kosovë përdorin pothuajse të gjitha instrumentet e sigurimit të cilësisë që aplikohen në vendet e tjera të OECD-së. Edhe në rast kur instrumentet nuk janë detyrime ligjore, shkollat me vetiniciativë kanë filluar të praktikojnë pyetsorët më nxënës. Rezultatet e arritshmërisë së nxënësve dhe efektshmërisë së mësimdhënësve kryesisht monitorohen. Një pjesë e konsiderueshme e shkollave zbatojnë një lloj mentorimi për mësimdhënës edhe pse ajo nuk është ende e rregulluar në nivel vendi. Përderisa shkollat monitorojnë dhe diskutojnë në lidhje me instrumentet e sigurimit të brendshëm të cilësisë, adresimi i tyre përmes ciklit të planifikimit dhe menaxhimit mbetet i kufizuar në mungesë të financimit apo autonomisë së shkollës.


#### 4.1.4 Mësimdhënia dhe të nxënët

**Procesi i zbatimit të kurrikulës ka hasur në disa sfida që kryesisht ndërlidhen me vështirësi në zbatim të kurrikulës** së re të bazuar në kompetenca, vështirësi për të ndërlidhur procesin e vlerësimit të vazhdueshëm të bazuar në arritje të kompetencave, mungesë të financimit adekuat, mungesë të teksteve adekuate shkollore dhe mungesë të infrastrukturës. MASHT ka përpiluar udhëzues dhe organizuar një seri të trajnimeve për zbatim të mësimdhënies dhe vlerësimit të bazuar në kompetenca, por mësimdhënësit vazhdojnë të preferojnë më shumë udhëzime në vend të punës (IPK, 2019).


Në bazë të Anketës me Nxënës të PISA 2018, ka një shpërputhje ndërmjet orëve zyrtare në kalendarin shkollor për numrin e orëve në javë që nxënësit kalojnë në lëndën e matematikës dhe asaj që ata raportojnë se ndjekin realisht. Rreth gjysma e nxënësve kalojnë ndërmjet 2-3 orë në javë matematikë që është dukshëm më e ulët sesa në Shqipëri (4 orë) apo Estoni (5 orë). Ka një ndërlidhje ndërmjet atyre që raportojnë më pak orë në matematikë dhe atyre që raportojnë se vonohen apo ikin nga orët mësimore. Kjo mund të sugjeroj që, potencialisht, një pjesë e nxënësve kanë tendencë të shmangen orës së matematikës, thelbësore për arritshmëri më të lartë të nxënësve.

Kalendari i zhvillimit të teksteve të reja shkollore, sipas kurrikulës së re, është pjesë e udhërrëfyesit për zbatimin kurrikulës së 2016-2021. **Pavarësisht orientimeve në këtë dokument, që zhvillimi i teksteve të reja për klasat e para të niveleve arsimore do të bëhet gjatë vitit shkollor 2016/2017, një gjë e tillë nuk është arritur.** Gjatë vitit shkollor 2019/2020, janë përgatitur tekstet e reja për klasën përgatitore, klasat 1,2,6,7 dhe 10,11. Ndërsa, kurríkula e re vazhdon të zbatohet edhe në klasat 3,8 dhe 12, por me tekste të vjetra, të cilat nuk janë të bazuara në kurríkulën e re. (IPK, 2019).

Sa orë (45 minuta) në javë keni ndjekur në lëndën e matematikës? - (OECD, 2019)



Megjithatë, koha që nxënësit kalojnë në shkollë nuk është gjithmonë një shpjegues i rezultateve të tyre në arritshmëri. Nuk ka ndonjë korrelacion të drejtëpërdrejtë ndërmjet kohës që nxënësit kalojnë në shkollë dhe rezultateve që ata arrijnë në PISA (OECD, 2019). Arritshmëria është më tepër funksion i cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënët sesa sasisë.



*Nxënësit në Kosovë kanë një sfidë në lexim.* Pjesa dërrmuese e nxënësve lexojnë kryesisht 1-10 faqe për një lëndë gjatë një viti shkollor. Kjo është tejet e ulët krahasuar me nxënësit në Slloveni apo Finlandë që lexojnë ndërmjet 100-500 faqe për lëndë mësimore gjatë vitit shkollor.

Mungesa e teksteve të mjaftueshme dhe adekuate për kurrikulën e re vazhdon të jetë një nga sfidat kryesore në arsim. Në bazë të të dhënave të OECD (2019) mbi analizën e arritshmërisë në PISA 2018, Kosova renditet si një nga vendet me knaqshmërinë më të ulët të drejtorëve, mësimdhënësve dhe nxënësve me tekstet mësimore. Publikimi i teksteve të reja dhe fillimi i përdorimit të tyre ka ngritur debate rreth cilësisë së tyre.

*Nëse krahasohet dinamika e parametrave kryesor në zbatim të kurrikulës ndërmjet 2014-2018, Kosova nuk ka shënuar ndonjë përmirësim në qasje të shkollave me pajisje digjitale, hapësira leximi, në qasjen e mësimdhënësve në raport me detyrat e nxënësve apo tekstet mësimore.*

Tabela: Krahasim i parametrevë % në zbatim të kurrikulës në vende të OECD dhe partnerëve 2015-2018

	Kosova 2015	Kosova 2018	OECD
Shkolla ofron tekste/pajisje adekuate	14.2	18.9	70.6
Shkolla ofron qasje në kompjuter	14	14	81
% kompjuterë me internet	29.2	27.9	97.8
Shkolla ofron hapësira leximi	19	24.2	73.2
Mësimdhënësi ndihmon në detyra	48.7	42.2	59.8

Burimi: OECD 2015-2019


**Sistemi arsimor ka qasje të ulët në teknologji të informimit dhe komunikimit dhe teknologjia bashkëkohore ende nuk është integruar në mënyrë të përshtatshme në kurrikulë, mësimdhënie dhe menaxhim të sistemit arsimor.** Ngritja e cilësisë në të gjitha nivelet është e kushtëzuar nga aftësia e mësimdhënësve dhe nxënësve për të përvetësuar mjetet bashkëkohore të mësimdhënies dhe teknologjisë. Nuk është shënuar ndonjë përparim i ndjeshëm në pajisjen e shkollave me pajisje digjitale. Qasja e tyre në kompjuterë është tejet e ulët krahasuar me vendet e avancuara. Nxënësit në të shumtën e rasteve nuk pranojnë ndihmesë në detyra të shtëpisë nga mësimdhënësit përtej mbajtjes së orës mësimore.

**Digjitalizimi do të ketë ndikim rrënjësor në procesin mësimor. Shkollat në Kosovë kanë ngecur në zhvillim të kapacitetit të teknologjisë së informimit dhe komunikimit.** Ekzistojnë mendime të ndryshme në lidhje me rolin e teknologjisë së informimit dhe komunikimit (TIK) në mësimdhënie dhe rezultate të nxënësve. Megjithatë, shkollat nuk mund të injorojnë transformimin digjital në mjedisin që i rrethojnë ato. Rreth 88 % e amvisërive familjare kanë qasje në kompjuterë dhe internet dhe rreth 1.7 milion shfrytëzojnë qasjen mobile në rrjet.<sup>10</sup> Mbi 90 % e të rinjëve 16-24 kanë qasje aktive dhe përdorin internetin për qasje në rrjete sociale dhe lexim<sup>11</sup>. Analiza e rezultateve të PISA 2015-2018, demonstroi trendin në rritje të kohës që nxënësit kalojnë në internet pas përfundimit të orarit mësimor. Nxënësit në Kosovë kalojnë mesatarisht rreth 3 orë në ditë duke shfrytëzuar informacione në internet. Ata që raportojnë se kanë kompjuter dhe internet në shtëpi dhe janë aktiv në rrjete sociale demonstrojnë rezultate më të larta sesa pjesa tjetër.

10 ASK (2018), Aneketa mbi përdorimin e Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit, 2018

11 Eurostat (2019), Përdorimi i Internetit në Evropën Juglindore, 2019

## Kapaciteti i shkollave (%) - Teknologjia e informimit dhe komunikimit (OECD, 2019)



Më parë, nxënësit pranojnë informacione në tekste shkollore të aprovuara nga Qeveria. Qasja e shtuar në internet ofron mundësi shtesë por edhe sfida, sidomos ekspozimin e nxënësve ndaj informacioneve të pavërteta dhe stereotipeve shoqërore. Më pak se 1 në 10 nxënës ishin në gjendje të dallojnë opinionin nga fakti në Testin PISA 2018. Nuk ka qasje të sistematizuar të përdorimit të kompjuterit dhe pajisjeve digjitale në proces mësimor. Shkollat mendojnë se shumica e mësimdhënësve (70.1%) kanë shkathhtësi për përdorim të TIK. **Megjithatë, Kosova renditet pothuajse e fundit në mesin e vendeve anëtare/partnere të OECD për nga shkalla e zhvillimit të kapacitetit të TIK. Mbi 80 % e shkollave raportuan se nuk kanë kompjuterë të mjaftueshëm.** Edhe në rastet kur kishin kompjuterë, rreth 76 % nuk ishin të lidhura në rrjetin e internetit. Shkollat kryesisht nuk përdorin platforma elektronike (Moodle) në mësimdhënie.


#### 4.1.5 Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve

Cilësia e mësimdhënësve është faktori kryesor në arritshmërinë e nxënësve dhe cilësinë e arsimit parauniversitar. Në kuadër të Ligjit për Pagat e Sektorit Publik (2019) është rritur paga për mësimdhënësit e të gjitha niveleve arsimore. Megjithatë, edhe reforma e fundit në pagesa të mësimdhënësve ishte lineare dhe nuk siguron financim shtesë për të inkurajuar performancën e mësimdhënësve që demonstronjë ekselencë. Skemat e kompensimit të mësimdhënësve vazhdojnë të jenë të bazuara në kualifikimet para shërbimit. Rritja e kompensimit të mësimdhënësve duhet të mbështetet edhe në performancën gjatë shërbimit dhe përvojës së punës. Vendimet për rritje të kompensimit nuk janë të ndërlidhura me procesin e gradimit të mësimdhënësve.

Paga e mësimdhënësve është mbi nivelin e të ardhurave vjetore për kokë banori, praktikë e krahasueshme me vendet e avancuara dhe mbi mesataren rajonale. Kosova ka krahasimisht normë më të ulët të angazhimit të

mësimdhënësve krahasuar me vendet e tjera të OECD. Mësimdhënësit në Kosovë kanë një normë mesatare vjetore prej rreth 539 orëve vjetore të mësimdhënësve apo mbi 100 orë më pak sesa mesatare e OECD. Norma e mësimdhënies është posaçërisht e ulët në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët (rreth 403 orë). Mësimdhënësit në Kosovë kanë një shkallë tejet të kufizuar të angazhimit në ndihmë të nxënësve për detyra. Ata zbatojnë vlerësime të rralla të nxënësve mesatarisht një herë në semestër krahasuar me vlerësimin e vazhdueshëm (3-5 herë) që bëhet në vendet e avancuara.

Të ardhurat vjetore të mësimdhënësve dhe mesatares së popullsisë 2004-2019




Është rishikuar dhe miratuar baza ligjore mbi kompetencat e mësimdhënësve dhe vlerësimit të performancës. Mbi 600 mësimdhënës i janë nënshtruar procesit të vlerësimit të jashtëm por akoma nuk kanë informata kthyesë që do t'i përdornin për përmirësim. Procesi i monitorimit dhe mentorimit të mësimdhënësve në shkolla ende vazhdon të jetë i vështirë. Në shumë raste hasen vështirësi në definim të qartë të përgjegjësive ndërmjet drejtorëve, koordinatorëve të cilësisë, komunës dhe Inspektoratit të Arsimit.

Zhvillimi profesional i mësimdhënësve vazhdon të jetë i dominuar me trajnime dhe punëtori, të ndërlidhura me programe të akredituara, të njohura nga MASHT për sistemin e licencimit. Kjo mund të ketë ndikuar në kufizimin e zhvillimit të sistemit për zhvillim profesional të bazuar në shkollë *Të kuptuarit e zhvillimit profesional të mësimdhënësve ende mbetet i kufizuar në lloje dhe orë të trajnimeve të organizuara nga partnerë zhvillimor ose organizata vendore. Trajnimet jo gjithmonë mund të jenë të ndërlidhura me prioritetet kryesore të shkollës sidomos zbatimi i kurrikulës së re, sigurimi i cilësisë apo vlerësimi i bazuar në rezultate të të mësuarit (IPK, 2019).*

Në anën tjetër, analiza krahasimore e faktorëve që përcaktojnë arritshmërinë e nxënësve në PISA shfaq një ndërlidhje të fortë ndërmjet kualifikimit dhe zhvillimit profesional të mësimdhënësve me arritshmërinë. Kosova mesatarisht ofron shumë më pak orë trajnime sesa vendet e tjera të avancuara të OECD. *Shkalla e përfshirjes së mësimdhënësve në zhvillim profesional ka pësuar rënje të vazhdueshme që nga viti 2015. Shkalla e përfshirjes së mësimdhënësve në zhvillim profesional në vitin 2019 ishte 24.7 % e numrit të përgjithshëm të mësimdhënësve.* Kjo shkallë është dukshëm më e ulët sesa në vendet me sisteme të avancuara arsimore. Shkalla e përfshirjes në zhvillim profesional ka rënë në mënyrë të vazhdueshme që nga



viti 2015. Rënia e përfshirjes ka rezultuar për shkak të uljes së shpenzimeve në zhvillim profesional dhe mosfunktionalizimit të një modeli të qëndrueshëm të financimit.




Viteve të fundit është vërejtur një tendencë në rritje e dominimit të femrës në profesionin e mësimdhënësit kryesisht në nivelin parashkollor, fillor dhe mesëm ulët. Kjo ka rezultuar edhe në saje të tendencës së pranimit kryesisht të femrave në programet e edukimit të institucioneve publike (rreth 95% femra). Kosova nuk zbaton provim shtetëror për profesionin e mësimdhënësve dhe nuk sanksionon nevojën e praktikës profesionale para punësimit. Kosova ka filluar procesin e vlerësimit të performancës së mësimdhënësve. Sidoqoftë, nuk është evidente ndikimi i procesit përderisa nuk është e ndërlidhur me sistemin e gradimit dhe shkallën e pagesës.

#### 4.1.6 Arsimi Profesional

**Rreth gjysma e nxënësve të arsimit të mesëm të lartë zgjedhin një nga 122 profilet e ofruara në kuadër të 68 shkollave profesionale dhe Qendrave të Kompetencës. Shkalla e orientimit të nxënësve drejt arsimit profesional është në ngritje që nga viti 2016.** Më shumë nxënës përzgjedhin profilet profesionale në arsimin e mesëm të lartë sesa arsimin e mesëm të lartë të përgjithshëm. Në vitin e fundit 52.4% e nxënësve janë orientuar në një nga profilet në kërkim sidomos në (1) inxhinieri, prodhim dhe ndërtimtari, (2) biznes, menaxhim dhe drejtësi, (3) mjekësi dhe mirëqenie dhe (4) teknologji e informimit dhe komunikimit. Nga analiza më e thellë e orientimit të nxënësve në bazë të profileve/fushave të studimit vërehet në tendencë në rritje e orientimit në sferat e mjekësisë (infermieri, farmaci), administrim biznesi inxhinieri dhe shkenca kompjuterike. Këto profesione kryesisht ndërlidhen me ekonominë e shërbimeve.

### Orientimi i nxënësve në arsimin e mesëm të lartë 2014-2019




*Arsimi profesional është në proces të rishikimit të profileve pas miratimit të kurrikulës* bërthamë.

Rishikimi i profileve ka filluar në vitin 2019 me qëllim të inkuorporimit të qasjes modulare, sistematizimit të praktikës profesionale dhe riorientimit të tyre drejt kërkesave bashkëkohore në treg. Rishikimi i të gjitha profileve është vështirësuar në mungesë të të gjitha standardeve profesionale dhe procesit të ngadalshëm të akreditimit.

Megjithë numrin e madh të ndërmarrjeve të angazhuara për ofrimin e praktikës profesionale, numri i praktikantëve të angazhuar ende mbetet shumë i vogël. Vendosija e bashkëpunimit mes shkollave dhe ndërmarrjeve ka qenë ndër sfidat kryesore. Ndërtimi i kapaciteteve të stafit të shkollave për të siguruar cilësinë që kërkohet nga tregu i punës dhe sigurimin e bashkëpunimit mes shkollave dhe ndërmarrjeve si: sigurimi i instruktorëve të cilët merren me praktikantët e angazhuar në ndërmarrje, rishikimin e standardeve ekzistuese të profesionit dhe vendosja e standardeve që mungojnë, janë çështje të cilave i duhet kushtuar vëmendje. Në anën tjetër, vlerësimi i jashtëm i shkollave nuk duket të jetë opsion i mundshëm dhe afatshkurtër. **Ndër sfidat primare në sistemin arsimor mbetet pjesëmarrja e ulët në arsimin gjatë gjithë jetës, ndërtimi i një sistemi të qëndrueshëm për promovim të arsimit të të rriturve dhe sigurimi i financimit për këtë prioritet.**


#### 4.1.7 Arsimi i Lartë dhe Shkenca

Është rritur përfshirja në arsimin e lartë në vitet e fundit dhe shifrat aktuale e rendisin Kosovën në mesin e vendeve me më shumë studentë për 100.000 banorë. Si rezultat i zgjerimit të shpejtë të nënsektorit dhe ritmit të ngadalshëm të rritjes së shpenzimeve në arsim të lartë, është ulur shkalla e shpenzimeve për student. Rritja e shpejtë e numrit të studentëve, institucioneve dhe programeve të studimit, po ashtu ka krijuar sfida në sigurim dhe menaxhim të cilësisë. Agjencia e Kosovës për Akreditim është bërë anëtare e ENQA në vitin 2014, mirëpo në vitin 2019 statusi i saj është rishqyrtuar me arsyetimin që pozicioni i saj institucional nuk siguron pavarësi të plotë nga ndërhyrjet politike. Kosova ka adoptuar Udhëzimet Standarde Evropiane (ESG) 2015 dhe kriteret për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë janë bërë më transparente.



**Ende mbetet sfidë zbatimi i praktikave të njehsuara në menaxhim, financim dhe sigurim të cilësisë në institucionet publike. Tri institucione publike të arsimit të lartë nuk janë akredituar në vitin 2019 për shkak se praktikave të administrimit nuk ishin vlerësuar konform kërkesave të reja për akreditim të institucioneve të arsimit të lartë.** Ende mungon ndërlidhja e institucioneve arsimore, kërkimit shkencor dhe industrisë edhe pse institucionet publike kanë themeluar Borde Industriale viteve të fundit. Shpenzimet qeveritare në kërkim shkencor janë të vogla krahasur me kërkesën ligjore për alokim të 0.7% të buxhetit vjetor qeveritar në kërkim shkencor dhe zhvillim.

Tregu i punës në Kosovë ballafaqohet me dy probleme strukturore e që ndërlidhen me shkallën dhe cilësinë e sistemit arsimor. Fillimisht shkalla e kërkesës në tregun e punës është e ulët dhe trendi i vendeve të punës të gjeneruara vitet e fundit nuk garanton punësim të të diplomuarve. Së dyti, ekziston edhe problemi i mospërputhjes së cilësisë së kualifikimit dhe tregun e punës – ekzistojnë disa sektorë ekonomik që ballafaqohen me mungesë të shkathtësive adekuate. Oferta arsimore aktualisht është e ndryshme nga nevojat e tregut të punës dhe nevojat për shkathtësi në sektorët strategjik qeveritar. Numri më i madh i studentëve dhe programeve arsimore janë në kategorinë e shkencave shoqërore dhe studimit të së drejtës. Gjatë viteve 2018-2019, është shënuar një rritje e theksuar e numrit të studentëve në fushat mjekësore, kryesisht në sektorin privat.



Nuk ka ndonjë studim gjithëpërfshirës për përshtatjen në mes të shkathtësive të të diplomuarve dhe nevojave të tregut të punës, mirëpo ka mjaft fakte që dëshmojnë të kundërtën. Numri i studenëve të diplomuar (bachelor/master) të papunë është duke u rritur ndjeshëm. Vitin e kaluar ishin rreth 12,000 të diplomuar të papunë, ndërsa që bizneset janë në kërkim të shkathtësive. Studentët janë duke shmangur STEM (shkenca ekzakte, teknologjinë, inxhinierinë dhe matematikën) në favor të shkencave shoqërore dhe juridike (me kërkesë të ulët në treg).

## 4.2 Treguesit strategjik të performancës

### TREGUESIT KRYESOR TË NDIKIMIT 2014-2017

	2015	2016	2017	2018	2019
<b>Treguesit Makroekonomik dhe tregut të punës</b>					
Bruto Produkti Kombëtar (GDP) miliard €	5.567.5	5.807	6.070.1	6,414	7,079
Të hyrat vjetore për kokë (GDP per capita)	3,084	3,277.1	3,386.4	3,566	3,954
Shpenzimet qeveritare në miliard €	1.589	1.612.3	1.764.7	2.104	2,378
NEET % e të rinjëve jashtë punësimit/edukimit	31.4	30.1	27.4	30.1	32.7
Shkalla e papunësisë tek të rinjtë (15-24)	57.7	52.4	52.7	55.4	49.4
Shkalla e papunësisë tek të diplomuarit AL	18.9	19	18	25	23
<b>Treguesit e numrit të nxënësve dhe studentëve</b>					
Numri i institucioneve shkollore parauniversitare	1,137	1,114	1,118	1,116	1,094
Numri i nxënësve parauniversitar	374,407	369,309	365,029	356,270	345,540
Numri i nxënësve në parashkollor (ISCED 0)	26,924	28,986	30,638	32,084	33,043
Numri i nxënësve mesëm lartë profesional	42973	46090	42953	43,803	40,817
Numri i nxënësve mesëm lartë gjimnaze	43,403	43,302	46761	40,446	37,090
Vijues në arsimin e të rriturve	1,962	1,794	2,270	1,912	1,869
Numri i studentëve në arsimin e lartë	120,429	123,988	116,424	104,513	-
Numri diplomuarve në arsimin e lartë	12,528	13,969	-	-	-
<b>Treguesit e kuadrit mësimdhënës parauniversitar</b>					
Numri i mësimdhënësve parauniversitar	23,336	23,202	23,281	23,262	23,234
Pariteti gjinor në kuadrin mësimdhënës	1.04	1.07	1.15	1.21	1.31
Raporti nxënës-mësimdhënës APU	16.3	15.7	15.5	15.3	14.9
Shkalla e pjesëmarrjes në zhvillim prof. (CPD)	54	49	47.2	33.5	24.7

**TREGUESIT KRYESOR TË NDIKIMIT 2014-2017**

	2015	2016	2017	2018	2019
<b>Përfshirja në arsim</b>					
Shkalla bruto e përfshirjes parashkollor (3-5)	29.6	30.9	33.9	36	37.5
Shkalla bruto e përfshirjes fillor	96.4	94.7	96.2	98.4	100.3
Shkalla bruto e përfshirjes mesëm ulët	99.5	96	93.3	91.2	90.5
Shkalla bruto e përfshirjes mesëm lartë	84.5	84.9	88.1	90.2	86.8
Shkalla bruto e përfshirjes arsimit i lartë	55.5	62.4	67.2	69.4	
Shkalla e braktisjes së shkollimit të obligativ	0.1	0.2	0.2	0.1	
<b>Treguesit e Cilësisë dhe arritshmërisë</b>					
Arritshmëria mesatare PISA	378		-	-	-
PISA arritshmëria në matematikë	362		-	366	-
PISA arritshmëria në lexim	347		-	355	-
PISA arritshmëria në shkencë	378		-	365	-
Arritshmëria në Testin e Semimaturës	-	-	-	-	-
Arritshmëria në Testin e Maturës	63.1	62.6	58.4	61	60.9
<b>Treguesit e shpenzimeve në arsim</b>					
Shpenzimet në arsim në milion €	262.9	268	266.7	285.9	303.2
Shpenzimet në arsim si % e BPV (GDP)	4.5	4.4	4.3	4.2	4.3
Shpenzimet në arsim si % e buxhetit qeveritar	16.3	15.2	14.7	13.6	12.8
Granti Specifik për Arsim Komunal në milion €	190.7	191.7	197.2	206.6	-
Shpenzimet në Arsim Parauniversitar në milion €	215.3	218.3	216.3	234.1	249.5
Shpenzimet në Arsim të Lartë në milion €	47.6	49.7	50.3	51.8	53.7

Burimi: SMIA/MASHT (2019), ASK (2019), Ministria e Financave (2019)

## 4.3 Rekomandime të përgjithshme

***Të avancohet praktika e matjes, analizës dhe reflektimit mbi rezultatet e arritshmërisë*** së nxënësve në nivel qendror, komunal dhe shkollor - Publikimi i rezultateve të arritshmërisë së PISA 2015, ka ndikuar në rritje të kërkesës së shoqërisë për arsim më cilësor. Në kuadër të rezultateve dokumentohen rezultate krahasimisht të ulëta në arritshmëri të përgjithëshme, matematikë, shkencë dhe lexim. Vlerësime të ngjashme janë nxjerrë edhe nga vlerësimet e vazhdueshme të jashtme të arritshmërisë së nxënësve në Testin e Semimaturës dhe Maturës. Këto zhvillime kanë kushtëzuar ndryshime të theksuara në paradigmen e menaxhimit të sistemit arsimor. Kërkesa për rezultate dhe llogaridhënie, resurset e kufizuara dhe presioni i vazhdueshëm demografik, e bëjnë të domosdoshme fuqizimin e një sistemit të integruar të planifikimit, raportimit dhe vlerësimit. MASHT ka ndërtuar kapacitete të theksuara në dokumentim të inputeve në sistemin arsimor. Sidoqoftë, kërkohet *ripërqëndrim* të vëmendjes në dokumentim të vazhdueshëm të *outputeve* të sistemit. Kjo e bën të nevojshme edhe ndërtimin e kapaciteteve organizative dhe njerëzore për planifikim, komunikim me komunat, komunikim me Agjencitë e pavaruara dhe Ministrinë tjera të linjës për avancim të administrimit të sistemit.

***Të zhvillohet dhe avancohet kapaciteti për ndërlidhje ndërmjet shkollimit dhe konkurrueshmërisë ekonomike*** - Kosova është përkushtuar për avancim të konkurrueshmërisë si mjet drejt përmirësimit të standardit jetësor. Të njëjtat prioritetë janë listuar edhe në kuadër të Agjendës së Reformës Evropiane, Planit për Zbatim të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit, Planit për Zhvillim Kombëtar dhe Programit për Reforma Ekonomike. *Përfshirja në arsim, relevanca e programeve të studimit dhe cilësia e tyre janë input thelbësor në ndërtim të kapitalit njerëzor.* Përparimi në dimensionin e kapitalit njerëzor është tejet i rëndësishëm për të eksploruar potencialet tjera ekonomike të vendit në industri nxjerrëse, energji, bujqësi, prodhim dhe shërbime. Kjo është bërë edhe më urgjente në saje të ekspozimit të ekonomisë së vendit ndaj presionit konkurrues global. Në kuadër të Raportit të OECD mbi Konkurrueshmërinë në Evropën Juglindore dhe Studimit të Bankës Botësore mbi Mjedisin Biznesor dhe Performancën e Ndërmarrjeve nënvizohet shkallë e ulët e produktivitetit të fuqisë punëtore dhe mungesë e shkathësive relevante për tregun e punës.

***Të përshpejtohet procesi i përmbushjes së prioritetëve që dalin nga Agjenda e Reformës Evropiane dhe Marrëveshjes për Stabilizim Asocim*** - Në kuadër të procesit të Integritimit Evropian, Kosova është përkushtuar për rritje të kapacitetit financiar, administrativ dhe njerëzor në adresim të prioritetëve që dalin në dimensionin e arsimit dhe shkencës. Viteve të fundit është rritur vetëdija mbi nevojën e luftimit të fenomenit të braktisjes së shkollimit. *Shkalla e braktisjes është në nivele të krahasueshme me vendet e avancuara.* Shkalla e pjesëmarrjes në arsim të obliguar është pothuajse universale. Sfidat e shkollimit dhe përfshirjes së femrës në arsim është tejkalar duke arritur paritet gjinor. Megjithatë, *shkalla e përfshirjes së grupeve të ndjeshme shoqërore nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian është ende e ulët krahasuar me mesataren kombëtare.* Në anën tjetër, përmirësimi i cilësisë së arsimit është ngushtë i lidhur me vitet e ndjekjes së shkollimit dhe shkallës së përfshirjes në arsim parashkollor. Shkalla e përfshirjes në edukim parashkollor vazhdon të jetë e ulët dhe nën mesataren e vendeve të OECD.

***Të zbatohet një sistem i binjakëzimit të modelit arsimor me vende simotra me sisteme të avancuara shkollore*** - Në bazë të analizave ekonometrike, shkalla e arritshmërisë dhe cilësisë në arsim është e ndërlidhur me nivelin e përfshirjes në edukim parashkollor, shkallën e financimit për kokë nxënësi, nivelin e përgjithëshëm të të hyrave për kokë banori, shkallën e kualifikimit të mësimitdhënësve, cilësia e kurrikulës dhe mësimitdhënies, cilësia e resurseve arsimore dhe infrastrukturës dhe modeli i administrimit të shkollës. Përparimi në arsim është domosdoshmërisht i ndërlidhur me nivelin e përgjithshëm të përparimit politik, shoqëror dhe ekonomik. Një pjesë e faktorëve që ndikojnë në arritshmëri dhe cilësi arsimore varen nga politikëbërja dhe administrimi. *Kapaciteti për të planifikuar politikën, monitoruar progresin dhe vlerësuar efektshmërinë duhet të rritet.* Duhet të bëhet analizë më e thellë për të dokumentuar modelet e sukseshme

arsimore të vendeve më madhësi të ngjashme të administratës dhe popullsisë. Estonia dhe Letonia janë shembuj për t'u eksploruar për shkak të arritshmërisë së lartë të nxënësve me shpenzime më të kufizuara se vendet tjera të OECD.

***Të rritet niveli i shpenzimeve të përgjithshme në arsim së paku 4.8 % e BPV/GDP .*** Përgjithësisht, shkalla e shpenzimeve arsimore në arsim është ende e ulët. Shpenzimet kombëtare në arsim në raport me shpenzimet e përgjithshme qeveritare dhe në raport me bruto produktin kombëtar janë të krahasueshme me trendet botërore. Sidoqoftë, Kosova ka strukturë të ndryshme të popullsisë dhe pjesëmarrje të lartë të popullsisë së re. *Numri i nxënësve është pothuajse dyfishi i vendeve me numër të ngjashëm të popullsisë në Evropë.* Kjo e bën të domosdoshme rritjen e shpenzimit në sektor. Rritja e shpenzimeve në arsim vitet e fundit është destinuar kryesisht për të rritur barrën e financimit të rrogave të mësimitdhënësve.

***Të prioritetizohet investimi në përfshirje në edukim parashkollor, komuniteteve, nxënësve me nevoja të veçanta dhe resurse mësimore*** - Mësimdhënësit në Kosovë kanë arritur kompensim adekuat krahasuar me të ardhurat mesatare të popullsisë. Rritja e pagave duhet të ndërlihet me një sistem të verifikueshëm të rritjes së performancës së mësimitdhënësve. Gjithashtu, *rritja e shpenzimeve në arsim duhet të prioritetizoj* përfshirjen e grupeve të ndjeshme shoqërore dhe nxënësve me nevoja të veçanta. Financimet shtesë në sektor duhet të orientohen edhe në rritje të kapacitetit absorbues në edukim parashkollor. Arsimi profesional është tejet i rëndësishëm dhe kërkon investime shtesë në infrastrukturë dhe mjete të konkretizimit. Financimi i arsimit të lartë është i orientuar vetëm në mësimdhënie. Kjo duhet të ndryshoj përmes miratimit të një formule të re të financimit që shpërblen kërkimin shkencor dhe ofrimin e studimeve në sferat deficitare për ekonominë e vendit.

***Si rezultat i zhvillimeve demografike numri i nxënësve pritet të bie në nivelin e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët dhe plani i ardhshëm duhet të përfshij obektiva rreth akomodimit të këtij zhvillimi përmes optimizimit të rrejtit të shkollave dhe optimizimit të numrit të mësimdhënësve*** - të dhënat e projeksioneve të popullsisë nënvizojnë një trend në rënie të numrit të nxënësve në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar. Ky zhvillim vjen paralel me lëvizjet e brendshme të popullsisë nga fshati në qytet dhe nga njëra komunë në tjetrën. Rënia e numrit të nxënësve krijon parakushte për rritje të eficiencës në sistem dhe kursime financiare. Objektiv i ardhshëm duhet të konsistoj në optimizim të numrit të mësimitdhënësve dhe optimizimit të numrit të shkollave. Kursimet nga arsimi parauniversitar do të mund të shërbenin për rritje të kapacitetit për rritje të përfshirjes në edukimin parashkollor.

***Përmirësimi i sistemit të të dhënave statistikore dhe ndërlihdja e tyre është esenciale për të ngritur kapacitetin për planifikim të bazuar në evidencë dhe për monitorim të performancës*** së sistemit arsimor - Sistemi për Menaxhim të Informatave në Arsim (EMIS) duhet të rishikohet në mënyrë që të sigurohet kapacitet i shtuar teknologjik dhe strukturor për mbledhjen e të dhënave më të detajuara në lidhje me performancën e nxënësit, mësimitdhënësit dhe shkollës. Në anën tjetër, duhet përqëndruar vëmendja edhe tek zhvillimi i një sistemi për të dhënat në lidhje me kërkimin shkencor dhe zhvillimit, mësimin tërëjetësor dhe ndërlihdjen e të dhënave me ASK dhe Ministrinë e Punës. Duhet përmirësuar kapaciteti për mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave të aspektit social dhe gjinor që ndikojnë në regjistrimin dhe arritshmërinë e nxënësve dhe studentëve.

***Të avancohet kultura e sigurimit të cilësisë dhe të fuqizohet autonomia e shkollës për të adresuar sfidat që dalin nga vlerësimi i jashtëm i nxënësve, shkollës dhe mësimitdhënësve*** - Plani i ri duhet të parasheh ndërtimin e strukturës institucionale dhe praktikës së vlerësimit periodik dhe ad-hoc të shkollave në nivelin parauniversitar. Ky proces duhet të përfshij vlerësim sistematik të të gjitha shkollave dhe publikim të rezultateve që dalin nga vlerësimi i menaxhimit të shkollës, menaxhimit financiar, zbatimit të kurrikulës, metodave të mësimitdhënies dhe mësimnxënies, kuadrit dhe kualifikimeve të mësimitdhënësve, mjedisit mësimor dhe



infrastrukturës, resurseve mësimore (teksteve dhe laboratorëve) dhe bashkëpunimit të shkollës me palët e interesit. Krahas vlerësimit të jashtëm, vëmendje shtesë duhet përqëndruar edhe tek promovimi i praktikës së menaxhimit të brendshëm të cilësisë dhe përfshirjes së të gjitha palëve të interesit në përmirësim të cilësisë në shkollë, sidomos të prindërve.

**Zbatimi i sistemit të vlerësimit të performancës** së mësimdhënësve, **liencimit dhe skemës së gradimit me shkallën e pagesave të mësimdhënësve është tejet i rëndësishëm si masë për promovim të ekselencës në mësimdhënie** - procesi i licencimit të mësimdhënësve është inicuar mirëpo i njeiti nuk është zbatuar në tërësi. Viteve të fundit janë përpiluar dhe miratuar udhëzimet administrative në lidhje me vlerësimin e performancës dhe zhvillimit profesional të mësimdhënësve. Megjithatë, procesi ka shkuar me hapa të ngadalshëm dhe nuk është ndërlidhur me Skemën e Pagesave të Mësimdhënësve në kuadër të Ligjit për Paga në Sektorin Publik (2019). Promovimi i ekselencës në mësimdhënie kërkon eliminimin e praktikës së rritjes lineare të pagesave të mësimdhënësve dhe ndërtimin e një sistemit të qëndrueshëm për mbështetjen dhe matjen e zhvillimit profesional të mësimdhënësve.

**MASHT duhet të përfundoj dhe zbatoj formula të reja financimi që promovojnë performancën** në arsimin parashkollor, arsimin profesional, arsim të të rriturve, arsimin e lartë dhe shkencës – ende nuk ka një strukturë dhe modele të reformura të financimit për arsimin e lartë dhe arsimin profesional. Formula e financimit duhet të kategorizohet në atë mënyrë që akomodon nevojat e ndryshme të profileve të arsimit profesional dhe promovon performancën në arsim të lartë. Po ashtu, MASHT duhet të shqyrtoj formën adekuate të ndërlidhjes së financimit të kërkimit shkencor në kuadër të institucione të arsimit të lartë për të inkurajuar si kërkimin shkencor ashtu edhe ndërlidhjen e edukimit, kërkimit shkencor dhe inovacionit. Ende nuk ka provizione të qarta në lidhje me modalitetet e financimit publik të arsimit tërëjetësor.

**MASHT duhet të rris përpjekje për të promovuar një mjedis të sigurtë dhe miqësor për nxënësit në arsimin parauniversitar me qëllim të adresimit të sfidave që dalin nga gjetjet e OECD PISA 2018** - Një pjesë e konsiderueshme e nxënësve janë subjekt i bulizimit të vazhdueshëm në shkolla. Praktika e ikjes dhe mungesa në orë mësimore, mungesa e vëmendjes së nxënësve në shkollë shenjojnë sfida në mjedisin e brendshëm shkollor. Plani i ri duhet të adresoj fenomenin e bulizimit në shkollë, adresoj sfidat në disiplinë shkollore dhe siguroj përfshirje më të lartë të prindërve në mbështetjen e fëmijëve të tyre.

## 5. Financimi i Arsimit

### 5.1 Planifikimi buxhetor në arsim

*Kosova ka një strukturë ekstensive të linjave buxhetore, të cilat mund të jenë të përshtatshme për kontrollim të shpenzimeve në nivel të zërave kontabël të shpenzimeve (kategorive ekonomike).* Buxhetimi është më tepër i bazuar në prioritizimin e institucioneve se sa të politikave arsimore gjë që njihet si buxhetim i bazuar në të hyra “inpute”. Kjo do të thotë, se ky buxhetim nuk mundëson matjen e drejtpërdrejtë të të hyrave që ndërlidhen me realizimin e një politike/programi si dhe koston përkatëse. Një situatë e tillë sjellë në pikëpyetje efektivitetin e shpenzimeve publike si dhe vështirëson matjen e suksesit/performancën e një politike të caktuar karshi fondeve të shpenzuara për atë politikë.


Përkundër përpjekjeve pozitive, viteve të fundit për të strukturuar më mirë buxhetin e arsimit në KASH dhe Buxhetin 2016-2019, akoma ekziston nevoja për përmirësime për të zbatuar qasjen sektoriale në planifikimin afatmesëm, nëpërmjet KASH në sektor që do të pasqyrohet në buxhet. MASHT, po ashtu, nuk ka kontroll të plotë mbi financimin e sektorit të arsimit. Pjesë të konsiderueshme të parave të sektorit ndahen në mënyrë të drejtpërdrejtë për komuna apo për Universitetin e Prishtinës, ndërsa MASHT nuk mund ta kontrollojë në mënyrë efektive këtë proces të ndarjes së mjeteve. Pra, vetëm rreth 20% e financimit të sektorit kalon nëpërmjet alokimit të drejtpërdrejtë nga buxheti i MASHT-it. Për këtë arsye, të dhënat themelore mbi performancën dhe ndërlidhja e strukturës buxhetore me prioritetet e PSAK bëhet kryesisht ex-post. Përlllogaritja e treguesve të shpenzimeve dhe niveleve arsimore bëhet përmes një procesi kompleks të përlllogaritjeve dhe kryesisht për nevoja të vlerësimit.

Menaxhimi i të hyrave vetjake në sistemin e arsimit është i fragmentuar. MASHT-i, nuk i kanë të dhënat e plota të hyrave të mbledhura, prandaj shfrytëzimi efikas i tyre në sistemin e arsimit është diskutabil, në veçanti në arsimin e lartë. E dyta ka të bëjë me mënyrën se si financohet niveli komunal i arsimit. Niveli lokal apo nivel komunal, i cili merret me arsimin parashkollor, arsimin fillor dhe të mesëm, përbëhet nga dy burime kryesore - granti i destinuar i arsimit për shkollat në nivel komunal dhe grantit të infrastrukturës, i cili përdoret për investime të mëdha në infrastrukturë në nivel të shkollave. Ndarja e mjeteve vendoset çdo vit duke u bazuar në të dhënat që i marrin nga shkollat dhe komunat (DKA). Një pasqyrë e qartë dhe e vazhdueshme për monitorim të ndërlidhjes së shpenzimeve me projektet e listuara në PSAK 2017-2021 është tejet i vështirë. Gjithashtu, nuk ka ndonjë sistem monitorimi të vazhdueshëm të shkallës së kontributit vjetor të partnerëve zhvillimor dhe projekteve të tyre.

### 5.2 Financimi i përgjithshëm

Shpenzimet kombëtare në arsim në raport me shpenzimet e përgjithshme qeveritare dhe në raport me bruto produktin kombëtar janë të krahasueshme me trendet botërore. Shpenzimet e Kosovës në arsim shprehur si % e BPV/GDP ndërmjet 2016-2019 ishin rreth 4.4 % dhe sipas praktikave rajonale dhe vendeve të avancuara. Megjithatë, janë dy faktorë që ndikojnë në shpenzime më të ulta nominale – ekonomia e vogël dhe numri i lartë i nxënësve krahasur me vendet tjera. Kosova ka strukturë të ndryshme të popullsisë dhe pjesëmarrje të lartë të popullsisë së re. Numri i nxënësve është pothuajse dyfishi i vendeve me numër të ngjashëm të popullsisë në Evropë.

## Shpenzimet në arsim 2016-2019 shprehur në milion euro (MASHT, 2019)



Struktura e shpenzimeve në arsim dominohet nga kategoria e rrogave të personelit (rreth 75%) dhe shpenzimet rrjedhëse. Shpenzimet kapitale vazhdojnë të jenë tejet të ulëta.

### 5.3 Financimi i Arsimit Parauniversitar

Shkalla e financimit të përgjithshëm për arsimin parauniversitar në vitin 2019 është rritur për 14.4 % krahasur me vitin 2016. Kjo rritje manifestohet kryesisht në kategorinë e pagave/mëditjeve dhe mallërave/shërbimeve. Shpenzimet për kategorinë e mallërave dhe shpenzimeve janë dyfishuar.


Financimi i Arsimit Parauniversitar 2016-2019 sipas kategorive të shpenzimeve (million euro)

	2016	2017	2018	2019
Pagat dhe mëditjet	170,740,155	171,240,847	177,834,417	180,634,947
Mallrat dhe shërbimet	16,008,314	15,813,272	20,420,401	33,842,900
Shpenzimet komunale	3,023,335	2,973,440	2,978,184	3,673,989
Subvencionet dhe transferet	1,118,186	1,840,624	2,009,896	1,888,799
Shpenzimet kapitale	27,381,979	24,442,299	30,894,035	29,499,239
<b>Total</b>	<b>218,271,968</b>	<b>216,310,481</b>	<b>234,136,932</b>	<b>249,539,874</b>

Burimi: MASHT 2016-2019

Financimi në arsimin parauniversitar dominohet nga shpenzimet rrjedhëse (88.2%). Investimet kapitale ishin mesatarisht vetëm 11% e të gjitha shpenzimeve në arsim parauniversitar. Gjithashtu, shpenzimet për rroga të mësimdhënësve dhe stafit administrative përbëjnë shpenzimet kryesore (73 %). Nuk është vërejtur ndonjë ndryshim thelbësor në zëra buxhetor ndërmjet 2016-2019.

### Shpenzimet në arsim parauniversitar sipas kategorive ekonomike 2016-2019




Vështuar sipas niveleve të arsimit, shpenzimet më të mëdha i dedikohen arsimin fillor, pasuar nga arsimi i mesëm i ulët dhe arsimi i mesëm i lartë. Shpenzimet në edukim parashkollor janë dukshëm më të vogla. Granti specifik për arsim që alokohet nga Qeveria në baza vjetore përbën pjesën dërrmuese të të hyrave të komunave dhe shkollave. Shkalla e kontributeve vetjake të komunave mbetet tejte e ulët.

### Financimi i arsimit parauniversitar 2016-2019 sipas niveleve (ISCED)

	2016	2017	2018	2019
Niveli parashkollor (0-4)	5,872,592	6,432,574	7,299,673	9,119,469
Niveli parafillor (5)	12,458,587	14,138,970	16,052,218	16,792,284
Niveli fillor	75,161,264	79,267,351	84,177,474	91,605,714
Niveli i mesëm i ulët	70,166,879	63,692,742	68,954,074	73,401,574
Niveli mesëm i lartë	54,612,646	52,778,844	57,653,493	58,620,834
<b>Total</b>	<b>218,271,968</b>	<b>216,310,481</b>	<b>234,136,932</b>	<b>249,539,874</b>


Edhe pse shpenzimet në edukim parashkollor janë ende të ulëta krahasuar me nivelet tjera arsimore, shkalla e financimit për edukimin e hershëm të fëmijëve ndërmjet 2016-2019 pothuajse janë dyfishuar. Rritje e ndjeshme vërehet edhe në arsimin fillor. Shkalla e financimit për nivelin e mesëm të ulët dhe të lartë është rritur me ritëm shumë më të ngadalshëm.



Nevojitet analizë ekstensive dhe krahasim manual i të dhënave buxhetore për të nxjerrë një shifër të saktë të shpenzimeve të përgjithshme në arsimin profesional. Shkollat e mesme profesionale janë të buxhetuara në kuadër të nënprogramit “Arsimi i Mesëm” në nivelin komunal, ndërsa kohëve të fundit edhe në nivelin qendror, apo në MASHT është krijuar nënprogrami për arsimin profesional që përfaqëson Agjencinë për Arsimin dhe Aftësimin Profesional që përfshin edhe një numër shkollash të llojit të Qendrës së Kompetencës.

## 5.4 Financimi i Arsimit të Lartë dhe Shkencës


Me gjithë faktin që ka qenë e paraparë me PSAK dhe me Ligjin për Arsimin e Lartë, Kosova akoma nuk ka zhvilluar një metodologji për financimin e institucioneve të arsimit të lartë që nxitë efektivitetin dhe llogaridhënien. Sidoqoftë, nga viti 2011, financimi për arsimin e lartë është në rritje.



Shpenzimet publike për arsimin e lartë janë në kufi të standardeve evropiane, ndërkohë që shpenzimet për kokë studenti janë të ulëta për shkak të shtimit të numrit të studentëve.

Nga ana tjetër, një analizë e të dhënave të shpenzimeve sipas kategorive buxhetore, rezulton se 64% e buxhetit institucional shpenzohet për pagat e të punësuarve edhe pse të gjitha institucionet kanë mungesë të personelit akademik.

Shpenzimet në arsim të lartë/shkencë 2019 sipas kategorive



## 6. Zbatimi i Aktiviteteve të PSAK 2017-2021

Plani Strategjik i Sektorit të Arsimit është ndarë në shtatë objektiva strategjike për të cilat janë zhvilluar rezultate dhe aktivitete specifike:

1	Rritja e gjithëpërfshirjes dhe parandalimi i braktisjes
2	Përmirësimi i menaxhimit të sistemit arsimor përmes zhvillimit të kapaciteteve menaxhuese në nivelin qendror, komunal dhe të shkollës
3	Zhvillimi i një sistemi funksional për sigurimin e cilësisë në përputhje me standardet ndërkombëtare
4	Ngritja e cilësisë së mësimdhënies përmes sistemit efektiv dhe të qëndrueshëm për përgatitjen dhe zhvillimin profesional të mësimdhënësve
5	Avancimi i të nxëniet përmes mësimdhënies cilësore, duke zbatuar kurrikulën e bazuar në kompetenca dhe duke shfrytëzuar resurse mësimore të cilësisë së lartë
6	Harmonizimi i arsimit dhe aftësimin profesional me kërkesat e tregut të punës në vend dhe më gjerë dhe krijimi i një sistemi të hapur të arsimit për të rriturit
7	Ngritja e cilësisë dhe konkurrueshmërisë së arsimit të lartë përmes nxitjes së përsosmërisë në mësimdhënie, kërkimit shkencor, krijimtarisë artistike, inovacionit dhe ndërkombëtarizimit.

Në bazë të vlerësimit të përshkallëzuar të aktiviteteve, rezultateve dhe ndikimit nënsektorial është përlogaritur shkalla e përgjithshme e zbatimit të PSAK 2019.

PSAK 2019: Indeksi i performancës (1-5) sipas objektivave strategjike

#	Objektivi strategjik	%	Niveli
1	Pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja	55%	3.3
2	Menaxhimi i sistemit arsimor	53%	3.1
3	Cilësia në arsim	49%	2.9
4	Zhvillimi profesional mësimdhënësve	50%	3
5	Mësimdhënia dhe të nxëniet	47%	2.8
6	Arsimi profesional	53%	3.1
7	Arsimi i lartë dhe shkenca	45%	2.7
<b>Total</b>		<b>50%</b>	<b>3</b>

Përlogaritja është bërë duke agreguar indekset e zbatimit të rezultateve dhe përmes aplikimit të mesatares së ponderuar. Rreth 50 % përqind e aktiviteteve të planifikuara janë realizuar. Kjo përbën një ulje në intensitetin e zbatimit krahasur me vitin 2018. Shkalla më e lartë e aktiviteteve janë zbatuar në kuadër të objektivit strategjik, Pjesëmarrja dhe Gjithëpërfshirja (55%), Menaxhimi i Sistemit Arsimor (53%) dhe Arsimi Profesional (53%). Një shkallë më e ulët e aktiviteteve vërehet tek Arsimi i Lartë (45%), Mësimdhënia dhe të Nxëniet (47%) dhe Cilësia në Arsim (49%). Një përmirësim i theksuar është dokumentuar në trajtim të aktiviteteve tek objektivi strategjik i mësimdhënies dhe të nxëniet dhe menaxhimit të sistemit arsimor.

# Pjesëmarrja dhe Gjithëpërfshirja

Rritja e gjithëpërfshirjes dhe parandalimi i braktisjes në arsim kërkojnë kohë dhe nuk mund të arrihen pa zbatimin e plotë të kornizës ligjore. Prandaj, ky objektivi strategjik ka lidhje të qarta me aspekte të tjera të PSAK-ut, në veçanti me krijimin e një sistemi të integruar për mbledhjen, përpunimin dhe përdorimin e të dhënave që gjithashtu do të mundësojë monitorimin e fëmijëve me nevoja të veçanta dhe fëmijët që braktisin shkollën, si dhe me përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, si përmes ofrimit të programeve të trajnimit për gjithëpërfshirje, ashtu edhe përmes zbatimit të ideve dhe qëllimeve themelore të KKK-së

## Rezultatet:

- Përfshirja në edukimin parashkollor cilësor arrin në 20% të fëmijëve të moshës 0-5
- Të gjithë fëmijët e moshës 5-vjeçare përfshihen në edukimin cilësor parafillor
- 50% e fëmijëve me nevoja të veçanta janë përfshirë në sistemin arsimor parauniversitar
- Përfshirja e fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin fillor është rritur për 10%, ndërsa në arsimin e mesëm të ultë dhe të lartë për 20
- Përfshihen të gjithë fëmijët e ri-atdhesuar në sistemin arsimor dhe fuqizohen mekanizmat për organizimin e mësimin në diasporë
- Ekzistojnë mekanizma efektivë për parandalimin e braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollë në arsimin parauniversitar
- Ekzistojnë mekanizma dhe programe për identifikimin dhe përkrahjen e fëmijëve me potencial të jashtëzakonshëm intelektual dhe me talente të veçanta në fusha akademike, kreative e artistike
- Ekzistojnë mekanizma e politika efektive të krijuara për promovimin e diversitetit përmes një sistemi të integruar arsimor



## 6.1 Pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja

Kosova ka arritur shkallë të lartë të përfshirjes në arsimin parauniversitar - përfshirja ende nuk është universale dhe ende mbeten grupe të vogla shoqërore që nuk janë përfshirë në sistem. Gjatë vitit të fundit Kosova ka shënuar ngritje të përfshirjes në edukimin parashkollor dhe parafillor. Kjo ka ardhur në sajë të integritimit të një numri të theksur të fëmijëve në edukim parashkollor nga sektori jo-publik dhe investimet publike në disa komuna. Shkalla bruto e regjistrimit në arsimin parashkollor në vitin shkollor 2018/2019 është rritur në 20% apo për 0.9% ngritje krahasuar me vitin paraprak. Që nga miratimi i PSAK në vitin shkollor 2016/2017, shkalla e përfshirjes në arsim parashkollor është rritur për 3.6%. Ky përparim i lehtë është funksion i rritjes së përfshirjes së fëmijëve (0-5) në sektorin privat dhe rënies demografike.

Gjithëpërfshirja - Progresi në rezultatet e synuara 2019 shprehur sipas shkallës së zbatimit 1-5 dhe %

Rez	Pershkrimi	%	Niveli
1	Përfshirja në edukim parashkollor arrin në 20%	62%	3.7
2	Përfshirje në edukim parafillor për të gjithë nxënësit	50%	3
3	Është rritur përfshirja e nxënësve me nevoja të veçanta në 50%	67%	4
4	Përfshirja e komunitetit rom, ashkali, egjiptian është rritur për 10-20%	47%	2.8
5	Përfshihen të gjithë fëmijet e ri-atdhesuar dhe organizohet mësimi në diasporë	62%	3.7
6	Ekzistojnë mekanizma për parandalim të braktijes	64%	3.8
7	Ekzistojnë mekanizma për identifikimin e fëmijëve me potencial të jashtëzakonsh.	47%	2.8
8	Ekzistojnë mekanizma për promovim të diversitetit	47%	2.8
<b>Total</b>		<b>55%</b>	<b>3.3</b>

Kosova ka arritur progres të theksuar në përfshirje të fëmijëve në edukimin parafillor (5 vjeç). Shkalla e përfshirjes në vitin 2019 (92.5%) është përtej synimit të shprehur në PSAK. Megjithatë, shkalla e përfshirjes të grup-moshave 0-4 vjeç ende mbetet shumë e ulët (6.2%). Shkalla bruto e përfshirjes së fëmijëve në arsimin fillor është 100 % dhe ka rrjedhur sipas dinamikës së planifikimit vjetor. Në anën tjetër, shkalla e përfshirjes së nxënësve në arsimin e mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë ka shënuar regres. Shkalla bruto e regjistrimit në arsimin e mesëm të ulët në vitin shkollor 2018/2019 ishte 90.5 % krahasuar me 96% në vitin shkollor 2016/2017. Nuk është shënuar ndonjë progres në rritje të shkallës së përfshirjes në arsimin e mesëm të lartë. Shkalla e përfshirjes në vitin 2018/2019 ishte 86.8 % apo një përmirësim prej 1.9% krahasuar me vitin shkollor 2016/2017.

### 6.1.1 Përfshirja në edukimin parashkollor

**Rezultati (1.1) i objektivit strategjik mbi gjithëpërfshirjen dhe pjesëmarrjen synon që të rris përfshirjen në edukimin parashkollor të gru-pmoshave 0-5 vjeç nga 15.7% në vitin 2015/2016 në 20% në vitin 2020/2021.**

Në kuadër të kornizës së performancës nuk janë specifikuar fazat vjetore të arritjes së synimit. Për të përmbushur këtë synim, Plani i Veprimit specifikon një seri të aktiviteteve: stimulimin e hapjes dhe akreditimit të institucioneve private dhe qendrave me bazë në komunitet nga ana e komunave, hartimin dhe zbatimin e programit për aftësimin e edukatorëve në shërbim, zhvillimin e programeve për vetëdijësimin e prindërve lidhur me fëmijërinë e hershme, organizimin e aktiviteteve për vetëdijësimin e shoqërisë për rëndësinë e edukimit parashkollor, pilotimin e kurrikulës së re parashkollore dhe zbatimin e kompetencave për edukatore që punojnë me fëmijët e moshës 3-5 vjeç. Synimi për të rritur përfshirjen e grup-moshës 0-5 vjeç do të duhej të rishikuar në mënyrë që të standardizohet sipas parametrave ndërkombëtar. Është më e zakonshme që planet strategjike të ngjashme në vendet e avancuara të synojnë rritjen e përfshirjes së grup-moshës 3-5 vjeç. Stadi zhvillimor i sistemit arsimor ka nevojë të proritizoj përfshirjen e grup-moshave 3-5 vjeç. Aktivitetet e listuara çuditërisht nuk inkorporojnë aktivitete bazë kongruente me kërkesat e arritjes së qëllimit. Nuk specifikohen qartë investimet publike në numër të edukatoreve, investimet infrastrukturore dhe numri i fëmijëve që do të përfshihen në proces.


Në lidhje me aktivitetet e parapara për rritjen e përfshirjes së fëmijëve në edukim parashkollor, gjatë vitit 2017, MASHT me mbështetje nga UNICEF ka punuar në procesin e hartimit të kurrikulës bërthamë për edukim parashkollor. Në vitin 2018 është përfunduar dhe propozuar kurrikula bërthamë për edukimin parashkollor për fëmijet 0-5 vjeç. Megjithatë, pas konsultimit publik në vitin 2019 mbetet të finalizohet dhe filloj pilotimi i këtij dokumenti. Në vitin 2018 është miratuar Konceptdokumenti për Ligjin për Edukim Parashkollor dhe është vendosur në platformën e diskutimit publik. Pas miratimit të Konceptdokumentit për Hartimin e Ligjit për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme, në vitin 2019 është nxjerr vendimi për themelimin e grupit punues për hartimin e Ligjit me nr 2-204 /2019. UNICEF dhe Save the Children kanë mbështetur MASHT në shqyrtimin e praktikave rajonale dhe modelet tjera evropiane gjatë finalizimit të Ligjit. Gjatë 2019 është rishikuar UA për Themelimin e institucioneve edukativo-arsimore dhe janë finalizuar kriteret dhe procedurat e themelimit dhe pushimit të veprimtarisë së institucioneve të arsimit parauniversitar përfshirë provizionet për institucioneve parashkollore.

Në kuadër të aktivitetit për ngritje të kapacitetit të edukatoreve në nivelin parashkollor, MASHT gjatë vitit 2017 dhe 2018 mbështetje të "Save dhe Children" ka hartuar Module trajnimi për aftësimin e edukatoreve në shërbim që punojnë me fëmijët 0-3 vjeç. Divizioni për Edukim të Hershëm dhe Parashkollor (MASHT) gjatë vitit 2019 ka ri funksionalizuar Kolegjiumin e drejtorëve të institucioneve parashkollore. Kolegjiumi ka mbajtur takime me drejtorët e institucioneve parashkollore publike dhe ka draftuar Plani Zhvillimor për Institucionet Parashkollor. Gjithashtu, me qëllim të rritjes së vetëdijes dhe koordinimit të aktiviteteve që kanë të bëjnë me zhvillimin dhe investimet në fëmijërinë e hershme, MASHT me përkrahje të UNICEF dhe Caritas Zvicrran, ka funksionalizuar Trupin Këshillues për Kujdesin, Zhvillimin dhe Edukimin në Fëmijërinë e Hershme (KZHEFH). Ky trup mbledh institucionet qendrore, lokale, partnerët zhvillimor, drejtues të institucioneve parashkollore, përfaqësues të prindërve dhe institucioneve të arsimit të lartë.

Gjatë vitit 2018, MASHT ka themeluar një institucion parashkollor në komunën e Gjilanit me kapacitet për të regjistruar 120 fëmijë, ndërsa në Suharekë janë themeluar paralelet e ndara në kuadër të institucionit parashkollor 'Flutrat' për përfshirjen e fëmijëve të grup-moshave 3-5. Gjatë periudhës ka vazhduar bashkëpunimi me partnerë zhvillimor për kompletim të 1 çerdhe në komunën e Prishtinës me financim të BE-së, 6 çerdhe janë në ndërtim me financim të MASHT në Prishtinë, Klinë, Shtime, Kaçanik, Rahovec dhe


Prizren. Po ashtu, gjatë 2018 MASHT me mbështetje të BE-së ka bërë planet për hapje të 6 çerdheve tjera në Pejë, Skenderaj, Obiliq Glllogovc dhe Prishtinë. Gjatë vitit 2019 janë hapur 4 qendra të reja me bazë në komunitet në Gjakovë, Dragash, Lipjan dhe Gjilan. Qendrat sigurojnë përfshirjen e 110 fëmijëve në edukim parashkollor. Aktivitet tjetër që i kontibon ngritjes së cilësisë dhe përfshirjes në edukimin e hershëm është edhe fillimi i bashkëpunimit të MASHT me Bankën Botërore. Është një studim gjithpërfshirës, për zhvillimin e edukimit në fëmijërinë e hershme në Kosovë, me fokus të veçantë: edukimin, shëndetin, kujdesin dhe mirëqenien e fëmijëve të moshës 0-6 vjeç, programet për prindërit dhe projektimi i investimeve për këtë nivel arsimor në vitet në vazhdim.

Numri i nxënësve parashkollor (0-4 vjeç) - 2014-2020




Numri i fëmijëve në edukim parashkollor pothuajse është dyfishuar ndërmjet periudhës 2015-2019. Një kontribut i rëndësishëm në rritje të përfshirjes është edhe sektori privat. Ndërmjet 2017-2019, MASHT ka licencuar 95 institucione private. Më shumë se gjysma e këtyre institucioneve (54) janë licencuar gjatë vitit 2019.

Shkalla e përfshirjes në edukim parashkollor (0-5 vjeç) 2015-2019 - Planifikuar/Arritur



Synimi në PSAK 2017-2019 për rritje të shkallës së përfshirjes në 20 % të fëmijëve 0-5 vjeç në edukim parashkollor/parafillor deri në vitin 2021 është arritur para kohe. Caku aktual duhet rritur nga 20 % në 20 % me qëllim të reflektimit të trendeve demografike, aktivitetit të shtuar të sektorit privat dhe zgjerimit të kapaciteteve të sektorit publik.

**Arritshmeria në PISA sipas moshës së përfshirjes në edukim parashkollor/parafillor - (OECD, 2019)**



Në analizën ekonometrike të ndikimit të edukimit parashkollor në arritshmëri të Testit PISA 2018 nënvizohet një anomali në rastin e Kosovës. Vitet e kaluara në edukim parashkollor nuk vërehet të kenë ndikuar në arritshmëri të nxënësve në Testin PISA 2018. Natyrisht, mungesa e ndërlidhjes ndërmjet viteve të kaluara në edukim parashkollor dhe rezultatin në vitin 2018 është reflektim i zhvillimeve në edukim parashkollor një dekadë më parë. Megjithatë, kjo hap pikëpyetje të reja potenciale mbi rolin dhe cilësinë e institucioneve parashkollore. Rritja e përfshirjes duhet të shkoj paralelisht me përpjekjet për të avancuar cilësinë e kurrikulës dhe stafit mësimdhënës.


Mbetet sfidë hartimi dhe finalizimi i kurrikulës bërthamë për edukimin në fëmijërinë e hershme dhe fillimi i pilotimit të këtij dokumenti. Duke ju referuar zhvillimit holistik të fëmijëve në moshën e hershme, mbetet sfidë “hartimi i planit kombëtar me qasje ndërsektoriale për zhvillimin e këtij niveli edukimi”. Licencimi i të gjitha institucioneve parashkollore private që veprojnë në Kosovë ende nuk është kompletuar. Gjithashtu, kërkohet rritja e shkallës së monitorimit dhe sigurimit të cilësisë në menaxhim dhe zhvillim të stafit edukativ të institucioneve private. Përcaktimi i lokacioneve të çerdheve të reja publike ka qenë sfidë ndërmjet 2017-2019. Komunitet nuk kanë vende urbane për ndërtimin e kopshteve si p.sh. Fushë Kosova, Prishtina dhe Lipjani dhe kanë humbur grante për shkak të mungesës së lokacioneve të kërkuara sipas kriterëve. Në anën tjetër, kërkohet rritje e shkallës së financimit për edukimin parashkollor dhe kalkulum i njejtë i grantit specifik për arsim për të gjithë fëmijët e arsimit parauniversitar, pa bërë dallime për fëmijët e institucioneve parashkollore, duke pasur parasysh specifikat e këtij niveli edukimi dhe qëndrimin ditor të fëmijëve në institucion.

## 6.1.2 Përfshirja në edukim parafillor

Rezultati (1.2) i objektivit strategjik mbi gjithëpërfshirjen dhe pjesëmarrjen synon që të rris përfshirjen në edukimin parafillor për të gjithë nxënësit.


Përfshirja e të gjithë fëmijëve të moshës 5 vjeç është rezultati i dytë i synuar në kuadër të objektivit strategjik të gjithëpërfshirjes. Plani i Veprimit liston disa aktivitete kryesore për të mundësuar arritjen e rezulttit të synuar: hapja e klasave të reja parafillore, aftësimi i edukatoreve për zbatimin e kurrikulës, hartimi i materialeve mësimore dhe didaktike të posaçme për klasën parafillore dhe krijimin e mekanizmit për monitorimin e cilësisë në edukimin parafillor sipas kompetencave të edukatoreve.

Kosova ka arritur progres të theksuar në përfshirje të fëmijëve në edukimin parafillor (5 vjeç). Shkalla e përfshirjes në vitin 2019 (92.5%) dhe nuk është larg synimit të shprehur në PSAK për të të gjithë fëmijëve 5 vjeçar në edukimin parafillor.



Gjatë 2018 dhe 2019, janë hapur 4 klasa të reja parafillore në zona urbane. MASHT me mbështetje të “Save the Children” ka hapur dhe 6 klasa të reja parafillore në zonat rurale të Kosovës. Me projektin e Caritasit zviceran gjatë periudhës 2017-2019, janë pajisur me inventar dhe materiale mësimore 150 klasë parafillore.

Gjatë viteve të fundit është regjistruar një rënie e numrit të fëmijëve parashkollor. Në vitin 2019 kishte rreth 23,650 nxënës krahasuar me 24,002 në vitin 2017. Kjo rënie prej rreth 350 nxënës mund të jetë shkak i rënies demografike të regjistruar viteve të fundit në Kosovë.



Në dispozitat kalimtare të Ligjit për Arsimin Parauniversitar thuhet që edukimi parafillor që nga viti 2015/2016 do të mund të bëhet i detyrueshëm nëse krijohen kushtet. Shumica e shkollave ka siguruar hapësirë për zhvillimin e edukimit parafillor. Megjithë progresin e arritur, ende vlerësohet se rreth 8% e fëmijëve mbesin jashtë edukimit parafillor, kryesisht nga komunitet jo-shumicë dhe zonat e lagëta rurale.

### 6.1.3 Përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta

Përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta adresohet në kuadër të Rezultatit 1.3. 50% e fëmijëve me nevoja të veçanta janë përfshirë në sistemin arsimor parauniversitar

Përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta adresohet në kuadër të Rezultatit 1.3. 50% e fëmijëve me nevoja të veçanta janë përfshirë në sistemin arsimor parauniversitar. Për të arritur rezultatin, Plani i Veprimit liston disa aktivitete kryesore: përcaktimi i treguesve për fëmijët me nevoja të veçanta në SMIA, funksionalizimi i ekipeve vlerësuese pedagogjike, trajnimi i personelit për punë me fëmijët me nevoja të veçanta, shndërrimi i klasave të bashkangjitura në Qendra Burimore dhe fuqizimi i mekanizmave për mbështetjen e shkollës. Sipas PSAK, zbatimi i këtyre aktiviteteve në baza vjetore do të mund të arrijnë synimin që 50% e fëmijëve me nevoja të veçanta të jenë përfshirë në arsimin gjithëpërfshirës. Sidoqoftë, ashtu siç potencohet edhe në dokumentin e planifikimit, numri i saktë i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe shkalla e përfshirës së tyre nuk dihen. Kjo për shkak se që nga shpallja e rezultateve të regjistrimit të popullsisë nuk është hasur në të dhëna që dokumentojnë numrin e tyre, llojin e dëmtimit dhe regjionet.

Gjatë vitit 2018, është hartuar pako dhe realizuar harmonizimi i dokumentacioni pedagogjik për të gjitha qendrat burimore. Pakoja përfshin rregullore të brendshme, dokumente, vërtetime dhe dokumente tjera që qendrat burimore përdorin në punën e tyre. Qëllimi ishte harmonizimi dhe përshtatja e dokumenteve, nevojave dhe specifikave të qendrave burimore. Janë hartuar instrumentet e standardizuara për vlerësimin pedagogjik të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe ka filluar pilotimi i tyre. Instrumentet janë të bazuara në Internacional Classification Functioning Children & Youth ICF/ Klasifikimi ndërkombëtar për Funksionalitet për Fëmijë dhe të Rinjtë. Gjatë vitit 2019, kanë përfunduar dhe janë publikuar instrumentet për vlerësimin pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta dhe janë pilotuar 7 komuna dhe 14 shkolla. Gjithashtu, është

hartuar raporti i detajuar i procesit të hartimit të instrumeneve për vlerësimin pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta. “Save dhe Children” ka mbështetur MASHT në hartimin e treguesve për fëmijët për aftësinë e kufizuar funksionale, pjesëmarrjen në shkollë, të mësuarit në shtëpi dhe mirëqenia të cilat duhet të integrohen në SMIA.

Gjatë vitit 2018, janë hartuar parametrat e financimit për nxënësit me nevoja të veçanta dhe formula shërben për ndarjen e buxhetit sipas llojeve të aftësisë së kufizuar dhe sipas shkallëve të aftësisë së kufizuar (e lehtë e mesme dhe e rëndë, shumëfishtë). Në vitin 2019, granti specifik për arsim komunal ka përfshirë një politikë të re të punësimit të 100 asistentëve. Komunitatet kanë marrë qarkoren e parë buxhetore, ku janë përfshirë edhe asistentët për punë pedagogjike me fëmijët me aftësi të kufizuara. Deri në fund të vitit 2019 kishte 70 asistentët të punësuar në të gjitha komunitatet, me përjahtim të Prishtinës, Fushë Kosovës, Lipjanit dhe Gjiçanit.

Ndërmjet periudhës së planit të aktiviteteve 2018-2019, janë trajnuar dhe certifikuar 711 mësues dhe edukatore nga 7 shkollat dhe 1 çerdhe në 3 module me gjithsej 9 dite trajnime për arsim gjithëpërfshirës. Modulet janë përgatitur nga Universiteti i Cyrihut dhe me përkrahje nga UNICEF dhe MASHT. Po ashtu, GIZ ka mbështetur trajnimin e 90 mësuesve lidhur me Planin Individual të arsimit (PIA). Në vitin 2019, është organizuar konferenca “Gjithëpërfshirja për të gjithë fëmijët” në bashkëpunim me Fakultetin e Edukimit (UP) dhe UNICEF. Konferenca ka trajtuar tema të ndryshme që lidhen me arsimin gjithëpërfshirës me fokus të nxënësit me nevoja të veçanta dhe ka nxjerrë rekomandimet për përmirësim të përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta në sistemin arsimor. Gjithashtu, janë hartuar programet për gjuhën e shenjave dhe shkrimin e Brajlit në bashkëpunim me qendrën burimore për nxënësit me dëmtime në të parë “Xheladin Deda” dhe qendrën burimore për nxënësit me dëmtime në dëgjim “Nënë Tereza”. Programi është në proces të akreditimit nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK).

Klasat e bashkëngjitura në shkollë vendi janë zvogëluar nga 76 sa kanë ekzistuar numri ka rënë në 18 klasë. Këto klasa planifikohet të shndërrohen në dhoma burimore sapo këta nxënës të përfundojnë klasën e nëntë pasi që integrimi i tyre në klasa të rregullta ka qenë i pamundur për shkak të moshës dhe shkallës së rëndë të aftësisë së kufizuar. Kjo mënyrë e tranzicionit të klasave të bashkëngjitura është bërë konform UA për shndërrimin e klasave të bashkëngjitura në dhoma burimore.

#### 6.1.4 Përfshirja e komuniteteve

**Rezultati 1.4. Përfshirja e fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin fillor është rritur për 10%, ndërsa në arsimin e mesëm të ulët dhe të lartë me 20%**

Në kuadër të rezultatit është mëtuar të rritet shkalla e përfshirjes së komuniteteve dhe të arrihet nivelizimi me trendet e përgjithshme të komunitetit shumicë. Në rast se analizohet për nga numri i nxënësve të përfshirë në nivele të ndryshme shkollore të arsimit parauniversitar atëherë kemi rritje të numrit të nxënësve të etnisë romë, ashkali dhe egjiptian në sistemin arsimor.

Komunitetet boshnjak, turk, rom, ashkali dhe egjiptian janë të integruar në sistemin e arsimit të Kosovës. Mësimi në Kosovë zhvillohet në katër gjuhë (gjuhë shqipe, serbe, boshnjake dhe turke) në të gjitha nivelet të arsimit; prej atij parashkollor deri në nivelin universitar/superior. Struktura etnike e nxënësve dominohet nga nxënës të etnisë shqiptare me rreth 95.8 % për qind. Numri i nxënësve të etnisë serbe duhet të jetë më i lartë, mirëpo të dhënat nuk raportohen në mënyrë konsistente nga komunitatet me shumicë serbe në Kosovë.



Table: Numri i nxënësve RAE në arsimin parauniversitar 2015-2019

	2015	2016	2017	2018	2019
Ashkalinje	3529	3866	3729	3949	4121
Rom	1853	1558	2002	1802	1385
Egjiptian	704	852	939	1088	1252
<b>Total RAE</b>	<b>6,086</b>	<b>6,276</b>	<b>6670</b>	<b>6,839</b>	<b>6758</b>
<b>Total RAE + shkolla serbe</b>	<b>6208</b>	<b>6331</b>	<b>6758</b>		

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës 2013-2019. Të dhënat (2015-2017) përfshijnë edhe nxënësit e komuniteteve në shkollat në gjuhën serbe në Kosovë.

Numri i nxënësve të komunitetit ram, ashkalinj dhe egjiptian kishte trend pozitiv të rritjes ndërmjet 2015-2018. Në vitin 2019, janë raportuar 6758 nxënës të këtyre komuniteteve në të gjitha nivelet arsimore, një rënie prej rreth 80 nxënës më pak krahasur me vitin paraprak. Nuk është evidente shkaku i rënies dhe nëse kjo ndërlidhet me rënien e përgjithshme të nxënësve në Kosovë. Të dhënat e nxënësve të përfshirë në shkollat në gjuhën serbe nuk janë raportuar në vitet e fundit.

Me qëllim të ngritjes të nivelit arsimor, nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian çdo vit shkollor ndërmjt 2017-2019 kanë lehtësime për regjistrimin në kl. 10, në shkolla profesionale dhe gjimnaze, pavarësisht nga suksesi në shkollën fillore dhe rezultateve në testin kombëtar të arritshmërisë. Aplikimi i masave afirmative dhe vendeve të rezervuara për regjistrim të kandidatëve nga komunitetet joshumicë implementohet çdo vit akademik edhe në institucionet e arsimit të lartë. MASHT nga viti shkollor 2008/2009, ofron tekste shkollore falas për të gjithë nxënësit e arsimit të obligueshëm. Në vitin shkollor 2017/2018, janë ofruar tekste për klasat 1-5 dhe këtë vit shkollor 2018/2019 janë ofruar tekste nga klasa 1-9 për të gjithë nxënësit e komuniteteve.

Gjatë vitit 2018, është rishikuar dhe hartuar Udhëzimi administrativ – për Themelimin dhe Funksionimin e Qendrave Mësimore. Në vitin 2019, është hartuar doracak për zbatim të Udhëzimit administrativ. Megjithatë statistikave arsimore dokumentojnë rritje të interesimit për përfshirje në sistem arsimor, politika e masave afirmative duhet të rregullohet për të eliminuar për të kufizuar keqpërdorimet. MASHT ka shqyrtuar modele alternative përfshirë edhe mënyrën e rregullimit dhe incentivizimit në Maqedoni. Udhëzimi administrativ ofron lirim nga pagesa për shkollim për nxënës dhe student të këtyre komuniteteve. Megjithatë, nuk janë shënuar përpjekje sistematike nga komunat për të avancuar procesin e përfshirjes. MASHT ka organizuar Tryezë për të shënuar “Dita Rome – 5 nëntor” gjatë 2019. Megjithatë, ngjarjet për ngritje të vetëdijes dhe informacionit në lidhje me shkollimin mbeten të kufizuara.

Është organizuar trajnim për mesimdhënësit e gjuhës rome për përdorimin e planprogrameve dhe teksteve të gjuhës dhe kulturës rome. MASHT në bashkëpunim me KFOS (EUSIMRAES2) dhe VoRAE (Voice of Roma, Ashkali and Egjiptian) kanë trajnuar 50 mentor/tutor. Në vitin shkollor 2017/2018, kanë përfituar nga komponenta e mentorimit dhe tutorimit kanë përfituar rreth 200 fëmijë me neçje në mesimnxënie nga këto komunitete. Ky aktivitet ka vazhduar edhe në vitin shkollor 2018/2019. Gjithashtu, gjatë vitit të kaluar është hartuar Udhëzuesi për promovimin e dialogut ndëretnik dhe kontakteve mes komuniteteve e cila është mbështetur nga OSBE.



MASHT në bashkëpunim me partnerët REF, KFOS (EUSIMRAES2), VORAE - HEKS për vitin shkollor 2017-2019 ka ndarë ndërmjet 507-550 bursa studimi sipas modalitetit të bashëfinancimit. Nga viti shkollor 2020/2021 nuk ka donatorë për bashkëfinancim të bursave të studimit dhe MASHT ende nuk ka plan për të mbuluar pjesën tjetër të bursave përtej 267 që mbulon aktualisht.

### 6.1.5 Përfshirja e të riatdhesuarve dhe diasporës

#### Rezultati 1.5 Përfshihen të gjithë fëmijët e riatdhesuar në sistemin arsimor dhe fuqizohen mekanizmat për organizimin e mësimit në diasporë

Gjatë vitit 2018, MASHT, ka përfunduar njësimin e dy dokumenteve kurrikulare (të Kosovës e të Shqipërisë) me titullin e ri “Kurrikula e mësimit të gjuhës shqipe dhe e kulturës shqiptare në diasporë e mërgatë”, ka zhvilluar punëtori me mësime të nxënësve të riatdhesuarit ku janë analizuar dhe identifikuar vështirësitë që këta mësime kanë pasur me këto programe.

Në vitin 2019, janë riatdhesuar dhe sistemuar në sistemin arsimor 240 nxënës. Të gjitha rastet janë sistemuar në shkolla. Sipas planifikimit dhe projektit për nxënës të riatdhesuar për vitin shkollor 2018-2019, me datë 25.02.2019, ka filluar mësimi plotësues për nxënës të riatdhesuar që fillimisht ishin identifikuar se kanë nevojë për mësime plotësues. Ky proces kishte filluar në 16 komuna: Pejë, Kaçanik, Gjakovë, Prizren, Han të Elezit, Istog, Vushtrri, Klinë, Dragash, Suharekë, Fushë Kosovë, Prishtinë, Podujevë, Obiliq, Lipjan dhe Ferizaj. Gjatë këtij viti shkollor 2018/2019, mësime plotësues e kanë vijuar 170 nxënës në 28 shkolla me mësime të përcaktuara sipas Udhëzimit administrativ 1/2016 të datës 12.01.2016. Ky proces ka vazhduar deri në qershor 2019.

Për organizimin e mbajtjes së mësimit plotësues për vitin shkollor 2018-2019, MASHT, në bashkëpunim me MPB dhe GIZ-projekti i Arsimit Fillor, ka siguruar tekstet mësimore të veçanta për nxënës të riatdhesuar (Libri i mësimit dhe Libri i nxënësve), dhe materialin didaktikë sipas Planit të Veprimtari dhe Marrëveshjes së Mirëkuptimit MASHT-MPB. Ky proces është monitoruar në vazhdimësi nga grupi punues i emëruar nga MASHT, duke monitoruar procesin dhe duke hartuar raporte për secilën komunë lidhur me mbarëvajtjen e mësimit plotësues. Gjatë muajit shkurt të vitit 2019 nën mbështetjen e GIZ, janë rishikuar dy tekstet për nxënës të riatdhesuar dhe pas rishikimit janë botuar 500 tekste, të cilat do të shpërndahen në komuna për mësime të riatdhesuar.

Komunat mund të hartojnë plane individuale në bazë të këtyre teksteve por ende nënvizojnë nevojën e mbështetjes nga MASHT. Ndërmjet periudhës 2017-2019, janë trajnuar 26 zyrtarë të DKA-ve, të cilët janë certifikuar si trajner për organizimin e mësimit plotësues sipas programeve të akredituara nga MASHT. Sistemimi i nxënësve të riatdhesuar shpesh sfidohet nga mungesa e dokumentacionit të nxënësve të kthyer për nivelin e shkollimit të mbaruar jashtë vendi. Sfidë tjetër ishte edhe përfshirja e zyrtarëve komunal dhe nxënësve të komunitetit serbe në projektin e riatdhesimit. Gjithashtu, në bazë të legjislacionit në fuqi komunat kanë përgjegjësi për organizim të mësimit plotësues por ka hezitime në raste të caktuara. MASHT ka inicuar gjithëherë procesin për të shmangur vështirësitë në organizim të mësimit plotësues.

## 6.1.6 Parandalimi i braktisjes

### Rezultati 1.6 Ekzistojnë mekanizma efektivë për parandalimin e braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollë në arsimin parauniversitar

Plani synon që të reduktohet shkalla e braktisjes së shkollimit në arsim të obliguar në 0.1% të nxënësve deri në vitin 2021. Në arsimin e mesëm të lartë synohet që braktisja të zvogëlohet nga 2.6 % në 1% deri në fund të ciklit të planifikimit. Për të adresuar sfidën e braktisjes së shkollimit dhe mosregjistrimit, plani liston një seri të veprimeve duke përfshirë ngritjen e kapaciteteve të ekipeve parandaluese në nivel qendror, komunal dhe shkolle, përmirësimin e të dhënave mbi braktisjen, krijimin e planeve të veprimit kundër braktisjes nga komunat dhe vetëdijësimin e popullatës për arsimin e kategorive të rrezikuara, monitorimin dhe vlerësimin e progresit dhe organizim të mësimin të përsheptuar për nxënësit që kanë braktisur shkollimin.

Në përgjithësi, MASHT ka arritur synimin e vendosur në Plan të Veprimit për zvogëlim të braktisjes në 0.1% në arsim të obliguar. Janë bërë hapa për të adresuar braktisjen edhe në arsim të mesëm të lartë dhe arritja e synimit prej 1 % është i realizueshëm deri më 2021.


Table: Shkalla e braktisjes sipas niveleve arsimore 2014-2019

	2013/14	2014/15	2015/16	2016/17	2017/18	2018/19
Arsimi fillor	0.40%	0.10%	0.20%	0.20%	0.10%	0.10%
Arsimi mesëm ulët	0.40%	0.10%	0.20%	0.20%	0.10%	0.09%
Arsimi mesëm lartë	2.30%	1.10%	1.70%	2.10%	1.60%	1.80%

Burimi: MASHT SMIA 2014-2019

Në bazë të të dhënave të Sistemit për Paralajmërim të Hershëm të Rrezikut të Braktisjes së Shkollës (2017-2019), shumica e rasteve janë nxënës meshkuj shqiptarë. Numri i nxënësve femra në rrezik për të braktisur shkollimin është shumë i vogël. Numri i nxënësve në rrezik të braktisjes të komunitetit ashkali ka rënë vazhdimisht që nga viti 2017, ndërsa është rritur numri i nxënësve të komunitetit rom.

### Nxënësit në rrezik të braktisjes së shkollimit sipas Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm 2017-2019



Në funksion të zbatimit të politikave për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes së shkollimit MASHT në koordinim me partnerët UNICEF dhe ECMI, ka vazhduar me një varg aktivitetesh që lidhen me mbështetjen e shkollave dhe komunave, por edhe me ngritjen e kapaciteteve të inspektoratit të arsimit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit në fuqi. Është hartuar plani dyvjeçar i punës së Ekipit kombëtar kundër braktisjes së shkollimit si dhe i kornizës monitoruese. Gjatë kësaj periudhe janë mbështetur 80 shkolla në zbatim të detyrimeve ligjore në 10 komuna (Pejë, Prishtina, Prizren, Fushë Kosovë, Obiliq, Podujevë, Gjilan, Ferizaj, Mitrovicë dhe Vushtrri). Gjithashtu, është organizuar një punëtori me grupin e parë të Inspektoratit të Arsimit për zbatim të SPS.

Gjatë Javës kundër Braktisjes së Shkollimit 2019, janë shënuar aktivitete sensibilizuese në nivel shkollash. Me mbështetje të Balkan Sunflowers, janë organizuar edhe dy sesione informative me shkollat e mesme të larta. Në përpjekje për të promovuar raportimet cilësore në modulën e paralajmërimit të hershëm të braktisjes dhe atë të dhunës në shkolla, janë botuar dhe shpërndarë materiale promovuese si posterë/ fletëpalosje dhe janë shpërblyer 50 shkolla të dalluara në raportim. Sistemi i paralajmërimit të hershëm të braktisjes është funksional dhe shkollat kanë filluar ta përdorin përgjatë identifikimit, trajtimit dhe referimit të rasteve në rrezik. Gjatë këtij viti shkollor janë raportuar 134 raste në rrezik të braktisjes, siç i kanë trajtuar dhe raportuar ekipet shkollore.

Shkalla e braktisjes në arsimin e obliguar për vitin shkollor 2018/2019 ishte 0.09% (228 nxënës), ndërsa në vitin 2017/2018 ishte 0.07% (159 nxënës). Konsiderohet se rënia e braktisjes vjen si shkak i funksionalizimit të ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes. Sfidë në këtë fushë është raportimi ende i vogël nga shkollat në SPH (Sistemi i paralajmërimit të hershëm). Aktualisht është numër i vogël i shkollave që po raportojnë sipas sistemit të ndërtuar, sistem ky që do të ndikonte shumë në parandalimin e braktisjes dhe të barrierave që çojnë në braktisje të shkollimit. Gjithashtu, sfidues është edhe mirëfunksionimi i ekipeve komunale, të cilat duhet t'i mbikëqyrin dhe mbështesin ekipet shkollore në trajtimin e rasteve që dalin jashtë kompetencës së institucionit shkollor dhe kërkojnë qasje ndërsektorale (Faktorët sociale, familjarë, varfëria, elementët abuzivë dhe dhunës në familje, punët e detyrueshme, delikuenca etj.)

### 6.1.7 Përkrahja e fëmijëve me potencial të jashtëzakonshëm

**Rezultati 1.7** Ekzistojnë mekanizma dhe programe për identifikimin dhe përkrahjen e fëmijëve me potencial të jashtëzakonshëm intelektual dhe me talente të veçanta në fusha akademike, kreative e artistike

Gjatë vitit 2019, është miratuar Udhëzimi administrativ për fëmijët me inteligjencë të jashtëzakonshme, dhunti dhe talente dhe udhëzuesi për zbatimin në praktikë të udhëzimit administrativ. MASHT, në vitin 2018, në kuadër të subvencioneve ka ndarë një shumë prej 100,000 euro për Institutin Atomi, organizatë kjo që merret me fëmijët me inteligjencë të jashtëzakonshme, dhunti dhe talente. MASHT ka një linjë të veçantë buxhetore dhe ndan 200,000 tek kategoria e subvencioneve. Nuk janë alokuar mjete shtesë për Institutin Atomi në vitin 2019. Gjatë vitit 2019 kanë aplikuar 936 nxënës të cilët i janë nënshtruar testimit në 3 faza dhe si rezultat janë përzgjedhur 63 nxënës nga 13 komuna të Kosovës. Për nxënësit e përzgjedhur është ofruar Kampi veror ATOMI 2019. Subvencionet prej 200,000 euro të parapara për aktivitetet e vitin pasues janë alokuar tek OJQ që nuk janë të specializuara për këtë fushë duke anashkaluar thirrjen dhe Udhëzimin administrativ dhe Udhëzuesi për nxënësit me aftësi të jashtëzakonshme dhunti dhe talente. Gjysma e aktiviteteve të parapara në planin vjetor të punës nuk janë realizuar meqë ato ishin planifikuar të realizohen nga mjetet që ishin në kategorine e subvencioneve.

Një nga prioritetet kryesore mbetet zbatimi i Udhëzimit administrativ dhe fuqizimi i shkollave për të identifikuar dhe trajtuar këtë kategori të nxënësve. GIZ - projekti i Arsimit Fillor ka mbështetur Institutin Atomi në organizimin e trajnimit mbi 'Identifikimin dhe mbështetjen e nxënësve me potencial dhe talent të jashtëzakonshëm. Gjatë vitit 2019 janë trajnuar 100 mësimitdhënës të shkollave të Prishtinës, Gjilanit dhe Prizrenit si pjesë e modulit. Gjithashtu, MASHT ka formuar grupin punues dhe janë mbajtur dy punëtori për hartimin e kornizës "Planit të individualizuar" për nxënësit me inteligjencë të jashtëzakonshme dhunti dhe talente. Janë organizuar 2 punëtori me komunat për të prezentuar Udhëzimin administrativ dhe rolin e komunave në proces.

### 6.1.8 Promovimi i diversitetit

**Rezultati 1.8** Ekzistojnë mekanizma e politika efektive të krijuara për promovimin e diversitetit përmes një sistemi të integruar arsimor

Përmes aktivitetit tentohet të promovohet respektimi i barazisë gjinore në arsim përmes zbatimit të planit të veprimit të Rezolutës 1325, programit të Kosovës për barazi gjinore si dhe dokumenteve të tjera strategjike në nivel të qeverisë që prekin çështjet gjinore. Gjatë vitit 2018, barazia gjinore është integruar në programet dhe tekstet e reja shkollore për klasën përgatitore dhe klasat 1,6 dhe 10 për vitin shkollor 2019/2020. MASHT, ka shpallë konkursin për tekstet dhe materialet mësimore për klasën përgatitore dhe për klasat: 1,6, dhe 10 (në të cilat tekste do të përfshihen edhe temat që ndërlidhen me barazinë gjinore). Gjatë kësaj periudhe kohore janë rishikuar edhe programet lëndore për klasat 2, 7, 11 dhe janë hartuar draftet finale të këtyre programeve lëndore, në të cilat janë përfshirë edhe temat që ndërlidhen me barazinë gjinore në programet shkollore.

## 6.1.9 Treguesit e performancës

### TREGUESIT KRYESOR TË PJESËMARRJES DHE GJITHËPËRFSHIRJES 2014-2017

	2014/15	2015/16	2016/17	2017/18	2018/19
<b>Shkalla bruto e regjistrimit (GER)</b>					
Shkalla bruto e regjistrimit parashkollor (0-5)	15.70%	16.40%	18.00%	19.10%	20%
Shkalla bruto e regjistrimit parashkollor (3-5)	29.60%	30.90%	33.90%	36%	37.5%
Shkalla bruto e regjistrimit parashkollor (0-4)	2.80%	3.50%	4.40%	4.90%	6.2%
Shkalla bruto e regjistrimit parafillor (5 vjeç)	79.60%	81.30%	87.60%	92.40%	92.5%
Shkalla bruto e regjistrimit fillor (ISCED 1)	96.40%	94.70%	96.20%	98.40%	100.3%
Shkalla bruto e regjistrimit mesëm ulët	99.50%	96.00%	93.30%	91.20%	90.5%
Shkalla bruto e regjistrimit mesëm lartë	84.50%	84.90%	88.10%	90.20%	86.8%
Shkalla bruto e regjistrimit nevoja të veçanta	-	44.60%	44%	40.10%	/
<b>Treguesit e numrit të nxënësve</b>					
Numri i i nxënësve parauniversitar	374407	369309	365029	356,270	345,540
Numri i nxënësve parauniversitar publik	367940	360237	354454	342,352	329,589
Numri i nxënësve parauniversitar privat	6467	9072	10575	13,918	15,951
Numri i nxënësve parashkollor (0-4 vjeç)	4792	5892	6636	8,335	9,393
Numri i nxënësve parafillor (5 vjeç)	22132	23094	24002	23,749	23,650
Numri parashkollor 0-5 privat	1354	3020	3779	5,934	7,219
Numri i nxënësve fillor/mesëm ulët total	261107	250931	244677	239,937	234,590
Numri i nxënësve fillor/mesëm ulët publik	258464	247824	240782	235,161	229,338
Numri i nxënësve fillor/mesëm ulët privat	2643	3107	3895	4,776	5,252
Numri i nxënësve mesëm lartë	86376	89392	89714	84,249	77,907
Numri i nxënësve mesëm lartë publik	83906	86447	86813	81,041	74,427
Numri i nxënësve mesëm lartë privat	2470	2945	2901	3,208	3,480

## TREGUESIT KRYESOR TË PJESËMARRJES DHE GJITHËPËRFSHIRJES 2014-2017

	2014/15	2015/16	2016/17	2017/18	2018/19
<b>Shkalla e braktisjes</b>					
Shkalla e braktisjes fillor	0.20%	0.20%	0.10%	0.10%	-
Shkalla e braktisjes mesëm ulët	0.20%	0.20%	0.10%	0.09%	-
Shkalla e braktisjes mesëm lartë	1.70%	2.10%	1.60%	1.80%	-
<b>Pariteti gjinor</b>					
Numri nxënësve femra parauniversitar	177,415	174,027	176,767	172,966	167,586
Numri nxënësve femra fillor/mesëm ulët	126,265	121,234	118,409	116,357	113,611
Numri nxënësve femra mesëm lartë	41,010	42,943	43,753	41,293	38160
Indeksi i Paritetit Gjinor parashkollor	0.92	0.84	0.85	0.89	0.91
Indeksi i Paritetit Gjinor parafillor	0.93	0.94	0.93	0.92	0.92
Indeksi i Paritetit Gjinor fillor/mesëm ulët	0.94	0.93	0.94	0.94	0.94
Indeksi i Paritetit Gjinor mesëm lartë	0.9	0.92	0.95	0.96	0.96
<b>Përfshirja e komunitetit rom, ashkalinjë dhe egjiptian</b>					
Total nxënës rom, ashkalinj, egjiptian	6,086	6,276	6,670	6,839	6,758
Total rom, ashkalinjë, egjiptian AE + shkolla në gjuhën serbe	6208	6331	6758	-	-
Numri i nxënësve ashkali	3529	3866	3729	3,949	4,121
Numri i nxënësve rom	1853	1558	2002	1,802	1,385
Numri i nxënësve egjiptian	704	852	939	1,088	1,252
<b>Nxënësit me nevoja të veçanta</b>					
Numri i nxënësve me nevoja të veçanta	-	6172	5565	3645	
Shkalla bruto e regjistrimit nx.nev.veçanta	-	44%	40.10%	-	

Burimi: MASHT/SMIA (2019)

### 6.1.10 Matrica e zbatimit të aktiviteteve

No.	Rezultatet	Aktivitetet	Status	%
1.1	Përfshirja në edukimin parashkollor cilësor arrin në 20% të fëmijëve të moshës 0-5.	1.1.1. Stimulimi i hapjes dhe akreditimit të institucioneve private dhe qendrave me bazë në komunitet nga ana e komunave		4
		1.1.2. Hartimi dhe zbatimi i programit për aftësimin e edukatoreve në shërbim që punojnë me fëmijët 0-3		3
		1.1.3 Zhvillimi i programeve për vetëdijesimin e prindërve lidhur me fëmijërinë e hershme		4
		1.1.4 Organizimi i aktiviteteve për vetëdijesimin e shoqërisë për rëndësinë e edukimin parashkollor		3
		1.1.5 Pilotimi i kurrikulës së re parashkollore		3
		1.1.6 Zbatimi dhe monitorimi i kompetencave për edukatore që punojnë me fëmijët e moshës 3-5		3
1.2	Të gjithë fëmijët e moshës 5-vjeçare përfshihen në edukimin cilësor parafillor	1.2.1 Hapja e klasave të reja parafillore		3
1.3	50% e fëmijëve me nevoja të veçanta janë përfshirë në sistemin arsimor parauniversitar	1.3.1 Përcaktimi i tregueseve për fëmijët me nevoja të veçanta për SMIA		5
		1.3.2 Funksionalizimi i ekipeve vlerësuese pedagogjike		4
		1.3.3 Trajnimi i personelit arsimor për arsimin gjithëpërfshirës		3
		1.3.4 Shendërrimi i klasave të bashkëngjitura në dhoma burimore		4
1.4	Përfshirja e fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin fillor është rritur për 10%, ndërsa në arsimin e mesëm të ultë dhe të lartë me 20%	1.4.1 Harmonizimi i programeve të qendrave mësimore		3
		1.4.2 Hartimi i rregulloreve nga komunat për lehtësimin e kushteve të regjistrimit dhe vijimit të fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në nivelin parashkollor dhe arsimin të mesëm		3
		1.4.3 Monitorimi i zbatimit të masave lehtësuese për regjistrimin e fëmijëve në nivelin parashkollor dhe në shkolla të mesme të larta		4
		1.4.4 Trajnimi i mësimitdhënësve për mësimitdhënien e gjuhës rome		2
		1.4.5 Organizimi i aktiviteteve për vetëdijesimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian për rëndësinë e regjistrimit me kohë dhe vijimin e shkollimit, me fokus të veçantë tek vajzat		2

No.	Rezultatet	Aktivitetet	Status	%
1.5	Përfshihen të gjithë fëmijët e riatdhesuar në sistemin arsimor dhe fuqizohen mekanizmat për organizimin e mësimit në diasporë	1.5.1 Monitorimi i zbatimit të legjislacionit për të riatdhesuarit nga grupi mbikëqyrësi i MASHT-it		4
		1.5.2 Hartimi i planeve individuale për nxënësit e riatdhesuar		4
		1.5.3 Rishikimi programit për të ri-atdhesuarit		4
		1.5.4 Trajnimi i mësimitdhënësve dhe zyrtarëve komunalë për programin për të ri-atdhesuarit		3
		1.5.5 Koordinimi dhe monitorimi i mësimit plotësues nga grupi mbikëqyrës i MASHT-it		4
		1.5.6 Organizimi i aktiviteteve për nxënësit e diasporës		2
1.6	Ekzistojnë mekanizma efektivë për parandalimin e braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollë në arsimin parauniversitar	1.6.1 Ngritja e kapaciteteve të ekipeve parandaluese në nivel, shkolle, komune dhe në nivelin qendror		4
		1.6.2 Rishikimi i rolit të EPMPB		5
		1.6.3 Përmirësimi i grumbullimit të të dhënave për braktisje dhe mos regjistrim		4
		1.6.4 Krijimi i planeve të veprimit për parandalimin e braktisjes dhe të mos regjistrimit në të gjitha komunat		4
		1.6.5 Vetëdijësimi i popullatës për arsimimin e kategorive tjera të rrezikuara		4
		1.6.6 Monitorimi dhe vlerësimi i progresit të arritur në zbatim të politikave që adresojnë braktisjen dhe mos-regjistrimin dhe paralajmërimin e hershëm për fëmijët në rrezik të braktisjes		3
		1.6.7 Organizimi i mësimit të përsheptuar për nxënësit që kanë braktisur ose nuk janë regjistruar në shkollë		3
1.7	Ekzistojnë mekanizma dhe programe për identifikimin dhe përkrahjen e fëmijëve me potencial të jashtëzakonshëm intelektual dhe me talente të veçanta në fusha akademike, kreative e artistike.	1.7.1 Krijimi dhe zhvillimi i mekanizmave dhe programeve identifikuese dhe mbështetëse për fëmijë me potencial të jashtëzakonshëm intelektual dhe me talente të veçanta.		3
		1.7.2 Trajnimi i mësimitdhënësve dhe psikologëve shkollorë për punën me fëmijë me potencial të jashtëzakonshëm intelektual dhe me talente të veçanta.		3
		1.7.3 Stimulohen fëmijët me potencial të jashtëzakonshëm intelektual dhe me talente të veçanta		3
		1.7.4 Bashkëpunimi me qendra dhe organizata vendore dhe ndërkombëtare të angazhuara në këtë fushë		2
1.8	Ekzistojnë mekanizma e politika efektive të krijuara për promovimin e diversitetit përmes një sistemi të integruar arsimor	1.8.1 Zhvillohet strategji për promovimin e dialogut ndëretnik dhe kontakteve mes komuniteteve		3
		1.8.2 Rishikimi i dispozitave për mësimitdhënien e gjuhëve		2
		1.8.3 Masat për përmirësimin e mësimitdhënies së gjuhës shqipe si gjuhë e dytë		3
		1.8.4 Zhvillimi i moduleve arsimore specifike për komunitete		3
		1.8.5 Zhvillimi i një politike për organizimin e mësimitdhënies për diversitetin dhe të drejtat e njeriut dhe të komuniteteve për të gjithë nxënësit		3



### 6.1.11 Rekomandimet

- Të investohet në promovim të shkollimit relevant për të rinjtë jashtë arsimit dhe punësimit dhe të luftohet fenomeni i braktisjes së shkollimit*** - Në bazë të regresionit linear është dokumentuar një ndërlidhje e fortë ndërmjet përfshirjes dhe nivelit arsimor me standardin e jetesës. *Popullsia me numër më të vogël të viteve të shkollimit është më e predispozur* të jetoj në kushte të varfërisë. Popullsia me shkollim universitar dhe arsim profesional janë më mirë të akomoduar në ekonominë e vendit. Ky variacion nuk është i rastësishëm dhe është statistikisht sinjifikant. Kjo nënvizon rëndësinë e investimit në shkollim si për të avancuar konkurrueshmërinë e vendit, ashtu edhe për të avancuar mirëqenien shoqërore. Gjithashtu, kemi një *korrelacion të fortë ndërmjet numrit të viteve të kaluara në edukim parashkollor dhe arritshmërisë në testet e vlerësimit të jashtëm (.837)*.
- Të rritet synimi për përfshirje në edukim parashkollor nga 20 % në 24% të grup-moshave 0-5 vjeç*** - Në bazë të parashikimit të popullsisë (varianti i mesëm) nga ASK (2017) janë bërë disa ripërshatje që mund të ndikojnë në shifrat e përfshirjes bruto të nxënësve në edukimin parashkollor. Parashikimi i popullsisë së grup-moshave 0-5 vjeç shfaq një tendencë të rënies së numrit të fëmijëve në Kosovë ndërmjet 2017-2021. Shkalla e përfshirjes së fëmijëve në edukim parashkollor është tejet e ulët krahasuar me vendet e avancuara. Numri i institucioneve parashkollore është krahasimisht i vogël në raport me numrin e përgjithshëm të institucioneve arsimore në vend (4 %) . Vetëm rreth 3.5 për qind e stafit mësimdhënës është i orientuar në nivelin parashkollor. *Shkalla e përgjithshme e shpërndarjes së shpenzimeve qeveritare është disproporcionale me objektivat e vendosura në Planin e Veprimit*. Vetëm rreth 8 për qind e financimit vjetor dedikohet për edukimin parashkollor.
- Të standardizohet klasifikimi i edukimit parashkollor sipas treguesve ndërkombëtar*** - Klasifikimi aktual ligjor i edukimit parashkollor është i pazakonshëm. Shumica e vendeve të avancuara të OECD përdorin klasifikimin ISCED 0 për grup-moshat 3-5 vjeç apo 3-6 vjeç. Eurostat përdor edhe një klasifikim tjetër për të dokumentuar progresionin në arritjen e objektivave EU 2020. Shkalla e përfshirjes në edukim parashkollor bëhet duke përllogaritur fëmijët e përfshirë në edukim parashkollor ndërmjet moshës 4 vjeç deri në fillimin e arsimit të obliguar. *Klasifikimi aktual duhet të ndryshoj për të mundësuar harmonizim të parametrave të krahasimit*. Kjo kategori do të mund të ndahej në grup-moshat 3-5 vjeç dhe < 3 vjeç. Ky ndryshim do të duhej të reflektohej edhe në riformulim të objektivave të synuara në Plan të Veprimit.
- Të ndërtohet kapaciteti për sigurim të cilësisë në edukim parashkollor*** - Përfshirja në këtë nivel të shkollimit nuk do të thotë domosdoshmërisht edhe kontribut në arritshmëri të nxënësve. Në analizën ekonometrike të ndikimit të edukimit parashkollor në arritshmëri nënvizohet një anomali në rastin e Kosovës. Ekziston pak dallim në arritshmëri ndërmjet atyre që kanë qenë të inkuadruar në shkollim të hershëm dhe atyre me vetëm arsim të obligueshëm. Kjo hap pyetje tjera mbi rolin e institucioneve parashkollore dhe orientimit të tyre si institucione edukative apo me përkujdesje. Rritja e përfshirjes duhet të shkoj paralelisht me përpjekjet për të avancuar cilësinë e kurrikulës dhe stafit mësimdhënës.
- Të ndërmerren veprime esenciale për zbatimin e dubur të politikave kundër braktisjes si*** ngritja e kapaciteteve të inspektoratit për mbikëqyrjen e politikave kundër braktisjes së shkollimit; Mbikëqyrja e monitorimi i shkollave nga inspektorati konform U.A.08/2018 për themelimin dhe funksionalizimin e EPRBM-ve në arsim parauniversitar, fuqizimi i ekipeve komunale për t'i mbështetur ekipet shkollore, shkollat dhe DKA-të ta marrin me prioritet trajtimin e braktisjes në planifikimet e tyre zhvillimore, qoftë si plan në vete apo si objektivë brenda planifikimit të përgjithshëm dhe regjistrimi i nxënësve në SMIA me numër personal, ashtu që të mund të prodhojmë saktësi në evidencë.

- ***Të sistematizohen përpjekjet për promovim të kompetencave ndërkulturore dhe sigurisë në shkolla*** - Në kuadër të avancimit të objektivit strategjik të pjesëmarrjes dhe gjithëpërfshirjes duhet të theksohet *rëndësia e ofrimit të mësimdhënies bazë për të edukuar fëmijët mbi kompetencat shoqërore, ndërkulturore, vlerave demokratike, të drejtave themelore, mos-diskriminimit dhe pjesëmarrjen aktive në shoqëri*. Një vëmendje e posaçme duhet kushtuar edukimit mbi përdorimin e mediave bashkëkohore dhe internetit me qëllim të parandalimit të fenomeneve të polarizimit shoqëror, ekstremizmit, indoktrinimit dhe dhunës. Rregullimi juridik dhe politik i vendit kërkon më shumë promovim të dialogut ndëretnik dhe ndërfaqësor.
- ***Të rritet shkalla e përfshirjes dhe investimet për nënsektorin e arsimit të fëmijëve me nevoja të veçanta*** - Është shënuar një përmirësim në cilësinë e rregullimit të arsimit për fëmijët me nevoja të veçanta dhe grupe të tjera të ndjeshme shoqërore. Sidoqoftë, prioritizimi i rritjes së përfshirjes së këtyre kategorive shoqërore nuk është përcjellë me hapa për rritje të kapacitetit financiar, njerëzor dhe infrastrukturor. Shkalla e financimit për arsimin special është pothuajse e njëjtë në 10 vitet e fundit. Është e rëndësishme të dyfishohet shkalla e financimit për këtë prioritet në rishikimin dhe planifikimin financiar. Në kuadër të këtij prioriteti duhet të integruar edhe fëmijët me potencial të jashtëzakonshëm.
- ***Të rishikohet Rezultati 1.5 përfshihen të gjithë fëmijët e riatdhesuar në sistemin arsimor dhe fuqizohen mekanizmat për organizimin e mësimin në diasporë*** – ky rezultat duhet të rishikohet me qëllim të ndarjes në dy rezultate të veçanta me aktivitete relevante për arritjen e tyre. Përfshirja e fëmijëve të riatdhesuar dhe atyre të diasporës janë grupe të ndryshme dhe kërkojnë orientim gjeografik, resurse dhe metodologji thelbësisht të papërputhshme mes vete.



# Menaxhimi i Sistemit Arsimor

## Rezultatet:

- Ndërtohen kapacitete për menaxhim efektiv dhe të përgjegjshëm të sistemit në nivelin qendror dhe komunal si dhe menaxhim efektiv në nivel shkolle
- Përcaktimi i standardeve profesionale për mekanizmin e punësimit dhe menaxhimit të karrierës së udhëheqësve të institucioneve edukative-arsimore
- Zbatohet një mekanizëm funksional i financimit të arsimit parauniversitar që i kontribuon zhvillimit të shkollës
- Përgatiten dhe publikohen raporte të rregullta të bazuara në analiza dhe interpretim të të dhënave nga SMIA si dhe shfrytëzohen këto analiza në politikëbërje
- Legjislacioni është harmonizuar dhe kompletuar për tërë sektorin e arsimit parauniversitar
- Shkollat kanë krijuar mjedise të sigurta, miqësore dhe të shëndetshme për të gjithë
- Ndërtohet një sistem efektiv i menaxhimit të infrastrukturës shkollore që shpie drejt krijimit të mjediseve fizike të përshtatshme për mësim
- Përmirësohet infrastruktura arsimore përmes ndërtimit, renovimit, zgjerimit dhe pajisjes së institucioneve arsimore me mjete adekuate për procesin mësimor

## 6.2 Menaxhimi i Sistemit Arsimor

Sfidë kryesore në menaxhimin e sistemit arsimor mbetet koordinimi i planeve dhe prioriteteve brenda një kornize të bashkërenduar të planifikimit dhe monitorimit. Planet strategjike në arsimin e Kosovës zbatohen në kontekst të përgjegjësive të ndara dhe pjesëmarrjes së institucioneve dhe organeve autonome në punën e tyre. Përfshirja e komunave, institucioneve të arsimit të lartë dhe sektorit privat është thelbësore për avancim të zbatimit të planeve arsimore. Kapaciteti për mbledhje dhe përpunim të dhënave në arsim është rritur dukshëm, mirëpo kërkohet vëmendje më e lartë ndaj nevojës së sigurimit të të dhënave me fokus tek nxënësi dhe studenti, mbledhja dhe raportimi i të dhënave mbi ndikimin e arsimit në punësim dhe rritja e kapaciteteve të nivelit lokal për raportim dhe përpunim të të dhënave.

Progresi në rezultatet e synuara 2019 shprehur sipas shkallës së zbatimit 1-5

Rez	Përshkrimi	%	Niveli
1	Ndërtohen kapacitete për menaxhim efektiv dhe të përgjegjshëm të sistemit në nivelin qendror dhe komunal, si dhe menaxhim efektiv në nivel shkollë	50%	3
2	Përcaktimi i standardeve profesionale për mekanizmin e punësimin dhe menaxhimin të karrierës së udhëheqësve të institucioneve edukative-arsimore	57%	3.4
3	Zbatohet një mekanizëm funksional i financimit të arsimit parauniversitar që i kontribuon zhvillimit të shkollës	45%	2.7
4	Përgatiten dhe publikohen raporte të rregullta të bazuara në analiza dhe interpretim të të dhënave nga SMIA, si dhe shfrytëzohen këto analiza në politikëbërje	67%	4
5	Legjislacioni është harmonizuar dhe kompletuar për tërë sektorin e arsimit parauniversitar	62%	3.7
6	Shkollat kanë krijuar mjedise të sigurta, miqësore dhe të shëndetshme për të gjithë	52	3.1
7	Ndërtohet një sistem efektiv i menaxhimit të infrastrukturës shkollë që shpie drejt krijimit të mjediseve fizike të përshtatshme për mësim	57%	3.4
8	Përmirësohet infrastruktura arsimore përmes ndërtimit, renovimit, zgjerimit dhe pajisjes së institucioneve arsimore me mjete adekuate për procesin mësimor	38%	2.3
<b>Total</b>		<b>53%</b>	<b>3.1</b>

Sigurimi i një mjedisi shkollor miqësor, me kushte dhe disiplinë optimale është një parashikues i fortë i arritshmërisë së nxënësve në arsimin parauniversitar. Si drejtorët, mësimdhënësit ashtu edhe nxënësit raportojnë sfida të theksuara me disiplinën në shkollat e Kosovës. Modeli i menaxhimit të shkollës ende karakterizohet nga mungesa e autonomisë, përgjegjësive të kufizuara për menaxhmentin e shkollës dhe mësimdhënësit. Shpenzimet e Kosovës në arsim shprehur si % e BPV/GDP ndërmjet 2016-2019 ishin rreth 4.2 % dhe sipas praktikave rajonale dhe vendeve të avancuara. Megjithatë, janë dy faktorë që ndikojnë në shpenzime më të ulëta nominale – ekonomia e vogël dhe numri i lartë i nxënësve krahasur me vendet tjera. Kosova ka strukturë të ndryshme të popullsisë dhe pjesëmarrje të lartë të popullsisë së re. Kosova po ballafaqohet me rënie të shtimit natyror dhe numër më të vogël të nxënësve. Kjo ka rezultuar me rënie të theksuar të numrit të nxënësve për klasë sidomos në zonat rurale. Rënia e numrit të lindjeve dhe lëvizjet e brendshme dhe të jashtme të popullsisë kushtëzojnë rimendimin e strategjisë për investime në ndërtim të shkollave të reja.

## 6.2.1 Menaxhimi efektiv në sistemin arsimor

### Rezultati 2.1. Ndërtohen kapacitete për menaxhim efektiv dhe të përgjegjshëm të sistemit në nivelin qendror dhe komunal, si dhe menaxhim efektiv në nivel shkollë

Në kuadër të masave fillestare të parapara për arritje të rezultatit është synuar trajnimi i personelit të MASHT për planifikim, politikbërje dhe monitorim, zhvillimi i kapacitetit për raportim, zhvillimi i kapacitetit për planifikim të integruar MASHT-DKA-Shkollë, ristrukturimi i organizimit të DKA, hartimi i rregulloreve dhe udhëzuesve për menaxhim të arsimit në nivel lokal, fuqizimi i autonomisë së shkollës, fuqizimi i Këshillave drejtues të shkollës dhe promovimi i bashkëpunimit ndërmjet shkollave përmes rrjetit shkollor. MASHT ka miratuar Udhëzimin administrativ UA 10/2016 për Themelimin e Sistemit të Planifikimit të Integruar për Arsim, Shkencë dhe Teknologji. Gjatë vitit 2017, është inicuar procesi i funksionalizimit të Komisionit për Menaxhim Strategjik dhe Komisioneve Programore, por ka munguar vullneti i menaxhmentit të lartë të MASHT-it për funksionalizimin e këtij komisioni. Komisioni për Planifikim Strategjik udhëhiqet nga Ministri i MASHT dhe mbledh kryesuesit e sektoreve të arsimit dhe shkencës në kuadër të Ministrisë. Komisionet Programore janë mandatuar si struktura përgjegjëse për planifikim sektorial, përpilim të planeve të punës, monitorim dhe vlerësim të progresit, përpilim të kalendarit vjetor të sektorit, aprovim të propozimeve të reja në politika dhe financim. MASHT me mbështetje të GIZ ka funksionalizuar sistemin e planifikimit të integruar si mekanizëm kryesor për planifikim, raportim dhe monitorim.

PSAK (2017-2021) ka formalizuar procesin e planifikimit strategjik në sektor. Plani paraqet një përpjekje për të organizuar kontributin dhe burimet drejt avancimit të cilësisë dhe gjithëpërfshirjes në arsim me qëllim që të arrihen qëllimet kombëtare dhe ndërkombëtare. Plani po ashtu përkrah, rregullon dhe promovon procesin e planifikimit vjetor dhe afatgjatë të hisedarëve të këtij sektori për arritjen e indikatorëve të verifikueshëm dhe të matshëm të arsimit. PSAK, ofron një instrument strategjik për planifikim të bazuar në të dhëna, i ndërlidhur me KASH dhe me përmbajtje të elementeve esenciale për Monitorim dhe Vlerësim të performancës në këtë sektor. Korniza e Vlerësimit të Performancës përfshin një seri të indikatorëve, afateve dhe caqeve. Sistemi i Menaxhimit të Informacionit në Arsim (SMIA) ofron mjetin për të mbledhur të dhënat, raportuar dhe komunikuar rezultatet e planit. Rishikimi Vjetor (RV) i PSAK është platformë për të shqyrtuar dhe vlerësuar progresin e arritur në zbatimin e planit.

Është nxjerrë rregullativa ligjore që sistematizon procesin e planifikimit dhe menaxhimit ndërmjet hallkave të qeverisjes në sistemin e arsimit parauniversitar, arsim profesional dhe arsim të lartë. Prosesi është i modeluar sipas qasjes së bazuar në tërë sistemin. Megjithatë, ky mekanizëm është ende në fazat fillestare. Në kuadër të Planit të Veprimit nuk janë vendosur caqe apo objektiva tjera në lidhje me komunikimin lartë-poshtë, poshtë-lartë dhe komunikimi anësor me hisedarë të sistemit, sidomos me komuna dhe agjenci të pavarura. Gjithashtu, nuk reflektohet ndonjë vëmendje e posaçme në modelin e administrimit të sistemit, shkallës së centralizimit dhe definimit të saktë të roleve dhe përgjegjësi. Në kuadër të Planit të Veprimit duhet të reflektohet përpjekja për institucionalizim të praktikës së planifikimit, monitorimit dhe raportimit të integruar. Në kuadër të aktivitetëve duhet të inkorporohen synimet për funksionalizim të Komisionit për Menaxhim Strategjik dhe Komisioneve Programore.

Plani Vjetor i Punës, përgatitet pas miratimit të buxhetit (nëntor dhe dhjetor). Kjo siguron mundësinë për të koordinuar me Planin Vjetor të Punës së MASHT-it (dokument i brendshëm). Logjika prapa kësaj është se ministritë, pasi ta dinë buxhetin e tyre, do t'i planifikojnë aktivitetet e veçanta vjetore. Aktivitetet e Planit Vjetor janë ndërlidhur me Planin e Veprimit të PSAK 2017-2021. Megjithatë, procesi i raportimit dhe rishikimit të PSAK nuk përkthehet domosdoshmërisht në aktivitete shitesë apo të ndryshuara. Sfidat kryesore konsistojnë në faktin që rishikimi përmbyllet në shkurt-mars, mjaftueshëm për përfshirjen e rezultateve të këtij procesi në propozimet e KASH-it për periudhën vijuese, mirëpo jo për integrimin e aktiviteteve kryesore në

Plan Vjetor të Punës. apo në Planin Vjetor, përveç nëse ndryshohet. Koha e PVPQ-së është e përcaktuar në nivel qendror. Gjatë vlerësimit të Planeve Vjetore të Punës 2017-2019, nuk është hasur në ndonjë inkorporim të rekomandimeve që kanë dalë nga Rishikimi Vjetor paraprak. Ngjashëm me Planin Vjetor janë edhe disa procese tjera të planifikimit që drejtohen nga jashtë. Shembuj të këtyre proceseve janë azhurnimi i Planit të Veprimit për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian (PKZMSA). Kjo bëhet pas publikimit të Raportit të Progresit të BE-së për Kosovën, në tetor të çdo viti. Në përgjithësi, struktura e planifikimit strategjik ende nuk është funksionalizuar. Raportimet janë të shpeshta për Plane të ndryshme dhe ende nuk ekziston një strukturë e unisuar e monitorimit dhe raportimit.

Sektori i edukimit në Kosovë mbështetet nga donatorë të shumtë dhe në të gjitha nivelet e sistemit të arsimit (qendror, komunal, shkollor) si dhe në të gjitha fushat e arsimit (parauniversitare, universitare, AAP, etj.). Në disa mënyra, MASHT-i është njëra nga agjencitë më të “ngjeshura” në kuptimin e mbështetjes në dispozicion nga partnerë të ndryshëm të zhvillimit. Përderisa, ky është në përfitim të sektorit, ai gjithashtu vë në dukje nevojën për koordinimin e përpjekjeve në mënyrë efektive të partnerëve kyç zhvillimor. Koordinimi i donatorëve realizohet përmes takimeve të rregullta të donatorëve dhe MASHT. Projektet e donatorëve (dhe menaxherët e programit) gjithashtu në mënyrë aktive ndërveprojnë dhe koordinohen në baza bilaterale. Megjithatë, donatorët në shumë raste janë ankuar për mungesë të mbledhjeve dhe kordinimit me MASHT gjatë vitit 2019. Nuk ekziston një inventarizim i të gjitha aktivitetëve të donatorëve.

Sipas sistemit aktual, komunat individualisht duhet të kenë plane zhvillimore/arsimore komunale (të ndara apo të integruara në planet e përgjithshme të zhvillimit). Përveç Planit Zhvillimor të Komunës, disa komuna, kanë zhvilluar Planet për Zhvillimin e Arsimit dhe ato reflektojnë prioritetet e PSAK 2017-2021. Megjithatë, kordinimi ndërmjet MASHT dhe komunave në zbatim të PSAK 2017-2021 nuk ka qenë sistematik. Gjatë vitit 2019, nuk janë mbajtur mbledhje të rregullta me drejtorët e DKA-ve. Në anën tjetër edhe kapaciteti i komunave ndryshon shumë varësisht nga madhësia e komunës dhe prioritetet politike në nivel lokal. Një hap pozitiv në adresimin e boshllëkut në hallkat e planifikimit komunal dhe ndërlidhjes më prioritetet e PSAK ishte Plani Strategjik i Kolegjiumit të Arsimit 2019-2021. Ky Plan i mbështetur nga GIZ ka synim kryesor zhvillimin e kapaciteteve komunale për menaxhim dhe sigurim të cilësisë në shkolla.

Gjatë vitit 2018, MASHT ka nxjerrë Rregulloren për Sistematizimin e Vendeve të Punës. Rregullorja ka paraparë ristrukturim të departamenteve dhe divizioneve në organogramin e ri. Procesi i zbatimit të ristrukturimit ka hasur në kundërshtime të theksuara nga stafi i MASHT. Stafi i MASHT nënvizon që në kuadër të procesit kishte munguar përfshirja e stafit në proces, struktura organizative kishte mangësi dhe përshkrimet e detyrave ishin të pazakonshme në disa raste. Gjatë Punëtorive të mbajtura ndërmjet janar-shkurt 2020, një pjesë e konsiderueshme e stafit dhe donatorëve nënvizuan se procesi kishte ndikuar thelbësisht në zbatim të aktivitetëve dhe koordinim me palët e jashtme të interesit. Në disa raste stafi ankohet edhe për zbatim të kriterëve selektive dhe ndërhyrje politike në proces.

Gjithashtu, për të rregulluar normativin e stafit profesional, MASHT ka miratuar Udhëzimin administrativ 10/2018 për Normativin e Stafit në Arsim të Përgjithshëm. Rishikimi i legjislacionit kishte për qëllim ridefinimin e normativit të mësimdhënësve në parashkollor, arsimin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë – përgjithshëm dhe arsimit special. Gjatë kësaj periudhe është formuar Këshilli i Prindërve të Kosovës dhe hartuar rregullorja për funksionimin e tij. Janë organizuar trajnime për drejtorë shkollash dhe kandidatë me ambicie për drejtorë në të ardhmen sipas programeve të akredituara (Të certifikuar 210 kandidatë) Trajnimet janë organizuar nga projekti i Arsimit Fillor të GIZ.

Mësimdhënësit dhe drejtorët e shkollës në Kosovë kanë përceptimin që përgjegjësia e tyre është e kufizuar në mësimdhënie, vlerësim të nxënësve dhe masave disiplinore (OECD,2019). Për ndryshim nga vendet e avancuara të OECD, drejtori i shkollës dhe mësimdhënësit nuk kanë përgjegjësi në përcaktim të kurrikulës,



përmbajtjes së lëndës dhe teksteve mësimore. Drejtorët e shkollave janë të kufizuar në administrim të shpenzimeve, pranim të nxënësve dhe masave disiplinore. Për dallim nga vendet e OECD, ata nuk përceptojnë se është përgjegjësi e tyre të angazhohen në përmbajtje të lëndëve, rregullat e vlerësimit të nxënësve, planifikim buxhetor, përzgjedhje të stafit, vlerësim të stafit apo shkarkim të tyre. Këshilli drejtues i shkollës është më tepër i kufizuar në planifikim buxhetor, mbikëqyrje të shpenzimeve dhe masave disiplinore.

Gjatë vitit 2017, është miratuar Udhëzimi administrativ mbi Vlerësimin e Përformancës së Institucioneve Arsimore në Nivelin Parauniversitar (UA 4/2017) që përcaktojnë detyrat dhe përgjegjësitë e hallkave arsimore në procesin e vlerësimit. Nëkuadër të fushave të vlerësimit të përformancës është edhe vlerësimi i menaxhimit dhe qeverisjes së institucionit arsimor. Udhëzimi Administrativ për Vlerësim të Përformancës së Mësimdhënësve nuk trajton aspektin e vlerësimit të përformancës së udhëheqësisë arsimore. Gjatë procesit të vlerësimit nuk është dokumentuar ndonjë rregullativë ligjore që definojnë aspektet e vlerësimit të drejtorit dhe zëvendës drejtorit të shkollës. Gjatë vitit 2018, është hartuar draftudhëzimi administrativ për detyrat, përgjegjësitë, procedurat dhe kriteret e zgjedhjes së drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar. Udhëzimi ka për qëllim që të definojë detyrat, përgjegjësitë, procedurat dhe kriteret për përzgjedhje të drejtorëve dhe zv. drejtorëve në institucione publike arsimore në arsimin parauniversitar. Gjithashtu, është hartuar draftudhëzimi administrativ për Vlerësim të Përformancës së drejtorëve dhe zv. drejtorëve në institucionet publike të arsimit parauniversitar. Udhëzimi rregullon sistemin e vlerësimit të performancës, definojnë kriteret dhe procedurat për zbatim të vlerësimit dhe detyrat dhe përgjegjësitë në proces të vlerësimit.

Gjithashtu janë hartuar formularë të vlerësimit të performancës së drejtorëve dhe zv. drejtorëve të cilët janë pilotuar në 4 komuna. Drafti i UA dhe formularët e vlerësimit kanë kaluar të gjitha procedurat ligjore duke përfshirë konsultimin paraprak dhe diskutimin publik. Ky draft UA, së bashku me formularët e vlerësimit është planifikuar të finalizohet dhe të miratohet gjatë vitit 2020.

## 6.2.2 Standardet profesionale për udhëheqje në arsim

### Rezultati 2.2 Përcaktimi i standardeve profesionale për mekanizmin e punësimit dhe menaxhimit të karrierës së udhëheqësve të institucioneve edukative-arsimore

Në kuadër të rezultatit është paraparë një listë e aktiviteteve për vitin 2018 duke përfshirë përcaktimin e statusit të drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucioneve edukative arsimore, krijimin e mekanizmave për vlerësim të performancës së drejtorëve, funksionalizimin e mekanizmave për përzgjedhjen e drejtorëve, zhvillimin e sistemit të menaxhimit të karrierës së drejtorëve në bazë të standardeve të aplikueshme dhe ofrimin e qasjes së barabartë për gratë dhe burrat në programet e zhvillimit profesional të drejtorëve.

Gjatë vitit 2017 është miratuar Udhëzimi Administrativ mbi Vlerësimin e Përformancës së Institucioneve Arsimore në Nivelin Parauniversitar (UA 4/2017) që përcaktojnë detyrat dhe përgjegjësitë e hallkave arsimore në procesin e vlerësimit. Në kuadër të fushave të vlerësimit të përformancës është edhe vlerësimi i menaxhimit dhe qeverisjes së institucionit arsimor. Udhëzimi Administrativ për Vlerësim të Përformancës së Mësimdhënësve nuk trajton aspektin e vlerësimit të përformancës së udhëheqësisë arsimore. Gjatë procesit të vlerësimit nuk është dokumentuar ndonjë rregullativë ligjore që definojnë aspektet e vlerësimit të drejtorit dhe zëvendës drejtorit të shkollës.

Gjatë vitit 2018, është hartuar draftudhëzimi administrativ për Procedurën e Përzgjedhjes së Drejtorëve dhe Zv. drejtorëve në Institucionet Publike të Arsimit të lartë. Udhëzimi ka për qëllim që të definojë kriteret dhe procedurat për përzgjedhje të drejtorëve dhe zv. drejtorëve në institucione publike arsimore dhe të trajnimit në



arsimin parauniversitar. Gjithashtu, është hartuar draftudhëzimi administrativ për Vlerësim të Performancës së Drejtorëve dhe Zv.drejtorëve në institucionet publike të arsimit parauniversitar. Udhëzimi rregullon sistemin e vlerësimit të performancës, definon kriteret dhe procedurat për zbatim të vlerësimit dhe detyrat dhe përgjegjësitë në proces të vlerësimit. Në vitin 2019, është hartuar UA për Vlerësimi i Performancës së drejtorëve dhe zv. drejtorëve. Gjithashtu janë hartuar formularët e vlerësimit të performancës së drejtorëve dhe zv. Drejtorëve të cilët janë pilotuar në 4 komuna. Drafti ka kaluar të gjitha procedurat ligjore duke përfshirë konsultimin paraprak dhe diskutimin publik.

### 6.2.3 Formula e financimit

**Rezultati 2.3 Zbatohet një mekanizëm funksional i financimit të arsimit parauniversitar që i kontribon zhvillimit të shkollës.**

Për të arritur rezultatin e synuar, Plani i Veprimit 2018, parashikon rishikimin e formulës së financimit të arsimit parauniversitar për të ofruar mundësi të adresimit të specifikave të ndryshme të shkollave në dobi të cilësisë, rritjen e efektshmërisë së proceseve të planifikimit të buxhetit arsimor në nivel lokal, zhvillimin e kapaciteteve në shkollë dhe në DKA për menaxhim financiar dhe përcaktimin e treguesve të shpenzimeve të realizuara në arsim me qëllim të vlerësimit të efikasitetit të shpenzimeve në arsim.

Granti specifik për arsim parauniversitar për vitin 2020 është aprovuar në shumë prej 205.5 milion euro, nga të cilat 192.1 milion euro janë paga dhe mëditje, 10.8 milion euro janë mallra dhe shërbime dhe 2.5 milion euro shpenzime kapitale. Granti Specifik për Arsim, bazohet në sistem të hapur të financimit, duke marrë parasysh kriteret në formulën e arsimit parauniversitar të MASHT për vitin 2020. Formula trajton nivelin e arsimit parafillor, fillor dhe të mesëm, duke marrë për bazë numrin e nxënësve, raportin nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor (1:21), raportin nxënës-mësimdhënës për edukimin parashkollor (1:12), raportin nxënës mësimdhënës për arsimin profesional (1:17), kalkulimin e stafit mësimdhënës të gjuhës angleze, kalkulimin për stafin teknik administrativ (1:630 nxënës), kalkulimi për stafin mësimdhënës në lehonë është paraparë 3% (bazë stafi mësimdhënës), kalkulimi për stafin ndihmës për 170 nxënës -1 staf (pastrues) si dhe 1 staf për shkollë (roje). Mallrat dhe shërbimet janë kalkuluar sipas kriterit për nxënës (23 euro për nxënës shumicë dhe 25 euro për nxënës pakicë) dhe për shkollë (1,500 euro për shkollë parafillore dhe fillore dhe 3,250 euro për shkollë të mesme). Kapitallet kalkulohen sipas kriterit 7 euro për nxënës.

Në kuadër të arsimit të fëmijëve me nevoja të veçanta është realizuar rregullorja për financim duke inkorporuar specifikat e nënsektorit. Në arsimin profesional ka filluar procesi i shqyrtimit të financimit bazuar në nevojat dhe specifikat e profileve dhe profesioneve. Në formulën e financimit të vitit 2019, janë inkuadruar edhe asistentët për nxënësit me nevoja speciale dhe financimi për kordinatorët e cilësisë. Megjithatë, ende nuk është miratuar ndonjë ndryshim në sistem. Reforma e formulës së financimit është e domosdoshme për të të trajtuar nevojën e investimit në resurse arsimore dhe ofruar shkollave përgjegjësi më të madhe në përcaktim të prioriteteve

Shkollat në përgjithësi kanë fare pak kontrollë mbi buxhetet e tyre. Mungesa e praktikës së funksionalizimit të tërësishëm të bordeve të shkollave dhe planeve të punës, e kombinuar me mungesën e buxhetit dhe të shkathtësive për menaxhim financiar në nivel të drejtorëve të shkollave, edhe më tutje e pengojnë procesin e decentralizimit. Në një situatë të tillë, DKA-të shpesh shërbejnë si qendra të prokurimit për rrjetin e shkollave vetëm nën mbikëqyrjen e tyre, duke e devijuar kështu vëmendjen nga çështjet strategjike të sektorit të arsimit në nivel lokal, siç është planifikimi i politikave, dhe monitorimi. Nuk janë raportuar aktivitete që ndërlidhen me përpjekje sistematike për të përmirësuar kapacitetin e shkollave dhe komunave për planifikim dhe zbatim të buxhetit. Nuk ekziston ndonjë raport për të përcaktuar shkallën e progresit në zbatim të decentralizimit

financiar. Shkalla e pjesëmarrjes së komunave në shpenzimet arsimore ëshë nën 5% të shpenzimeve të përgjithshme në arsimin parauniversitar. Në lidhje me aktivitetin mbi nevojën e përcaktimit të treguesve financiar në nivelin paauniversitar, MASHT, me mbështetje nga UNICEF, është përcaktuar metodologjia e përlogaritjes së shpenzimeve publike në arsim parauniversitar, janë përcaktuar përgjegjësitë institucionale dhe janë definuar treguesit bazë. Dokumenti udhëzues që përshkruan metodologjinë për përlogaritjen e përqindjes së shpenzimeve publike në arsimin parauniversitar në Kosovë, të ndara sipas niveleve të ISCED (arsimi parafillor, fillor, i mesëm i ulët dhe i mesëm i lartë) të arsimit, duke përfshirë identifikimin e departamenteve/ institucioneve përgjegjëse qeveritare si dhe treguesit është përlogaritur në baza vjetore 2016-2019.

## 6.2.4 Informatat dhe statistikat arsimore

### Rezultati 2.4: Përgatiten dhe publikohen raporte të rregullta të bazuara në analiza dhe interpretim të të dhënave nga SMIA, si dhe shfrytëzohen këto analiza në politikëbërje

Në kuadër të rezultatit parashihen disa aktivitete përfshirë plotësimin e kornizës së treguesve sipas UNESCO, EUROSTAT, OECD, zhvillimi i kapaciteteve për mbledhje, analizë dhe interpretim të avancuar të të dhënave, zhvillimi i procedurave për menaxhimin e të dhënave dhe përdorimin e tyre, ngritja e kapaciteteve për shfrytëzuesit e të dhënave nga shkollat, komunat, niveli qendror dhe universitetet, zhvillimi i platformës për integrimin e sistemeve ekzistuese të informative dhe bazave të të dhënave për të gjitha nivelet dhe ristrukturimi i divizionit për koordinim të politikave dhe statistikave për të qartësuar rolet që lidhen me SMIA.

MASHT ka përmbushur aktivitetin e paraparë për rishikim dhe publikim të kornizës së treguesve të përditësuar arsimor sipas kërkesave të UNESCO, EUROSTAT dhe OECD. Në vitin 2017, është përfunduar dhe publikuar botimi “Korniza e Treguesve të Arsimit”. Publikimi Vjetor i Treguesve arsimor 2018/2019, është strukturuar sipas metodologjisë së re të përlogaritjes së treguesve.

Publikimi vjetor i treguesve arsimor 2018/2019, është strukturuar sipas metodologjisë së re të përlogaritjes së treguesve. MASHT në vazhdimësi u ofron përkrahje drejtorëve të shkollave për futjen e të dhënave statistikore në sistemin SMIA. Po ashtu, janë përgatitur dhe gjeneruar raporte të ndryshme, varësisht nga periudhat e raportimit dhe kërkesat e menaxhmentit, si dhe publikimet: “Raporti vjetor statistikor me tregues arsimorë” për vitin 2018/19 dhe “Statistikat e arsimit në Kosovë 2018/2019” (në bashkëpunim me ASK). Përfaqësues të MASHT janë pjesë e Komitetit Teknik të MICS-it 2019 dhe vazhdon puna në realizimin e këtij projekti, në bashkëpunim me UNICEF dhe ASK.

MASHT ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në mbledhjen e të dhënave mbi sistemin arsimor. Hendeku i viteve të mëhershme mbi të dhënat në arsimin profesional dhe arsimin e lartë ka filluar të adresohet dhe duhet të jetë funksional gjatë viteve në vazhdim. Të dhënat input në lidhje me shkollën, mësimdhënësit dhe infrastrukturën janë përgjithësisht të disponueshme. Këto të dhëna kanë filluar të përdoren në procesin e planifikimit dhe menaxhimit. Sidoqoftë, arsimit është një nga politikat kyçe publike dhe barra kryesore e buxhetit vjetor qeveritar.

Me hyrjen në fuqi të Rregullores së re për organizimin e brendshëm të MASHT-it (tetor 2018) Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim të Lartë (SMIAL) ka kaluar nën administrim të Divizionit për grumbullimin dhe analizën e të dhënave (në kuadër të të cilit divizion është dhe SMIA).

Që nga viti 2017, MASHT është duke zbatuar Projektin e Bankës Botërore për Përmirësimin e Sistemit të Arsimit, në kuadër të të cilit projekt kanë qenë të përfshira edhe zhvillimin i sistemeve qendrore dhe avancimi i sistemit ekzistues SMIA (Sistemi për Menaxhimin e Informatave në Arsim). Gjatë vitit 2018, janë aprovuar termat e referencës për specifikacionet e reja të sistemit dhe është bërë shpallja për ofertues të interesuar.

Megjithatë, ky aktivitet thelbësor për avancim të të dhënave të sistemit arsimor ka dështuar, për shkak të procesit të tejzgjatur të përzgjedhjes së kompanisë implementuese. Projekti është ridizajnuar dhe zgjatuar deri në vitin 2020, por me komponenta të reduktuara.

## 6.2.5 Legjislacioni në arsim parauniversitar

### Rezultati 2.5 Legjislacioni është harmonizuar dhe kompletuar për tërë sektorin e arsimit parauniversitar

Plani i Veprimit 2017-2021, liston një seri të aktiviteteve duke përfshirë analizën e koherencës së legjislacionit primar dhe sekondar në raport me projektligjet që janë në proces të miratimit, politikat tjera dhe ligjet jashtë sektorit të arsimit, hartimin e planit dinamik të hartimit të legjislacionit, hartimin dhe plotësimin e akteve nënligjore dhe ligjore dhe monitorimin e implementimit të akteve ligjore dhe nënligjore. Aktivitetet nuk janë specifike sa i përket llojit apo numrit të akteve ligjore apo nënligjore që duhet miratuar në kornizën kohore të zbatimit.

MASHT me mbështetje të GIZ-it ka bërë Analizën e Koherencës së Legjislacionit Primar dhe Sekondar. Kjo analizë ofron një pasqyrë të legjislacionit në fushën e arsimit parauniversitar në Kosovë, përkatësisht një analizë krahasimtare në mes të ligjeve primare si Ligji nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar, Ligji nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet të Kosovës dhe legjislacionit sekondar, përkatësisht Udhëzimeve administrative të nxjerra nga MASHT. Sipas gjetjeve të Raportit, Ligjet kanë shumë gabime teknike dhe drejtshkrimore, u mungon koherenca e brendshme dhe nenet nuk janë të renditura në mënyrë konsekuenteve për nga çështja që trajtojnë. Analiza po ashtu, demonstroi se shpesh herë ligji përmban dispozita që e tejkalojnë vetë fushëveprimin e atij ligji, e që edhe bien në kundërshtim me ligjin bazik. Dispozitat ligjore që ndërlidhen me zgjedhjen e drejtorit dhe të zëvendës-drejtorit, janë jo-koherente dhe lënë zbrazëti ligjore dhe shpesh herë edhe kundërshtojnë njëra tjetrën. Gjithashtu, UA për Zbatimin e Standardeve të Teksteve Mësimore (2011) paradaton Ligjin për Arsimin e Lartë dhe nuk eksitojnë dispozita të qarta në aktet nënligjore mbi procedurat e prokurimit dhe botimit të teksteve shkollore.

Analiza e koherencës nënvizon nevojën e adresimit të paqartësive edhe në UA për Licencimin e Mësimdhënësve. Sa i përket sistemit të Licencimit ekzistojnë paqartësi të shumta për sa i përket kompetencave të institucioneve. Nga një lexim makro, lexuesi dhe interpretuesi mund të vie në përfundim se institucionet qendrore në procesin e licencimit janë MASHT, KSHLM dhe Divizioni për ZHPM ku këto dy të fundit faktikisht janë bartëse të procesit. Por dispozitat e ligjit dhe udhëzimeve nuk e bëjnë të lehtë që të kuptohet kjo ndërlidhje funksionale dhe ndarje e kompetencave. Përkundrazi, dispozitat shpesh herë janë në kundërshtim me njëra tjetrën dhe krijojnë paqartësi të shumta dhe krijojnë hapësirë për interpretim dhe keqkuptim lidhur me rolin dhe kompetencat e KSHLM në raport me Ministrinë për sa i përket procesit të licencimit të mësimdhënësve. Udhëzimi 05/17 për sistemin e Licencimit ka qartësuar disa nga këto pika, por ekziston një domosdoshmëri e sigurimit të koherencës në mes të këtyre akteve. Për më shumë vërehen mangësi dhe kundërthënie lidhur me procesin e hyrjes në profesion, kriterin e hyrjes në profesion dhe licencimin.

Ndërmjet periudhës 2017-2019 janë aprovuar dy Ligje të rëndësishme për sistemin arsimor – Ligji për Inspektoratin e Arsimit dhe Ligji për Statusin e Punëtorëve të Arsimit Shqip 1990-1999. Gjithashtu, janë në proces edhe disa iniciativa tjera të rëndësishme ligjore si Ligji për Edukim Parashkollor, Ligji për Arsimin Profesional dhe Ligji për Teste Shkollore. Gjatë vitit 2019 janë miratuar/rishikuar 18 Udhëzime Administrative. Në tërësi, MASHT ka rishikuar/miratuar 55 Udhëzime administrative që nga viti 2017 me qëllim të zbatimit të legjislacionit primar në arsim.

## 6.2.6 Siguria dhe shëndeti në shkolla


### Rezultati 2.6: Shkollat kanë krijuar mjedise të sigurta, miqësore dhe të shëndetshme për të gjithë

Në kuadër të rezultatit, Plani i Veprimit 2017-2019, parasheh aktivitete vetëdijësimi për mjedisin dhe shëndetin, krijimin e mekanizmave për promovim të shëndetit në nivel komunal, hartimin e materialeve për shëndetin dhe mjedisin shkollor, ndërtimin e mekanizmave për reagim në rastet emergjente, pajisja e shkollave me pajisje zjarrfikëse, pajisja e shkollave me komplete të ndihmës së parë, aktivitete të ngritjes së kapaciteteve të shkollave dhe komunave për parandalim të dhunës dhe trajnimin e personelit të shkollës për sigurinë dhe shëndetin në shkollë.

Janë krijuar grupet apo komisionet për edukim dhe promovim shëndetësor në 7 rajonet e formuara nga Komisioni për Edukim Shëndetësor që funksionin në kuadër të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike, me pjesëmarrje edhe nga MASHT. Gjatë vitit 2019, është realizuar një seri e aktiviteteve në Prishtinë për jetësimin e konceptit të shkollave promovuese të shëndetit. Në komponentën mjedisore të rezultatit, aktivitetet përqëndrohen në vetëdijësim të nxënësve në lidhje me mjedisin. MASHT dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor bashkërisht organizojnë Ditën Ndërkombëtare të Tokës dhe Mjedisit. Krijimi i mekanizmave në nivel lokal dhe në nivel shkolle për promovim të shëndetit në shkolla ende vazhdon të jetë sfidë në saje të numrit të madh të akterëve dhe Ministrive të linjës. Shkollat dhe komunat organizojnë aktivitete që jo domosdoshmërisht raportohen në MASHT.

Sa i përket aktiviteteve për sigurinë dhe parandalimin e dhunës janë mbajtur tri sesione me shkollat e Gjakovës, Pejës dhe Klinës rreth zbatimit të politikave për parandalim dhe referim të dhunës në shkolla. Gjithashtu është mbajtur punëtorja rreth zbatimit të Protokollit 21/2013 për parandalim dhe referim të dhunës në komunat: Gjakovë, Gjiilan dhe Mitrovicë.

#### Incidentet e dhunës në shkolla të raportuara në SMIA (2014-2019)



Deri tani nëpër vite shkollore në modulin e rasteve të dhunës në SMIA janë raportuar gjithsej 141 raste. Në raste të caktuara shkollat arrijnë të raportojnë siç përcaktohet në legjisacionin sekondar në lidhje me elementin e dhunës. Për ta motivuar raportimin cilësor, MASHT gjatë 2019 ka shpërblyer shkollat që kanë raportuar, duke i njohur si shkolla të mira e të vëmendshme ndaj problemeve që u paraqiten. Gjithashtu është zhvilluar edhe programi i përbashkët Kosovë- Shqipëri “Me shkollat për komunitete të sigurta”, si dhe u mbajtën trajnime për trajnerë. Sfidë është raportimi i dhunës dhe trajtimi adekuat i temave që lidhen me sigurinë dhe parandalimin e dhunës e të dukurive negative në shkolla. Rekomandohet që stafi arsimor t`i kushtojë kohë pjesës së edukimit krahas arsimit, ngase komponenta edukative ka një shkëputje nga veprimtaria aktuale e

shkollave tona. Gjithsesi duhet të ketë koordinim ndërinstitucional për trajtimin e duhur të predispozitave të dhunës dhe rasteve që kanë nevojë për shërbime, siç e kërkon Protokollin për parandalim dhe referim të dhunës në shkolla dhe legjislacioni në fuqi.


## 6.2.7 Sistemi i menaxhimit të infrastrukturës

### Rezultati 2.7: Ndërtohet një sistem efektiv i menaxhimit të infrastrukturës shkollore që shpie drejt krijimit të mjediseve fizike të përshtatshme për mësim

Në kuadër të rezultateve parashihen disa aktivitete duke përfshirë zhvillimin e normave dhe standardeve për projektimin e objekteve arsimore për të gjitha nivelet, promovimin e normave dhe standardeve, monitorimin e implementimit të normave, vlerësimin e gjendjes fizike të objekteve edukative-arsimore, hartimi i udhëzuesve për mirëmbajtjen dhe ruajtjen e hapësirave shkollore të të gjitha niveleve, avancimi i databazës për ndërtesat arsimore, hartimi i një udhëzuesi për planifikimin e investimeve në ndërtesat e reja shkollore dhe hartimi i një plani të investimeve për hapësirat shkollore për një periudhë 3-5 vjeçare.

Shkollat në vendet e OECD kanë mesatarisht 769 nxënës dhe 34 mësimdhënës. Kosova në vitin 2019, kishte mesatarisht 301 nxënës dhe 14.2 mësimdhënës për shkollë. Kosova karakterizohet për nga modeli i shkollave të vogla. Rreth 60 % për qind të shkollave nën 250 nxënës. Mbi 300 shkolla funksionojnë me nën 100 nxënës apo rreth 4 nxënës për klasë. Operimi i këtyre paraleleve duhet të shqyrtohet jo vetëm për shkak të jo-eficiencës së theksuar buxhetore por edhe për shkak të cilësisë së dobët të mësimdhënies.

Shkollat sipas numrit të nxënësve 2019 - SMIA 2019




Kostoja mesatare vjetore për operim të një institucioni shkollor është rreth 228,098,000 euro. Shkollat kanë kosto të lartë fikse në staf dhe mirëmbajtje. Shpenzimet mesatare vjetore të shkollave me 1000-2500 nxënës në krahasim me shkollat me 100 nxënës janë vetëm 4 herë më të larta edhe pse numri i nxënësve mund të jetë 10 herë më i lartë. Prishtina, Mitrovica, Ferizaj, Fushë Kosova dhe Prizreni kanë ngarkesë më të lartë të nxënësve. Optimalizimi i numrit të nxënësve bazuar në Planin Hapësinor dhe parashikimet demografike do të jenë të domosdoshme në një të ardhme të afërt.

## 6.2.8 Investimet kapitale

### Rezultati 2.8: Përmirësohet infrastruktura arsimore përmes ndërtimit, renovimit, zgjerimit dhe pajisjes së institucioneve arsimore me mjete adekuate për procesin mësimor

Për të përmbushur rezultatin, Plani i Veprimit 2017-2019 liston një seri të aktiviteteve duke përfshirë ndërtimin e 5 objekteve të reja shkollore, ndërtimin e 3 kopshteve, renovimin e 50 objekteve shkollore, pajisjen e 10 shkollave me pako sportive, pajisjen e dhomave të mësimin me inventar adekuat për mësim dhe pajisjen e shkollave me dollapë individual për nxënës. Gjatë vitit 2018, janë rritur shpenzimet kapitale për infrastrukturë shkollore pas një rënie të vazhdueshme që nga viti 2014. MASHT ka realizuar një numër të konsiderueshëm të projekteve kapitale me mbështetje të BE-së në edukim parashkollor. Ka filluar ndërtimi i një çerdheje në Prishtinë me projektin IPA dhe janë në proces të hartimeve të projekt-dizajneve 6 çerdhe tjera me IPA II. Vazhdon ndërtimi i 2 çerdheve me participim të MASHT (IPA II) dhe 2 çerdhe me buxhet të MASHT-it. Gjithashtu, gjatë vitit 2018 ka përfunduar ndërtimi i dy objekteve shkollore, një salle të sportit. Vazhdon ndërtimi i 14 objekteve tjera nga MASHT dhe 5 sallave të sportit. MAP po vazhdon ndërtimin e 9 objekteve të shkollave dhe një salle të sportit dhe ka filluar, ndërtimet në 3 objekte tjera shkollore.

Shpenzimet kapitale në milion euro në arsimin parauniversitar 2012-2019 - MASHT 2019



Rreth 80% e drejtorëve dhe mësimdhënësve në Kosovë nëvizojnë rëndësinë e riorientimit të financimit dhe investimeve në teksteve mësimore, biblioteka, laboratorëve dhe mjetet digjitale. Mungesa e infrastrukturës fizike dhe infrastruktura jo-adekuate, sidomos mungesa e dhomave të leximit për nxënës, janë po ashtu sfida primare. Sistemi arsimor ka qasje të ulët në teknologji të informimit dhe komunikimit dhe teknologjia bashkëkohore ende nuk është integruar në mënyrë të përshtatshme në kurrikulë, mësimdhënie dhe menaxhim të sistemit arsimor. Ngritja e cilësisë në të gjitha nivelet është e kushtëzuar nga aftësia e mësimdhënësve dhe nxënësve për të përvetësuar mjetet bashkëkohore të mësimdhënies dhe teknologjisë. Nuk është shënuar ndonjë përparim i ndjeshëm në pajisjen e shkollave me pajisje digjitale. Strategjia në vazhdim duhet të rishikohet në favour të infrastrukturës së brendshme shkollore dhe mjeteve të konkretizimit. Kjo për arsye sepse Kosova listohet në mesin e vendeve me kënaqshmërinë më të ulët të mësimdhënësve/drejtorëve të shkollave me resurset mësimore duke përfshirë laboratorët, tekstat mësimore dhe kompjuterët (OECD, 2019).

## 6.2.9 Matrica e Zbatimit të Aktiviteteve

No.	Rezultatet	Aktivitetet	Status	%
2.1	Ndërtohen kapacitete për menaxhim efektiv dhe të përgjegjshëm të sistemit në nivelin qendror dhe komunal, si dhe menaxhim efektiv në nivel shkolle.	2.1.1 Ristrukturimi i organizimit të DKA-ve në përputhje me strukturën e decentralizuar të sistemit të arsimit		4
		2.1.2 Trajnimi i personelit të DKA-ve sipas nevojave të identifikuara dhe në përputhje me strukturën e decentralizuar të sistemit të arsimit		3
		2.1.3 Hartimi i rregulloreve dhe udhëzuesve mbështetës për menaxhimin e arsimit në nivel komunal		3
		2.1.4 Trajnimi i personelit të MASHT për planifikim, politikë-bërje dhe monitorim		3
		2.1.5 Zhvillimi i mekanizmave për komunikim efektiv midis palëve të ndryshme në sistem përmes raportimit dhe proceseve të tjera të rregullta koordinuese		3
		2.1.6 Funksionalizimi dhe fuqizimi i këshillave të prindërve në nivel shkolle, komune dhe shteti përmes ofrimit të mbështetjes për punën e tyre dhe monitorimin e punës së tyre		3
		2.1.7 Trajnimi i personelit administrativ dhe anëtarëve të organeve drejtuese të shkollës për qeverisje dhe udhëheqje		4
		2.1.8 Krijimi i rrjetit të bashkëpunimit dhe të komunikimit në mes të shkollave në fushën e udhëheqjes dhe zhvillimit profesional të mësimitdhënësve (Komuniteti i të nxëniet)		3
		2.1.9 Fuqizimi i qasjes së integruar në planifikim midis MASHT – DKA – Shkollë		3
		2.1.10 Menaxhimi i rrjetit të shkollave		2
		2.1.11 Fuqizimi i autonomisë së shkollës		2
2.2	Përcaktimi i standardeve profesionale për mekanizmin e punësimit dhe menaxhimit të karrierës së udhëheqësve të institucioneve edukative-arsimore	2.2.1 Përcaktimi i statusit të drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucioneve edukative-arsimore		4
		2.2.2 Krijimi i mekanizmave për monitorim dhe vlerësim të performancës së drejtorëve dhe zëvendës-drejtorëve		4
		2.2.3 Funksionalizimi i mekanizmave për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës-drejtorëve duke përfshirë trajnimin e komisioneve përzgjedhëse		3
		2.2.4 Zhvillimi i sistemit të menaxhimit të karrierës së drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në bazë të standardeve të aplikueshme		3
		2.2.5 Ofrimi i qasjes së barabartë për gratë dhe burrat në programet e zhvillimit profesional të drejtorëve dhe zëvendës-drejtorëve dhe mësimitdhënësve që synojnë karrierë menaxhimi duke siguruar një ofertë gjithëpërfshirëse dhe financim të qëndrueshëm		3
2.3	Zbatohet një mekanizëm funksional i financimit të arsimit parauniversitar që i kontribuon zhvillimit të shkollës përfshirë në sistemin arsimor parauniversitar	2.3.1 Rishikimi i formulës së financimit të arsimit parauniversitar për të ofruar mundësi të adresimit të specifikave të ndryshme të shkollave në dobi të cilësisë		3
		2.3.2 Rritja e efektshmërisë së proceseve të planifikimit të buxhetit arsimor në nivel lokal		2
		2.3.3 Zhvillimi i kapaciteteve në shkollë dhe në DKA për menaxhim financiar		2
		2.3.4 Përcaktimi i treguesve të shpenzimeve të realizuara në arsim me qëllim të vlerësimit të efikasitetit të shpenzimeve në arsim		4



No.	Rezultatet	Aktivitetet	Status	%
2.4	Përgatiten dhe publikohen raporte të rregullta të bazuara në analiza dhe interpretim të të dhënave nga SMIA, si dhe shfrytëzohen këto analiza në politikëbërje	2.4.1 Ristrukturimi i divizionit për koordinim të politikave dhe statistika që të qartësohen rolet që lidhen me SMIA		4
		2.4.2 Zhvillimi i kapaciteteve për mbledhje, analizë dhe interpretim të avancuar të të dhënave		4
		2.4.3 Zhvillim i procedurave për menaxhimin e të dhënave dhe përdorimin e tyre		4
		2.4.4 Zhvillimi i platformës për integrimin e sistemeve ekzistuese të informatave dhe bazave të të dhënave për të gjitha nivelet		3
		2.4.5 Ngritja e kapaciteteve për shfrytëzuesit e të dhënave nga shkollat, DKA-të, niveli qendror dhe universitetet		3
		2.4.6 Plotësimi i kornizës së treguesve sipas UNESCO, EUROSTAT dhe OECD		5
		2.5	Legjislacioni është harmonizuar dhe kompletuar për tërë sektorin e arsimit parauniversitar	2.5.1 Analiza e koherencës së legjislacionit primar dhe sekondar në raport me projektligjet që janë në proces të miratimit, politikat tjera dhe ligjet jashtë sektorit të arsimit
2.5.2 Hartimi dhe plotësimi i akteve ligjore dhe nënligjore				4
2.5.3 Monitorimi i implementimit të akteve ligjore dhe nënligjore.				2
2.6	Shkollat kanë krijuar mjedise të sigurta, miqësore dhe të shëndetshme për të gjithë	2.6.1 Aktivitete vetëdijesimi për mjedisin dhe shëndetin		3
		2.6.2 Krijimi i mekanizmave për promovim të shëndetit në nivel komunal dhe në nivel shkolle		3
		2.6.3 Hartimi i materialeve për shëndetin dhe mjedisin shkollor		4
		2.6.4 Analizohen nevojat për ujë të pijshëm dhe nyje sanitare, si dhe zhvillohen mekanizma për mirëmbajtjen e tyre		3
		2.6.5 Hartimi i një udhëzuesi për sigurinë në institucione edukative-arsimore		4
		2.6.6 Ndërtimi i mekanizmave për reagim në rastet emergjente		3
		2.6.7 Vendosja e pajisjeve zjarrfikëse në shkolla		2
		2.6.8 Pajisja e shkollave me komplete të ndihmës së parë		2
		2.6.9 Aktivitete të ngritjes së kapaciteteve të shkollave dhe DKA-ve për parandalim të dhunës		4
		2.6.10 Trajnimi i personelit shkollor për sigurinë dhe shëndetin në shkollë		3



No.	Rezultatet	Aktivitetet	Status	%
2.7	Ndërtohet një sistem efektiv i menaxhimit të infrastrukturës shkollore që shpie drejt krijimit të mjediseve fizike të përshtatshme për mësim.	2.7.1 Zhvillimi i normave dhe standardeve për projektimin e objekteve arsimore për të gjitha nivelet.		4
		2.7.2 Promovimi i normave dhe standardeve të ndërtimit të objekteve tek të gjitha nivelet dhe palët.		3
		2.7.3 Monitorimi i implementimit të normave dhe standardeve të ndërtimit të objekteve.		3
		2.7.4 Vlerësimi i gjendjes fizike të objekteve edukative-arsimore		3
		2.7.5 Hartohen udhëzuesit për mirëmbajtjen dhe ruajtjen e hapësirave shkollore të të gjitha profileve dhe niveleve		3
		2.7.6 Avancimi i databazës për ndërtesat arsimore		4
		2.7.7 Hartimi i një udhëzuesi për planifikimin e investimeve në ndërtesat e reja shkollore		4
		2.7.8 Hartimi i një plani të investimit për hapësirat shkollore për një periudhë prej 3 dhe 5 vjeçare		3
2.8	Përmirësohet infrastruktura arsimore përmes ndërtimit, renovimit, zgjerimit dhe pajisjes së institucioneve arsimore me mjete adekuate për procesin mësimor	2.8.1 Ndërtohen objekte të reja shkollore duke synuar që 1/3 e nxënësve të mësojnë në një ndërrim		4
		2.8.2 Ndërtimi i objekteve për parashkollor/parafillor		3
		2.8.3 Renovimi i objekteve edukativo-arsimore		3
		2.8.4 Pajisja e shkollave me pako sportive		2
		2.8.5 Pajisja e dhomave të mësimit me inventar adekuat për mësim		2
		2.8.6 Pajisja e shkollave me dollapë individualë për nxënës		1
		2.8.7 Zgjerimi dhe përmirësimi i mjediseve mësimore në institucionet e arsimit të lartë		3

## 6.2.10 Treguesit e Performancës

### TREGUESIT KRYESOR TË MENAXHIMIT TË SISTEMIT ARSIMOR 2015-2019

	2015	2016	2017	2018	2019
<b>Numri i nxënësve</b>					
Numri i nxënësve parauniversitar total	374,407	369,309	365,029	356,270	345,540
Numri i nxënësve parauniversitar publik	367,940	360,237	354,454	342,352	329,589
Numri i nxënësve parauniversitar privat	6,467	9,072	10,575	13,918	15,951
Shkalla e nxënësve privat në parauniversitar	1.8	2.5	2.9	3.9	4.6
<b>Numri i shkollave</b>					
Numri i institucioneve shkollore parauniversitare	1137	1114	1118	1116	1094
Numri i institucioneve parashkollor	43	43	42	43	44
Numri i institucioneve fillor/mesëm ulët	969	946	948	942	921
Numri i institucioneve mesëm lartë	119	119	122	125	123
Shkolla speciale	6	6	6	6	6
<b>Personeli</b>					
Total personel parauniversitar	28,103	27,964	28,121	28,131	28,150
Numri i personelit administrativ	1654	1673	1659	1675	1566
Personeli administrativ femra (%)	26.5	26.8	28.6	30	49.4
Numri i mësimdhënësve	23,266	23,202	23,281	23,262	23,234
Numri i personelit ndihmës	3080	3089	3181	3194	3,350
Personeli parashkollor	801	808	812	854	847
Personeli fillor/mesëm ulët	21,170	21,025	21,150	21,145	21,151
Personeli mesëm lartë	6132	6131	6159	6132	6152

<b>Shpenzimet sipas ISCED</b>					
Shpenzimet parauniversitar milion €	215,294	218,271	216.31	234,31	249,56
Shpenzimet ISCED 0 Parashkollor	18,220	18,331	20,571	23,351	25,91
Shpenzimet ISCED 1 Fillor	75,025	75,161	79,267	84,177	91,60
Shpenzimet ISCED 2 Mesëm Ulët	69,559	70,166	63,692	68,954	73.40
Shpenzimet ISCED 3 Mesëm Lartë	52,489	54,612	52,778	57,653	58,62
<b>Shpenzimet sipas kategorive</b>					
Paga dhe Mëditje ne million €	168,138	170,740	171,240	177,834	186,634
Shpenzime kapitale ne million €	24,982	27,381	24,442	30,894	29,499
Mallëra dhe Shërbime ne million €	17,258	16,008	15,813	20,420	33,842
Shpenzime komunal ne million €	2,951	3,023	2,973	2,978	3,673
Subvencione dhe transfere ne million €	1,964	1,118	1,840	2,009	1,888
<b>Shpenzimet tjera</b>					
Shpenzimet vjetore për nxënës €	585.1	605.9	610.2	683.9	757.1
Shpenzimet në paga % në parauniversitar	78	78.2	79.1	75.9	73.4
Shpenzimet kapitale si % në parauniversitar	11.6	12.5	11.2	13.2	11.2
Shpenzimet mesatare për shkollë (000') €	189,352	195,934	193,479	209,800	228,098
Shpenzimet parauniversitar si % në arsim	81.9	81.4	81.1	81.9	82.3
Shpenzimet paraunivers. Si % buxhetit qeveritar	13.4	12.4	11.9	11.1	

## 6.2.11 Rekomandimet

- Të avancohet praktika e Sistemit të Integruar të Planifikimit*** - Është nxjerrë rregullativa ligjore që sistematizon procesin e planifikimit dhe menaxhimit ndërmjet hallkave të qeverisjes në sistemin e arsimit parauniversitar, arsim profesional dhe arsim të lartë. Procesi është i modeluar sipas qasjes së bazuar në tërë sistemin. Megjithatë, ky mekanizëm është ende në fazat fillestare. Në kuadër të Planit të Veprimit nuk janë vendosur caqe apo objektiva tjera në lidhje me komunikimin lartë-poshtë, poshtë-lartë dhe komunikimi anësor me hisedarë të sistemit. Gjithashtu, nuk reflektohet ndonjë vëmendje e posaçme në modelin e administrimit të sistemit, shkallës së centralizimit dhe definimit të saktë të roleve dhe përgjegjësi. Në kuadër të Planit të Veprimit duhet të reflektohet përpjekja për institucionalizim të praktikës së planifikimit, monitorimit dhe raportimit të integruar. Në kuadër të aktiviteteve duhet të inkorporohen synimet për funksionalizim të Komisionit për Menaxhim Strategjik dhe Komisioneve Programore.
- Të sistematizohet praktika e menaxhimit arsimor në komuna dhe shkolla*** - Menaxhimi i sistemit duhet të reflektoj shërbimet kryesore në shkolla (edukim parashkollor, arsim profesional, arsim themelor dhe arsim i lartë) dhe shërbime mbështetëse (planifikim, legjislacion, infrastrukturë, IT, tekste mësimore, zhvillim të mësimdhënësve, financa, prokurim). Një model i tillë i administrimit duhet të vendoset si në nivel komune ashtu edhe në nivel qendror. Një sistematizim i vendeve të punës, përshkrim i kompetencave dhe përgjegjësi duhet të realizohet në të ardhmen e afërt. Në kuadër të Planit të Veprimit të PSAK, duhet të integrohet përpjekja për nxjerrjen e Udhëzuesve Standard të Menaxhimit të Drejtorive Komunale dhe Vendeve të Punës.
- Të avancohet praktika e analizës së të dhënave mbi rezultatet dhe impaktin e politikave*** - Arsimi është një nga politikat kyçe publike dhe barrë kryesore të buxhetit vjetor qeveritar. Është e rëndësishme të rritet kapaciteti për të mbledhur të dhënat mbi rezultatet e veprimeve, legjislacionit, destinacionit të nxënësve dhe studentëve. Gjithashtu, me reformën e procesit të planifikimit në nivel qendror është inkorporuar dimensionin e analizës së sensitivitetit dhe ndikimit. Këto procese kushtëzojnë analiza më të avancuara ekonometrike mbi impaktin e politikave. MASHT duhet të jetë në gjendje të përcaktoj efektshmërinë e investimeve dhe rregullimit në arritje të rezultateve të synuara.
- Të përshpejtohen përpjekjet për miratim të formulës së re të financimit në arsimin parauniversitar*** - Vendet e avancuara kryesisht zbatojnë formula të financimit me disa shtylla. Një nga shtyllat e formulës mund të jetë formula aktuale e bazuar në kokë nxënësi. Shtyllat tjera mund të vendosen varësisht nga prioritetet dhe grupet e synuara: mësimi për nxënës me nevoja të veçanta, mësimi për nxënës në distanca të caktuara, shtylla për nxënës me asistencë sociale, shtylla për nxënës të gjuhës joamëtare, shtylla për zhvillim profesional të mësimdhënësve, shtylla për infrastrukturë dhe shtylla për performancë.
- Të rritet shkalla e investimeve kapitale në arsimin parauniversitar me qëllim të prioritizimit të infrastrukturës së brendshme dhe resurseve shkollore*** - Shkalla e investimeve kapitale në vitin 2018 dhe 2019 është rritur krahasuar me vitet paraprake. Megjithatë, shpenzimet kapitale ende mbeten të vogla në krahasim me shpenzimet e përgjithshme dhe më të ulëta se sa gjatë periudhës 2010-2012. Trendi aktual nuk lejon përmbushjen e caqeve të vendosura në Planin e Veprimit mbi renovimin, ndërtesat e reja dhe pajisjet shkollore. Vitet e fundit është prioritizuar nevoja e reduktimit të numrit të nxënësve në klasë dhe mësimin në ndërrime. Megjithatë, nuk ka ndonjë evidencë konkluzive që dëshmon ndërlidhje të fortë ndërmjet proporcionit nxënës – klasë dhe arritshmërisë së nxënësve. Komunitet me arritshmëri të ulët të nxënësve në Testin e Semimaturës kanë numër kryesisht të ulët të nxënësve në klasë, mirëpo kjo nuk ka adresuar kërkesën shoqërore për rezultate më të larta.

- ***Të rishikohet Plani i Investimeve në nivel qendror dhe komunal për të reflektuar revidimin e projeksioneve të popullsisë*** - Kjo e bën të domosdoshme lansimin e një studimi mbi rizonimin kombëtar të shkollave konform Planit Kombëtar Hapësinor. Kapaciteti infrastrukturor dhe njerëzor i shkollës duhet të peshohet me projeksionet dhe variablat tjera siç janë lëvizjet e brendshme të popullsisë dhe rënies demografike. Themelimi i rrjetit të shkollave do të lehtësonte sfidat që dalin nga mobiliteti i brendshëm i nxënësve. Investimet kapitale duhet të orientohen në investime që ndërlidhen me infrastrukturën e brendshme duke përfshirë dhoma leximi, laboratore, mjete digjitale të konkretizimit dhe TIK.
- ***Të zbatohet plani për profilizim të mësimdhënësve*** - është e rëndësishme të zbatohet dhe inkorporohet në planifikim synimi për profilizim të mësimdhënësve. Kjo ngase ekziston evidencë e gjerë shkencore mbi kthimin në investim. Në kuadër të profilizimit duhet të vështrohet me prioritet nevoja e rritjes së numrit dhe cilësisë së mësimdhënësve në sferat STEM – shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë. Në bazë të analizave krahasimore në PISA 2018, mësimdhënësit e matematikës, shkencave ekzakte dhe gjuhës amëtare janë thelbësor në avancim të arritshmërisë së nxënësve.
- ***Të lansohet procesi i optimalizimit të shkollave*** - Shkollat në vendet e OECD kanë mesatarisht 769 nxënës dhe 34 mësimdhënës. Kosova ka mesatarisht rreth 300 nxënës për shkollë. Kosova karakterizohet për nga modeli i shkollave të vogla. Rreth 60 % për qind të shkollave nën 250 nxënës. Mbi 200 shkolla (paralele të ndara) funksionojnë me nën 50 nxënës apo rreth 4 nxënës për klasë. Operimi i këtyre paraleleve duhet të shqyrtohet jo vetëm për shkak të jo-efiçencës së theksuar buxhetore, por edhe për shkak të cilësisë së dobët të mësimdhënies.
- ***Të rishikohet modeli i menaxhimit të shkollës për të avancuar rolin e drejtorit dhe mësimdhënësve në proces mësimor*** - Modeli i menaxhimit të shkollës në Kosovë, ndryshon thelbësisht në krahasim me modelet e vendeve me arritshmëri të lartë të nxënësve në PISA të OECD. Përgjegjësia primare për administrimin, stafin, resurset dhe rezultatet e shkollës varet nga drejtori i shkollës. Komuna, Këshilli i Shkollës dhe në disa raste Ministria përzgjedhin drejtorin bashkërisht. Roli i Ministrisë është të mbështes shkollën duke përcaktuar kriteret fillestare të kompensimit të stafit dhe standardet bazë të kurrikulës. Komuna mbështet drejtorin në planifikim buxhetor dhe në disa raste, në bashkëpunim me Ministrinë, përcakton rrogën bazë dhe vendimet për rritje të rrogave të stafit. Drejtori i shkollës sipas modelit të vendeve me sisteme të avancuara arsimore ka përgjegjësinë për përzgjedhjen e mësimdhënësve, shkarkimin e tyre, rritjen e rrogës, planifikim buxhetor, masa disiplinore, përcaktimin e rregullave të pranimi dhe vlerësimit të nxënësve dhe përmbajtjen e lëndëve. Mësimdhënësi është përgjegjës për përcaktimin e përmbajtjes së lëndës, kurrikulës, rregullave të vlerësimit dhe teksteve mësimore. Këshilli i Shkollës është më tepër i orientuar në përcaktim të kurrikulës, përmbajtje të lëndëve, rregullave të vlerësimit dhe masave disiplinore. Përgjithësisht, shkolla është përgjegjëse për gjithë procesin mësimor. Ministria dhe komuna ofrojnë mbështetje në aspekte më të kufizuara si përcaktimi i kriterëve minimale të kurrikulës, kriterëve të rrogës bazë, kriterëve për rritje të rrogës dhe planifikim buxhetor.
- ***Të prioritetizohet investimi në infrastrukturë të brendshme dhe dhoma leximi*** - Vetëm 23 % për qind e nxënësve raportojnë se në shkollat e tyre ka hapësirë për lexim dhe punë shkollore. Kjo shifër është jashtëzakonisht e ulët në krahasim me mesataren e OECD, ku rreth 75 % e nxënësve u ofrohet një mundësi e tillë

# Sigurimi i Cilësisë

Zhvillimi i një sistemi funksional për sigurimin e cilësisë, në përputhje me standardet ndërkombëtare

## Rezultatet:

- Deri në vitin 2020 janë në funksion mekanizma efektivë për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar të Kosovës të bazuar në ndarjen e autorizimeve në mes të MASHT, DKA dhe shkollës
- Të gjitha shkollat dhe komunat hartojnë dhe ndërlidhin planet zhvillimore në përputhje me legjislacionin në fuqi
- Ekzistojnë kapacitete për sigurimin e cilësisë në nivelin qendror, atë komunal dhe në nivel shkolle
- Profesionistët, politikëbërësit, prindërit dhe publiku i gjerë kanë informacion të mjaftueshëm për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar
- Rezultatet e testeve kombëtare janë të besueshme dhe shfrytëzohen për politikëbërje në arsim

## 6.3 Cilësia në arsim

Aktivitetet e listuara në kuadër të caktuar janë të mangëta dhe në disa raste edhe jo relevante për arritjen e caktuar. Kultura e menaxhimit të cilësisë do të duhej të kishte një sistem koherent të vlerësimit të jashtëm dhe të brendshëm. Në kuadër të vlerësimit të jashtëm do të duhej listuar prioriteti i ndërtimit të sistemit për vlerësim të nxënësve, vlerësim të shkollave dhe vlerësim të mësimdhënësve. Janë ndërtuar mekanizmat e vlerësimit të jashtëm të nxënësve dhe Kosova ka marrë pjesë në PISA 2015 dhe 2018. MASHT, organizon vlerësim vjetor të jashtëm të nxënësve përmes testit të maturës dhe testit të semimaturës. Në përgjithësi ekziston një sistem institucional dhe praktikë e vlerësimit të jashtëm të nxënësve. Është shënuar përparim i lehtë në arritshmërinë e nxënësve në testet e semimaturës dhe testin e maturës. Në vitin 2015, Kosova ka marrë pjesë për herë të parë në Programin Ndërkombëtar të Vlerësimit të Studentëve (PISA). Vitin e kaluar janë publikuar edhe rezultatet e PISA 2018. Në bazë të analizës krahasimore të rezultateve të arritshmërisë në PISA, Kosova nuk ka shënuar ndonjë përparim në arritshmëri të nxënësve krahasuar me katër vite më parë.

Indeksi i performancës 2019

Rez	Rezultati	%	Niveli
1	Deri në vitin 2020 janë në funksion mekanizma efektivë për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar	53%	3.2
2	Të gjitha shkollat dhe komunat hartojnë dhe ndërlidhin planet zhvillimore në përputhje me legjislacionin në fuqi	42%	2.5
3	Ekzistojnë kapacitete për sigurimin e cilësisë në nivelin qendror, atë komunal dhe në nivel shkolle	42%	2.5
4	Profesionistët, prindërit dhe publiku i gjerë kanë informacion për sigurimin e cilësisë në APU	47%	2.8
5	Rezultatet e testeve kombëtare janë të besueshme dhe shfrytëzohen për politikëbërje në arsim	62%	3.7
<b>Total</b>		<b>49%</b>	<b>2.9</b>

Ndërmjet 2017-2019, është arritur një progres i ndjeshëm në disa aktivitete të rëndësishme për aspektet e jashtme dhe të brendshme të sigurimit të cilësisë. Krahas miratimit të Ligjit për Inspektoratin e Arsimit, është dyfishuar numri i koordinatorëve të cilësisë në nivel shkolle dhe pothuajse është kompletuar përcaktimi i zyrtarëve komunal për sigurim të cilësisë. Gjithashtu, ka filluar vlerësimi i jashtëm i shkollës dhe mësimdhënësve dhe është pilotuar në të gjitha komunat e Kosovës. Në dimensionin e vlerësimit të jashtëm të nxënësve, janë shënuar përmirësime të lehta në arritshmëri të nxënësve në testin e maturës dhe shtuar aktivitetet për monitorim dhe transparencë në proces. Kosova ka implementuar PISA 2018 dhe pilotuar testin TIMSS. Në formulën e financimit të vitit 2019 janë inkuadruar edhe pagesat për kordinatorët e cilësisë.

### 6.3.1 Mekanizmat për sigurim të cilësisë

#### Rezultati 3.1: Deri në vitin 2020 janë në funksion mekanizma efektivë për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar bazuar në ndarjen e autorizimeve në mes MASHT, DKA dhe shkollë

Në kuadër të rezultatit parashihen disa aktivitete duke përfshirë ngritjen e sistemit efikas për vlerësimin e performancës së shkollës, aplikimi i ciklit të menaxhimit të cilësisë në arsim, fuqizimi i organeve të shkollës për të kryer funksionin e sigurimit të cilësisë, përcaktimin e rolit të DKA në sigurim të cilësisë dhe ngritjen e strukturave përkatëse për sigurim të cilësisë në komuna, funksionimi i Inspektoratit të Arsimit në aspektin juridik-administrativ dhe pedagogjik-profesional dhe shfrytëzimi efektiv i të dhënave nga monitorimi i arsimit për sigurimin e cilësisë në të gjitha nivelet dhe në të gjitha gjuhët mësimore.

Në vitin 2018, është miratuar Ligji mbi Inspektoratin e Arsimit. Në bazë të provizioneve ligjore, Inspektorati i Arsimit është organ ekzekutiv qendror për sigurimin e cilësisë në varësi të drejtpërdrejtë të Ministrit të MASHT. Në kuadër të autorizimeve mbi sigurimin e cilësisë, Inspektorati i Arsimit është përgjegjës për inspektim të përgjithshëm të institucioneve shkollore – vlerësim të jashtëm të performancës së shkollës në bazë të UA 04/2017, inspektim të cilësisë së punës dhe vlerësim të performancës së mësimdhënësve për procesin e licencimit sipas UA 14/2018 për Vlerësimin e Performancës së Mësimdhënësve dhe inspektim të cilësisë së punës dhe vlerësim të performancës së drejtorit dhe zëvendës drejtorit të shkollës. Në të njëjtën periudhë, janë caktuar inspektorët për vlerësim të performancës së shkollës dhe mësimdhënësve. Krahas shtimit të kapacitetit njerëzor, inspektorati është në proces të miratimit të Rregullores së Punës. Gjatë kësaj periudhe është themeluar grupi punues dhe mbajtur disa takime për konkludim të udhëzimit administrativ për vlerësim të performancës së drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të shkollave. Instrumentet e vlerësimit të performancës së drejtorëve janë pilotuar në 10 shkolla.

Në vitin 2017, është miratuar Udhëzimi administrativ 4/2017 për vlerësimin e performancës së shkollave në arsimin parauniversitar. Në kuadër të Udhëzimit definohet korniza e vlerësimit të performancës së shkollës. Janë definuar përgjegjësitë e mekanizmave për vlerësim të brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë. Në kuadër të parimit të vlerësimit të jashtëm të shkollës është definuar roli i Inspektoratit të Arsimit, Drejtorive Komunale të Arsimit dhe institucioneve arsimore. Gjatë vitit 2018, ka vazhduar vlerësimi i jashtëm i shkollave në të gjitha komunat. Inspektorati i Arsimit ka mbështetur shkollat gjatë procesit të përpilimit të raporteve të vetëvlerësimit. Gjatë kësaj periudhe është miratuar edhe Plani i Veprimit për vlerësim të jashtëm të shkollave sipas Kornizës së Vlerësimit të Performancës së Shkollës. Në fazën fillestare janë përzgjedhur nga një shkollë në secilin komunë. Në tërësi gjatë këtij viti është realizuar vlerësimi i jashtëm i 28 shkollave. Janë trajnuar inspektorët arsimor dhe janë iniciuar aktivitete për shkëmbim përvojash me vendet e tjera. Të dhënat nga procesi i vlerësimit të shkollës planifikohet të publikohen në portalin sigurimit të cilësisë. Në kuadër të vlerësimit të performancës së mësimdhënësve është zbatuar faza e parë e vlerësimit të performancës së 216 mësimdhënësve nga 72 shkolla të komunave të ndryshme të Kosovës. Vlerësimi pozitiv i performancës është ndërlidhur me procesin e licencimit të mësimdhënësve. Mësimdhënësit që nuk arrijnë shkallë adekuate të vlerësimit do të rekomandohen për vlerësim të mëtejshëm profesional dhe rikualifikim.

Në vitin 2019 janë vlerësuar 29 shkolla. Vlerësimi i shkollave bëhet në bazë të Ligjit 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës, UA 4/2017 për Vlerësimin e performancës së institucioneve arsimore të arsimit parauniversitar si dhe Udhëzuesit për vlerësimin të jashtëm të performancës së shkollës. Për të gjitha vlerësimet e realizuara janë përpiluar raporte për nivelin e performancës. Në të gjitha raportet e vlerësimit janë dhënë edhe rekomandimet për përmirësim. Për shkak të numrit të vogël të inspektorëve nuk janë realizuar riinspektime. Shkollat kanë vështësi në sigurimin e dëshmimeve, sidomos të dëshmimeve të protokolluara. Procesi ka hasur në vështirësi për shkak të numrit të vogël të inspektorëve. Një pjesë e shkollave nuk kanë përfunduar trajnimin për vetëvlerësimin, prandaj kanë vështirësi në zbatimin e procesit të vlerësimit



të brendshëm. Nëse nuk shtohet numri i inspektorëve është vështirë të realizohet ky proces sipas dinamikës së paraparë me legjislacionin në fuqi.

Për vlerësim të jashtëm të shkollës, janë trajnuar 17 inspektorë përmes Institutit Pedagogjik dhe Projektit të Binjakëzimit. Për rilicencimin e mësimitdhënësve, përkatësisht për procesin e Vlerësimit të performancës së mësimitdhënësve janë trajnuar 17 inspektorë përmes projektit të Bankës Botërore. Vlerësimi i performancës së mësimitdhënësve bëhet në bazë të Ligjit 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës dhe të UA 14/2018 për Vlerësimin e performancës së mësimitdhënësve. Inspektorati përpilon raportin dhe nxjerr vendimin për nivelin e performancës së mësimitdhënësve. Ende nuk është bërë ndarja e inspektorëve në inspektor pedagogjik dhe në inspektor administrativ. Pritet miratimi i Rregullores për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Inspektoratit të Arsimit. Për pilotimin e procesit të vlerësimit të performancës së drejtorëve janë trajnuar pesë (5) inspektorë të arsimit. Pritet miratimi i UA për vlerësimin e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të shkollës. Trajnimi i inspektorëve të arsimit për këtë proces do të fillojë bazuar në kriteret që do të caktohen në UA-në dhe instrumentet (udhëzuesin) për vlerësimin e performancës së drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të shkollave.

### 6.3.2 Planet zhvillimore të shkollave dhe komunave

**Rezultati 3.2: Të gjitha shkollat dhe komunat hartojnë dhe ndërlikojnë planet zhvillimore në përputhje me legjislacionin në fuqi**

Gjatë inspektimeve të përgjithshme, përkatësisht gjatë procesit të vlerësimit të performancës së institucioneve arsimore të arsimit parauniversitar, Inspektorati i Arsimit vlerëson zbatimin e planeve zhvillimore të shkollave. Këto plane do t'i kontrollojë dhe vlerësojë edhe gjatë vlerësimit të performancës së drejtorëve dhe zv. drejtorëve, pas miratimit të UA-së për këtë lloj vlerësimi. Numri i vogël i inspektorëve të arsimit dhe angazhimi i tyre në të gjitha aktivitetet që burojnë nga Ligji 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës ka ndikuar në numrin e vogël të mësimitdhënësve dhe të shkollave të cilave u është bërë vlerësimi i performancës.

### 6.3.3 Sigurimi i jashtëm i cilësisë

**Rezultati 3.3: Ekzistojnë kapacitete për sigurimin e cilësisë në nivelin qendror, komunal dhe nivel shkolle**

Sistemi i sigurimit të cilësisë në arsimin parauniversitar ka filluar të marrë formën e sistemeve të avancuara arsimore. Ndërtimi i sistemit të jashtëm të sigurimit të cilësisë ka shkuar paralelisht me pjesëmarrjen në testet ndërkombëtare të vlerësimit të nxënësve. Në tetor të vitit 2017, ka filluar vlerësimi i jashtëm i performancës së shkollave, ndërsa në tetor të vitit 2018 ka filluar edhe vlerësimi i jashtëm i performancës së mësimitdhënësve. Në aspektin e sigurimit të brendshëm të cilësisë, pjesa më e madhe e komunave dhe shkollat e Kosovës kanë caktuar Koordinatorët e Cilësisë dhe kanë filluar pilotimin e procesit të vetëvlerësimit. Pothuajse të gjitha shkollat e Kosovës janë të vetëdijshme mbi nevojën e vetëvlerësimit, vlerësimit të jashtëm të shkollës dhe mësimitdhënësve (OECD, 2019).

Ndërmjet 2017-2021, ka vazhduar procesi i shtrirjes së kapacitetit për sigurim të brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë. Pothuajse të gjitha komunat kanë caktuar Koordinatorët për Sigurim të Cilësisë. Gjithashtu, është dyfishuar numri i Koordinatorëve për Sigurim të Cilësisë në nivel shkolle nga 336 shkolla në vitin 2017 në

645 shkolla në vitin 2018. Koordinatorët e sigurimit të cilësisë, kanë përfunduar trajnimet. Rreth 423 kanë përfituar nga proceset e trajnimit të organizuara gjatë këtij viti. Sidoqoftë, në proces të jetësimit të ciklit të sigurimit të cilësisë kërkohet të saktësohet roli i Koordinatorëve Komunal dhe Koordinatorëve të Shkollës. Krahas përkushtimit për trajnim të zyrtarëve për sigurim të cilësisë kërkohet edhe mbështetja e trajnimeve për ekipet e sigurimit të cilësisë. Pozitat dhe aktivitetet e sigurimit të cilësisë në nivel shkolle, komune dhe qendror duhet qartësuar edhe më tutje dhe shtuar kapacitetet financiare për funksionet e tyre.

### 6.3.4 Vetëdijësimi mbi sigurimin e cilësisë

**Rezultati 3.4: Profesionistët, politikëbërësit, prindërit dhe publiku i gjerë kanë informacion të mjaftueshëm për sigurimin e cilësisë në arsim parauniversitar**

Nga analiza krahasimore, drejtorët dhe mësuesit në Kosovë përdorin pothuajse të gjitha instrumentet e sigurimit të cilësisë që aplikohen në vendet e tjera të OECD-së. Edhe në rast kur instrumentet nuk janë detyrime ligjore, shkollat me vetiniciativë kanë filluar të praktikojnë pyetësorët me nxënës. Rezultatet e arritshmërisë së nxënësve dhe efektshmërisë së mësuesve kryesisht monitorohen. Një pjesë e konsiderueshme e shkollave zbatojnë një lloj mentorimi për mësuesin edhe pse ajo nuk është ende e rregulluar në nivel vendi. Përderisa shkollat monitorojnë dhe diskutojnë në lidhje me instrumentet e sigurimit të brendshëm të cilësisë, adresimi i tyre përmes ciklit të planifikimit dhe menaxhimit mbetet i kufizuar në mungesë të financimit apo autonomisë së shkollës.

MASHT me mbështetje të GIZ dhe në koordinim me partnerët zhvillimor ka organizuar një seri të aktiviteteve për promovim të cilësisë në arsim. Gjithashtu, është shënuar përmirësim i parametrave sasior dhe financimit (inputet) në arsimin parauniversitar. Në anën tjetër janë shënuar hapa përmirësimi edhe në parametrat sasior të cilësisë si raporti klasë-nxënës dhe mësues-nxënës. Ky përmirësim vjen pjesërisht për shkak të rënies demografike dhe uljes së numrit të nxënësve dhe investimeve shtesë në kuadrin mësues-nxënës dhe infrastrukturë. Sidoqoftë, përmirësimi të këtyre parametrave janë vërejtur kryesisht në zona rurale e më pak në zona urbane. Shkollat e arsimit parauniversitar në qendrat e mëdha urbane në disa raste vazhdojnë të kenë numër tejet të lartë të nxënësve për klasë. Kjo ka rezultuar për shkak të lëvizjes së popullsisë nga zonat rurale në zona urbane. Në të ardhmen duhet kujdesur që të ketë optimizim të këtyre parametrave dhe investime shtesë në infrastrukturë në zona urbane.

### 6.3.5 Vlerësimi i jashtëm i nxënësve


**Rezultati 3.5: Rezultatet e testeve kombëtare janë të besueshme dhe shfrytëzohen për politikëbërje në arsim**

Në kuadër të rezultatit janë paraparë disa aktivitete duke përfshirë rishikimi i udhëzuesit për administrimin dhe monitorimin e testeve, trajnimi i administruesve dhe monitoruesve të testeve, sigurimi i mbarëvajtjes dhe transparencës së procesit të testimit, krijimi i bankës së pyetjeve dhe analiza e testeve pas përfundimit të tyre.

Janë ndërtuar mekanizmat e vlerësimit të jashtëm të nxënësve dhe Kosova ka marrë pjesë në PISA 2015-2018. MASHT organizon vlerësim vjetor të jashtëm të nxënësve përmes testit të maturës dhe testit të semimaturës. Në përgjithësi ekziston një sistem institucional dhe praktikë e vlerësimit të jashtëm të nxënësve. Është shënuar përparim i lehtë në arritshmërinë e nxënësve në testet e semimaturës dhe testin e maturës. Arritshmëria në


testin e maturës ka një trend pozitiv që nga viti 2017. Në disa raste është kontestuar integriteti i vetë sistemit për shkak të praktikave të kopjimit gjatë testimit në të kaluarën. Mirëpo, në dy vitet e fundit (2018-2019), MASHT ka ndërmarrë hapa shtesë për të rikthyer besimin në sistem të vlerësimit.

#### Rezultatet e arritshmerisë në Testin e Maturës 2012-2019 - MASHT 2019



Në vitin 2015, Kosova ka marrë pjesë për herë të parë në Programin Ndërkombëtar të Vlerësimit të Studentëve (PISA). Vitin e kaluar janë publikuar edhe rezultatet e PISA 2018. Në bazë të analizës krahasimore të rezultateve të arritshmerisë në PISA, Kosova nuk ka shënuar ndonjë përparim në arritshmëri të nxënësve krahasuar me katër vite më parë.

#### Rezultatet e arritshmerisë në Testin PISA 2015-2018 (OECD, 2019)



Nxënësit 15 vjeçar vazhdojnë të kenë arritshmëri të ulët në matematikë, shkencë dhe lexim krahasuar me mesataren e rajonit dhe vendeve të OECD-së. Në vitin 2018 rezultatet e arritshmerisë së nxënësve në matematikë dhe lexim ishin minimalisht më mirë sesa në vitin 2015, ndërsa rezultatet në segmentin e shkencave janë përkeqësuar.

Në kuadër të projektit KESIP, gjatë vitit 2018 kanë filluar këto aktivitete: Hartimi i Kornizës Kombëtare të Kosovës për Vlerësimin e Nxënësve. Hartimi dhe zbatimi i procedurave të reja logjistike dhe masave të sigurisë për të përmirësuar administrimin e provimeve dhe për të zvogëluar neglizhencën, trajnimi i stafit DCSVL dhe bashkëpunëtorëve të tyre në parimet e vlerësimit, hartimit të pyetjeve dhe dizajnit të testeve dhe disa aspekteve të analizës statistikore dhe rishikimi i blueprinteve dhe tabelave të specifikave të zhvilluara tashmë. Gjatë periudhës së njëjtë, është realizuar trajnimi i stafit të DCSVL -se dhe bashkëpunëtorëve të tyre, në parimet e analizës dhe raportimit statistikor me theks të veçantë në kalibrimin e pyetjeve. Në përpjekje për të përmirësuar procesin e vlerësimit të jashtëm të nxënësve, është ofruar edhe mbështetje teknike për zhvillimin e testeve dhe pilotimin e pyetjeve për një vlerësim kombëtar në klasën e 12, duke përdorur IRT dhe procedurat gjithëpërfshirëse të raportimit. Kjo do të përfshijë analiza klasike dhe IRT, si dhe rekomandime për tu raportuar te politikbërësit dhe palët e tjera të interesit. Gjithashtu, kuadri gjegjës është mbështetur në analiza shtesë dhe shpërndarjen e rezultateve të testit PISA 2018 , si dhe përkrahje për vlerësimet e tjera ndërkombëtare.

### 6.3.6 Matrica e zbatimit të aktiviteteve

No.	Rezultatet	Aktivitetet	Statusi	Niveli
3.1	Deri në vitin 2020 janë në funksion mekanizma efektive për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar të Kosovës të bazuar në ndarjen e autorizimeve në mes të MASHT, DKA dhe shkollës	3.1.1 Ngritja e sistemit efikas për vlerësimin e performancës së shkollës		3
		3.1.2 Aplikimi i ciklit të menaxhimit të cilësisë në arsim		3
		3.1.3 Fuqizimi i organeve shkollore (aktivet dhe këshillat) për të kryer funksionin e tyre të SC-së		3
		3.1.4 Përcaktimi i rolit të DKA në SC dhe ngritja e strukturave përkatëse për SC në DKA		3
		3.1.5 Funksionimi i Inspektoratit në aspektin juridik-administrativ dhe pedagogjik-profesional		4
		3.1.6 Shfrytëzimi efektiv i të dhënave nga monitorimi i arsimit për sigurimin e cilësisë në të gjitha nivelet dhe në të gjitha gjuhët mësimore		3
3.2	Të gjitha shkollat dhe komunat hartojnë dhe ndërtojnë planet zhvillimore në përputhje me legjislacionin në fuqi	3.2.1 Rishikimi i procedurave dhe instrumenteve për planifikim zhvillimor		3
		3.2.2 Monitorimi i zbatimit të planeve zhvillimore të shkollave		2
		3.2.3 Harmonizimi i planeve komunale me planet shkollore sipas fushave të cilësisë, përmes planifikimit të integruar		3
		3.2.4 Nxitja e shkëmbimit të praktikave më të mira		2
3.3	Ekzistojnë kapacitete për sigurimin e cilësisë në nivelin qendror, atë komunal dhe në nivel shkollë	3.3.1 Ngritja e kapaciteteve të Inspektoratit për përgjegjësitë e reja		3
		3.3.2 Hartimi i doracakut për aktivet e shkollës me fokus të qartë në zhvillimin e cilësisë		4
		3.3.3 Trajnimi i stafit të DKA, drejtorëve dhe stafit përgjegjës të shkollave për menaxhimin e cilësisë		3
		3.3.4 Ofrimi i ndihmës nga grupet profesionale në nivel komunal		3
		3.3.5 Trajnimi i përfaqësuesve të shkollave dhe komunave për planifikimin zhvillimor		4
		3.3.6 Krijohet Agjencia për Kurrikulë, Vlerësim dhe Standarde (AKVS) në përputhje me Ligjin e Arsimit Parauniversitar		1

No.	Rezultatet	Aktivitetet	Statusi	Niveli
3.4	Profesionistët, politikëbërësit, prindërit dhe publiku i gjerë kanë informacion të mjaftueshëm për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar	3.4.1 Zhvillohet sistemi për raportimin e rezultateve të testeve kombëtare		4
		3.4.2 Promovimi i sukseseve dhe shpërblimi i arritjeve		2
		3.4.3 Informimi i prindërve për aspekte të ndryshme të kurrikulës dhe sigurimit të cilësisë		4
		3.4.4 Promovimi i debateve publike lidhur me cilësinë në arsim		3
		3.4.5 Krijimi i portalit për sigurimin e cilësisë		1
3.5	Rezultatet e testeve kombëtare janë të besueshme dhe shfrytëzohen për politikëbërje në arsim	3.5.1 Rishikimi i udhëzuesit për administrimin dhe monitorimin e testeve		4
		3.5.2 Trajnimi i administruesve dhe monitoruesve të testeve		4
		3.5.3 Zhvillimi i platformës për integrimin e sistemeve ekzistuese të informatave dhe bazave të të dhënave për të gjitha nivelet		3
		3.5.4 Sigurohet mbarëvajtja dhe transparenca e procesit të testimit		4
		3.5.5 Krijimi i bankës së pyetjeve me karakteristika të plota të pyetjeve		4
		3.5.6 Analiza e testeve pas përfundimit të tyre		3

### 6.3.7 Treguesit e Sigurimit të Cilësisë

#### TREGUESIT KRYESOR TË CILËSISË 2015-2019

	2015	2016	2017	2018	2019
<b>Kushtet e mësimdhënies</b>					
Raporti nxënës klasë fillor-mesëm ulët	19.8	19.2	19	18.8	18.4
Raporti nxënës klasë mesëm lartë	26.1	26.5	26.6	25.0	23.2
Raporti nxënës për mësimdhënës	15.7	15.5	15.2	14.7	14
Raporti nxënës-mësimdhënës fillor/mesëm ul	15.5	15.1	14.6	14.3	14
Raporti nxënës-mësimdhënës mesëm lartë	15.9	16.4	16.4	15.4	14.2
<b>Arritshmëria</b>					
Arritshmëria në Testin PISA	378	-	-	-	
PISA % dobët në matematikë	77.7	-	-	-	
PISA % dobët në shkencë	68	-	-	-	
PISA % dobët në lexim	76.9	-	-	-	
Arritshmëria në Testin e Maturës	54	64.7	58	61	60.9
Arritshmëria në Testin e Semimaturës	63.1	62.6	58.4	-	
Arritshmëria Gjuhë Amtare	64.7	57.5	-	-	
Arritshmëria Gjuhë Angleze	77.9	81.1	-	-	
Arritshmëria Histori	59.4	47.4	-	-	
Arritshmëria Gjeografi	62.3	52.6	-	-	
Arritshmëria Matematikë	64.9	62.1	-	-	
Arritshmëria Informatikë	72.9	67.3	-	-	

TREGUESIT KRYESOR TË CILËSISË 2015-2019

	2015	2016	2017	2018	2019
Arritshmëria Fizikë	66.9	50.7	-	-	
Arritshmëria Kimi	64.1	56.9	-	-	
Arritshmëria Biologji	62	61.9	-	-	
<b>Shkalla e tranzicionit</b>					
Shkalla e tranzicionit fillor-mesëm ulët	98.8	97.8	99.3		-
Shkalla e tranzicionit mesëm ulët-mesëm lartë	97.2	92.5	96.1		-
<b>Cilësia në menaxhim</b>					
Numri i shkollave me Kordinatorë për Cilësi	-	336	645	-	-
Numri i komunave me Kordinatorë për Cilësi		10	29	-	-
Numri i Kordinatorëve të trajnuar		156	645	-	-
Numri i shkollave të vlerësuara	-	-	28	60	72
Numri i mësimitdhënësve të vlerësuar	-	130	216	-	650



### 6.3.8 Rekomandimet

- ***Të defnohet me më shumë precizitet koncepti i sigurimit të cilësisë në arsimin parauniversitar*** - Në kuadër të Planit të Veprimit nuk janë diferencuar me saktësi veprimet në kuadër të këtij prioriteti strategjik. Në bazë të analizës së dokumenteve nuk ekziston një konceptim koherent i cilësisë dhe sigurimit të cilësisë në arsim. Kërkohej një rikonceptim i prioritetit dhe veprimeve për të diferencuar cilësinë si qëllim dhe procedurat për sigurim të cilësisë. Prioriteti duhet të riemërtohet me qëllim të nënvizimit të dimensionit të promovimit dhe sigurimit të cilësisë. Sigurimi i cilësisë në kuadër të ciklit të përgjithshëm të menaxhimit i referohet sigurimit të cilësisë në dalje të sistemit (rezultate të nxënësve), sigurim të cilësisë në inpute të sistemit (numër dhe kualifikim të mësimdhënësve, numër të klasave, teksteve mësimore, pajisjeve etj) dhe sigurim të cilësisë në proces (mësimdhënie, mësimnxënie, administrim etj).
- ***Të defnohen dhe trajnohen palët e interesit mbi rolet dhe përgjegjësitë për sigurim të jashtëm të cilësisë*** - Ministria duhet të sistematizoj procesin e vlerësimit të jashtëm, duke definuar përgjegjësitë, rolet, pasojat dhe shpërblimet mbi performancën. Vlerësimi i jashtëm duhet të përfshijë: vlerësimin e jashtëm të sistemit, vlerësimin e jashtëm të nxënësve/studentëve, vlerësimin e jashtëm të nxënësve, vlerësimin e jashtëm të shkollës/institucioneve. Vlerësimi i jashtëm nuk është qëllim përfundimtar. Ai më tepër përdoret për të prodhuar ndryshime pozitive në performancë. Për këtë arsye, kërkohej edhe definimi i hapave ex-post në rastet kur dokumentohen ngecje si për komunat ashtu edhe për institucionet.
- ***Të sistematizohet procedura e sigurimit të brendshëm të cilësisë në menaxhim të shkollës*** – shkolla duhet të zhvilloj kapacitetin dhe politikën e sigurimit të brendshëm të cilësisë, të përcaktoj rolet dhe përgjegjësitë dhe të caktoj zyrar/koordinator për sigurim të cilësisë. Në këtë kuadër shkollat duhet të përsosin praktikën e sigurimit të brendshëm dhe jashtëm të cilësisë, planet zhvillimore të shkollave, planet financiare të shkollës, planin e përbushjes së kërkesave të stafit për zhvillim profesional. Praktika e përpilimit të raportit të vetëvlerësimit vjetor dhe periodik duhet të jetë në agjendën e zhvillimit të procedurës së sigurimit të cilësisë.
- ***Të zhvillohet dhe sistematizohet procedura e sigurimit të cilësisë në zhvillim dhe rishikim të kurrikulave dhe profileve*** - shkolla duhet të zhvilloj kapacitetin për sigurim të cilësisë në procesin e zhvillimit dhe rishikimit të kurrikulave dhe profileve. Kjo është sidomos e rëndësishme për arsimin e mesëm të lartë. Shkolla duhet të implementoj një procedurë për rishikim të kurrikulave dhe profileve në bashkëpunim me nxënësit, të diplomuarit, mësimdhënësit, industrinë dhe autoritetet publike. Shkollat duhet të përfitojnë nga trajnimet për të zhvilluar kurrikulat dhe planet mësimore të bazuara në kompetenca.
- ***Të zhvillohet dhe sistematizohet procedura e sigurimit të brendshëm të cilësisë në mësimdhënie*** – Shkollat duhet të ndërtojnë kapacitetin dhe procedurat për vlerësim të mësimdhënies, potencialisht vlerësim të mësimdhënësve nga nxënësit, të dhënat mbi kualifikimet, orët e zhvillimit profesional dhe planin për zhvillim profesional të mësimdhënësve.
- ***Të zhvillohet dhe sistematizohet procedura për sigurim të brendshëm të cilësisë në mësimnxënie*** – shkollat duhet të zhvillojnë kapacitetin dhe procedurën për të analizuar rregullisht të dhënat e performancës së nxënësve të përgjithshme dhe lëndore, të dokumentojnë ngecjet, të dhënat mbi vijueshmërinë dhe braktisjen. Të dhënat mbi nxënësit duhet të procedohen në baza semestrale dhe vitit shkollor për të dokumentuar dhe reflektuar mbi ngecjet potenciale.

- ***Të zhvillohet dhe sistematizohet procedura për sigurim të brendshëm të cilësisë në resurse shkollore***  
-Shkollat duhet të ndërtojnë kapacitetin dhe procedurat për vlerësim të vazhdueshëm të përputhshmërisë së mësimdhënies dhe resurset mësimore duke përfshirë klasat, bibliotekat, hapësirat e leximit, praktikës, teksteve mësimore, objektit, ngrohjes, shëndetit dhe sigurisë. Të dhënat e monitorimit vjetor mund të shërbejnë për të ndërtuar planin e zhvillimit të shkollës.
- ***Të avancohet kapaciteti për vlerësim të jashtëm të nxënësve*** – Kosova zbaton teste të rregullta të standardizuara kombëtare dhe ndërkombëtare. Në këtë kuadër hyn edhe përpjekja për të siguruar integritet dhe besueshmëri të testeve të standardizuara. Të dhënat e vlerësimit të studentëve duhet të jenë transparente dhe lehtësisht të disponueshme për palët e interesit. Analiza e rezultateve të performancës së studentëve duhet të bëhet sipas lëndëve, komunave, shkollave, gjinive, të ardhurave dhe gjendjes sociale të nxënësve. Kosova duhet të siguroj pjesëmarrje të vazhdueshme dhe reflektim mbi rezultatet e PISA. Duhet të shqyrtohet mundësia e pjesëmarrjes në teste tjera të standardizuara ndërkombëtare.
- ***Të avancohet kapaciteti për vlerësim të jashtëm të shkollës dhe mësimdhënësve*** -Është prioritarë të investohet në zhvillim të kapacitetit organizativ dhe njerëzor të Inspektoratit të Arsimit. Institucioni duhet të zhvilloj kapacitetin dhe procedurën për vlerësim të jashtëm të shkollës dhe mësimdhënësve. Në kuadër të procedurës duhet të specifikohen edhe masat ex post. Në vendet e avancuara, shkollat i nënshtrohen vlerësimit periodik të jashtëm dhe mësimdhënësve. Të dhënat mbi vlerësimin e jashtëm bëhen publike dhe janë të disponueshme për palët e interesit.



# Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve

Ngritja e cilësisë së mësimdhënies përmes sistemit efektiv dhe të qëndrueshëm për përgatitjen dhe zhvillimin profesional të mësimdhënësve

## Rezultatet:

- Ndërtohet sistem i qëndrueshëm i zhvillimit profesional të mësimdhënësve në funksion të realizimit të reformës arsimore
- Realizohet procesi i vlerësimit të performancës së mësimdhënësve
- Funksionalizohet në tërësi sistemi për licencimin e mësimdhënësve
- Sigurohet përgatitja cilësore e mësimdhënësve para shërbimit

## 6.4 Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve

Në kuadër të objektivit strategjik për zhvillim profesional të mësimdhënësve është rishikuar baza ligjore për procesin e vlerësimit të performancës, licencimit të mësimdhënësve dhe programeve të zhvillimit profesional. Rreth 25 % e mësimdhënësve kanë marrë pjesë në aktivitete të zhvillimit profesional. Sidoqoftë, trendi i përfshirjes së mësimdhënësve në aktivitete trajnimi gjatë shërbimit është në rënie. Gjatë 2017-2021, është ndërtuar një sistem për zhvillim të mësimdhënësve dhe ka filluar procesi i vlerësimit të performancës së rreth 650 mësimdhënësve (VPM). Janë bërë hapa të rëndësishëm edhe në funksionalizim të sistemit për licencimin e mësimdhënësve dhe programeve për përgatitje para shërbimit. Sidoqoftë, procesi i vlerësimit të performancës së mësimdhënësve, megjithëse ka filluar, vazhdon të mbetet mbrapa kornizës së paraparë kohore.


Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve – Indeksi i Peformancës 2019

Rez	Përshkrimi	%	Niveli
1	Ndërtohet sistem i qëndrueshëm i zhvillimit profesional të mësimdhënësve	47%	2.8
2	Realizohet procesi i vlerësimit të performancës së mësimdhënësve	52%	3.1
3	Funksionalizohet në tërësi sistemi për licencimin e mësimdhënësve	50%	3
4	Sigurohet përgatitja cilësore e mësimdhënësve para shërbimit	50%	3
<b>Total</b>		<b>50%</b>	<b>3</b>

Cilësia e mësimdhënësve është faktori kryesor në arritshmërinë e nxënësve dhe cilësinë e arsimit parauniversitar. Në kuadër të Ligjit për Pagat e Sektorit Publik (2019) është rritur paga për mësimdhënësit e të gjitha niveleve arsimore. Megjithatë, edhe reforma e fundit në pagesa të mësimdhënësve ishte lineare dhe nuk siguron financim shtesë për inkurajuar performancën e mësimdhënësve që demonstrojnë ekselencë. Skemat e kompensimit të mësimdhënësve vazhdojnë të jenë të bazuara në kualifikimet para shërbimit. Rritja e kompensimit të mësimdhënësve duhet të mbështetet edhe në performancën gjatë shërbimit dhe përvojës së punës. Vendimet për rritje të kompensimit nuk janë të ndërlidhura me procesin e gradimit të mësimdhënësve.

Paga e mësimdhënësve është mbi nivelin e të ardhurave vjetore për kokë banori, praktikë e krahasueshme me vendet e avancuara dhe mbi mesataren rajonale. Kosova ka krahasimisht normë më të ulët të angazhimit të mësimdhënësve krahasuar me vendet e tjera të OECD. Mësimdhënësit në Kosovë kanë një normë mesatare vjetore prej rreth 539 orëve vjetore të mësimdhënësve apo mbi 100 orë më pak sesa mesatare e OECD. Norma e mësimdhënies është posaçërisht e ulët në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët (rreth 403 orë). Mësimdhënësit në Kosovë kanë një shkallë tejet të kufizuar të angazhimit në ndihmë të nxënësve për detyra. Ata zbatojnë vlerësime të rralla të nxënësve mesatarisht një herë në semestër krahasuar me vlerësimin e vazhdueshëm (3-5 herë) që bëhet në vendet e avancuara.

### Të ardhurat vjetore të mësimit 2004-2019



Është rishikuar dhe miratuar baza ligjore mbi kompetencat e mësimit dhe vlerësimit të performancës. Një numër i kufizuar i mësimit janë nënshtruar procesit të vlerësimit të jashtëm, por akoma nuk kanë informata kthyesë që do t'i përdornin për përmirësim. Procesi i monitorimit dhe mentorimit të mësimit në shkollë ende vazhdon të jetë i vështirë. Në shumë raste hasen vështirësi në definim të qartë të përgjegjësi ndërmjet drejtorëve, kordinatorëve të cilësisë, komunës dhe Inspektoratit të Arsimit.

Zhvillimi profesional i mësimit vazhdon të jetë i dominuar me trajnime dhe punëtori, të ndërlidhura me programe të akredituara, të njohura nga MASHT për sistemin e licencimit. Kjo mund të ketë ndikuar në kufizimin e zhvillimit të sistemit për zhvillim profesional të bazuar në shkollë. Të kuptuarit e zhvillimit profesional të mësimit, ende mbetet i kufizuar në lloje dhe orë të trajnimeve të organizuara nga partnerë zhvillimor ose organizata vendore. Trajnimet jo gjithmonë mund të jenë të ndërlidhura me prioritetet kryesore të shkollës, sidomos zbatimi i kurrikulës së re, sigurimi i cilësisë apo vlerësimi i bazuar në rezultatet të të mësuarit (IPK, 2019).

Kuadri i mësimit në Kosovë ka mbetur kryesisht i njëjtë në numër. Kosova ka rreth 23,300 mësimit. Viteve të fundit vërehet një tendencë në rritje për dominim të femrës në kuadrin mësimit. Në vitin 2014, kishte një baraspeshë gjinore në kuadrin mësimit ndërsa në vitin 2019, dallimi ishte rreth 3000 në favor të mësimit femra. Sidoqoftë, kuadri mësimit femra është kryesisht dominues në nivelin parashkollor (99%). Pjesëmarrja e femrës mësimit fillon të bie në përqindje në nivelet më të larta të shkollimit me 53.4% në nivelin fillor/ të mesëm të ulët (ISCED 1,2) respektivisht 38.2% në nivelin e mesëm të lartë (ISCED 3).

Mosha mesatare e mësimit në Kosovë është rreth 43 vjeç. Shumica e tyre kanë përvojë mësimore më shumë se 10 vjet. Numri i atyre me përvojë më të kufizuar është rreth 8 % për qind. Numri i mësimit që do të pensionohen në 5 vitet e ardhshme është rreth 3,400 apo rreth 670 në baza vjetore. Studentët e regjistruar në Fakultetet e Edukimit në universitetet publike janë kryesisht femra dhe kjo pritet të ndikojë ndjeshëm në bilancin gjinor. Numri i nxënësve për mësimit në vitin 2019 ishte rreth 14.1. Në vitet e kaluara është vërejtur një rënie e theksuar e nxënësve për shkak të rënies së natalitetit në Kosovë. Kosova ka proporcione të ngjashme të mësimit për nxënës me vendet e avancuara të OECD. Megjithatë, kuadri mësimit nuk është shpërndarë në mënyrë të baraspeshuar. Një numër i komunave rurale si Kamenica, Dragashi kanë numër tejet të lartë të mësimit në raport me nxënësit. Komuna tjera si Gjilani dhe

Gjakova kanë numër shumë më të madh të mësimdhënësve sesa komunat tjera urbane si Prishtina, Ferizaj apo Mitrovica. Numri i mësimdhënësve në Fushë Kosovë, Skenderaj, Glllogovc dhe Vushtrri është i vogël për numrin e nxënësve.

#### 6.4.1 Ndërtimi i Sistemit për Zhvillim Profesional

##### Rezultati 4.1. Ndërtohet sistem i qëndrueshem i zhvillimit profesional të mësimdhënësve në funksion të realizimit të reformes arsimore

Në kuadër të rezultatit është paraparë një listë e gjerë e aktiviteteve që ndërlidhen me: rishikimin, hartimin dhe aprovimin e dokumenteve të zhvillimit profesional të mësimdhënësve, ndërtimi i mekanizmave në nivel shkolle për zhvillim profesional, zhvillimi i kornizës nacionale për zhvillim profesional, hartim i planit vjetor dhe kornizës afatmesme të shpenzimeve për financim të zhvillimit profesional, caktimi i ekipeve profesionale në nivel komunal për zhvillim profesional, hartimi i programeve trajnuese sipas prioriteteve, mbikëqyrja dhe vlerësimi i trajnimeve të mësimdhënësve, mbështetja e qendrave profesionale dhe hartimi i literaturës dhe udhëzuesve për zhvillim profesional.

Gjatë periudhës 2017-2019, është rishikuar Udhëzimi administrativ për Normativin e Stafit Mësimdhënës në Shkollat e Përgjithshme (UA 10/2018). Qëllimi i Udhëzimit administrativ është të definoj normativin e mësimdhënësve në nivelin fillor, të mesëm të ulët, të mesëm të lartë, arsim profesional dhe arsim special. Në bazë të normativit ngarkesa e mësimdhënësve është 20 orë mësimdhënie në baza javore dhe e shpërndarë në 30-32 javë mësimore. Në bazë të normativit mësimdhënës do të duhej të kalonin rreth 640 orë mësimore në vit. Megjithatë, normativi real në shkollat fillore dhe mesme të ulët është rreth 12.7 orë mësimdhënie në javë apo rreth 408 orë në vit. Ngarkesa javore e mësimdhënies në shkollat e mesme të larta është rreth 22.2 orë në javë apo 691 në baza vjetore.


Tabela: Krahasim i ngarkesës në mësimdhënie në vendet e OECD

	Kosova	Shqipëria	Sllovenia	Estonia	OECD
Ngarkesa fillor/mesëm ulët	408	M	665	601	687
Ngarkesa mesëm lartë	691	M	604	591	619
Ngarkesa mesatare	539	M	635	600	654

Burimi: OECD / Të dhënat për Kosovën janë kalkuluar duke përllogaritur numrin e orëve sipas kurrikulës, numrin e institucioneve arsimore dhe javëve të mësimdhënies. Të njëjtat janë përpjestuar me numrin e mësimdhënësve për nivel.

Në përgjithësi, mësimdhënësit në Kosovë kanë një angazhim prej rreth 539 orëve në baza vjetore apo rreth 110 orë më pak se mesatarja e vendeve të OECD. Orari i punës për një mësimdhënës të rëndomtë është tejet i shkurtër dhe pa ndonjë angazhim të theksuar në ndihmë të nxënësve. Shkalla e nxënësve që kanë pranuar asistencë në detyra është rreth 23 % për qind. Në bazë të Udhëzimit administrativ mbi Normativin e Mësimdhënësve shkalla minimale e kualifikimit për të fituar të drejtën në mësimdhënie është shkollimi universitar 4 vjeçar apo master për ata me shkollim universitar. Udhëzimi parasheh një periudhë tranzitore deri në vitin 2020/2021.


Në anën tjetër, analiza krahasimore e faktorëve që përcaktojnë arritshmërinë e nxënësve në PISA shfaq një ndërlidhje të fortë ndërmjet kualifikimit dhe zhvillimit profesional të mësimitdhënësve me arritshmërinë. Kosova mesatarisht ofron shumë më pak orë trajnimi sesa vendet e tjera të avancuara të OECD. Shkalla e përfshirjes së mësimitdhënësve në zhvillim profesional ka pësuar rënie të vazhdueshme që nga viti 2015. Shkalla e përfshirjes së mësimitdhënësve në zhvillim profesional në vitin 2019 ishte 24.7 % e numrit të përgjithshëm të mësimitdhënësve. Kjo shkallë është dukshëm më e ulët sesa në vendet me sisteme të avancuara arsimore. Shkalla e përfshirjes në zhvillim profesional ka rënë në mënyrë të vazhdueshme që nga viti 2015. Rënia e përfshirjes ka rezultuar për shkak të uljes së shpenzimeve në zhvillim profesional dhe mosfunktionalizimit të një modeli të qëndrueshëm të financimit.



Në vitin 2019, shpenzimet e MASHT për Zhvillim Profesional të Mësimitdhënësve, ishin rreth 432,187 euro apo rreth 0.17% e shpenzimeve të përgjithshme në arsimin parauniversitar. Kishte një rritje të lehtë në financim krahasuar me vitin 2018, mirëpo ende mbetet e vogël krahasuar me shpenzimet e ZHPM në itin 2017. Shpenzimet në ZHPM qendrore dhe komunale duhet të rriten gradualisht dhe ti përafrohen praktikës së mirë në vendet e avancuara (1%).



### Shpenzimet në Zhvillim Profesional në euro dhe si % e shpenzime në Arsimin Parauniversitar 2015-2019



Viteve të fundit është vërejtur një tendencë në rritje e dominimit të femrës në profesionin e mësimdhënësit kryesisht në nivelin parashkollor, fillor dhe mesëm ulët. Kjo ka rezultuar edhe në saje të tendencës së pranimit kryesisht të femrave në programet e edukimit të institucioneve publike (rreth 95% femra). Kosova nuk zbaton provim shtetëror për profesionin e mësimdhënësve dhe nuk sanksionon nevojën e praktikës profesionale para punësimit. Kosova ka filluar procesin e vlerësimit të performancës së mësimdhënësve. Sidoqoftë, nuk është evidente ndikimi i procesit përderisa nuk është e ndërlidhur me sistemin e gradimit dhe shkallën e pagesës.

MASHT ka miratuar Kornizën strategjike për zhvillim të mësimdhënësve në Kosovë në vitin 2017. Megjithëse ishin pjesë e planit vjetor të punës 2019, ende nuk është finalizuar procesi i rishikimit të Udhëzimit administrativ për Financim të Zhvillimit Profesional dhe hartimi i Udhëzimit administrativ për Licencim të Pedagogëve. Dy dokumente tjera të rëndësishme janë në proces të finalizimit – Udhëzimi administrativ për Zhvillim Profesional me bazë në shkollë dhe programi për mësimdhënësit fillestarë/faza induktive.

## 6.4.2 Vlerësimi i performancës së mësimdhënësve

### Rezultati 4.2: Realizohet procesi i vlerësimit të performancës së mësimdhënësve

Vlerësimi i performancës së mësimdhënësve bazohet në kërkesat e Kornizës Strategjike për zhvillim të mësimdhënësve. Gjatë periudhës 2017-2019 është miratuar Ligji 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës. Në bazë të provizioneve e dispozitave ligjore, Inspektorati i Arsimit është organ ekzekutiv qendror për sigurimin e cilësisë në varësi të drejtëpërdrejtë të Ministrit të MASHT. Në kuadër

të autorizimeve mbi sigurimin e cilësisë, institucioni është përgjegjës për inspektim të përgjithshëm të institucioneve shkollore – vlerësim të jashtëm të performancës së shkollës në bazë të UA 04/2017, inspektim të cilësisë së punës dhe vlerësim të performancës së mësimdhënësve për procesin e licencimit sipas UA 14/2018 për Vlerësimin e Performancës së Mësimdhënësve dhe inspektim të cilësisë së punës dhe vlerësim të performancës së drejtorit dhe zëvendësdrejtorit të shkollës.

Në të njëjtën periudhë janë caktuar inspektorët për vlerësim të performancës së shkollës dhe vlerësim të performancës së mësimdhënësve. Inspektorati i Arsimit ka trajnuar 21 inspektorë të arsimit për vlerësimin e performancës së mësimdhënësve krahas tij edhe për përdorimin e instrumenteve për vlerësim. Numri i pamjaftueshëm i inspektorëve për të realizuar këtë proces ka ndikuar në ngecje të realizimit të planit brenda afateve të parapara. Në 2019, para fillimit të fazës së dytë të procesit të vlerësimit të performancës së mësimdhënësve, Inspektorati i Arsimit mban takime me menaxhmentin dhe mësimdhënësit e shkollës përkatëse duke i njoftuar me procesin e VPM-së. Gjithashtu organizon takime me drejtorin dhe mësimdhënësit të cilët i plotësojnë kriteret për t'iu nënshtruar procesit të VPM-së, me ç'rast të pranishmit njoftohen me punët dhe detyrat që i kanë, afatet kohore për realizimin e tyre, si dhe me të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me këtë proces. Numri i vogël i mësimdhënësve që i plotësojnë kriteret për t'iu nënshtruar këtij procesi dhe shpërndarja e tyre nëpër shkolla të shumta e ka pamundësuar Inspektoratin e Arsimit që të organizoj trajnime me grupe të mëdha shkollesh. Gjithashtu, ndërrimet e shpeshta në DKA, ndërrimet e shpeshta në menaxhment të shkollave si dhe pozita e ushtruesit të detyrës së drejtorit, kanë ndikuar që ky proces të zhvillohet sipas procedurave të lartcekura.

Gjatë vitit 2018, në nivel vendi, procesit të vlerësimit të jashtëm të performancës së shkollës iu kanë nënshtruar 29 shkolla, kurse procesit të vlerësimit të performancës së mësimdhënësve iu kanë nënshtruar 216 mësimdhënës të përfshirë në Fazën e Parë të VPM-së. Të gjithë këta mësimdhënës e kanë përfunduar me sukses procesin e vlerësimit të brendshëm bazuar në procesin e VPM-së, prej të cilëve 107 mësimdhënësve iu është vlerësuar ora mësimore e vëzhguar nga inspektori i arsimit. Krahas shtimit të kapacitetit njerëzor. Deri në vitin 2019, vlerësimi i jashtëm ka përfshirë 72 shkolla dhe 650 mësimdhënës. Inspektorati i Arsimit është në proces të miratimit të Rregullorës së Punës. Gjatë kësaj periudhe është themeluar grupi punues dhe ka mbajtur disa takime për konkludim përgatitje të udhëzimit administrativ për vlerësim të performancës së drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të shkollave. Instrumentet e vlerësimit të performancës së drejtorëve janë pilotuar në 10 shkolla. Gjatë përvojës në terren me procesin e VPM-së, viti 2018-2019 konsiderohet e nevojshme që të bëhet rishikimi i UA 14/2018 për Vlerësimin e performancës së mësimdhënësve (të reduktohet dokumentacioni i VPM-së).

### 6.4.3 Licencimi i mësimdhënësve

#### Rezultati 4.3: Funkcionalizohet në tërësi sistemi për licencimin e mësimdhënësve

Në kuadër të rezultatit janë listuar disa aktivitete të nevojshme për arritje të synimeve. Këtu përfshihet finalizimi i dokumenteve për vlerësimin e performancës së mësimdhënësve, hartimi i kornizës për përcaktimin e kompetencave të mësimdhënësve sipas skemës së licencimit, trajnimi i inspektorëve dhe vlerësuesve për shfrytëzim të instrumenteve të vlerësimit të performancës, trajnimi i menaxhmentit të shkollës për vlerësim të mësimdhënësve, organizimi i takimeve njoftuese me mësimdhënës, angazhimi i ekipit të ekspertëve për vlerësim dhe të dhënat e procesit të vlerësimit përdoren për politikbërje nga MASHT dhe DKA.

Licencimi dhe avancimi i mësimdhënësve bëhet përmes procesit të Vlerësimit të Performancës. Prosesi i vlerësimit kombinohet ndërmjet vlerësimit të brendshëm nga mbikëqyrësi i shkollës dhe vlerësimi i jashtëm

që realizohet nga Inspektorati i Arsimit. Ripërtërirja e licencës së mësimdhënësit të karrierës, bëhet në baza pesëvjeçare dhe kushtëzohet me plotësimin e normës prej 100 orë trajnime profesionale gjatë periudhës paraprahe. Numri i orëve të zhvillimit profesional për avancim në nivele më të larta kushtëzohet me plotësim të ndërmjet 200-450 orë të zhvillimit profesional. Sipas Udhëzimit administrativ, procesi i licencimit dhe gradimit përcillet me diferencim të pagesave të mësimdhënësve apo rritje në rast të avancimit. Modalitetet e financimit do të rregullohen me rregullore të veçantë.

Gjatë vititeve 2017-2019, është rishikuar Udhëzimi administrativ për Licencim të Mësimdhënësve të Karrierës- UA 5/2017. Në vitin 2018, Këshilli Shtetëror për Licencim të Mësimdhënësve ka marrë vendim për avancim të gradës së 500 mësimdhënësve të pedagogjisë të angazhuar në fëmijëri të hershme. Udhëzimi rregullon sistemin e licencimit dhe zhvillimit profesional të mësimdhënësve, përcakton akterët për licencim dhe zhvillim profesional të mësimdhënësve dhe përcakton kriteret e aplikimit për licencim. Rregullimi i ri përcakton katër lloje të licencës së rregullt: licenca për mësimdhënës të karrierës, licenca për mësimdhënës të avancuar, licencë për mësimdhënës mentor dhe licencë për mësimdhënës të merituar. Kualifikimi i mësimdhënësit para shërbimit, programet e arsimit të lartë për kualifikim të mësimdhënësve dhe zhvillimi profesional në vend të punës, duhet të jenë të ndërlidhura me Kornizën Strategjike për Zhvillim të Mësimdhënësve në Kosovë.

Përgjithësisht, është iniciuar projekti për vlerësim të performancës së mësimdhënësve. Sidoqoftë, projekti është ende në fazën fillestare të zbatimit. Lansimit të procesit të vlerësimit të performancës, i kanë paraprirë disa aktivitete tjera siç janë rishikimi i Udhëzimit administrativ për Vlerësim të Performancës, draftimi i Ligjit për Inspektoratin e Arsimit dhe zhvillimi i Kornizës Strategjike për Zhvillim të Mësimdhënësve. Aktivitetet tjera të parapara në kuadër të rezultatit duhet të shtyhen për vitin pasues ngase janë të ndërtuara në supozimin që procesi i vlerësimit të performancës ka përfunduar. Për mësimdhënësit e vlerësuar gjatë procesit të rilicencimit përgatiten raporte dhe nxirret vendim për nivelin e performancës së tij/saj. Përveç të mësimdhënësi, këto raporte dhe vendime dërgohen në shkollë dhe në DKA. Gjithashtu, këto të dhëna shfrytëzohen nga MASHT/IA. Nuk ka një adresë zyrtare të MASHT-it ku duhet dërguar një kopje e raportit përfundimtar dhe vendimit për nivelin e performancës.

#### 6.4.4 Matrica e zbatimit të aktiviteteve

No.	Rezultatet	Aktivitetet	Status	%
4.1	Ndërtohet sistem i qëndrueshëm i zhvillimit profesional të mësimit në funksion të realizimit të reformës arsimore.	4.1.1 Rishikimi, hartimi dhe aprovimi i dokumenteve për ZHPM		3
		4.1.2 Ndërtimi i mekanizmave në nivel shkolle për identifikim të nevojave për ZHPM		2
		4.1.3 Zhvillimi i një kornize nacionale për ZHPM të bazuar në nevojat dhe prioritetet e identifikuara		5
		4.1.4 Hartimi i planit vjetor dhe i planit të KASH për financimin e ZHPM		2
		4.1.5 Angazhimi i ekipeve profesionale të ekspertëve në nivel komune		3
		4.1.6 Nxitja e hartimit të programeve trajnuese sipas prioriteteve (për KKK, metodologji, lëndore, arsim gjithëpërfshirës, TIK, mësim i integruar, e tjera)		3
		4.1.7 Ndërtimi i një mekanizmi të financimit të qëndrueshëm për ZHPM		2
		4.1.8 Mbikëqyrja dhe vlerësimi i zbatimit të programeve për ZHPM		2
		4.1.9 Ndërtimi i Nxitja e hartimit të programeve për ZHPM të profileve jo arsimore		4
		4.1.10 Organizimi i trajnimeve për mësimit në nivel qendror dhe komunal (për zbatim të KKK, gjithëpërfshirje, TIK, metodologji të mësimit, programe sipas fushave lëndore, për grupet e marginalizuara, vlerësim të performancës, mentorim, përgatitje të regjistratorit, hartim të PIA, e tjera)		3
		4.1.11 Organizimi i aktiviteteve për ZHPM në shkollë sipas nevojave të shkollës dhe në harmoni me kornizën afatgjatë për zhvillim profesional		2
		4.1.12 Organizimi i trajnimeve për zbatimin e kurrikulave bërthamë sektoriale dhe kornizave të profileve për AAP		3
		4.1.13 Mbështetja e qendrave për ngritje profesionale në nivel komune		3
		4.1.14 Sigurimi i materialeve/literaturës për ZHPM		3
		4.1.15 Mbështetja e bashkëpunimeve në nivel rajonal dhe më gjerë		2

No.	Rezultatet	Aktivitetet	Status	%
4.2	Realizohet procesi i vlerësimit të performancës së mësimdhënësve	4.2.1 Finalizimi i dokumenteve për vlerësimin e performancës së mësimdhënësve		4
		4.2.2 Zhvillimi i licencimit të mësimdhënësve me bazë në performancë dhe skema e promovimit që definojnë kompetencat kyçe për secilin lloj të licencës në skemën ekzistuese dhe ndërlidhja e tyre me sistemin e pagave		2
		4.2.3 Ngritja e kapaciteteve të inspektorëve dhe të vlerësuesve për vlerësim të performancës		3
		4.2.4 Ngritja e kapaciteteve të shkollës (drejtorit, bashkëpunëtorëve profesional, mësimdhënësve) për vlerësim të performancës		3
		4.2.5 Ndërtimi i një programi hyrës për mësimdhënësit e rinj dhe aktivitetet e tjera të planifikuara me qëllim të përmirësimit dhe institucionalizimit të vlerësimit të performancës së mësimdhënësve dhe zhvillimit profesional		3
		4.2.6 Hartimi i planit të veprimit për vlerësim të performancës		4
		4.2.7 Organizimi i procesit të vlerësimit të performancës		3
		4.2.8 Mbikëqyrja dhe vlerësimi i zbatimit të planit të veprimit për vlerësimin e performancës		3
		4.2.9 Përdorimi i të dhënave nga procesi i vlerësimit të performancës për politikë-bërje dhe caktim të prioriteteve për ZHPM në nivel kombëtar		3
4.3	Funksionalizohet në tërësi sistemi për licencimin e mësimdhënësve	4.3.1 Hartimi i Planit të veprimit për zbatimin e procesit të licencimit		4
		4.3.2 Bashkëpunimi me institucionet përgjegjëse për sigurimin e mjeteve financiare për procesin e licencimit të mësimdhënësve (MF, MAP, Kuvendi i Kosovës)		2
		4.3.3 Informimi i mësimdhënësve për sistemin e licencimit		4
		4.3.4 Zbatimi i procesit të gradimit dhe harmonizimi me sistemin e pagave		1
		4.3.5 Organizimi i procesit të licencimit për mësimdhënësit fillestarë		4
		4.3.6 Mbikëqyrja dhe vlerësimi i zbatimit të Planit të veprimit për licencimin e mësimdhënësve		3
4.4	Sigurohet përgatitja cilësore e mësimdhënësve para shërbimit	4.4.1 Përcaktimi i standardeve të pranimit të studentëve në fakultete arsimore		4
		4.4.2 Harmonizimi i programeve të FA me politika të MASHT		4
		4.4.3 Rritja e kapaciteteve të FA për hartimin dhe zbatimin e programeve sipas KKK		3
		4.4.4 Organizimi i hulumtimeve nga ana e stafit të FA lidhur me zbatimin e KKK, metodologjive, gjithëpërfshirjes, e tjera.		2

## 6.4.5 Treguesit e performancës

### TREGUESIT KRYESOR TË CILËSISË 2015-2017

	2015	2016	2017	2018	2019
<b>Kushtet e mësimdhënies (publik)</b>					
Raporti nxënës për mësimdhënës APU	15.7	15.5	15.2	14.7	14.1
Raporti nxënës-mësimdhënës fillor/mesëm ul	15.5	15.1	14.6	14.3	14
Raporti nxënës-mësimdhënës mesëm lartë	15.9	16.4	16.4	15.4	14.1
<b>Numri i mësimdhënësve sipas gjinisë (publik)</b>					
Numri i mësimdhënësve	23,366	23,202	23,281	23,262	23,234
Numri i mësimdhënësve femra	11,925	12,011	12,498	13,761	13,165
Numri i mësimdhënësve meshkuj	11,441	11,191	10,783	10,489	10,069
Indeksi i Paritetit Gjinator	1.04	1.07	1.15	1.31	1.31
<b>Numri i mësimdhënësve sipas niveleve të arsimit parauniversitar ISCED (publik)</b>					
Numri i mësimdhënësve parashkollor	528	535	537	548	553
Numri i mësimdhënësve fillor/mesëm ulët	17,563	17,410	17,464	17,453	17,426
Numri i mësimdhënësve mesëm lartë	5,275	5,257	5,280	5,261	5,255
<b>Mosha e mësimdhënësve (publik)</b>					
Mësimdhënësit % nën 30 vjeç	13.65	-	-	8.43	12.7
Mësimdhënësit % 30-39 vjeç	24.84	-	-	27.56	28.4
Mësimdhënësit % 40-49 vjeç	21.18	-	-	20.24	20.1
Mësimdhënësit % 50-59 vjeç	27.14	-	-	26.54	24.6
Mësimdhënësit % mbi 60 vjeç	13.18	-	-	17.24	14.2

## TREGUESIT KRYESOR TË CILËSISË 2015-2017

	2015	2016	2017	2018	2019
<b>Përfshirja në zhvillim profesional (publik)</b>					
Shkalla e përfshirjes në zhvillim profesional	54	49	47.2	33.5	24.7
Orët vjetore të trajnimit					
<b>Cilësia në mësimdhënie</b>					
Numri i mësimdhënësve të vlerësuar	-	-	131	216	650
Shpenzimet në zhvillim profesional në Euro	487,779	372,159	662,889	356,071	432,187

Burimi: MASHT/SMIA (2019)

## 6.4.6 Rekomandimet

- Të avancohet procesi dhe procedura e regjistrimit të individualizuar të zhvillimit profesional*** - Kosova ofron krahasimisht më pak orë trajnimi dhe zhvillimi profesional për mësimdhënësit krahasuar me vendet e avancuara të OECD. Në analizën ekonometrike dhe regresionit linear është dokumentuar *ndërlidhje dhe variabilitet i lartë në shkallë të arritshmërisë* së nxënësve ndërmjet vendeve që (nuk) investojnë në zhvillim profesional. Shkalla e financimit për zhvillim profesional të mësimdhënësve është rreth 0.17 % e buxhetit të përgjithshëm në arsim parauniversitar. Kjo është më pak se 0.3 e shpenzimeve në ZHPM në vitin 2017. Alokimi i rreth 432,137 euro në vitin 2019 është ende vetëm 35 % e nivelit të financimit të vitit 2011. Ulja e shkallës së investimit mund të ketë ndikuar në ulje të shkallës së përfshirjes dhe numrit mesatar të orëve të kaluara në zhvillim profesional.
- Të avancohet sistemi dhe cilësia e programeve të zhvillimit profesional*** - Rritja e shkallës së përfshirjes së mësimdhënësve në zhvillim profesional dhe ofrimi i trajnimeve nuk është domosdoshmërisht kontribut i drejtpërdrejtë në arritshmëri të nxënësve. Kërkohej që krahas rritjes së shkallës së përfshirjes, të sigurohet që ato janë cilësore dhe të përshtatshme për profilin e mësimdhënësit. MASHT ka kompletuar bazën ligjore rreth sistematizimit të procesit të zhvillimit profesional të mësimdhënësve. Këto zhvillime kanë ofruar sqarime të theksuara mbi ndarjen e përgjegjësisë të hisedarëve në proces. Megjithatë, shkalla e kontributit financiar nga komunat për këtë prioritet ende mbetet e parëndësishme. Është e rëndësishme që të punohet me universitetet publike rajonale për të krijuar qendra hulumtimi dhe zhvillimi profesional të mësimdhënësve.
- Të definohet politika dhe sistemi i rritjes së pagave bazuar në performancë*** - Rritja e rrogave të mësimdhënësve duhet të bazohet te performanca gjatë shërbimit. Kosova ka bërë hapa të theksuar në përmirësim të standardit jetësor dhe kompensimit të mësimdhënësve. Të hyrat mesatare vjetore të kuadrit mësimdhënës tejkalojnë ndjeshëm të hyrat mesatare për kokë banori. Këto hapa janë marrë në mënyrë lineare për të gjithë mësimdhënësit. Janë bërë pak përpjekje për të diferencuar kuadrin mësimdhënës sipas parametrave të performancës. Gjatë vitit të kaluar është rishikuar dhe miratuar baza ligjore mbi kompetencat e mësimdhënësve dhe vlerësimit të performancës. Në pilot projekt me përfshirje të kufizuar është në përfundim e sipër. Rritja e kompensimit duhet të mbështetet në performancën e mësimdhënësit në shërbim. Vendimet për rritje të kompensimit duhet të mbështeten në procesin e vlerësimit të performancës dhe gradimit. Duhet të shmangët rritja lineare e rrogave të mësimdhënësve. Rritja e rrogave e indeksuar sipas nivelit të rritjes ekonomike duhet të përcillet edhe me përpjekje për të rritur normën e punës së mësimdhënësit. Kosova ka krahasimisht normë më të ulët të angazhimit të mësimdhënësve krahasuar me vendet e tjera të OECD.
- Të rritet kriteri për pranimit në programet e kualifikimit të mësimdhënësve në favor të tërheqjes së nxënësve më të mirë në profesion*** - Është dokumentuar që ekziston një ndërlidhje e fortë ndërmjet nivelit të kualifikimit të mësimdhënësve dhe arritshmërisë së nxënësve. Kosova duhet të bëjë përpjekje të eliminojë praktikën e inkuadrimin të mësimdhënësve të pa profilizuar në mësimdhënie. Një vëmendje më e posaçme kërkohej në fuqizim të institucioneve dhe programeve të përgatitjes së mësimdhënësve para shërbimit. Shkalla aktuale e pranimit të studentëve në Fakultete të Edukimit është shumë më e lartë sesa kërkesa për mësimdhënës në treg. Kosova ka në proces të natyrshëm të pensionit të rreth 650-700 mësimdhënësve brenda vitit. Vendet vjetore të studimit do të duhej të ishin të kufizuara në rreth 1000 studentë. Kërkohej zbatim i kritereve më të larta në procesin e pranimit.



- ***Të sistematizohet përkrahja dhe trajnimi për mësime të punës me nxënësit përtej instruksionit teorik*** - Vetëm një pjesë e vogël e nxënësve raportojnë të kenë pranuar ndihmë nga mësime të punës për kryerjen e detyrave të shtëpisë. Sipas OECD (2019), kjo përbën shkallën më të ulët në vendet e OECD dhe vendeve partnere. Në vendet e OECD rreth 70 % për qind e nxënësve raportojnë të jenë ndihmuar nga mësime të punës të tyre.
- ***Të organizohet provimi shtetëror për profesionin e mësime të punës*** – Në shumicën e vendeve të OECD, mësime të punës i nënshtrohen provimit kombëtar për hyrje në profesion. Ky provim shtetëror është i organizuar pas përfundimit të ciklit 5-7 vjeçar të studimeve mbi profesionin dhe teston shkallën e arritjes së kompetencave. Certifikata e provimit shtetëror është parakusht për të aplikuar për mësime të punës.
- ***Të sanksionohet nevoja e praktikës profesionale për mësime të punës si parakusht për hyrje në profesionin e mësime të punës*** – Në shumicën e vendeve të OECD, mësime të punës duhet ti nënshtrohen praktikës profesionale. Në disa raste praktika profesionale është pjesë integrale e kurrikulës së studimit. Zakonisht viti i fundit i studimit (60 ECTS) i dedikohet kompletimit të praktikës profesionale. Praktika profesionale është e obliguar dhe duhet të përfundojë në një nga shkollat që ofron profilin e specializimit të mësime të punës.

# Mësimdhënia dhe të Nxënit

Avancimi i të nxënit përmes mësimdhënies cilësore, duke zbatuar kurrikulën e bazuar në kompetenca dhe duke shfrytëzuar resurse mësimore të cilësisë së lartë

## Rezultatet:

- Kurrikula e bazuar në kompetenca zbatohet në të gjitha shkollat dhe nivelet e arsimit parauniversitar në Kosovë
- Hartohen tekste shkollore dhe materiale të tjera mësimore për të gjitha klasat dhe të gjitha lëndët
- Të gjitha shkollat janë të pajisura me mjete të TIK-ut dhe mjete të tjera të konkretizimit të nevojshme për zbatim të suksesshëm të kurrikulës së re

## 6.5 Mësimdhënia dhe të Nxënit

Në kuadër të këtij caku parashihen disa aktivitete që ndërlidhen me zbatimin e kurrikulës së re, teksteve mësimore dhe mjeteve të konkretizimit. Objektivi synon zbatimin e kurrikulës së re, trajnimin e mësimdhënësve, hartimin e teksteve të reja mësimore, hartimin e materialeve të reja për mësimdhënie dhe mësimnxënie, hartimin e programeve lëndore edhe për komunitetet, hartimin e instrumentet e reja të vlerësimit dhe sigurimin e mjeteve adekuate të konkretizimit. Procesi i zbatimit të kurrikulës ka hasur në disa sfida që kryesisht ndërlidhen me vështirësi në zbatim të kurrikulës së re të bazuar në kompetenca, vështirësi për të ndërlidhur procesin e vlerësimit të vazhdueshëm të bazuar në arritje të kompetencave, mungesë të financimit adekuat, mungesë të teksteve adekuate shkollore dhe mungesë të infrastrukturës. Pavarësisht orientimeve në këtë dokument, që zhvillimi i teksteve të reja për klasat e para të niveleve arsimore do të bëhet gjatë vitit shkollor 2016/2017, një gjë e tillë nuk është arritur.

Indeksi i performancës 2019

Rez	Rezultati	%	Niveli
1	Kurrikula e bazuar në kompetenca zbatohet në të gjitha shkollat dhe nivelet e arsimit parauniversitar në Kosovë	60%	3.6
2	Hartohen tekste shkollore dhe materiale të tjera mësimore për të gjitha klasat dhe të gjitha lëndët	50%	3
3	Të gjitha shkollat janë të pajisura me mjete të TIK-ut dhe mjete të tjera të konkretizimit	30%	1.8
<b>Total</b>		<b>47%</b>	<b>2.8</b>

Sistemi arsimor ka qasje të ulët në teknologji të informimit dhe komunikimit dhe teknologjia bashkëkohore ende nuk është integruar në mënyrë të përshtatshme në kurrikulë, mësimdhënie dhe menaxhim të sistemit arsimor. Ngritja e cilësisë në të gjitha nivelet është e kushtëzuar nga aftësia e mësimdhënësve dhe nxënësve për të përvetësuar mjetet bashkëkohore të mësimdhënies dhe teknologjisë. Kosova nuk ka shënuar ndonjë përmirësim në qasje të shkollave me mjete konkretizimi dhe hapësira leximi.

### 6.5.1 Zbatimi i kurrikulës së re

#### Rezultati 5.1 Kurrikula e bazuar në kompetenca zbatohet në të gjitha shkollat dhe nivelet e arsimit parauniversitar në Kosovë

Për të përmbushur rezultatin, janë paraparë një seri e aktiviteteve si : zhvillimi i kurrikulave lëndore / programeve të reja mësimore për klasë të caktuar, hartimi i programeve për trajnimin e mësimdhënësve të të gjitha shkollave për zbatimin e programeve të reja mësimore për lëndë dhe klasë, hartimi i programe të trajnimeve dhe materialet për administrator të sistemit arsimor, përgatitja e materialeve promovuese për informim të prindërve dhe monitorimi i zbatimit të kurrikulës së re nga niveli i shkollës, komunës dhe niveli qendror.

MASHT, pas rishikimit të Kornizës Kurrikulare të arsimit parauniversitar dhe kurrikulave bërthamë për tre nivelet formale të arsimit parauniversitar në vitin 2016, ka marrë vendim që nga viti i ri shkollor 2017/18, të fillohet me zbatimin e programeve të reja mësimore në të gjitha shkollat e Republikës së Kosovës, me klasën përgatitore klasën e parë, klasën e gjashtë dhe klasën e dhjetë. Gjatë vitit 2018, MASHT ka hartuar programet e reja mësimore për klasën 2,7,11 të cilat në vitin shkollor 2018 / 2019 janë në zbatim në të gjitha shkollat e Kosovës. MASHT, ka përgatitur edhe draftprogramet për gjuhën shqipe për nxënësit e komuniteteve të klasave 3,6,10. Në bashkëpunim me Institutin Shqiptar për Zhvillim Arsimor, është përpiluar draftkorniza e Kurrikulës për Diasporën. Kufizimet buxhetore kanë pamundësuar botimin e dokumenteve të shtypura të programeve të reja. Gjithashtu, programet mësimore për klasat 0,1,2,6,7,10,11, nuk janë përkthyer në gjuhën serbe, turke dhe boshnjake.

Në vitin 2019, janë rishikuar dhe finalizuar kurrikulat/programet mësimore për të gjitha lëndët për klasët 3, 8, 12. Gjithashtu, janë hartuar draft kurrikulat /programet mësimore për gjitha lëndët, për klasat 4, 9. Kurrikulat/programet mësimore për lëndën gjuhë shqipe për komunitetet joshqiptare për klasat 3,4,6,7,10 dhe 11 janë përfunduar gjatë kësaj periudhe.

Zhvillimi dhe rishikimi i kurrikulës Niveli 1-3 sipas klasave 2016-2019

		2016	2017	2018	2019
ISCED/SNKA 1 Shkolla Fillore	Klasa 1	+			
	Klasa 2		+		
	Klasa 3			++	
	Klasa 4				+
	Klasa 5				
ISCED/SNKA 2 Shkolla e Mesme e Ulët	Klasa 6	+			
	Klasa 7		+		
	Klasa 8			++	
	Klasa 9				+
ISCED/SNKA 3 Shkolla e Mesme e Lartë	Klasa 10	+			
	Klasa 11	+	+		
	Klasa 12			++	

Sa i përket aktivitetit për trajnimin e mësimitdhënësve, gjatë vitit 2018 janë organizuar trajnime për rreth 31.76% të mësimitdhënësve për kornizën e kurrikulës, kurrikulën bërthamë dhe programet e reja mësimore. Përgatitja e portfoliove sipas programit të trajnimit ka mundësuar një përgatitje më të mirë në zbatim të kurrikulës në praktikë. Gjithashtu, janë hartuar dosjet fizike dhe elektronike dhe është promovuar një bashkëpunim më i afërt ndërmjet shkollave, mësimitdhënësve dhe koordinatorëve të fushave.

Procesi i zbatimit të kurrikulës ka hasur në disa sfida që kryesisht ndërlidhen me vështirësi në për zbatim të kurrikulës së re të bazuar në kompetenca, vështirësi për të ndërlidhur procesin e vlerësimit të vazhdueshëm të bazuar në arritje të kompetencave, mungesë të financimit adekuat, mungesë të teksteve adekuate shkollore dhe mungesë të infrastrukturës. MASHT ka përpiluar udhëzues dhe organizuar një seri të trajnimeve për zbatim të mësimitdhënies dhe vlerësimit të bazuar në kompetenca por mësimitdhënësit vazhdojnë të preferojnë më shumë udhëzime në vend të punës (IPK, 2019).

## 6.5.2 Tekstet dhe materialet mësimore

### Rezultati 5.2: Hartohen tekste shkollore dhe materiale të tjera mësimore për të gjitha klasat dhe të gjitha lëndët

Në kuadër të rezultatit janë paraparë përcaktimi i procesit të hartimit të teksteve të reja shkollore, përgatitja e teksteve shkollore për të gjitha lëndët dhe për të gjitha klasat në arsimin e përgjithshëm dhe trajnimin e mësimitdhënësve për zhvillimin dhe shfrytëzimin e materialeve elektronike. Është formuar Këshilli i Ekspertëve për Programe dhe Tekste Shkollore - KEPTSH. Janë hartuar: Drafregullorja për detyrat, obligimet dhe përgjegjësitë për të gjithë anëtarët KEPTSH (Këshilli i Ekspertëve për Programe dhe Tekste Shkollore) dhe draftplani i punës për zhvillimin e teksteve të reja. Gjatë vitit 2018, MASHT ka shpallur konkurs për tekstet e reja shkollore për klasat përgatitore 1,6,10 si dhe klasat 2,7,11. Institucioni është në fazën e përcaktimit, shpërndarjes së dorëshkrimeve tek recensentë për vlerësimin e teksteve për klasën përgatitore dhe ka siguruar tekste të reja për gjuhët e huaja. Mungesa e teksteve mësimore vazhdon të sfidojë procesin e zbatimit të programeve të reja. Mjetet e konkretizimit dhe sistemi i vlerësimit të nxënësve duhet të përshtaten me kurrikulën e re. Në vitin 2019, janë botuar dhe miratuar nga MASHT tekstet e reja shkollore për klasën përgatitore, klasat 1,2,6,7,10,11. Tekstet e reja janë shpërndarë në të gjitha shkollat e Kosovës, këto tekste gjatë vitit shkollor 2019/2020 janë duke u pilotuar. Tekstet shkollore për gjuhët e huaja si : gjuhë angleze ( klasa përgatitore 1,2,6,7,10,11), gjuhë gjermane (klasa 6,7,10,11) dhe gjuhë frënge ( 6,7,10,11 janë marrë nga shtëpitë botuese të huaja .

Teksti shkollor për lëndën e kimisë për klasën 7 nuk ka kaluar vlerësimin nga recensentët. Është shpallur konkursi për tekstet e reja shkollore për klasat 3,8,12 dhe për tekstet e reja shkollore, të cilat nuk kanë marrë vlerësimin nga recensentët. Në vazhdim duhet të vlerësohen tekstet e reja shkollore, të cilat janë duke u pilotuar nga mësimitdhënësit dhe të vlerësohen tekstet e reja shkollore nga grupet profesionale për të vërtetuar lidhjen me kërkesat e dokumentet kurrikulare, faktet shkencore, përmbajtjen, informacionin etj.

Mungesa e teksteve të mjaftueshme dhe adekuate për kurrikulën e re vazhdon të jetë një nga sfidat kryesore në arsim. Në bazë të të dhënave të OECD (2019) mbi analizën e arritshmërisë në PISA 2018, Kosova renditet si një nga vendet me knaqshmërinë më të ulët të drejtorëve, mësimitdhënësve dhe nxënësve me tekstet mësimore. Publikimi i teksteve të reja dhe fillimi i përdorimit të tyre ka ngritur debate rreth cilësisë së tyre. ***Nëse krabasohet dinamika e parametrave kryesor në zbatim të kurrikulës ndërmjet 2014-2018, Kosova nuk ka shënuar ndonjë përmirësim në qasje të shkollave me pajisje digjitale, hapësira leximi, në qasjen e mësimitdhënësve në raport me detyrat e nxënësve apo tekstet mësimore.***

Tabela: Krahasim i parametrave % në zbatim të kurrikulës në vende të OECD dhe partnerëve 2015-2018

	Kosova 2015	Kosova 2018	OECD
Shkolla ofron tekste/pajisje adekuate	14.2	18.9	70.6
Shkolla ofron qasje në kompjuter	14	14	81
% kompjuterë me internet	29.2	27.9	97.8
Shkolla ofron hapësira leximi	19	24.2	73.2
Mësimdhënësi ndihmon në detyra	48.7	42.2	59.8

Burimi: OECD 2015-2019


### 6.5.3 Mjetet e konkretizimit dhe TIK

**Rezultati 5.3: Të gjitha shkollat janë të pajisura me mjete të TIK dhe mjete të tjera të konkretizimit të nevojshme për zbatim të suksesshëm të kurrikulës së re**

Politika e investimeve infrastrukturore në Kosovë është përqendruar kryesisht në ndërtim të objekteve shkollore.

**Sistemi arsimor ka qasje të ulët në teknologji të informimit dhe komunikimit dhe teknologjia bashkëkohore ende nuk është integruar në mënyrë të përshtatshme në kurrikulë, mësimdhënie dhe menaxhim të sistemit arsimor.** Ngritja e cilësisë në të gjitha nivelet është e kushtëzuar nga aftësia e mësimdhënësve dhe nxënësve për të përvetësuar mjetet bashkëkohore të mësimdhënies dhe teknologjisë. Nuk është shënuar ndonjë përparim i ndjeshëm në pajisjen e shkollave me pajisje digjitale. Qasja e tyre në kompjuterë është tejet e ulët krahasuar me vendet e avancuara. Nxënësit në të shumtën e rasteve nuk pranojnë ndihmesë në detyra të shtëpisë nga mësimdhënësit përtej mbajtjes së orës mësimore.

A keni ndjekur trajnim për përdorim të TIK në mësimdhënie (OECD, 2019)



Vëmendje e posaçme duhet kushtuar investimeve në teknologji të komunikimit dhe informimit si në administrim, ashtu edhe në mësimdhënie/mësimnxënie. Kosova ka krahasimisht shkallë të ulët të integritit të TIK në mësimdhënie. Në vendet e OECD, pothuajse të gjitha klasat janë të pajisura me projektor dhe tabela smart.

## 6.5.4 Matrica e zbatimit të aktiviteteve

No.	Rezultatet	Aktivitetet	Status	%
5.1	Kurrikula e bazuar në kompetenca zbatohet në të gjitha shkollat dhe nivelet e arsimit parauniversitar në Kosovë	5.1.1. Zhvillimi i kurrikulave dhe planprogrameve sipas klasës dhe lëndës		4
		5.1.2. Hartimi i programeve të trajnimit dhe materialeve trajnuese përcjellëse		4
		5.1.3. Trajnimi i mësimitdhënësve nga të gjitha shkollat për zbatimin e kurrikulës së re		3
		5.1.4. Trajnime për drejtorë, zyrtarë komunalë të arsimit dhe inspektorë për zbatimin e kurrikulës së re		4
		5.1.5. Informimi i prindërve me procesin e zbatimit të kurrikulës së re dhe konsultimet e vazhdueshme me ta		3
		5.1.6. Monitorimi sistematik i zbatimit të kurrikulës së re nga niveli i shkollës, i komunës dhe niveli qendror		3
		5.1.7. Rishikimi i vazhdueshëm i kurrikulës së re		4
		5.1.8. Organizimi i vlerësimit për shkallët kurrikulare		4
5.2	Hartohen tekste shkollore dhe materiale të tjera mësimore për të gjitha klasat dhe të gjitha lëndët	5.2.1. Përcaktimi i procesit të hartimit të teksteve të reja shkollore		4
		5.2.2. Përgatitja e teksteve shkollore për të gjitha lëndët dhe për të gjitha klasat në arsimin e përgjithshëm		3
		5.2.3. Trajnimi i mësimitdhënësve për zhvillimin dhe shfrytëzimin e materialeve elektronike		2
5.3	Të gjitha shkollat janë të pajisura me mjete të TIK-ut dhe mjete të tjera të konkretizimit të nevojshme për zbatim të suksesshëm të kurrikulës së re	5.3.1. Sigurimi i qasjes në Internet me brez të gjerë për të gjitha shkollat		3
		5.3.2. Furnizimi i shkollave me kompjuterë dhe me infrastrukturë të TIK-ut dhe mjeteve të tjera të nevojshme		2
		5.3.3. Hartimi i planeve për mirëmbajtjen dhe përditësimin e pajisjeve të TIK-ut		1
		5.3.4. Promovimi i shfrytëzimit të pajisjeve personale të TIK-ut		2
		5.3.5. Subvencionimi i laptopëve për mësimitdhënës		1
		5.3.6. Furnizimi i shkollave me mjete konkretizimi të nevojshme për zbatimin e kurrikulës së re		2



## 6.5.5 Treguesit e Performancës

### TREGUESIT KRYESOR TË CILËSISË 2015-2018

	2015	2016	2017	2018	2019
<b>Numri i nxënësve në arsim profesional</b>					
Ngarkesa vjetore arsim fillor (mst.)	-	-	-	530	-
Ngarkesa javore arsim fillor (45 min)	-	-	-	21-24	-
Ngarkesa vjetore arsim mesëm ulët (mst.)	-	-	-	714	-
Ngarkesa javore arsim mesëm ulët (45 min)	-	-	-	29-30	-
Ngarkesa vjetore arsim mesëm lartë (mst.)	-	-	-	720	-
Ngarkesa javore arsim mesëm lartë (45 min)	-	-	-	30-32	-
<b>Orët javore të kaluara në studim sipas lëndëve</b>					
Gjuhët dhe komunikimi (mst)	-	-	-	8	-
Artet (mst)	-	-	-	2	-
Matematikë (mst)	-	-	-	4	-
Shkencat natyrore (mst)	-	-	-	6	-
Shoqëria dhe mjedisi (mst)	-	-	-	5	-
Edukata fizike, sported dhe shëndeti (mst)	-	-	-	2	-
Jeta dhe Puna (mst)	-	-	-	2	-
Zgjedhore (mst)	-	-	-	1	-

TREGUESIT KRYESOR TË CILËSISË 2015-2018

	2015	2016	2017	2018	2019
<b>Knaqshmëria me pajisjet dhe materialet shkollore</b>					
Knaqëshmëria me pajisje dhe tekste	-	14.2	-	-	18.9
Proporcioni nxënës-kompjuter	-	0.14	-	-	0.14
Shkollat % që ofrojnë hapësira leximi	-	19	-	-	24.2
Numri i shkollave me bibliotekë	-	-	-	111	
<b>Shpenzimet në mësimdhënie dhe të nxënit</b>					
Shpenzimet në TIK në milion €					
Shpenzimet në kurrikulë në milion €					
Shpenzimet në kurrikulë si % e shpz.parauniversiar					

## 6.5.6 Rekomandimet

- Të avancohen përpjekjet dhe resurset për zbatim të kurrikulës së re në të gjitha shkollat dhe nivelet***  
 - Ka filluar zbatimi i kurrikulës së re në të gjitha shkollat e Kosovës. Kjo ka ardhur pas një periudhe relativisht të gjatë të përgatitjes dhe pilotimit. Kurrikula nënkupton ndryshim të theksuar në paradigmen arsimore duke vendosur theksin tek kompetencat e nxënësve. Sidoqoftë zbatimi i suksesshëm i kurrikulës varet nga kapaciteti administrativ, njerëzor dhe infrastrukturor. Në aspektin strukturor nxënësit do të jenë në gjendje të përfitojnë të gjitha njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat e nevojshme. Sidoqoftë, kjo varet edhe nga pesha dhe normat e shpërndarjes së orëve mësimore.
- Të sigurohet trajnim i mësimdhënësve për metodat e reja të vlerësimit për të inkurajuar pjesëmarrjen dhe mësimnxënien*** -Kurrikula e re kushtëzon metoda të reja të mësimdhënies duke e bërë të nevojshëm trajnimin e vazhdueshëm të stafit mësimdhënës. Zbatimi në disa raste mund të ndeshet me mungesë të stafit adekuat dhe hendekun ndërmjet kualifikimeve të mësimdhënësve dhe lëndëve të studimit. Reforma kurrikulare kushtëzon edhe metoda të reja të vlerësimit dhe mësimnxënies. Këtu nënvizohet rëndësia e trajnimit të vazhdueshëm mbi metodat e vlerësimit të mësimnxënies së bazuar në kompetenca. Kërkohe mbështetje e vazhdueshme në formë të udhëzimeve, standarde në ato fusha ku zbatohet mësim integrativ i disa lëndëve.
- Të rishikohen metodat e vlerësimit në favor të inkurajimit të vlerësimit të vazhdueshëm të mësimnxënies*** - Mësimdhënësit në Kosovë zbatojnë vlerësime kryesisht të rralla të nxënësve. Sipas të dhënave të OECD (2019) një nxënës i nënshtrohet vlerësimit kryesisht një herë brenda semestrit. Kjo përbën një anomali në krahasim me vendet e avancuara të OECD ku nxënësit vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme apo rreth 4-5 herë brenda semestrit. Rreth 90 % për qind e nxënësve në Estoni i nënshtrohen vlerësimit përmes testeve të zhvilluara nga mësimdhënësi çdo muaj. Vlerësimi i vazhdueshëm mund të promovoj pjesëmarrjen dhe stimuloj mësimnxënien.
- Të rritet financimi për zbatim të kurrikulës së re*** - Procesi i zbatimit kërkon më shumë resurse arsimore duke përfshirë rritje të financimit për administrim, tekste mësimore dhe mjete të konkretizimit.
- Të inkurajohet kontributi i shkollës dhe mësimdhënësve në përmbajtjen e kurrikulës dhe lëndëve***  
 - Shkollat dhe mësimdhënësit në Kosovë përceptojnë se kanë përgjegjësi të kufizuara në përcaktim të përmbajtjes së kurrikulës dhe përmbajtjes së lëndëve. Megjithatë, kurrikula bërthamë inkurajon shkollat të avancojnë lëndë të reja zgjedhore që mund të avancojnë kompetencat e nxënësve. Kjo praktikë korrespondon me zhvillimet në vendet me sisteme të avancuara arsimore të OECD. Shkolla ka përgjegjësi të theksuara në përcaktimin e kurrikulës dhe përmbajtjes së lëndëve.
- Të inkurajohen aktivitetet ekstrakurrikulare dhe të ofrohet infrastrukturë mbështetëse për shkollat*** – Kosova duhet të promovoj aktivitetet ekstrakurrikulare për të zhvilluar potencialin e nxënësve në orkestër, muzikë, gazetë shkollore, vullnetarizëm, klubet e shkencës, garat shkollore, komunale dhe kombëtare, klubet e teknologjisë informative, klubet e artit, shahut dhe sporteve. Kosova ka një traditë të organizimit të aktiviteteve ekstrakurrikulare. Megjithatë, ajo duhet të shtrihet dhe mbështetet në të gjitha shkollat dhe posaçërisht në viset rurale ku dokumentohet një pjesëmarrje më e ulët (OECD, 2016)
- Të shtohen përpjekjet për monitorim të zbatimit të ngarkesës së nxënësve në shkollë*** - Kosova duhet të zbatoj një ngarkesë mesatare prej 28-30 orë për javë për t'u përafëruar me vendet e OECD. Monitorimi nuk duhet të kufizohet vetëm në faktin nëse plani mësimor konsiston në këtë ngarkesë. Monitorimi duhet të

shërbej që secili nxënës të plotësoj një normë minimale prej 28-30 orë mësimi në shkollë dhe rreth 15-20 orë shtesë punë në shtëpi.

- ***Të shtohen përpjekjet për monitorim dhe harmonizim të ngarkesës mësimore në lëndët e matematikës dhe shkencë*** - Kosova duhet të siguroj një normë minimale javore prej 4 orë matematikë dhe 4 orë lëndë shkencore. Monitorimi nuk duhet të kufizohet në atë nëse plani mësimor përkushtohet për një minimum të tillë. Monitorimi duhet të përqendrohet që secili nxënës të ketë ndjekur një praktikë të tillë me rreth 8 orë javore në matematikë dhe shkencë dhe rreth 8 orë punë shtëpie.
- ***Të sigurohen tekste adekuate dhe të shqyrtohet liberalizimi i politikës së teksteve mësimore*** – Zbatimi i kurrikulës së re kërkon tekste mësimore më të avancuara. Kosova duhet të shqyrtoj mundësinë e adaptimit të teksteve ndërkombëtare në fushat e shkencave ekzakto. Në kuadër të teksteve mësimore vëmendje të posaçme duhet përkushtuar edhe Teksteve Udhëzuese për Mësimdhënësit. Në krahasim me vendet e tjera të OECD-së, Kosova zbaton një politikë tejet konservative në tekste mësimore. Librat kryesisht përcaktohen nga niveli qendror dhe mësimdhënësit dhe shkollat përceptojnë që nuk është në domenin e kompetencave të tyre të angazhohen në këtë drejtim. Në shumicën e vendeve të OECD, mësimdhënësit, shkollat dhe këshilli i shkollës angazhohen aktivisht për të kontribuar në përzgjedhjen e teksteve mësimore dhe ofrimin e teksteve alternative.
- ***Të lansohet një studim mbi meritat e zgjatjes së orës mësimore në 60-90 minuta*** – Zgjatja e orëve mësimore është praktikë mjaft e përhapur në vende të ndryshme partnere dhe të OECD-së. Kjo vjen në sajë të gjetjeve shkencore që favorizojnë një qasje të tillë në kontekst të mësimi interaktiv. Zgjatja e orëve mësimore apo ofrimi modular mund të shmangin problemet ergonomike dhe shëndetësore që burojnë nga nevoja e nxënësve për çanta të mëdha. Kjo do të ishte sidomos e rekomandueshme për të eliminuar shpenzimet infrastrukture në dollapë shkollor.



# Arsimi dhe Aftësimi Profesional

Harmonizimi i arsimit dhe aftësimit profesional me kërkesat e tregut të punës në vend dhe më gjerë dhe krijimi i një sistemi të hapur të arsimit për të rriturit

## Rezultatet:

- Të gjitha profilet profesionale që ofrohen në shkollat e AAP janë të harmonizuara me nevojat e tregut të punës
- Është rritur për 30% numri i nxënësve në drejtimet deficitare dhe numri i femrave në drejtimet teknike
- Janë zhvilluar materialet mësimore të së paku dy lëndëve të ngushta profesionale për të gjitha profilet prioritare
- Kurrikulat e AAP dhe arsimit për të rriturit janë të harmonizuara me Kornizën e Kurrikulës për arsim parauniversitar dhe me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve
- Të gjithë nxënësit e shkollave profesionale realizojnë mësimin praktik në shkollë, dhe një praktikë profesionale jashtë shkollës në përputhje me programin mësimor
- Këshillimi dhe orientimi në karrierë është funksional në sistemin e shkollimit për nxënësit dhe të rriturit
- Institucionet e AP dhe ofruesit e arsimit të të rriturve kanë autonomi të plotë financiare dhe menaxhuese
- Ekzistojnë kapacitete njerëzore dhe infrastrukturore për menaxhimin e arsimit për të rriturit
- Është rritur oferta e shkollimit në nivelin 5 të kualifikimeve

## 6.6 Arsimi Profesional


Arsimi profesional është në proces të rishikimit të profileve pas miratimit të kurrikulës bërthamë. Rishikimi i profileve ka filluar në vitin 2019 me qëllim të inkorporimit të qasjes modulare, sistematizimit të praktikës profesionale dhe riorientimit të tyre drejt kërkesave bashkëkohore në treg. Rishikimi i të gjitha profileve është vështirësuar në mungesë të të gjitha standardeve profesionale dhe procesit të ngadalshëm të akreditimit. Megjithë numrin e madh të ndërmarrjeve të angazhuara për ofrimin e praktikës profesionale, numri i praktikantëve të angazhuar ende mbetet shumë i vogël. Vendosja e bashkëpunimit mes shkollave dhe ndërmarrjeve ka qenë ndër sfidat kryesore. Ndërtimi i kapaciteteve të stafit të shkollave për të siguruar cilësinë që kërkohet nga tregu i punës dhe sigurimin e bashkëpunimit mes shkollave dhe ndërmarrjeve si: sigurimi i instruktorëve të cilët merren me praktikat e angazhuar në ndërmarrje, rishikimin e standardeve ekzistuese të profesionit dhe vendosja e standardeve që mungojnë, janë çështje të cilave duhet kushtuar vëmendje.

Progresi në aktivitete dhe rezultatet e synuara 2019 shprehur sipas shkallës së zbatimit 1-5 dhe %

Rez	Përshkrimi	%	Niveli
1	Të gjitha profilet profesionale që ofrohen në shkollat e AAP janë të harmonizuara me nevojat e tregut të punës	47%	2.8
2	Është rritur për 30% numri i nxënësve në drejtimet deficitare dhe numri i femrave në drejtimet teknike	52%	3.1
3	Janë zhvilluar materialet mësimore të së paku dy lëndëve të ngushta profesionale për të gjitha profilet prioritare	47%	2.8
4	Kurrikulat e AAP dhe arsimit për të rriturit janë të harmonizuara me Kornizën e Kurrikulës për arsim parauniversitar dhe KKK	58%	3.5
5	Të gjithë nxënësit e shkollave profesionale realizojnë mësimin praktik në shkollë, dhe një praktikë profesionale jashtë shkollës në përputhje me programin mësimor	72%	4.3
6	Këshillimi dhe orientimi në karrierë është funksional në sistemin e shkollimit për nxënësit dhe të rriturit	62%	3.7
7	Institucionet e AP dhe ofruesit e arsimit të të rriturve kanë autonomi të plotë financiare dhe menaxhuese	43%	2.6
8	Ekzistojnë kapacitete njerëzore dhe infrastrukturore për menaxhimin e arsimit për të rriturit	38%	2.3
9	Është rritur oferta e shkollimit në nivelin 5 të kualifikimeve	62%	3.7
<b>Total</b>		<b>53%</b>	<b>3</b>

**Rreth gjysma e nxënësve të arsimit të mesëm të lartë zgjedhin një nga 122 profilet e ofruara në kuadër të 68 shkollave profesionale dhe Qendrave të Kompetencës. Shkalla e orientimit të nxënësve drejt arsimit profesional është në ngritje që viti 2016.** Më shumë nxënës përzgjedhin profilet profesionale në arsimin e mesëm të lartë sesa arsimin e mesëm të lartë të përgjithshëm. Në vitin e fundit 52.4% e nxënësve janë orientuar në një nga profilet në kërkim sidomos në (1) inxhinieri, prodhim dhe ndërtimtari, (2) biznes, menaxhim dhe drejtësi, (3) mjekësi dhe mirëqenie dhe (4) teknologji e informimit dhe komunikimit. Nga analiza më e thellë e orientimit të nxënësve në bazë të profileve/fushave të studimit vërehet në tendencë në

rritje e orientimit në sferat e mjekësisë (infirmieri, farmaci), administrim biznesi inxhinieri dhe shkenca kompjuterike. Këto profesione kryesisht ndërlidhen me ekonominë e shërbimeve.



### 6.6.1 Harmonizimi i profileve me nevojat e tregut të punës


**Rezultati 6.1 Të gjitha profilet profesionale që ofrohen në shkollat e AAP janë të harmonizuara me nevojat e tregut të punës**

Në kuadër të rezultatit janë paraparë : përmirësimi i sistemit të informatave të tregut të punës për të analizuar dhe përmirësuar mekanizmat për identifikimin dhe parashikimin e nevojave për shkathtësi dhe planifikim në sistemin e AAP-së dhe ARr-së, rishikimi i profileve që ofrohen në shkollat e AAP-së dhe përshtatja me nevojat e tregut, zhvillimi i standardeve të profesioneve të ofruara, analiza e nevojave në nivel qendror dhe lokal për plotësimin e kushteve për ofrimin e profileve nga lista e rishikuar dhe ngritja e kapaciteteve të shkollave të AAP-së për përgatitjen e raportit të vetëvlerësimit dhe procedurave për akreditim.

*Arsimi profesional është në proces të rishikimit të profileve pas miratimit të kurrikulës bërthamë. Rishikimi i profileve ka filluar në vitin 2019 me qëllim të inkorporimit të qasjes modulare, sistematizimit të praktikës profesionale dhe riorientimit të tyre drejt kërkesave bashkëkohore në treg. Rishikimi i të gjitha profileve është vështirësuar në mungesë të të gjitha standardeve profesionale dhe procesit të ngadalshëm të akreditimit. Megjithë numrin e madh të ndërmarrjeve të angazhuara për ofrimin e praktikës profesionale, numri i praktikantëve të angazhuar ende mbetet shumë i vogël. Vendosija e bashkëpunimit mes shkollave dhe ndërmarrjeve ka qenë ndër sfidat kryesore. Ndërtimi i kapaciteteve të stafit të shkollave për të siguruar cilësinë që kërkohet nga tregu i punës dhe sigurimin e bashkëpunimit mes shkollave dhe ndërmarrjeve si: sigurimi i instruktorëve të cilët merren me praktikantët e angazhuar në ndërmarrje, rishikimin e standardeve ekzistuese të profesionit dhe vendosja e standardeve që mungojnë, janë çështje të cilave i duhet kushtuar vëmendje. Në anën tjetër, vlerësimi i jashtëm i shkollave nuk duket të jetë opsion i mundshëm dhe afatshkurtër. Ndër sfidat primare në sistemin arsimor mbetet pjesëmarrja e ulët në arsimin gjatë gjithë jetës, ndërtimi i një sistemi të qëndrueshëm për promovim të arsimit të të rriturve dhe sigurimi i financimit për këtë prioritet.*




### Orientimi i nxënësve sipas fushave ISCED F 2015-2019



Nga analiza më e thellë e orientimit të nxënësve në bazë të profileve/fushave të studimit vërehet në tendencë në rritje e orientimit në sferat e mjekësisë (infirmieri, farmaci), administrim biznesi dhe shkencë kompjuterike. Këto profesione kryesisht ndërlidhen me ekonominë e shërbimeve. Orientimi i përgjithshëm i nxënësve në bujqësi është tejet i ulët. Rritja e kapitalit njerëzor në industri dhe bujqësi është i domosdoshëm për të stimuluar rritjen e qëndrueshme ekonomike dhe krijimin e vendeve të reja të punës.


Shkollat e arsimit të mesëm të lartë profesionale potencialisht shërbejnë si mekanizma të rëndësishëm në procesin e rritjes së konkurrueshmërisë së ekonomive lokale dhe rajonale. Në rast se analizohet orientimi i nxënësve të arsimit të mesëm profesional në nivelin rajonal dhe komunal është e lehtë të dokumentohen shpërputhjet e ndjeshme ndërmjet sektorëve ekonomik rajonal dhe ofertës së shkollave profesionale.

### ORIENTIMI I NXËNËSVE TË AAP NË KOMUNA 2018-2019



Mungon praktika, mekanizmat dhe kapaciteti për analizim, ndërlidhje dhe parashikim të nevojave të tregut të punës - Nuk kemi sistem aktiv për ndërlidhjen e të dhënave të tregut të punës me arsimin në Kosovë dhe nuk ka ndonjë evidencë se ato janë shfrytëzuar në reformimin e profileve në arsimin profesional. Aktualisht ekzistojnë tri sisteme të të dhënave që mund të shfrytëzohen për të prodhuar të dhëna të përafërta: Sistemi i regjistrimit të të papunëve që mirëmbahet nga Ministria e Punës (LMIS), të dhënat në lidhje me fuqinë punëtore nga Agjencia e Statistikave (ASK) dhe studimet në lidhje me disponimin e ndërmarrjeve në raport me mjedisin biznesor e ku shkathhtësitë e fuqisë punëtore janë një nga dimensionet si BEEPS (2013) nga Banka Botërore. Kosova ka nevojë urgjente për një sistem për përpunimin e të dhënave që ndërlidh të dhënat e kategorive të shkollimit të ISCED dhe Eurostat me të dhënat e kategorive të punësimit (ISCO) dhe sektorëve ekonomik (NACE). Të dhënat statike sasiore mund të jenë të dobishme për të dhënë indikacion numerike në lidhje me kërkesën e tregut të punës, mirëpo ato duhet të kombinohen me të dhëna cilësore (BEEPS) dhe produktivitetin e fuqisë punëtore (OECD). Ndërlidhja sasiore me tregun e punës nuk nënkupton domosdoshmërisht që fuqia punëtore të ketë arritur shkallën e duhur të cilësisë.

### ORIENTIMI I NXËNËSVE NË ARSIM TË MESËM TË LARTË 2018-2019 SIPAS KOMUNAVE



Përderisa në kategoritë e caktuara kemi numër më të lartë të nxënësve se sa fuqia e absorbimit në treg të punës, ekzistojnë disa sektorë ku numri i nxënësve është më i vogël se sa trendi i krijimit të vendeve të punës. Kemi një shpërputhje të theksuar ndërmjet numrit të nxënësve në kategorinë e shërbimeve (9%) me numrin e vendeve të punës të krijuara në dekadën e fundit (27) %. Numri i studentëve në profilet që ndërlidhen me shërbimet si shërbimet personale (hoteleri, turizëm, floktar dhe estetikë), shërbimet e transportit, mbrojtje e natyrës dhe përkujdesje e kafshëve dhe shërbime të sigurimit të pronës dhe sigurimit fizik janë rreth 3 tre herë më e vogël se sa potenciali i tregut të punës. Kemi edhe një shpërputhje modeste në kategorinë inxhinieri, përpunim dhe ndërtim ku numri i studentëve të këtyre profileve është i lartë, por ende nën potencial të tregut të punës. Kjo jap indikacione se arsimit profesional duhet të përkujdeset për një numër më të madh të studentëve në profilet ekzistuese apo të reja në përpunim ushqimor, makineri, përpunim druri, përpunim të metaleve, përpunim të gomës, pajisje elektrike, zdrukthtari, përpunim të plastikës, tekstil dhe përpunim të lëkurës.

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve nuk është përgjegjës për zhvillimin e standardeve të profesionit (SP) andaj, standardet e profesionit janë zhvilluar nga institucione dhe partnerë të ndryshëm si në vijim: Asociacioni Kosovar i Motorizmit, Shoqata Netrda, Bau Academy, Projekti ALLED, Oda Ekonomike e Kosovës, Këshilli i Konsulentëve të Biznesit (BCC), dhe shoqata të ndryshme, etj. Në vitin 2018, ka përfunduar procesi i verifikimit për këto standarde të profesionit:

Standardet e Profesionit të aprovuara nga AKK (2018)

No	Institucioni	S	Niveli
1	Sektori i komunikacionit	Instruktor i shoferëve	5
2	Sektori për prodhim dhe përpunim të ushqimit	Kultivues i perimeve/kultivuese e perimeve	2
3		Konservuesit e frutave, perimeve dhe të ngjashme	4
4		Punëtorët e të mbjellave	2
5	Sektori i turizmit	Agjent/agjente turistike dhe i informimit për udhëtimet	4
6	Sektori i arsimit	Punëtorët e prodhimit-Paketuesit me dorë	3
7	Sektori i bujqësisë	Vreshtar/vreshtarë	3
8	Sektori i shërbimeve	Rrobaqepësit/rrobaqepëset, kapelabërësit	3
9		Modelist prerës dhe punues të tekstit dhe të tjerë të ngjashëm	4
10	Sektori i transportit	Operuesit e kamionëve të ngritjes (niveli 3),	3
11		Operuesit e impianteve të lëvizjes së dheut dhe të ngjashëm	3
12		Shoferët e makinave, taksive dhe furgonave	4


Burimi: Numri i studentëve (MEST/AKK, 2019)

AKK ka akredituar 12 ofrues të Arsimit dhe Aftësisit Profesional me 45 kualifikime të ndryshme të vendosura në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve. AKK ka zhvilluar procesin e rishikimit të kushteve të 5 ofruesve të akredituar me kusht për 21 kualifikime. Në procesin e ri-akreditimit janë riakredituar tri (3) institucione si dhe janë zhvilluar katër ofrues të AAP me 10 kualifikime të ndryshme. Asnjë nga këto nuk janë shkolla publike të AAP.

### 6.6.2 Drejtimit deficitare dhe pjesëmarrja e femrës

#### Rezultati 6.2. Është rritur për 30% numri i nxënësve në drejtimit deficitare dhe numri i femrave në drejtimit teknike

Për të përmbushur rezultatin, Plani i Veprimit, parasheh organizimin e fushatave dhe prezentimeve të rregullta në shkollat e arsimit profesional nga industria për nxënësit e klasave 8 dhe 9, krijimi i një strukture stimuluese nga qeveria dhe bizneset për mbështetjen e shkollimit në drejtimit deficitare dhe për femrat në drejtimit teknike dhe realizimin e emisioneve televizive dhe shkrimeve me rrëfime të suksesshme të femrave në profesionet teknike.




Rezultati është jospecifik sa i përket llojit të profileve deficitare në Kosovë. Është e vështirë të matet shkalla e progresit në raport me gjendjen bazë përderisa nuk janë dokumentuar dhe specifikuar se cilat profile janë deficitare për Kosovën. Megjithatë, analiza gjinore e orientimit në arsim profesional dokumenton një tendencë të orientimit të femrës në profile si arte dhe humanistikë, shëndet dhe mirëqenie dhe shërbime. Meshkujt kanë tendencë të dominojnë profilet në inxhinieri, teknologji të informacionit dhe bujqësi.

Femrat në arsim profesional	2014/15	2015/16	2016/17	2017/18	2018/19
Biznesi, administrimi dhe drejtësia	6,181	6,146	6,346	6,609	5,762
Shëndeti dhe mirëqenia	4,212	4,400	4,822	5,161	5,495
Inxhinieri, prodhim dhe ndërtimtari	3,071	3,151	3,595	3,578	3,391
Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit	1,643	1,604	1,729	1,602	1,388
Arte dhe humanistike	517	677	832	1,024	1,023
Bujqësi, pylltari, peshkim dhe veterinar	434	549	404	656	536
Shërbime	340	320	363	362	321
<b>Total</b>	<b>16,398</b>	<b>16,847</b>	<b>18,091</b>	<b>18,992</b>	<b>17,916</b>

Burimi: MASHT 2014-2018

Është rritur shkalla e pjesëmarrjes së femrës në arsim profesional. Rreth 41 % për qind e nxënësve në arsim profesional ishin femra. Shkalla e pjesëmarrjes në vitin 2018 është rritur në krahasim me vitin e kaluar kur ishin evidentuar rreth 40 % për qind femra në arsimin profesional. Gjithashtu, në vitet e fundit është shënuar progres në rritjen e orientimit të femrës në profilet teknike në rreth 23 %. Gjatë vitit 2018 në profilet teknike kishte shkallë më të ulët krahasuar me vitin paraprak.

#### Tendenca e orientimit të femrës në arsim profesional dhe profile teknike 2015-2019 (MASHT 2019)



Arritja e cakut prej 40 % femra në profilet teknike deri në vitin 2021 duket të jetë sfidues. Megjithatë, orientimi i nxënësve drejt profileve deficitare duke përfshirë edhe inkuadrimitin e femrës do të mund të realizohej përmes incentivizimit dhe formulës së financimit.

## RAPORTI I NXËNËSVE TË REGJISTRUAR (FEMRA/MESHKUJ) NËPËR SHKOLLAT E AAAPARr-së

Shkollat e AAAPARr-së	2017/2018					2018/2019					Ndryshimi
	M	[%]	F	[%]	Gj	M	[%]	F	[%]	Gj	
Prizren	508	81%	121	19%	629	455	83%	94	17%	549	-13%
Prishtinë	253	71%	101	29%	354	261	74%	90	26%	351	-1%
QK-Ferizaj	34	24%	109	76%	143	47	32%	98	68%	145	1%
QK-Malishevë	263	66%	135	34%	398	238	71%	96	29%	334	-16%
QK-Skenderaj	195	83%	41	17%	236	165	79%	45	21%	210	-11%
QK-Prizren	94	65%	51	35%	145	64	66%	33	34%	97	-33%
Gjithsej	1347	71%	558	29%	1905	1230	73%	456	27%	1686	-11%
Ndryshimi në përqindje në raport me vitin paraprak						-9%		-18%		-11%	

Në gjashtë shkollat partnere të AAAPARr-së, numri i përgjithshëm i nxënësve të regjistruar në vitin shkollor 2018/2019 ka pësuar një rënie prej 11% në raport me vitin shkollor 2017/2018, ndërsa sa i përket raportit të nxënësve femra/meshkuj ndaj numrit të përgjithshëm të nxënësve të regjistruar, në vitin shkollor 2017/2018 nga të gjithë nxënësit e regjistruar, 29% prej tyre ishin femra, kurse në vitin shkollor 2018/2019 raporti i numrit të femrave ndaj numrit të përgjithshëm të nxënësve të regjistruar ka pësuar një rënie të lehtë në 27%. Nga të gjitha shkollat partnere të AAAPARr-së përveç rënies në numër të përgjithshëm të nxënësve të regjistruar në vitin shkollor 2018/2019 në raport me vitin shkollor 2017/2018 dhe rënies në përqindje të pjesëmarrjes së nxënësve femra për të gjitha shkollat, në QK-Ferizaj ka pasur rritje të lehtë prej 1% të nxënësve të regjistruar (ndërsa rënie të regjistrimit të femrave nga 76% në 68%), kurse në QK-Skenderaj kishte rritje të numrit të nxënësve të regjistruar prej 11% mirëpo ngritje të pjesëmarrjes në përqindje të regjistrimit të femrave (nga 17% në 21%).

### 6.6.3 Materiali mësimor

#### Rezultati 6.3. Janë zhvilluar materialet mësimore të së paku dy lëndëve të ngushta profesionale për të gjitha profilet prioritare

Në kuadër të rezultatit janë paraparë mbledhja e modeleve të mira të materialeve mësimore ekzistuese, ngritja e kapacitetit të mësimdhënësve për zhvillim të materialeve mësimore të cilat mbulojnë së paku 2 lëndë profesionale nga secili sektor ekonomik, zhvillimi i materialeve mësimore për së paku dy lëndë profesionale për sektor ekonomik, zhvillimi i materialeve mësimore nga fushat e përgjithshme dhe trajnimi i mësimdhënësve



për shfrytëzim të platformave elektronike. Gjatë vitit 2018, AAAPARr ka mbështetur zhvillimin e Udhëzuesve për metodat e mësimdhënies në shkollat e mesme profesionale, udhëzues për trajnime pedagogjike të mësimdhënëseë, udhëzues për zhvillimin e ndërmarrësisë, udhëzues për instalues të ngrohjes, udhëzues për dizajn mode, udhëzues për analizë të shkollave profesionale për hartimin e planeve zhvillimore të shkollave, udhëzues për shkollat e mesme të larta profesionale, udhëzues për AutoCard 2015 2D dhe udhëzues për konstruksione.

## 6.6.4 Kurrikula e Arsimit Profesional

**Rezultati 6.4. Kurrikulat e AAP dhe arsimit për të rriturit janë të harmonizuara me Kornizën e Kurrikulës për arsim parauniversitar dhe me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve**

Rezultati parashih një seri të aktiviteteve duke përfshirë zhvillimin e kurrikulës bërthamë për arsimin profesional, trajnimin e zhvilluesve të kurrikulit për kurrikula modulare, zhvillimin e testeve të provimit përfundimtar të profesioneve të caktuara të ofruara në arsim profesional dhe rishikimin e udhëzimit administrative për provimin përfundimtar të profesionit.

Gjatë diskutimeve fillestare në lidhje me arsimin profesional ishte konkluduar që zhvillimi i kurrikulave kishte qenë pjesërisht i shkëputur nga zhvillimet ekonomike dhe përmblende trajtat të vazhdimësisë së funksionimit të kushtëzuar nga zhvillimet e dekadave të kaluara. Adresimi i këtij prioriteti nënkuptonte rishikimin e standardeve të profesionit dhe kurrikulave dhe rregullimi i tyre sipas trendeve bashkëkohore në arsimin profesional. Pas miratimit të kurrikulës bërthamë në arsimin profesional, në vitin 2018 janë themeluar grupet e koordinatorëve dhe ekspertëve për rishikim të kurrikulës bërthamë të profileve në të gjitha fushat e studimit. Profilet e arsimit profesional duhet të rishikohen në atë mënyrë që i inkorporon kompetencat e profesionit në kurrikulë mësimore, staf mësimdhënës dhe infrastrukturë. Profilet duhet të jenë të standardizuara sipas emërtimeve të Kornizës Kombëtare të Profesioneve dhe Kualifikimeve. Matja e ofertës dhe kërkesës duhet të duhej integruar disa metoda: Anketa e Fuqisë Punëtore të ASK mbi numrin e të punësuarve sipas profesioneve, LMIS i Ministrisë së Punës mbi dinamikën e vendeve të reja të punës dhe Eurostat mbi dinamikën e tregut evropian.

## 6.6.5 Praktika profesionale

**Rezultati 6.5. Të gjithë nxënësit e shkollave profesionale realizojnë mësimin praktik në shkollë, dhe një praktikë profesionale jashtë shkollës në përputhje me programin mësimor**

Plani i Veprimit parashih zbatimin e disa aktiviteteve për të përmbushur rezultatin e synuar për të inkuadruar të gjithë nxënësit në praktikë profesionale në shkollë dhe jashtë shkollës. Gjatë viteve 2017-2019, MASHT do të duhej zbatuar këto aktivitete: zhvillimin e instrumenteve për stimulimin e kompanive për pranimin e nxënësve në praktikë, zhvillimin e rregullores për mbrojtje të shëndetit të nxënësve gjatë praktikës, trajnimin e personelit të zyrave për bashkëpunim me ekonominë, pajisjen e punëtorive të 15 shkollave profesionale, nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me kompanitë dhe hartimin e akteve nënligjore që përcaktojnë kriteret për themelimin e parteritetit publiko-privat në fushën e arsimit profesional.

Nuk ka lidhje të strukturuar ndërmjet shkollave profesionale dhe bizneseve, duke krijuar një mungesë besimi dhe dyshime për cilësinë e ofertës së sistemit të AAP. MASHT në vitin 2013, ka lansuar strategjinë për

Praktikën Profesionale 2013-2020 dhe ka përgatitur dy udhëzues për ndërmarrjet dhe shkollat profesionale, me qëllim që të ofrojë mundësinë për bashkëpunim më të madh, por deri më tani nuk ka ndonjë marrëveshje ndërministrorë për ta lehtësuar këtë bashkëpunim dhe për zhvillimin e partneriteteve publiko-private në fushën e AAP. Gjithashtu, me këto dokumente, MASHT po mundohet që të rrisë bashkëpunimin me përfaqësuesit e partnerëve social, bizneseve dhe sektorit privat për dizajnimin e politikave, zhvillimin e standardeve të profesionit dhe zhvillimeve të kurrikulave dhe në tërësi në zhvillimin e reformave në fushën e AAP. Në këtë kontekst edhe numri i marrëveshjeve shkollë profesionale dhe ndërmarrje për praktikën profesionale të nxënësve ka shënuar rritje, por kjo gjë nuk është e mjaftueshme. Gjithashtu edhe shërbimet për këshillim në karrierë dhe përcjelljes së punësimit të posa diplomuarve mungojnë në shumicën e SHP dhe numri i nxënësve që kanë përfutuar nga këto shërbime është shumë i vogël.


Gjatë vitit 2018, janë mbajtur trajnime me 87 përfaqësues të bizneseve dhe 20 përfaqësues të shkollave për bashkëpunimin mes instruktorëve në kompani dhe instruktorëve në shkollë. Të gjithë këta të trajnuar do të jenë pjesë e hartimit të kurrikulave bërthamë dhe e pjesës praktike të kurrikulit. Ky proces mbështetet nga GIZ dhe është nën-komponentë në kuadër të projektit “Rinia dhe Punësimi”. Bazuar në pilotimin me 4 shkolla profesionale dhe në bashkëpunim të ngushtë me bizneset është hartuar drafti i parë i Udhëzimit administrativ për mësimin në vendin e punës/sistemin dual. Po ashtu, në bashkëpunim me donatorët janë vizituar 25 shkolla me drejtime të shëndetësisë, teknike dhe ekonomike si shkolla potenciale për intervenim dhe përkrahje. Përgjithësisht, praktika profesionale zbatohet në shkolla (40 %) dhe në kompani (60%).

### 6.6.6 Këshillimi dhe orientimi në karrierë

#### Rezultati 6.6 Trajnimi i mësimdhënësve të AAP për zhvillimin e kurrikulave të këshillimit dhe orientimit në karrierë për të rinjtë dhe të rriturit

Në kuadër të rezultatit janë paraparë trajnime të mësimdhënësve për zhvillim të kurrikulave të këshillimit dhe orientimit në karrierë, zhvillimi i standardit dhe kualifikimit të profesionit të këshilltarit të karrierës, zhvillimi i kurrikulit për edukim dhe këshillim në karrierë, zhvillimi i programit trajnues për mësimdhënësit e këshillimit në karrierë, caktimi i këshilltarëve të karrierës në shkolla dhe zhvillimi i mekanizmave për përcjelljen e të diplomuarve në shkollat e arsimit profesional.

#### Kush është përgjegjës për orientim në karrierë në shkolla të AAP? (OECD, 2019)



Në bazë të analizës së Anketës me Nxënës të OECD (2019), rezulton që shkollat e arsimit dhe aftësimit profesional kryesisht nuk kanë këshilltar për orientim në karrierë (4.7%). Në shumicën e shkollave duket sikur kjo përgjegjësi ushtrohet nga të gjithë mësimitdhënësit (63.4%) ose i është caktuar një mësimitdhënësi specifik (20.9%) në raste më të rralla. Një pjesë e vogël e nxënësve kanë raportuar se ata kishin qasje të vazhdueshme në këshilltar karriere që vinin nga jashtë shkollës (4.1%).

Të diplomuarit në arsim profesional arrijnë shkallë më të lartë të punësimit krahasuar me nxënësit e orientuar në profile të përgjithshme. Megjithatë, orientimi në karrierë mbetet sfidë dhe shërbimet e ofruara janë ende të kufizuara në disa komuna. MASHT ka adresuar prioritetin duke promovuar integrimin e dimensionit të orientimit në karrierë në kuadër të kurrikulës, ka themeluar platforma të orientimit në karrierë dhe ka miratuar standardet e profesionit për këshillim në karrierë. Me mbështetje të LuxDev ka ndërtuar platformën elektronike Busulla.com. Përmes platformës nxënësit mund të informohen rreth mundësisë së shkollimit dhe punësimit në Kosovë, testet IVAP (interesat, vlerat, aftësitë, preferencat), profesionet dhe materialet promociionale, kërkesat e profesioneve, validim të shkathtësive dhe këshillim virtual. Në përgjithësi, platforma synon të përmirësoj vendimmarrjen e nxënësve në përcaktim të karrierës dhe profesional. Gjithashtu, MASHT ka vazhduar mbështetjen për mësimitdhënësit të TIK për përdorim të platformës. Në kuadër të platformës janë përgatitur 8 module të trajnimit për këshillim dhe orientim në karrierë, është zhvilluar softueri për analizën e tregut të punës në nivel kombëtar dhe lokal, janë publikuar shpalljet për rreth 1200 vende të punës dhe praktikës profesionale. Platforma ka arritur rreth 28,000 përdorues në nivel vendi.

Edukimi mbi karrierën është pjesë thelbësore e kurrikulës së re bërthamë. MASHT është mbështetur nga ETF në hartimin e instrumenteve për të marrë informata kthyese nga të diplomuarit e arsimit profesional. Ky mekanizëm ka për qëllim të mbledhë të dhëna mbi gjendjen e të diplomuarve, destinacionit, punësimin dhe informata kthyese mbi reformat potenciale në profilet e studimit. Gjithashtu, janë trajnuar mësimitdhënësit e klasave 6-9 për të ndihmuar nxënësit në orientim profesional në kuadër të shkollave zbatuese të kurrikulës së re. Vazhdon të zbatohet programi Micro Space (kënde për ndërmarrësi dhe karrierë) në gjimnazin “Xhevdet Doda” në Prishtinë dhe në gjimnazin “Hajdar Dushi” në Gjakovë në sajë të mbështetjes nga USAID ASSET. Në përkrahje të Institutit PEARSON, ka filluar programi për shkollim në nivelin e 5-të të kualifikimit për këshilltar të karrierës. Ka vazhduar promovimi i qendrave të karrierës përmes konferencave dhe takimeve në komuna. Ka filluar përpilimi e një memorandumit të bashkëpunimit mes MASHT, MPMS si dhe Ministrisë së Rinisë për krijimin e forumit kombëtar për bashkëpunim në procesin e këshillimit në karrierë.

MASHT me mbështetje të GIZ ka implementuar projektin ‘Opportunity Scouting’ për hulumtim të mundësive për punësi

m në komunën e Ferizaj. GIZ dhe USAID ASSET kanë inicuar mbështetjen për themelimin e Klubeve të Karrierës. Këto klube synojnë të krijojnë aktivitete të vazhdueshme për orientim në karrierë dhe promovim të ndërmarrësisë. Projekti EYE dhe Solidar Suisse ka mbështetur themelimin e katër 4 qendrave të orientimit në karrierë në Kaçanik, Gjakovë, Ferizaj dhe Pejë. Këto qendra në shkolla të AAP-së do pilotojnë konceptin e ‘të mësuarit në vendin e punës’ dhe do të kenë rolin kryesor në lehtësimin dhe promovimin e konceptit në komunitetin e biznesit. USAID ASSET është duke mbështetur zhvillimin e kompetencave për jetë, edukimin për ndërmarrësi dhe themelimin e ndërmarrjeve të nxënësve në komunat Prishtinë, Gjakovë, Han i Elezit, Viti, Gjilan, Fushë Kosovë, Kamenicë, Vushtrri dhe Ferizaj. Është në proces themelimi i tri qendrave të karrierës në tri shkollat partnere të AAAPARr-së.

## 6.6.7 Autonomia financiare dhe menaxhuese


### Rezultati 6.7. Institucionet e AP dhe ofruesit e arsimit të të rriturve kanë autonomi të plotë financiare dhe menaxhuese

Në kuadër të rezultatit janë paraparë këto aktivitete: rishikimi i formulës së financimit të institucioneve të arsimit profesional, rishikimi i rregullores për gjenerimin dhe shfrytëzimin e të hyrave vetjake në shkollë, trajnimi i stafit për hartim të projekteve që gjenerojnë të hyra, rishikimi i programeve të institucioneve të AAP që ofrojnë arsimim për të rritur dhe rritja e pjesëmarrjes së nxënësve nga komunat tjera në Qendrat e Kompetencës.

MASHT ka miratuar Udhëzimin administrativ (UA 01/2014) për organizimin dhe planifikimin e arsimit dhe aftësisimit profesional në institucionet publike dhe Udhëzimin administrativ (UA 07/2014) për rregullimin e veprimtarisë ekonomike të institucioneve të arsimit dhe aftësisimit profesional. Kjo paraqet një hap tutje në rregullimin e kushteve dhe kriterëve për veprimtarinë ekonomike për institucionet e arsimit profesional. Udhëzimi u mundëson institucioneve që të zgjerojnë veprimtarinë shërbyese dhe prodhuese, të menaxhojnë mjetet vetjake, të angazhojnë ekspertë të jashtëm në procesin mësimor dhe për të rregulluar angazhimin e stafit në aktivitete prodhuese dhe shërbyese. Ndërsa, sa i përket çështjes së financimit publik të institucioneve të arsimit dhe aftësisimit profesional janë shqyrtuar mundësitë për (i) krijimin e një nënsektori buxhetor në nivel qendror dhe nivel komunal dhe MASHT po shqyrton mundësinë e ndryshimit të formulës së financimit sipas sektorëve /profileve përkatëse. Vështirësitë në këtë kuadër konsistojnë në krijimin e shkallëve dhe profileve të ndryshme të financimit varësisht nga nevojat e veçanta infrastrukturore për arsim profesional.

Formula aktuale e financimit është e përgjithësuar sipas orientimit për kokë nxënësi dhe pa ndonjë diferencim të shpenzimeve sipas kërkesave specifike të profileve. Sa i përket financimit të Qendrave të Arsimit dhe Formimit Profesional, me mbështetjen e Bankës Botërore dhe GIZ, është bërë analiza e kostos për disa profile (shëndetësia, ekonomia dhe disa profile teknike), të cilat do të plotësojnë formulën e financimit që do të zhvillohet në Planin Strategjik të Arsimit 2017-2021. Një analizë e shpenzimeve totale për dy vitet e fundit është kryer për ta krahasuar atë me shpenzimet aktuale. Në korrik, të gjitha të dhënat e shpenzimeve në shkollat profesionale janë mbledhur nga thesari dhe janë duke u analizuar. Formulimi i financimit për arsimin parauniversitar po analizohet dhe parashikon rishikimin e formulës për shkollat e arsimit profesional si pjesë e arsimit parauniversitar. Për këtë qëllim, është ngritur një grup pune me përfaqësuesit e Ministrisë së Financave.

Shpenzimet në AAP shprehur në milion Euro 2015-2019



Përkundër zhvillimeve pozitive për autonomi financiare dhe ngritjes së kapaciteteve të menaxherëve të shkollave për menaxhim, është i nevojshëm decentralizimi i mëtejshëm dhe autonomia në lidhje me buxhetin e shkollave të AAP për planifikim, drejtim dhe menaxhim nga komunat në nivel të shkollave, për të lidhur prioritetet e shkollave dhe alokimin e buxhetit. Kjo do të duhej të mbështetej duke zhvilluar kapacitetin e drejtorit për të menaxhuar vetë buxhetin e shkollës. Është i nevojshëm zhvillimi i sistemeve më efektive dhe më fleksibile të buxhetit të shkollave të AAP për të përmbushur nevojat e ndryshme të profileve të AAP, pasi shpenzimet ndryshojnë në një shkallë të madhe. Duhet të thjeshtësohen procedurat administrative dhe burokratike për gjenerimin e të ardhurave vetanake, burimet financuese dhe nevojat e menaxhimit dhe institucionet e AAP duhet të inkurajohen dhe stimulohen në këtë drejtim. Kjo do të ketë një ndikim të madh në ofrimin e shkathtësive që kërkohen nga tregu i punës. Politika qeveritare duhet të marrë parasysh themelimin e programeve formale post-sekondare të AAP brenda QK me programe fleksibile për të përmbushur nevojat e ndryshueshme dhe zhvillimin personal për të siguruar qëndrueshmëri financiare të tyre.

Me qëllim të rregullimit të autonomisë operacionale dhe financiare të institucioneve të arsimit profesional, MASHT ka miratuar Udhëzimin administrativ (UA 01/2014) për organizimin dhe planifikimin e arsimit dhe aftësimin profesional në institucionet publike dhe Udhëzimin administrativ (UA 07/2014) për rregullimin e veprimtarisë ekonomike të institucioneve të arsimit dhe aftësimin profesional. Kjo paraqet një hap tutje në rregullimin e kushteve dhe kriterëve për veprimtarinë ekonomike për institucionet e arsimit profesional. Udhëzimi u mundëson institucioneve që të zgjerojnë veprimtarinë shërbyese dhe prodhuese, të menaxhojnë mjetet vetanake, të angazhojnë ekspertë të jashtëm në procesin mësimor dhe për të rregulluar angazhimin e stafit në aktivitete prodhuese dhe shërbyese.

Ndërsa, sa i përket çështjes së financimit publik të institucioneve të arsimit dhe aftësimin profesional janë shqyrtuar mundësitë për (i) krijimin e një nënsektori buxhetor në nivel qendror dhe nivel komunal dhe MASHT po shqyrton mundësinë e ndryshimit të formulës së financimit sipas sektorëve /profileve përkatëse. Në saje të këtij aktiviteti legjislativ por edhe veprimeve tjera për trajnimin e udhëheqësve të shkollave dhe krijimit të kodeve të veçanta buxhetore, konsiderohet që është arritur cak i PSAK për avancim të autonomisë së 61 shkollave të arsimit profesional. Sidoqoftë, ende mbesin vështirësi teknike në kthimin e mjeteve vetanake nga buxheti arsimor komunal.

Modeli i financimit të institucioneve të arsimit profesional është propozuar nga MASHT, mirëpo ende nuk është në proces të zhvillimit. Vështirësitë në këtë kuadër konsistojnë në krijimin e shkallëve dhe profileve të ndryshme të financimit varësisht nga nevojat e veçanta infrastrukturore për arsim profesional. Finalizimi i këtij procesi ishte një nga caqet e nënprogramit për arsim profesional në kuadër të PSAK në vitin 2019, mirëpo për shkak të nevojës për diskutime dhe elaborime shtesë ky aktivitet prioritar pritet të trajtohet gjatë vitit në vazhdim. Sektori i arsimit profesional ka përfituar një përqindje të lartë të financimit nga partnerët zhvillimor që nga miratimi i PSAK, mirëpo vitin e fundit janë vërejtur rënie të kontributeve. Andaj, si për të avancuar autonominë operacionale dhe financiare por edhe për të krijuar plane për të kompensuar zvoglimin e asistencës së jashtme, duhet të trajtohet dhe zgjedhet çështja e formulës së financimit të arsimit profesional. Po ashtu, duhet bërë një plan veprimi për të zgjeruar mundësinë e bashkëfinancimit nga punëmarrësit.

Financimi i arsimit profesional në Kosovë në kuadër të buxhetit të përgjithshëm për arsim, nuk ka shënuar ndonjë rritje të ndjeshme në vitet e fundit. Rritja e shpenzimeve në arsim profesional i është përkushtuar pothuajse në tërësi shpenzimeve në rroga të mësimdhënësve dhe për të financuar rritjen e pagave në sektor. Investimet qeveritare në kategori tjera të shpenzimeve të arsimit profesional si në investime kapitale, mallra dhe shërbime dhe shpenzime tjera rrjedhëse ka rënë gradualisht. Investimet kapitale nga buxheti qeveritar në nënsektor ishin të parëndësishme. Kufizimet buxhetore kanë ndikuar në mospërmbushje të aktivitetit të paraparë për promovim të regjistrimeve të nxënësve nga komunat tjera në Qendra të Kompetencës. MASHT nuk ka arritur të krijoj një skemë të financimit të mobilitetit të brendshëm të nxënësve të arsimit profesional.

Në anën tjetër, oferta arsimore në kuadër të Qendrave është e përafërt me shkollat profesionale komunale dhe mund të ketë ndikuar në mungesë të interesimit për studentë përtej perimetrit komunal. Shkalla e financimit për arsimin profesional nuk ka pësuar ndonjë ndryshim të theksuar në 10 vitet e fundit. Ndryshimi i vetëm nënvizohet në vitin 2018 me shtim të buxhetit prej 1 milion euro në investime kapitale dhe pajisje. Arsimi profesional kërkon investime shtesë dhe urgjente në punëtori, hapësira mësimi, teknologji të informimit dhe komunikimit dhe tekste bashkëkohore.

Gjatë vitit 2018, janë ndërmarrë një seri e aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve financiare dhe menaxhuese në shkollat partnere të AAAPARr-së: trajnimi i stafit të shkollave partnere për menaxhimin e financave dhe qasje në SIMFK, planifikim të buxhetit sipas nevojave të profileve të shkollave, hartimin e planeve zhvillimore dhe granteve shkollore, rekrutimin e stafit të mësimdhënësve për pjesëmarrje në komisione dhe zhvillimin e materialeve mësimore nga mësimdhënësit e profileve përkatëse.

### 6.6.8 Kapaciteti për arsimim të të rriturve

#### Rezultati 6.8. Ekzistojnë kapacitete njerëzore dhe infrastrukurore për menaxhimin e arsimimit për të rriturit

Në kuadër të rezultatit është paraparë përpunimi dhe mirëmbajtja e të dhënave mbi arsimimin e të rriturve në SMIA, aftësimi i stafit të nivelit qendror dhe komunal për arsimim të të rriturve dhe mbështetja e personelit shkollor për zbatim të prioriteteve. Në bazë të të dhënave të MASHT, numri i vijuese të arsimit të të rriturve në arsimin publik, është rritur në krahasim me vitin paraprak. Mbledhja e të dhënave mbi arsimin e të rriturve dhe arsimin gjatë gjithë jetës ende mbetet një nga sfidat kryesore. Kapaciteti për të mbledhur dhe përpunuar zhvillimet në sektorin jo-publik është i kufizuar. AAAPARr, në bashkëpunim me ekspertët përkatës ka realizuar një hulumtim në shkollat e AAP-së në Kosovë për të vlerësuar kapacitetet e shkollave në infrastrukturë, personel mësimdhënës dhe materialet për zhvillimin e nivelit të pestë të kualifikimeve në Kosovë. Agjencia në bashkëpunim me DVV/International ka ofruar trajnim për 33 mësimdhënës për Curriculum Globale për 5 nivele (andragog). Në përgjithësi, ka infrastrukturë të mirë për ofrimin dhe menaxhimin e arsimit për të rritur sidomos në drejtimit teknike. Megjithatë, mungojnë standardet e profesionit dhe një kurrikulë e mirëfilltë për ofrimin e arsimit për të rritur.

### 6.6.9 Rritja e ofertës së arsimit postsekondar joterciar

#### Rezultati 6.9: Është rritur oferta e shkollimit në nivelin 5 të kualifikimeve

Plani i Veprimtimit parasheh realizimin e një studimi mbi nevojat për kualifikimet e nivelit postsekondar joterciar dhe zhvillim të 5 programeve të reja të kualifikimit të nivelit 5 në Qendrat e Kompetencës. Gjatë procesit të vlerësimit nuk është hasur në një studim që dokumenton nevojat e ekonomisë vendore për kualifikime të tilla. AAAPARr ka përfunduar një analizë për hulumtim për nivelin e pestë të kualifikimeve arsimore në shkollat e AAP-së. Gjithashtu, ka zhvilluar dy standarde të profesionit – automekanik dhe metalpunues. Sidoqoftë, dy programe të reja të nivelit 5 (Këshilltar i Karrierës dhe Asistent për Fëmijë me Nevoja të Veçanta) janë aprovuar dhe ofrohen në Qendrat e Kompetencës në Ferizaj dhe Prizren. AKA ka akredituar një numër të programeve të llojit të njëjtë në energji të ripërtërishme, teknik dentar dhe teknologjisë mjekësore. Nuk është

hasur në një regjistër të unisuar për të matur shkallën e tërësishme të progresit. Mungesa e strukturave dhe ekspertizës në fushën e arsimit për të rritur në Kosovë, e kombinuar me nevojën urgjente për të përmirësuar cilësinë e dispozitave ligjore, bëjnë të pamundur që zhvillimi i mësimi gjatë gjithë jetës në Kosovë, të jetë prioritet brenda një periudhe afatmesme.

AKK nuk është përgjegjësjës për hulumtim të nevojave për kualifikime të nivelit V. AKK nëpërmjet Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve zhvillon politikat në lidhje me përfshirjen e kualifikimeve në KKK, përkatësisht kualifikimet e nivelit V. Nevojat e tregut të punës dhe hulumtimet tjera që ndërlidhen me ofrimin e këtij niveli u takojnë zhvilluesve dhe ofruesve të këtyre kualifikimeve. AKK ka bërë validimin e disa kualifikimeve të ndryshme në nivelin V si dhe ka akredituar po ashtu ofrues të ndryshëm privat dhe publik për të dhënë këto kualifikime. Gjatë vitit 2018, AKK ka verifikuar gjithsej 11 standarde të profesionit: instruktor i shoferëve, kultivues i perimeve/ kultivuese e perimeve, konservuesit e frutave, perimeve dhe të ngjashme, vreshtar/ vreshtare, rrobaqepësit, rrobaqepëset, gëzofpunuesit dhe kapelabërësit, modelist, prerës dhe punues të tekstilit dhe të tjerë të ngjashëm, agjent/agjente turistike dhe i/e informimit për udhëtimet, asistent i nutricionizmit dhe sigurisë së ushqimit, ndërtimtari, punëtorët e të mbjellave, punëtorët e prodhimit – Paketuesit me dorë. Gjithashtu, janë hartuar edhe një numër i standardeve të profesionit: dizajni i interierit- produktet drusore, zdrukthëtar, përpunues i drurit, teknik i inxhinierisë teknike (niveli 5), hidraulik dhe montues i tubave (niveli 4), mekanikë dhe montues elektrik (nivel 4) dhe instalues të nxehtësisë dhe montues të tubave.



## 6.6.10 Matrica e zbatimit të aktiviteteve 2019

No.	Rezultatet	Aktivitetet	Statusi	%
6.1	Të gjitha profilet profesionale që ofrohen në shkollat e AAP janë të harmonizuara me nevojat e tregut të punës	6.1.1 Përmirësimi i sistemit të informatave të tregut të punës për të analizuar dhe përmirësuar mekanizmat për identifikimin dhe parashikimin e nevojave për shkathtësi dhe planifikim në sistemin e AAP-së dhe ARr-së		3
		6.1.2 Rishikimi i profileve që ofrohen në shkollat e AAP-së dhe përshtatja me nevojat e tregut		3
		6.1.3 Zhvillimi i standardeve të profesioneve të ofruara		3
		6.1.4 Analiza e nevojave në nivel qendror dhe lokal për plotësimin e kushteve për ofrimin e profileve nga lista e rishikuar		3
		6.1.5 Ngritja e kapaciteteve të shkollave të AAP-së për përgatitjen e raportit të vetëvlerësimit dhe procedurave për akreditim		2
6.2	Është rritur për 30% numri i nxënësve në drejtimet deficitare dhe numri i femrave në drejtimet teknike	6.2.1 Organizimi i fushatave vetëdijesuese dhe prezantimeve të rregullta në shkollat e AAP-së nga industria, për nxënësit e klasave 8 dhe 9		4
		6.2.2 Krijimi i një strukture stimuluese (fondi të përbashkët) nga qeveria dhe bizneset, për mbështetjen e shkollimit në drejtimet deficitare dhe për femrat në drejtimet teknike		3
		6.2.3 Realizimi i emisioneve televizive, dhe shkrimeve me rrëfimeve të suksesshme të femrave në profesionet teknike		4
6.3	Janë zhvilluar materialet mësimore të së paku dy lëndëve të ngushta profesionale për të gjitha profilet prioritare	6.3.1 Mbledhja e modeleve të mira të materialeve mësimore ekzistuese të përgatitura nga mësimdhënësit e profileve të ndryshme		3
		6.3.2 Trajnimi i mësimdhënësve për shfrytëzimin e platformave elektronike		2
		6.3.3 Ngritja e kapacitetit të mësimdhënësve për zhvillim të materialeve mësimore të cilat mbulojnë së paku dy lëndë profesionale nga secili sektor ekonomik		4
		6.3.4 Zhvillimi i materialeve mësimore për së paku dy lëndë profesionale të përzgjedhura nga secili sektor ekonomik që ofrohet në shkollat e AAP		4
		6.3.5 Ngritja e kapacitetit të mësimdhënësve të lëndëve të përgjithshme në AAP për zhvillimin e materialeve mësimore të aplikuara në profesion		3
		6.3.6 Zhvillimi i materialeve mësimore nga fushat/lëndët mësimore e përgjithshme të aplikuara në profesion		3
6.4	Kurrikulat e AAP dhe arsimit për të rriturit janë të harmonizuara me Kornizën e Kurrikulës për arsim parauniversitar dhe me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve	6.4.1 Trajnimi i zhvilluesve të kurrikulit në AAP për kurrikula modulare		4
		6.4.2 Zhvillimi i Kurrikulës Bërthamë për AAP		4
		6.4.3 Zhvillimi i testeve të provimit përfundimtar të profesioneve të ofruara në AAP		3
		6.4.4 Rishikimi i udhëzimit administrativ për provimin përfundimtar të profesionit		3



No.	Rezultatet	Aktivitetet	Statusi	%
6.5	Të gjithë nxënësit e shkollave profesionale realizojnë mësimin praktik në shkollë, dhe një praktikë profesionale jashtë shkollës në përputhje me programin mësimor	6.5.1 Zhvillimi i instrumenteve për stimulimin e kompanive për pranimin e nxënësve në praktikë		3
		6.5.2 Zhvillimi i rregullores për mbrojtjen e shëndetit të nxënësve gjatë praktikës		4
		6.5.3 Trajnimi i personelit të zyrave për bashkëpunim me ekonominë		3
		6.5.4 Pajisja e punëtorive të 15 shkollave profesionale		4
		6.5.5 Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me kompanitë për praktikën e nxënësve dhe zbatimi i tyre		4
		6.5.6 Hartimi i akteve nënligjore që përcaktojnë kriteret për themelimin e partneritetit publiko-privat (PPP) në fushën e arsimit		3
6.6	Trajnimi i mësimdhënësve të AAP për zhvillimin e kurrikulave të këshillimit dhe orientimit në karrierë për të rinjtë dhe të rriturit	6.6.1 Trajnimi i mësimdhënësve të AAP për zhvillimin e kurrikulave të këshillimit dhe orientimit në karrierë për të rinjtë dhe të rriturit		4
		6.6.2 Zhvillimi i standardit dhe kualifikimit të profesionit të këshilltarit të karrierës		5
		6.6.3 Zhvillimi i kurrikulit për edukim dhe këshillim në karrierë për shkollat profesionale		5
		6.6.4 Zhvillimi i programit trajnues për mësimdhënësit e këshillimit dhe orientimit në karrierë		4
		6.6.5 Trajnimi dhe certifikimi i mësimdhënësve të këshillimit dhe orientim në karrierë për të rinjtë dhe të rriturit		4
		6.6.6 Caktimi i këshilltarëve të karrierës në shkolla		2
		6.6.7 Zhvillimi i mekanizmave për përcjelljen e të diplomuarve në shkollat e AAP		2
6.7	Institucionet e AP dhe ofruesit e arsimit të të rriturve kanë autonomi të plotë financiare dhe menaxhuese.	6.7.1 Rishikimi i rregullores për gjenerimin dhe shfrytëzimin e të hyrave vetanake në shkollë		3
		6.7.2 Trajnimi i stafit të institucioneve të AP për hartim të projekteve që gjenerojnë të hyra		2
		6.7.3 Rishikimi i programeve të institucioneve të AAP që ofrojnë arsimit për të rritur		3
		6.7.4 Rritja e pjesëmarrjes së nxënësve nga komunat tjera në Qendrat e Kompetencës		3
		6.7.5 Rishikimi i formulës së financimit të institucioneve të AAP-së		2
6.8	Ekzistojnë kapacitete njerëzore dhe infrastrukturore për menaxhimin e arsimit për të rriturit	6.8.1 Përpunimi dhe mirëmbajtja e të dhënave mbi arsimimin e të rriturve në SMIA		2
		6.8.2 Ofrimi i mundësive të aftësisë për stafin menaxhues në nivelin qendror, lokal dhe shkollor		3
		6.8.3 Trajnimi i personelit shkollor për zbatim të Arr		2
6.9	Rritet mobiliteti i stafit akademik dhe studentëve të IAL	6.9.1 Identifikimi i nevojave për kualifikime të nivelit 5		3
		6.9.2 Zhvillimi i programeve të reja për arritjen e kualifikimeve në nivelin 5 post-sekondar sipas KKK-së		4
		6.9.3 Ofrimi i programeve të reja të nivelit 5 post-sekondar në IAAP, veçanërisht në Qendrat e Kompetencës		4

## 6.6.11 Treguesit e performancës

### TREGUESIT KRYESOR TË ARSIMIT PROFESIONAL 2015-2019

	2015	2016	2017	2018	2019
<b>Numri i nxënësve në arsim profesional</b>					
Numri i nxënësve në arsim profesional	42,973	46,090	46,766	43,803	40,085
Shkalla e orientimit në AAP në arsim të mesëm	49.80%	51.60%	52.10%	52.00%	52.4%
Shkalla e studentëve femra në AAP	38.6	39.3	40.2	40.9	-
Shkalla e studentëve femra në Profile Teknike	22.9	23.4	23.5	23.3	-
Vijues në arsim dhe aftësim të të rriturve	-	1962	1794	2270	-
Shkalla e përfshirjes në arsim aftësim të të rriturve	4.9	4.4	3.9	-	-
<b>Orientimi i nxënësve të arsimit profesional sipas fushave të studimit ISCED F</b>					
Arte		2.92	3.12	3.3	4.21
Administrim Biznesi dhe Juridik		32.6	31.54	30.42	28.67
Inxhinieri, Prodhim dhe Ndërtimtari	-	31.82	31.85	31.95	29.91
Shëndetësi	-	14.55	15.3	15.62	18.05
Bujqësi dhe Veterinë	-	3.46	4	3.92	6.1
TIK		7.96	7.48	7.81	8.28
Shëbime	-	6.69	6.71	6.98	4.78
<b>Standardet e profesionit</b>					
Numri standardeve të aprovuara	-	-	8	11	-
Numri profileve të rishikuara	-	-	21	24	-
	-	-	-		

## TREGUESIT KRYESOR TË ARSIMIT PROFESIONAL 2015-2019

	2015	2016	2017	2018	2019
<b>Shpenzimet në arsim profesional</b>					
Shpenzimet në AAP në milion €	25,241	25,833	25,692	27,375	28,584
Shpenzimet në AAP si % e shpz.në arsim	9.60%	9.60%	9.60%	9.60%	9.40%
Shpenzimet në AAP si % e shpz.qeveritare	1.56	1.5	1.4	-	-
Rrogat e personelit si % e shpz.në AAP	95.4	95.2	95.7	-	-
Shpenzimet kapitale si % shpz.në AAP	0.00%	0.00%	0.30%	-	-
Shpenzimet për kokë nxënësi në AAP	587.4	560.5	557.4	625	713.1

Burimi: MASHT/SMIA (2018)

## 6.6.12 Rekomandimet

- ***Të shtohen përpjekjet për inkurajim të pjesëmarrjes së nxënësve në profesionet që ndërlidhen me bujqësinë, shërbimet, përpunimin dhe prodhimin industrial*** - Ekziston një baraspeshë e orientimit të nxënësve të shkollimit të mesëm të lartë në arsim profesional dhe gjimnaze të përgjithshme. Nga analiza më e thellë e orientimit të nxënësve në bazë të profileve/fushave të studimit vërehet një tendencë në rritje e orientimit në sferat e mjekësisë (infirmieri, teknologji mjekësore, farmaci), administrim biznesi dhe shkenca kompjuterike. Këto profesione kryesisht ndërlidhen me ekonominë e shërbimeve. Orientimi i përgjithshëm i nxënësve në prodhim/përpunim dhe bujqësi është tejet i ulët. Rritja e kapitalit njerëzor në industri dhe bujqësi është i domosdoshëm për të stimuluar rritjen e qëndrueshme ekonomike dhe krijimin e vendeve të reja të punës.
- ***Të avancohet mekanizmi dhe procedura për ndërlidhje të ofertës arsimore me kërkesën e tregut të punës*** - Analiza e kërkesës dhe ofertës në arsimin profesional është në fazën e hershme të zhvillimit. Këto vështirësi në ndërlidhje sistematike të vendeve të studimit me kërkesën në treg mund të burojnë nga mungesa e familjarizimit dhe komunikimit ndërministror. Kosova fillimisht duhet të përcaktoj fushat prioritare të zhvillimit ekonomik. Të njëjtat duhet të komunikohen dhe barten në Këshillin Ndërmministror për implementim. Implementimi nuk mund të kufizohet vetëm në listimin e qëllimeve të mira. Kërkohej prioritizim i ndërlidhjes në formë të financimit dhe kapacitetit të shtuar administrativ dhe njerëzor.
- ***Të ndërlidhen profilet me Kornizën Kombëtare të Profesioneve*** - Profilet e arsimit profesional duhet të rishikohen në atë mënyrë që i inkorporon kompetencat e profesionit në kurrikulë mësimore, staf mësimdhënës dhe infrastrukturë. Profilet duhet të jenë të standardizuara sipas emërtimeve të Kornizës Kombëtare të Profesioneve dhe Kualifikimeve. Matja e ofertës dhe kërkesës duhet të duhej integruar disa metoda: Anketa e Fuqisë Punëtore të ASK mbi numrin e të punësuarve sipas profesioneve, LMIS i Ministrisë së Punës mbi dinamikën e vendeve të reja të punës dhe Eurostat mbi dinamikën e tregut evropian.
- ***Të miratohet formula e financimit në arsim profesional e diferencuar sipas fushave dhe profileve*** - Orientimi i nxënësve drejt profileve deficitare duke përfshirë edhe inkuadrimitin e femrës do të mund të realizohej përmes incentivizimit dhe formulës së financimit. Rishikimi i formulës së financimit është ende në fazën e hershme. Formula e financimit duhet të jetë e strukturuar në atë mënyrë që inkurajon studimin në profile deficitare, inkurajon përfshirjen e grupeve të ndjeshme shoqërore, diferencon profilet sipas kërkesave, shpërblen performancën dhe ndërlidhjen e profileve me tregun e punës. Themelimi i një zyre për bashkëpunim me industrinë do të mund të lehtësonte procesin.
- ***Të zhvillohet kapaciteti për orientim të nxënësve në karrierë*** - MASHT ka shënuar disa hapa pozitiv në përmirësim të orientimit të nxënësve në karrierë. Duhet kushtuar vëmendje e posaçme ofrimit të kapacitetit njerëzor për orientim dhe këshillim, ofrimit të dritareve për praktikë profesionale, ofrimit të shërbimeve në të gjitha shkollat dhe mbledhjes së informacionit mbi destinacionin e të diplomuarve.
- ***Të rritet investimi kapital në arsim profesional*** - Shkalla e financimit për arsimin profesional nuk ka pësuar ndonjë ndryshim të theksuar në 10 vitet e fundit. Me përjashtim të shtimit të investimeve për rreth 1 milion euro në vitin 2018, ndryshimi i vetëm nënvizohet në rritje të shpenzimeve për kompensim të mësimdhënësve. Arsimi profesional kërkon investime shtesë dhe urgjente në punëtori, hapësira mësimi, teknologji të informimit dhe komunikimit dhe tekste bashkëkohore.



# Arsimi i lartë

Ngritja e cilësisë dhe konkurrueshmërisë së arsimit të lartë përmes nxitjes së përsosmërisë në mësimdhënie, kërkimit shkencor, krijimtarisë artistike, inovacionit dhe ndërkombëtarizimit.

## Rezultatet:

- Raporti Staf-Student në AL është të paktën 1:40
- Mekanizmat për zhvillim profesional të stafit akademik në IAL janë plotësisht funksional
- Mekanizmat për sigurimin e cilësisë në arsim të lartë janë plotësisht funksional
- Avancohet infrastruktura dhe teknologjia për mësimdhënie, punë kërkimore shkencore dhe artistike
- Deri në vitin 2019 Sistemi për menaxhimin e informatave në arsim të lartë (SMIAL) është plotësisht funksional
- Programet e studimit janë në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe shërbimet për orientim dhe këshillim në karrierë janë funksionale në IAL
- Numri i publikimeve shkencore në revista të indeksuara ndërkombëtare i stafit akademik rritet për 25% në çdo vit
- Deri në vitin 2018 është rishikuar dhe kompletuar infrastruktura ligjore për arsim të lartë
- Deri në vitin 2020 fillon zbatimi i formulës së financimit të arsimit të lartë në bazë të performances
- Rritet mobiliteti i stafit akademik dhe studentëve të IAL
- Rritet pjesëmarrja në programet ndërkombëtare për arsim të lartë dhe kërkime shkencore

## 6.7 Arsimi i Lartë dhe Shkenca


Rezultatet e synuara në kuadër të PSAK 2017-2021, ndërlihen me përmirësimin e raportit staf-mësimdhënës-student, funksionalizimin e praktikës së zhvillimit të stafit në arsim të lartë, funksionalizimin e hallkave të sigurimit të jashtëm dhe të brendshëm të cilësisë, përmirësim të infrastrukturës për mësimdhënie dhe kërkim shkencor, zhvillimin e sistemit për të dhëna dhe evidencë në arsimin e lartë, ndërlihdjen e programeve të studimit me tregun e punës, rritjen e aktivitetit kërkimor-shkencor, avancimin e legjislacionit dhe rregullimit administrativ, përmirësimin e praktikës së financimit të bazuar në performancë, rritjen e mobiliteteve të stafit mësimdhënës dhe studentëve dhe përmirësimin e pjesëmarrjes së institucioneve të arsimit të lartë në programet ndërkombëtare arsimore dhe kërkimit shkencor.

Progresi në rezultatet e synuara 2019 shprehur sipas shkallës së zbatimit 1-5 dhe %

Rez	Pershkrimi	%	Niveli
1	Raporti staf akademik-student në IAL është të pakten 1:40	50%	3
2	Mekanizmat për zhvillim profesional në IAL janë plotësisht funksional	42%	2.5
3	Mekanizmat për sigurim të cilësisë janë plotësisht funksional	33%	2
4	Avancohet infrastruktura për mësimdhënie dhe kërkim shkencor/artistic	45%	2.7
5	Deri në vitin 2019 SMIAL është plotësisht funksional	55%	3.3
6	Programet e studimit janë në përputhje me tregun/orientimi në karrierë	40%	2.4
7	Numri i publikimeve shkencore në revistat ndërkombëtoare për 25% cdo vit	38%	2.3
8	Deri në vitin 2018 është rishikuar dhe kompletuar legjislacioni i arsimit të lartë	40%	3.3
9	Deri në vitin 2020 fillon zbatimi i formulës së financimit në AL bazuar në performancë	40%	2.4
10	Rritet mobiliteti i stafit akademik dhe studentëve të institucioneve të AL	68%	4
11	Rritet pjesëmarrja në programet ndërkombëtare të AL dhe kërkimit shkencor	50%	3
<b>Total</b>		<b>45%</b>	<b>2.7</b>

Është rritur përfshirja në arsimin e lartë në vitet e fundit dhe shifrat aktuale e rendisin Kosovën në mesin e vendeve me më shumë studentë për 100.000 banorë. Si rezultat i zgjerimit të shpejtë të nënsektorit dhe ritmit të ngadalshëm të rritjes së shpenzimeve në arsim të lartë, është ulur shkalla e shpenzimeve për student. Rritja e shpejtë e numrit të studentëve, institucioneve dhe programeve të studimit, po ashtu ka krijuar sfida në sigurim dhe menaxhim të cilësisë. Agjencia e Kosovës për Akreditim është bërë anëtare e ENQA në vitin 2014, mirëpo

në vitin 2019, statusi i saj është rishqyrtuar me arsyetimin që pozicioni i saj institucional nuk siguron pavarësi të plotë nga ndërhyrjet politike. Kosova ka adoptuar Udhëzimet Standarde Evropiane (ESG) 2015 dhe kriteret për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë janë bërë më transparente.



### 6.7.1 Stafi dhe studentët në arsimin e lartë

#### Rezultati 7.1 Raporti Staf-Student në AL është të paktën 1:40

Rezultati i synuar në kuadër të planifikimit synon të adresoj gjendjen e rënduar të institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë për shkak të rritjes së numrit të studentëve. Në kuadër të rezultatit parashihet që raporti staf mësimmshënës-student të jetë të paktën 1:40 apo rreth 40 student për 1 mësimmshënës. Në kuadër të rezultatit të synuar nuk ofrohen detajet mbi metodologjinë e përlllogaritjes dhe nëse kjo përfshin stafin mësimmshënës të rregullt dhe të angazhuar me normë të pjesshme. Për të përlllogaritur progresin e arritur duhet adoptuar sqarimin metodologjik përmes të cilit përlllogaritet edhe stafi me gjysmë normë (0.5) dhe stafi me normë të plotë (1). Përmbledhja e stafit të plotë dhe atij me gjysmë normë duhet përpjesëtuar me numrin e tërësishëm të studentëve.

Në bazë të të dhënave të numrit të studentëve (ASK, 2019) dhe numrit të stafit akademik të raportuar në MASHT/SMIAL (2019), rezulton që proporcioni staf-student është larg caktit të synuar në pothuajse të gjitha institucionet publike. Treguesi duket të jetë i rënduar sidomos në Universitetin e Pejës “Haxhi Zeka” (1:191), në Universitetin e Gjilanit “Kadri Zeka” (1:74) dhe Universitetin e Prizrenit “Ukshin Hoti (1:73). Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (1:41) dhe Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” (1:46) janë afër caktit të PSAK (1:40). Universiteti i Mitrovicës dhe institucionet private kanë proporcione më të favorshme.



## Proporcioni staf akademik-student në IAL 2018/2019

No	Institucioni		Proporcioni
1	Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"	39,700	46
2	Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini"	2,888	30
3	Universiteti i Pejës "Haxhi Zeka"	12,977	191
4	Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani"	2,419	48
5	Universiteti i Gjilanit "Kadri Zeka"	2,988	74
6	Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti"	5,638	73
7	Akademia e Kosovës për Siguri Publike	230	28
8	Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj	1,356	41
9	Fakulteti i Studimeve Islame	328	41
10	Public IAL	68,524	55
11	Privvate IAL	35,989	18
12	Mesatare	-	32

Burimi: Numri i studentëve (ASK, 2019), numri i stafit akademik (MASHT/SMIAL, 2019)

Vështruar në bazë të fakulteteve dhe njërive akademike të universiteteve publike, proporcioni staf-student duket të jetë posaçërisht i rënduar në Fakultetin Ekonomik dhe Turizmit të Universitetit të Pejës "Haxhi Zeka", Fakultetin Ekonomik dhe Juridik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe Fakultetin Ekonomik, Edukimit dhe Juridik të Universitetit të Prishtinës "Ukshin Hoti".

## 6.7.2 Zhvillimi profesional në arsimin e lartë

### Rezultati 7.2 Mekanizmat për zhvillim profesional të stafit akademik në IAL janë plotësisht funksional

Plani i Veprimit të PSAK 2017-2021, liston disa aktivitete për të përmbushur rezultatin e synuar për funksionalizimin e mekanizmave për zhvillim profesional të stafit akademik në institucionet e arsimit të lartë. Aktivitetet kryesore ndërlidhen me themelimin dhe funksionalizimin e zyrave për përsosmëri të mësimdhënies, vlerësimi i nevojave të stafit akademik për zhvillim profesional, hartimin e planit për zhvillim profesional të stafit akademik dhe zhvillimi i mekanizmit për monitorim dhe vlerësim të punës së stafit akademik.


MASHT ka miratuar Udhëzimin administrativ për 01/2018, mbi Parimet e Njohjes së Platformave dhe Revistave Ndërkombëtare me Recension. Qëllimi kryesor i rregullativës ishte sistematizimi i parimeve të njohjes së revistave ndërkombëtare në të gjitha institucionet e arsimit të lartë, parandalimi i shkeljeve etike dhe sistematizimi

i procedurës së zhvillimit profesional dhe akademik. Nuk janë dokumentuar hapa të koordinuar për zbatim të aktiviteteve tjera si vlerësimi i nevojave për zhvillim profesional, hartimi i planeve për zhvillim profesional të stafit akademik dhe zhvillimi i mekanizmit për monitorim dhe vlerësim të punës së stafit akademik. Është evidente mungesa e stafit akademik të nivelit të doktoratës në pothuajse të gjitha institucionet e arsimit të lartë. AKA përmes Udhëzimit administrativ ka zbatuar praktikën e vlerësimit të institucioneve mbi bazën e posedimit të Planeve për Zhvillim të Stafit Akademik. Sidoqoftë, kërkohet një studim më i detajuar për të përcaktuar shkallën e zbatimit të zhvillimit profesional në arsim të lartë, nëse institucionet kanë plane të zbatueshme dhe nëse ekzistojnë vlerësime të nevojave për zhvillim. Gjithashtu, është e rëndësishme të kuptohet shkalla e zbatimit të praktikës së vlerësimit të stafit mësimdhënës mbi bazën e performancës në mësimdhënie dhe kërkim shkencor. Gjatë vitit 2018 dhe 2019 janë dokumentuar disa iniciativa për të mbështetur zhvillimin e kualifikimeve të stafit akademik. Projekti HERAS ka mbështetur mësimdhënës të institucioneve publike për studime të doktoratës dhe post-doktoratës. Departamenti i Shkencës së MASHT ka mbështetur 4 kandidatë për studime të doktoratës. MASHT në bashkëpunim me partnerë të tjerë bilateral ka mbështetur studentë për studime të doktoratës.

### 6.7.3 Sigurimi i Cilësisë në arsimin e lartë

#### Rezultati 7.3 Mekanizmat për sigurimin e cilësisë në arsim të lartë janë plotësisht funksional

Për të arritur rezultatin e synuar, Plani i Veprimit parashihet progres në zhvillimin dhe zgjerimin e kapaciteteve njerëzore dhe financiare për Agjencinë e Akreditimit të Kosovës (AKA) për zbatim të Udhëzimeve, Standarde Evropiane mbi cilësinë në arsimin e lartë, zhvillimin dhe zgjerimin e kapaciteteve njerëzore për Qendrën Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik (NARIC), mbështetja e institucioneve të arsimit të lartë për zbatim të standardeve të brendshme të sigurimit të cilësisë, plotësimi i akreditimit me një proces të rangimit sipas Kornizës Multidimensionale Evropiane dhe themelimi dhe funksionalizimi i Agjencisë për Standarde dhe Vlerësim për Profesionet e Rregulluara. Agjencia e Akreditimit të Kosovës, bën vlerësimin e jashtëm të institucioneve të arsimit të lartë në nivel institucional dhe të programeve të studimit. Deri në dhjetor të vitit 2019, janë gjithsej 293 programe të akredituara të studimit në institucionet publike dhe private të arsimit të lartë, të ofruara nga gjithsej 31 IAL (9 bartës publik dhe 22 bartës privat). Megjithatë, me zbatimin e plotë të Udhëzimit administrativ për akreditim (kërkesën për 1 PhD për çdo 60 ECTS, të fushës respektive për program të studimit) ka pasur një zbritje domethënëse të programeve të akredituara të studimit për shkak se disa institucione kanë dështuar që të plotësojnë këto kriterë. Në vitin 2019, kishte në tërësi 154 programe bachelor, 119 programe të nivelit master dhe 19 programe të doktoratës.



Regjistri Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (EQAR) në fillim të vitit 2018, ka përjashtuar AKA nga ky mekanizëm, ndërsa Rrjeti Evropian i Agjencive të Sigurimit të Cilësisë për Arsim të Lartë (ENQA) ka përjashtuar AKA-në në vitin 2019. AKA është në proces të rivlerësimit dhe institucioni ka themeluar një grup punues për hartimin e Raportit të Vetëvlerësimit, i cili është dorëzuar në ENQA në muajin nëntor 2018. AKA ka riaplikuar dhe i është nënshtruar vlerësimit të jashtëm gjatë vitit 2019, mirëpo nuk ka arritur të rikthehet si anëtare e plotë.

AKA ka hartuar dhe miratuar standardet e reja të saj bazuar në standardet dhe udhëzuesit evropian ESG 2015. AKA, po ashtu ka funksionalizuar platformën elektronike “E-Akreditimi”, përmes së cilës tashmë shumë nga proceset që lidhen me vlerësimin dhe akreditimin e IAL-ve, siç janë deklarimi i stafit akademik të angazhuar në IAL dhe aplikimi për akreditim, do të realizohet përmes mënyrës elektronike. Kjo platformë po ashtu do t’i mundësojë stafit akademik, studentëve, grupeve të interesit dhe opinionit publik, marrjen e informatave të sakta lidhur me procesin e akreditimit, duke rritur kështu maksimalisht transparencën dhe llogaridhënien e AKA-së. Në këtë kontekst është duke u realizuar po ashtu monitorimi i mbledhjeve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KSHC) përmes pjesëmarrjes në mbledhjet e KSHC-së, të përfaqësuesve të organizatave shoqërisë civile që merren me arsimin e lartë si dhe mediave.

Si aktivitet i fundit për arritje të rezultatit listohet nevoja për themelimin dhe funksionalizimin e Agjencisë për Profesionet të Rregulluara. Ekziston një konfuzion sa i përket emërimit të saktë të Agjencisë që administron çështjet që ndërlidhen me profesione të rregulluara. Në kuadër të PSAK 2017, gabimisht emërtohet si Agjencia për Standarde dhe Vlerësim për Profesionet të Rregulluara. Në kuadër të aktivitetit duhet të rishikohet emërtimi i trupit administrativ sipas Ligjit për Profesionet e Rregulluara (05/L-066). Emërtimi ligjor i trupit administrativ përgjegjës për administrimin e çështjeve që ndërlidhen me profesionet e rregulluara është Agjencia Shtetërore e Provimeve të Kosovës (ASHPA). Funksionalizimi i trupave të paraparë në kuadër të Ligjit për Profesionet e rregulluara dhe definimi i profesioneve të rregulluara është kriter për plotësim të Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociim me BE-në. Gjatë viteve 2017-2019, është themeluar dhe funksionalizur Divizioni për Profesionet të Rregulluara në kuadër të Departamentit për Arsim të Lartë. Gjithashtu, është themeluar Grupi Negociues ndërqeveritar për negociim të njohjes së kualifikimeve dhe profesioneve të rregulluara arkitekt, mjek i përgjithshëm, stomatolog dhe inxhinier në kuadër të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal në Ballkanin Perëndimor (RCC). Deri në dhjetor 2019 nuk është dakordim për liberalizim të këtyre profesioneve.

Në lidhje me Ligjin për Profesionet të Rregulluara, është miratuar Udhëzimi administrativ nr. 21/2018 për “Detyrat dhe Përgjegjësitë e Këshillit Shtetëror për Profesionet e Rregulluara”. Po ashtu, janë draftuar tri Udhëzime administrative për “Kriteret dhe procedurat për fitimin e të drejtës në ushtrimin e profesionit të rregulluar” UA-“Rregullat për funksionimin e Komisionit të Provimit Shtetëror, kompensimin e anëtarëve të saj, si dhe procedurat dhe mënyrën e zhvillimit të Provimit Shtetëror” si dhe UA- “Organizimi dhe funksionimi i organit profesional për zhvillimin e standardeve të profesionit”.

#### **6.7.4 Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsimin e Lartë**

**Rezultati 7.5. Deri në vitin 2019, sistemi për menaxhimin e informatave në arsim të lartë (SMIAL) është plotësisht funksional**

Për të përmbushur këtë rezultat janë paraparë disa aktivitete: zhvillimi i sistemit për menaxhim të informative në arsimin e lartë (SMIAL), hartimi i udhëzuesve dhe aftësimi i stafit për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave dhe zhvillimi i treguesve kombëtar në arsimin e lartë. Për të përmbushur këtë rezultat janë paraparë

disa aktivitete: zhvillimi i sistemit për menaxhim të informative në arsimin e lartë (SMIAL), hartimi i udhëzuesve dhe aftësimi i stafit për mbledhjen dhe përpunim të dhënave dhe zhvillimi i treguesve kombëtar në arsimin e lartë. Në lidhje me aktivitetin e parë, MASHT ka pilotuar SMIAL gjatë vitit 2017 në disa institucione për të testuar operabilitetin e sistemit. Është instaluar një version i ri i sistemit SMIAL me disa plotësime duke përfshirë kufizimin e numrit të studentëve sipas vendimeve të institucioneve licencuese/akredituese, gradat akademike të stafit dhe janë caktuar afatet kohore mbështetur në vendimet për akreditim. Platforma e re e SMIAL mbështetet në interoperabilitet me databazën e AKA për vendimet për (mos) akreditim, suspendim apo tërheqje të akreditimit. Vetëm institucionet e arsimit të lartë që janë të akredituara dhe programet gjegjëse mund të regjistrojnë të dhënat në sistem. Përditësimi i sistemit ka hasur në disa vështirësi logjistike për shkak të skadimit të kontratës me zhvilluesin e sistemit. Mirëmbajtja e sistemit kërkon kontratë afatgjatë. Megjithatë, SMIAL ka mungesë të mbështetjes së vazhdueshme teknike për të adresuar pengesat në futje të të dhënave

Aktiviteti i dytë i propozuar në kuadër të rezultatit ndërlidhet me hartimin e udhëzuesve dhe manualeve për zbatim të SMIAL. Gjatë vitit 2018 është nxjerrë Udhëzimi administrativ për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzuesit paraprak për Sistemin e Menaxhimit të Informatave në Arsimin e Lartë. Plotësimi i SMIAL ndërlidhet me afatet e raportimit të të dhënave të studentëve të regjistruar për studimet baçelor, master dhe doktoratës dhe librit amëz. Afatet e raportimit të të dhënave për regjistrim të studentëve baçelor janë zgjatur nga data paraprake 30 shtator në 15 nëntor të vitit akademik. Me ndryshimet e UA, institucionet e arsimit të lartë që nuk raportojnë të dhënat e studentëve nuk u ofrohet qasje në SMIAL dhe është shfuqizuar Udhëzimi administrativ për Librin Amëz (33/2014). Një numër i institucioneve private të arsimit të lartë nuk kanë respektuar afatet ligjore për raportim të të dhënave për studentët e regjistruar. Një pjesë e institucioneve kanë raportuar vështirësi në futje të të dhënave në mungesë të stafit të specializuar. Rekomandohen plotësime shtesë në Udhëzimin administrativ SMIAL mbi afatet e raportimit dhe pasojat që rezultojnë nga mosdeklarimi i studentëve të regjistruar.


Përpilimi i treguesve kombëtar për arsimin e lartë është specifikuar si aktiviteti i tretë në kuadër të sistemit. MASHT, ende nuk ka ndërmarrë ndonjë hap në këtë drejtim. Përgjithësisht, standardizimi i treguesve të arsimit të lartë është thelbësor për matje të performancës së institucioneve të arsimit të lartë. Treguesit mund të standardizohen sipas treguesve ndërkombëtar të propozuar nga Eurostat, OECD dhe UNESCO. Mbledhja dhe përpunimi i treguesve është i rëndësishëm për zbatim të formulës së financimit dhe promovim të cilësisë në arsimin e lartë. MASHT dhe ASK kanë filluar publikimin e të dhënave në bazë vjetore të arsimit të lartë në Kosovë. Të dhënat për institucionet publike janë të standardizuara. Kërkohej unisim i procedurës së mbledhjes së të dhënave për të gjitha institucionet.

### 6.7.5 Ndërlidhja me tregun e punës

#### Rezultati 7.6. Programet e studimit janë në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe shërbimet për orientim dhe këshillim në karrierë janë funksionale në IAL


Synimi për të përmirësuar kushtet e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në arsim të lartë vazhdon të sfidohet nga numri i tejet i lartë i studentëve dhe mungesa e stafit mësimdhënës. Në bazë të të dhënave të MASHT/SMIAL 2019, numri më i madh i studentëve të regjistruar për herë të parë ishte në fushën e biznesit, mjekësisë, drejtësisë, informatikës dhe shkencave shoqërore. Në dy vitet e fundit është dokumentuar një rritje e ndjeshme e studentëve të orientuar në fushat e mjekësisë kryesisht në fushën e përkujdesit mjekësor dhe infermierisë.

### Studentët e regjistruar për herë të parë në Kosovë sipas fushave të studimit ESAC 2018/2019 (SMIAL, 2019)




Orientimi i studentëve në shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë ende mbetet i ulët. Tregu i punës në Kosovë ballafaqohet me dy probleme strukturore e që ndërlidhen me shkallën dhe cilësinë e sistemit arsimor. Fillimisht shkalla e kërkesës në tregun e punës është e ulët dhe trendi i vendeve të punës të gjeneruara vitet e fundit nuk garanton punësim të të diplomuarve. Së dyti, ekziston edhe problemi i mospërputhjes së cilësisë së kualifikimit dhe tregun e punës – ekzistojnë disa sektorë ekonomik që ballafaqohen me mungesë të shkathësive adekuate. Oferta arsimore aktualisht është e ndryshme nga nevojat e tregut të punës dhe nevojat për shkathësi në sektorët strategjik qeveritar. Numri më i madh i studentëve dhe programeve arsimore janë në kategorinë e shkencave shoqërore dhe studimit të së drejtës. Gjatë viteve 2018-2019, është shënuar një rritje e theksuar e numrit të studentëve në fushat mjekësore, kryesisht në sektorin privat.

### Të diplomuar BA/MA të papunë 2012-2019 (ASK, 2019)




Nuk ka ndonjë studim gjithëpërfshirës për përshtatjen në mes të shkathtësive të të diplomuarve dhe nevojave të tregut të punës, mirëpo, ka mjaft fakte që dëshmojnë të kundërtën. Numri i studenëve të diplomuar (bachelor/master) të papunë është duke u rritur ndjeshëm. Vitin e kaluar ishin rreth 12,000 të diplomuar të papunë, ndërsa që bizneset janë në kërkim të shkathtësive. Studentët janë duke shmangur STEM (shkenca ekzakte, teknologjinë, inxhinierinë dhe matematikën) në favor të shkencave shoqërore dhe juridike (me kërkesë të ulët në treg).

### ORIENTIMI I STUDENTËVE SIPAS INSTITUCIONEVE 2018/2019



Oferta arsimore e institucioneve publike të arsimit të lartë të themeluara vitet e fundit nuk ndjek domosdoshmërisht prioritetet ekonomike të rajoneve gjegjëse. Ofrimi i programeve në fushën e trajnimit të mësimdhënësve dhe shëndetësisë nga ana e institucioneve publike të arsimit të lartë, mund të jenë të rëndësishme për promovim të shërbimeve arsimore dhe shëndetësore në komuna. Vërehet një dallim i theksuar

në orientim në fusha të caktuara të studimit në arsimin e lartë sipas gjinisë. Femrat janë të prirura të jenë të orientuara (mbi 90%) në programet e edukimit, shkencave natyrore, shkencave shoqërore, mjekësisë, komunikimit dhe gjuhësisë. Meshkujt dominojnë në fusha të studimit të informatikës, humanistikë, gjeografi/gjeologji dhe inxhinieri/teknologji. Një orientim i baraspeshuar gjinor vërehet në fushat e arkitekturës, biznesit dhe drejtësisë.



Në kuadër të ndërlidhjes së arsimit me tregun e punës janë paraparë disa aktivitete që ndërlidhen me (a) themelimin e bordeve industriale dhe realizimin e studimeve të mirëfillta mbi ndërlidhjen e arsimit dhe tregut të punës. Të gjitha bordet industriale janë në universitetet publike që janë themeluar gjatë vitit 2018-2019. Nga 16 borde industriale, 10 nga to janë në Universitetin e Prishtinës, 1 në Universitetin e Ferizajt, 2 në Universitetin e Gjakovës, 3 në Universitetin e Pejës. Universiteti i Mitrovicës dhe Universiteti i Gjilanit,

janë në proces të aprovimit të rregulloreve dhe themelimit. Nuk është hasur në evidencë që dokumenton që realizimin e studimit mbi ndërlydhen e ofertës arsimore me tregun e punës apo përpjekjeve sistematike për të krijuar një sistem që shqyrton dhe drejton studentët drejt fushave me kërkesë të lartë në ekonomi.

## 6.7.6 Infrastruktura

### Rezultati 7.6. Avancohet infrastruktura dhe teknologjia për mësimdhënie, punë kërkimore-shkencore dhe artistike

Në kuadër të rezultatit janë paraparë aktivitete që kanë qëllim ofrimin e mbështetjes institucionale për zhvillim të infrastrukturës kërkimore-shkencore, vlerësimin e nevojave të infrastrukturës për mësim dhe punë kërkimore shkencore dhe hartimi i planeve për mirëmbajtje dhe përditësimin e pajisjeve të laboratorëve. Gjatë vitit 2018, janë realizuar investime kapitale rreth 4.6 milion euro. Gjithashtu, është alokuar buxheti për ndërtim të hartës së infrastrukturës kërkimore shkencore.

## 6.7.7. Publikimet shkencore


### Rezultati 7.7. Numri i publikimeve shkencore në revista të indeksuara ndërkombëtare i stafit akademik rritet për 25% në çdo vit

Shkenca dhe hulumtimet në Kosovë rregullohen me Ligjin nr. 04/L-135 për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore. Ky ligj ka përfshirë praktikat e mira evropiane të cilat e përkrahin hulumtimin shkencor me fokus në zhvillimin ekonomik dhe social. Gjithashtu, ligji posedon dispozita që rregullojnë lidhjen e hulumtimit shkencor me ekonominë dhe industrinë. Si strukturë përgjegjëse për administrimin e prioritetëve kombëtare të kërkimit është Këshilli Kombëtar i Shkencës, ndërsa Departamenti për arsim të lartë, shkencë dhe teknologji në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë është institucioni kryesor për politikbërje në fushën e shkencës dhe hulumtimeve. Ligji për Inovacion Shkencor, Transfer të Dijes dhe Teknologjisë është miratuar në nëntor të 2018 në Kuvend.

PSAK ka paraparë ngritje të vazhdueshme të publikimeve në revista të indeksuara ndërkombëtare. Kosova nuk ka një sistem të matjes së produktivitetit shkencor as në kuptim të volumit dhe as cilësisë së publikimeve. Megjithatë, në bazë të të dhënave të Bankës Botërore (2018), numri i publikimeve shkencore nga Kosova në revista të indeksuara ndërkombëtare është rritur gradualisht që nga viti 2009.




**Numri i publikimeve shkencore në revista të indeksuara 2009-2019 -Banka Botërore 2019**



Megjithatë, kërkimi shkencor në Kosovë mbetet një nga sfidat kryesore. Shkalla e aktivitetit kërkimor shkencor në institucionet e arsimit të lartë është rritur vazhdimisht. Numri i publikimeve shkencore/teknike në revista të indeksuara ndërkombëtare është dyfishuar krahasuar me vitin 2015. Megjithatë, në bazë të të dhënave krahasimore në Ballkanin Perëndimor, viteve të fundit Kosova ka tejkaluar numrin e publikimeve shkencore të Shqipërisë dhe Malit të Zi. Serbia përbën pjesën dërmuese (70%) të të gjitha publikimeve shkencore/teknike në Ballkanin Perëndimor.

**Numri i publikimeve shkencore/teknike në revista të indeksuara 2009-2019 në Ballkan P. (Banka Botërore, 2019)**



Për ngritjen e kapaciteteve në fushën e hulumtimit shkencor dhe të inovacionit, duhet të vazhdohet me ndarjen e bursave të doktoratës për studentë të të dyja gjinive që studiojnë në 500 universitetet më të mira të botës. Në kuadër të projekteve kërkimore shkencore, MASHT gjatë vitit 2018, ka përzgjedhur 6 projekte për financim (100,000 euro). Pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtare promovohet përmes subvencionimit dhe mbulimit të kostos së participimit (50,000 euro). Me qëllim të promovimit dhe inkurajimit të aktiviteteve kërkimore, MASHT mbështet organizimin e Javës së Shkencës dhe përzgjedh Shkencëtarin e Vitit dhe Shkencëtarin e Ri të Vitit. Gjithashtu, gjatë vitit 2018 janë mbështetur 13 përfitues për kategorinë e publikimeve në revista të indeksuara ndërkombëtare. Buxheti për këtë kategori aktiviteti është rritur nga 20,000 euro në 100,000 euro në vitet në vazhdim. Institucioni ka themeluar ekipin për draftim të Strategjisë për Specializim të Mençur në kuadër të iniciativës së Komisionit Evropian dhe JRC.

### 6.7.8 Legjislacioni

#### Rezultati 7.8. Deri në vitin 2018, është rishikuar dhe kompletuar infrastruktura ligjore për arsim të lartë

Rezultati është ndërtuar mbi supozimin që Kuvendi i Kosovës do të miratonte Ligjin e ri për Arsimin e Lartë në vitin 2017. Rishikimi i akteve nënligjore për t'u përshtatur me ndryshimet dhe plotësimet e legjislacionit primar janë aktivitetet kryesore për të përmbushur rezultatin. Sidoqoftë, Ligji i arsimit të lartë është miratuar në Qeverinë e Kosovës në nëntor 2018, mirëpo nuk ka kaluar në Kuvend. Është hartuar dhe miratuar Udhëzimi administrativ 01/2018 "Parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension", i cili rregullon procesin e avancimit të stafit akademik në institucionet e arsimit të lartë. Në lidhje me procesin e akreditimit në arsim të lartë është miratuar Udhëzimi administrativ mbi Procedurën dhe Kriteret për Përzgjedhjen dhe Caktimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar për Cilësi (UA 05/2018). Gjithashtu, është miratuar Udhëzimi administrativ (UA 15/2018) mbi Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë për të inkorporuar provizionin për themelimin e Komisionit të Ankesave të Këshillit Kombëtar për Cilësi. AKA ka finalizuar konceptdokumentin për Ligjin mbi Agjencinë e Akreditimit të Kosovës. Në lidhje me Ligjin për Profesionet të Rregulluara, është draftuar UA për detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit Shtetëror për Profesionet e Rregulluara. Gjithashtu, janë rishikuar UA për licencim të institucioneve të arsimit të lartë dhe UA për verifikim të dokumentacionit të institucioneve të arsimit të lartë.

Gjatë vitit 2019, është miratuar Konceptdokumenti për Ligjin e Agjencisë së Kosovës për Akreditim dhe është emëruar grupi punues për hartimin e projekligjit për AKA. Drafti është ende në përpunim dhe nuk është finalizuar. Është rishikuar UA nr.15/2018 dhe miratuar me nr. 08.2019 për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë. Dy akte tjera nënligjore a) Rishikimin e UA për bursa dhe draftimi i UA për etikën për kërkim shkencor në arsim të lartë. Janë themeluar grupet punuese dhe kemi përgatitur draftet preliminare. Është bërë rishikimi i UA për verifikim të dokumenteve të IAL, dhe si draft ka kaluar të gjitha procedurat e konsultimit paraprak dhe publik. Drafti është dorëzuar tek Ministri për nënshkrim, por ende është i pamiratuar.

## 6.7.9 Performanca dhe formula e financimit

### Rezultati 7.9. Deri në vitin 2020 fillon zbatimi i formulës së financimit të arsimit të lartë në bazë të performances

Nuk është rishikuar apo aprovuar formula e re e financimit në arsimin e lartë. Kërkohej investim i mëtejshëm në zhvillimin e një modeli bashkëkohor dhe të qëndrueshëm financiar. Aktualisht nuk ka ndonjë rregull të veçantë për alokimin e fondeve për Universitet Publike të themeluar në dekadën e fundit. Universiteti i Prishtinës është një organizatë autonome e cila trajtohet si organizatë buxhetore e veçantë dhe program i veçantë buxhetor mbi të cilën MASHT-i nuk ka kontroll të plotë. Katër universitetet tjera, të cilat paraqiten si nënprograme në kuadër të strukturës së MASHT-it, nuk e kanë një autonomi të tillë. Për alokimin e burimeve në këto universitete nuk ka rregulla të veçanta që aplikohen. Përderisa modeli i financimit të Universitetit të Prishtinës ka mangësitë e veta, ende mbetet e paqartë se pse institucionet publike të arsimit të lartë aplikojnë mënyra të ndryshme financimi.

Buxhetet e këtyre universiteteve përgatiten mbi baza historike ku si pikënisje përdoret shuma e ndarë fillimisht. Për më tepër, kostoja adekuate e nënprogrameve përkatëse nuk ka qenë e mundur të bëhet deri më tani për shkak të mungesës së marrëveshjes se si të strukturohen degët dhe fakultetet e universiteteve, dhe si të kufizohet numri i përgjithshëm i studentëve në këto universitete (e nevojshme për shkak të burimeve të kufizuara financiare që janë alokuar për arsimin e lartë). Universiteteve u mungojnë të dhënat bazike të nevojshme për zhvillimin e një sistemi të bazuar në formulën për financimin e tyre. Kjo është një nga pengesat kryesore për zbatimin e financimit të bazuar në formulë dhe decentralizimin e ekzekutimit të buxhetit. Kjo gjithashtu e pengon MASHT-in që të sigurojë përmbushjen e qëllimit të politikave në nivel kombëtar.

Gjatë vitit 2017-2019, nuk është plotësuar veprimi i paraparë për hartimin e aktit nënligjor për formulën e financimit. Ende kërkohej të themelohej një Grup punues me përfshirje nga MASHT, Ministria e Financave, institucionet publike të arsimit të lartë dhe Ministria e Administrimit Publik. Grupi punues do të mund të trajtonte propozimet e ofruara në kuadër të Studimit të mbështetur nga Projekti ESIP i Bankës Botërore për rishikimin funksional në menaxhimin e financave, kapaciteteve menaxhuese dhe llogaridhënies në institucionet publike të arsimit të lartë. Në përgjithësi, Universiteti i Prishtinës vazhdon të jetë kategori e veçantë buxhetore, ndërsa universitetet tjera publike janë si nënprograme financiare të arsimit të lartë të MASHT.

Formula e financimit ngërthen një dimension të performancës në përfshirje dhe cilësi në mësimdhënie dhe kërkim shkencor dhe dimensionin social. Përcaktimi i formulës së financimit duhet të shkojë paralelisht me zhvillimin e treguesve arsimor, mbledhjen e të dhënave në arsimin e lartë, definimin e kornizës së performancës dhe profilizimin e institucioneve të arsimit të lartë. Bazuar në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) të Ministrisë së Financave, rreth 72% të financimit për institucionet e arsimit të lartë shkojnë për Universitetin e Prishtinës.

## Shpenzimet vjetore të IAL Publike Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2016-2019

	2016	2017	2018	2019
Universiteti i Prishtinës	28,152,852	30,782,339	33,834,712	35,761,829
Universiteti i Prizrenit	2,553,215	2,493,346	2,633,346	2,575,483
Universiteti i Pejës	2,343,956	2,376,823	3,026,823	3,226,823
Universiteti i Mitrovicës	2,402,651	2,968,698	2,905,398	3,588,698
Universiteti i Ferizajt	580,050	949,563	1,522,227	2,293,863
Univrsiteti i Gjakovës	1,302,793	1,615,972	2,095,872	2,145,972
Universiteti i Gjilanit	1,492,846	1,556,553	2,126,553	2,226,553
<b>Total</b>	<b>38,828,363</b>	<b>42,743,294</b>	<b>48,144,931</b>	<b>51,819,221</b>

Burimi: Ministria e Financave (RKS) 2016-2019 KASH

Në kuadër të aktivitetit të tretë të propozuar për arritjen e rezultatit, nënvizohet nevoja e zhvillimit të masave të veçanta pozitive dhe i programeve përgatitore për regjistrimin dhe mbajtjen e studentëve në IAL nga radhët e kategorive të cenueshme sociale dhe komunitetet e nën përfaqësuar. Në kuadër të Planit të Veprimit parashihen disa veprime që do të kontribuojnë në përmbushjen e aktivitetit duke përfshirë hartimin e strategjisë për dimensionin social të arsimit të lartë, themelimin e fondit dhe programit për mbështetje të komuniteteve, organizimin e programeve përgatitore për studime akademike, themelimin e fondit për mbështetjen e studentëve në gjendje jo të mirë sociale dhe ofrimi i ndihmës për studentët me nevoja të veçanta. Baraspesha gjinore nuk është sfidë dhe prioritet në arsimin e lartë. Është e diskutueshme relevanca e këtij aktiviteti për atë sa Kosova vazhdon të ketë shkallë pothuajse të baraspeshuar të përfshirjes së meshkujve dhe femrave në arsimin e lartë. Sipas SMIAL (2018), nga të gjithë studentët e regjistruar për herë të parë në studime universitare gjatë vitit 2017/2018, rreth 54.6% ishin femra ndërsa 45.4 % ishin meshkuj. MASHT ka përkrahur me bursa studentët kosovarë për studime brenda vendit në fushat deficitare të universiteteve publike (teknikë, bujqësi, edukim, shkenca natyrore që janë paraparë edhe në SKZH) dhe personave me aftësi të veçanta – në total mbi 660 studentë në vit për nivelet bachelor dhe master.

### 6.7.10 Mobiliteti i stafit dhe studentëve

#### Rezultati 7.10.Rritet mobiliteti i stafit akademik dhe studentëve të IAL

Në kuadër të rezultatit specifikohet nevoja e promovimit të mobilitetit të stafit mesimdhënës dhe studentëve në rajon, vendet e BE-së dhe vende tjera me sistem të avancuar arsimor. Për të arritur rezultatin janë paraparë dy aktivitete kryesore: pjesëmarrja në programet rajonale dhe ndërkombëtare të mobilitetit akademik dhe zbatimi i programeve të përbashkëta të studimit me institucione ndërkombëtare të arsimit të lartë.

Në dy programet kryesore për mobilitet akademik -programin ERASMUS+ dhe CEEPUS gjatë vitit 2019 është shënuar rritje në numër të mobiliteteve. Në kuadër të programit Erasmus + janë shkëmbyer 1405 mobilitete, prej të cilave 905 nga Kosova në vendet e EU, dhe 500 prej EU në Kosovë. Gjithashtu, në kuadër të komponentës për ngritje të kapaciteteve në arsim të lartë kemi 8 projekte të përfituara, 3 prej të cilave do të koordinohen nga IAL në Kosovë. Rritje të theksuar të mobiliteteve kemi edhe në kuadër të programit të shkëmbimit akademik CEEPUS. Për vitin 2019, janë realizuar 125 mobilitete prej të cilave 44 nga vendet partnere në Kosovë dhe 81 nga Kosova në vendet partnere të CEEPUS. Në kuadër të marrëveshjes bilaterale, MASHT-Ambasadë Amerikane-Programi Fullbright. Në komponentën e bursave master janë dhënë 4 bursa të plota për studime master në SHBA. Komponentën për ngritje të kapaciteteve të stafit akademik janë 4 përfitues. Komponenta për zhvillimin e hulumtuesve të rinj janë 4 përfitues. Në kuadër të angazhimit të ekspertëve të huaj nga SHBA në Kosovë, janë 3 përfitues.

Janë realizuar edhe aktivitetet mbështetur në marrëveshjet me partner për ofrim të bursave për studime jashtë vendit për nivelet Bachelor, Master dhe Doktoratë: programi “Shtipendium Hungarikum” (Marrëveshja MASHT-Qeveri hungareze) janë dhënë 50 bursa të plota për studime në Universitete në Hungari (25 BA, 20 MA dhe 5 PHD). Në kuadër të marrëveshjes mes Ambasadës së Francës dhe MASHT janë përzgjedhur dy përfitues për nivelin master. Është arritur marrëveshja me Universitetin e Camerinos në Itali për ofrim të bursave për studime bachelor dhe master. Janë dhënë gjithsej 14 bursa të plota.

### **6.7.11 Pjesëmarrja në programe ndërkombëtare të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor**

#### **Rezultati 7.11.Rritet pjesëmarrja në programet ndërkombëtare për arsim të lartë dhe kërkime shkencore**

Përmes këtij rezultati synohet të rritet shkalla e pjesëmarrjes së institucioneve arsimore dhe kërkimore shkencore në programet ndërkombëtare. Për të arritur këtë rezultat parashihen disa aktivitete duke përfshirë mbështetjen për aplikim në programe evropiane për arsim të lartë dhe kërkim shkencor, promovimi i programeve evropiane për arsim të lartë dhe kërkim shkencor, ndërtimi i kapaciteteve të institucioneve të arsimit të lartë për menaxhim të projekteve bazuar në vlerësim dhe krijimi dhe funksionalizimi i mekanizmave institucional për zhvillimin dhe koordinimin e projekteve.

Në kuadër të programit Kornizë të BE-së për hulumtim dhe Inovacion Horizon 2020, janë organizuar sesione informative, trajnim për shkrim të projektpropozimeve, mbështetje Pikave Kombëtare të Kontaktit për pjesëmarrje në takimet e rrjetëzimeve sipas fushave tematike në vendet evropiane. HERAS ka mbështetur MASHT në promovim të programit dhe shkrim të projekt/propozimeve dhe janë zhvilluar dy punëtori me rreth 30 pjesëmarrës në secilën punëtori.

Po ashtu, në kordinim me zyrën e BE janë ofruar sesione informative për mundësitë e pjesëmarrjes së Kosovës në program. Gjatë vitit 2019, janë fituar 7 projekte me pjesëmarrës nga Kosova në vlerë afërsisht 1 milion euro. Kosova në programin Horizon 2020 mban satatusin e vendit të bashkëpunimit ndërkombëtar, me shkallë suksesi të përgjithshme 23.6 %, me gjithsej 82 projekt aplikime, 19 prej të cilave janë financuar. Gjithashtu, është promovuar COST (European Cooperation for Science and Technology). Kosova ka avancuar statusin në fund të viti 2018 -Near Neighbouring Country, me të cilin status hulumtuesit nga Kosova janë të ligjshëm të rimbursohen për pjesëmarrje në aktivitetet që realizohen nga kuadër të COST. Në mars të vitit 2019 është emruar pika nacionale e kontaktit për programin. Janë organizuar sesione informuese, takime të personalizuara me hulumtues, përfshirë aktivitetin qendror në bashkëpunim me asociacionin. Rreth 20 hulumtues nga Kosova tanimë janë pjesë e aksioneve të COST dhe kanë filluar aktivitete e tyre.

## 6.7.12 Matrica e zbatimit të aktiviteteve

No.	Rezultatet	Aktivitetet	Status	%
7.1	Raporti Staf-Student në AL është të paktën 1:40	7.1.1 Zhvillimi i programeve të reja të studimeve të doktoratës		3
		7.1.2 Mbështetja e studentëve në studimet e doktoratës në IAL ndërkombëtare		3
		7.1.3 Zhvillimi i mekanizmave për planifikim të pranimit të studentëve në IAL		3
7.2	Mekanizmat për zhvillim profesional të stafit akademik në IAL janë plotësisht funksional	7.2.1 Themelimi dhe funksionalizimi i zyrave për përsosmëri të mësimdhënies		2
		7.2.2 Vlerësimi i nevojave të stafit akademik për zhvillim profesional		2
		7.2.3 Hartimi i planit për zhvillim profesional të stafit akademik		2
		7.2.4 Zhvillimi i mekanizmit për monitorimin dhe vlerësimin e punës së stafit akademik		4
7.3	Mekanizmat për sigurimin e cilësisë në arsim të lartë janë plotësisht funksional	7.3.1 Zhvillimi dhe zgjerimi i kapaciteteve njerëzore dhe financiare të AKA-së për t'i zbatuar standardet ESG		2
		7.3.2 Zhvillimi dhe zgjerimi i kapaciteteve njerëzore të Qendrës Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik – NARIC		3
		7.3.3 Mbështetja e IAL në zbatimin e politikave për sigurimin të cilësisë		3
		7.3.4 Plotësimi i akreditimit me një proces të rankimit të programeve dhe institucioneve sipas Kornizës Multidimensionale Evropiane		1
		7.3.5 Themelimi dhe funksionalizimi i Agjencisë për Standarde dhe Vlerësim për Profesionet e Rregulluara		1
7.4	Avancohet infrastruktura dhe teknologjia për mësimdhënie, punë kërkimore-shkencore dhe artistike	7.4.1 Vlerësimi i nevojave të infrastrukturës për mësim dhe punë kërkimore-shkencore		3
		7.4.2 Mbështetje institucionale për zhvillim të infrastrukturës kërkimore-shkencore		3
		7.4.3 Hartimi i planeve për mirëmbajtjen dhe përditësimin e pajisjeve të laboratorëve		2
7.5	Deri në vitin 2018 Sistemi për menaxhimin e informatave në arsim të lartë (SMIAL) është plotësisht funksional	7.5.1 Zhvillimi i SMIAL me mundësi të mbledhjes dhe përpunimit të informatave relevante në nivel të IAL		4
		7.5.2 Hartimi i udhëzuesve dhe aftësimi i stafit për mbledhjen dhe analizën e të dhënave		4
		7.5.3 Zhvillimi i tregueseve kombëtarë të arsimit të lartë		2

No.	Rezultatet	Aktivitetet	Status	%
7.6	Programet e studimit janë në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe shërbimet për orientim dhe Rritet mobiliteti i stafit akademik dhe studentëve të IAL këshillim në karrierë janë funksionale në IAL	7.6.1 Themelimi dhe funksionalizimi i këshillave industrial		3
		7.6.2 Inkurajimi i partneriteteve me biznese		3
		7.6.3 Realizimi i një studimi të mirëfilltë për ndërlidhjen e programeve të arsimit të lartë me tregun e punës		2
		7.6.4 Rishikimi i programeve ekzistuese të studimit		3
		7.6.5 Mbështetja e programeve të reja në shkencat e aplikuara dhe programeve profesionale në përputhje me kërkesat e tregut të punës		3
		7.6.6 Ofrimi i shërbimeve profesionale për biznese		2
		7.6.7 Krijimi i sistemit për analizën e tregut të punës në nivel nacional, rajonal dhe lokal		2
		7.6.8 Themelimi dhe funksionalizimi i mekanizimit për zhvillim të karrierës në IAL		2
		7.6.9 Zhvillimi i standardeve të profesionit në arsim të lartë		2
7.7	Numri i publikimeve shkencore në revista të indeksuara ndërkombëtare i stafit akademik rritet për 25% në çdo vit.	7.7.1 Analiza e aktiviteteve hulumtuese të stafit akademik		3
		7.7.2 Zhvillimi i planeve të veprimit për veprimtari kërkimore shkencore		2
		7.7.3 Themelimi dhe funksionalizimi i këshillave të etikës në IAL		3
		7.7.4 Mbështetja e publikimit të punimeve shkencore në revista të indeksuara dhe prezantimi i rezultateve		2
		7.7.5 Sigurimi i qasjes në biblioteka elektronike		3
		7.7.6 Krijimi i regjistrit kombëtar i hulumtuesve shkencor		1
7.8	Deri në vitin 2018 është rishikuar dhe kompletuar infrastruktura ligjore për arsim të lartë	7.8.1 Rishikimi dhe hartimi i akteve nënligjore në përputhje me legjislacionin e ri		3
		7.8.2 Harmonizimi i statuteve dhe akteve tjera nënligjore të IAL me legjislacionin e ri		3
		7.8.3 Zhvillimi i kornizës ligjore për SMIAL		4
7.9	Deri në vitin 2020 fillon zbatimi i formulës së financimit të arsimit të lartë në bazë të performancës	7.9.1 Hartimi i aktit nënligjor për formulën e financimit të arsimit të lartë		2
		7.9.2 Zhvillimi i treguesve të ndjeshëm gjinor të performancës në arsimin e lartë		3
		7.9.3 Zhvillimi i planeve strategjike të zhvillimit të IAL		3
		7.9.4 Zhvillimi i kornizës për monitorim dhe vlerësim të marrëveshjeve të performances		1
		7.9.5 Zhvillimi i masave të veçanta pozitive dhe i programeve përgatitore për regjistrimin dhe mbajtjen e studentëve në IAL nga radhët e kategorive të cenushme sociale dhe komunitetet e nën përfaqësuara		3
7.10	Rritet mobiliteti i stafit akademik dhe studentëve të IAL	7.10.1 Zbatimi i programeve të përbashkëta të studimit me institucione ndërkombëtare të arsimit të lartë		4
		7.10.2 Pjesëmarrja në programet rajonale dhe ndërkombëtare të mobilitetit akademik		4
7.11	Rritet pjesëmarrja në programet ndërkombëtare për arsim të lartë dhe kërkime shkencore	7.11.1 Krijimi dhe funksionalizimi i mekanizmave institucional për zhvillimin dhe koordinimin e projekteve		
		7.11.2 Ndërtimi i kapaciteteve të IAL për menaxhim të projekteve bazuar në vlerësim		
		7.11.3 Mbështetja për aplikim në programe evropiane për arsim të lartë dhe kërkim shkencor		
		7.11.4 Promovimi i programeve evropiane për arsim të lartë dhe kërkim shkencor		

## 6.7.13 Treguesit e performancës

### TREGUESIT KRYESOR TË ARSIMIT TË LARTË 2014-2018

	2014/15	2015/16	2016/17	2017/18	2018/19
<b>Numri i studentëve dhe diplomuarve</b>					
Numri i i studentëve në arsimin e lartë	110,378	120,429	123,988	116,424	104,513
Numri i studentëve + Universiteti i Mitrovicës Veriore	120,378	130,429	133,988	126,424	
Numri i studentëve publik	82,225	73,111	76,707		68,524
Numri i studentëve privat		38,153	47,318	47,281	35,989
Studentët e pranuar në vitin e parë				23,399	29,284
Studentët e pranuar publik	18,729	18,002		11,953	11,759
Studentët e pranuar privat	13,639	14,025	11,546	11,446	17,525
Studentët e pranuar femra				12,791	15,925
Numri i të diplomuarve	9612	10512	12528	13969	
Numri i të diplomuarve publik	5458	5730	7312	8629	
Numri i të diplomuarve privat	4154	4782	5216	5340	
<b>Pariteti Gjiner</b>					
Numri i studenteve femra	35495	46,275	58,567	64,594	63,311
Indeksi i Paritetit Gjiner	0.86	1.02	0.94	1.08	1.19
<b>Shkalla bruto e regjistrimit</b>					
Shkalla bruto e regjistrimit (18-22 vjeç)	55.5	62.4	67.2	69.4	73.6
Shkalla bruto e regjistrimit (18-24 vjeç)	40.40%	45.30%	48.90%	50.10%	53.20%
<b>Fushat e studimit ESAC - Studentët fillestar</b>					
Shkenca Agrikulturore (01)				942	847
Arkitektura, Planifikimi Urban (02)				896	1,048
Art dhe Dizajn (03)				713	687
Biznes dhe Menaxhment (04)				5,555	6,775



## TREGUESIT KRYESOR TË ARSIMIT TË LARTË 2014-2018

	2014/15	2015/16	2016/17	2017/18	2018/19
Edukim dhe Mesimdhënie (05)				1,527	1,148
Inxhinieri (06)				1,818	3,458
Shkenca Mjedisore (07)				367	289
Filozofi,Teologji (08)				358	347
Gjuhë dhe Filologji (09)				1,730	1,667
Drejtësi (10)				2,388	3,727
Matematikë,Informatikë (11)				925	1357
Mjekësi (12)				2,899	3,981
Shkenca Natyrore (13)				281	246
Shkenca shoqerore (14)				2,080	2,533
Komunikim,informim (15)				377	377
Tjera (16)				445	797
<b>Institucionet dhe programet</b>					
Numri i institucioneve të arsimit të lartë				30	
Numri i programeve të akredituara	477	468	415	344	355
Numri i programeve bachelor	270	262	237	217	
Numri i programeve master	181	180	156	107	
Numri i programeve doctorate	26	26	22	20	
<b>Shpenzimet në arsimin e lartë</b>					
Shpenzimet në arsim të lartë milion €	47.6	49.7	50.3	51.7	53.7
Shpenzimet për kokë studenti	571.9	679.8	656.9		
Shpenzimet në AL në raport me shpz.arsim	18.1	18.5	19	18.1	17.6

Burimi: ASK (2019), MASHT (2019)

## 6.7.14 Rekomandimet

- Të monitorohet dhe rritet shkalla e diplomimit në arsim të lartë*** - Numri i studentëve dhe shkalla e përfshirjes ka arritur shifra shumë të larta. Kosova ka rreth 104,513 studentë në arsimin e lartë dhe rreth 70 për qind e grup-moshave 18-22 vijojnë arsimin e lartë. Rritja e shkallës së përfshirjes nuk do thotë domosdoshmërisht ndonjë kontribut të theksuar për rritje të produktivitetit të fuqisë punëtore. Ndikimi i shkollimit universitar në konkurrueshmërinë e vendit varet nga cilësia e ofertës, numri i të diplomuarve dhe fushat e diplomimit të tyre. Megjithëse numri i studentëve është rritur ndjeshëm kjo nuk është përkthyer në ndonjë ndryshim thelbësor në rritje të numrit të të diplomuarve. Numri i studentëve që mbarojnë studimet dhe diplomojnë në institucionet publike të arsimit të lartë vazhdon të jetë nën 20 për qind. Kjo sjell në sipërfaqe edhe sfida të tjera në sistem duke përfshirë numrin dhe cilësinë e stafit mësimdhënës, numrin dhe cilësinë e stafit administrativ dhe atraktivitetin e përgjithshëm të ofertës arsimore.
- Të rritet shkalla e orientimit dhe diplomimit të studentëve në fushat STEM (shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë) dhe fusha tjera deficitare*** - Në përgjithësi, rritja e numrit të studentëve ka ardhur në fusha të studimit që ndërlidhen me ekonominë e shërbimeve (juridik, administrim biznesi, shkencë shoqërore). Shkalla e studentëve të orientuar në fushat STEM (shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë) është ende tejet e ulët. Rritja e numrit të të diplomuarve në STEM, do të mund të favorizonte konkurrueshmërinë e vendit në prodhim dhe përpunim industrial. Edhe orientimi i studentëve në bujqësi dhe veterinarin vazhdon të jetë i ulët. Studentët kanë një tendencë të orientohen në ato sfera të studimit që kanë pak vlerë të shtuar për ekonominë e vendit, por në të njëjtën kohë edhe më pak shanse për punësim.
- Të rishikohet dhe miratohen standarde të operimit mbi proporcionin staf-student në arsimin e lartë*** - Rritje e theksuar e numrit të studentëve në sfera me vlerë të kufizuar për ekonominë e vendit dhe pa rritje të kapacitetit të stafit mund të krijoj sfida në cilësi arsimore. Proporcioni student-staf mësimdhënës në studimet e fakultetit juridik dhe ekonomik është shumë përtej praktikave të mira dhe kufizimit ligjor (1:20). Institucionet e sigurimit të cilësisë duhet të operojnë më standarde të qarta rreth proporcionit të lejuar staf-student. Ky standard mund të rregullohet dhe diferencohet sipas fushave të studimit. Është e rëndësishme që të krijohen norma mbi të cilat mund të kufizohet proporcioni 1:200 në fushat e juridikut dhe ekonomikut.
- Të bëhet profilizimi i institucioneve publike të arsimit të lartë*** - Kjo dinamikë në arsimin e lartë kërkon vëmendje të posaçme në profilizim të institucioneve arsimore dhe fuqizim të institucioneve përgjegjëse për sigurim të cilësisë. Oferta arsimore e Universitetit të Prishtinës është relativisht e diversifikuar sipas zhvillimeve ekonomike dhe shoqërore. Sidoqoftë, analiza më e thellë e orientimit të studentëve dhe disponueshmërisë së stafit, nxjerr shumë pikëpyetje mbi vlerën e shtuar të institucioneve rajonale. Në shumë raste, institucionet universitare publike të themeluara rishtazi, kanë ndjekur një model të zhvillimit të Universitetit të Prishtinës në miniaturë. Oferta nuk është e ndërlidhur me kërkesën në treg. Mungesa e një strategjie të qartë të zhvillimit për të avancuar interesat ekonomike dhe shoqërore të rajoneve, ka kushtëzuar zhvillime që do të mund të rrezikojnë edhe përvojën e akumuluar më herët (p.sh. industria nxjerrëse në Mitrovicë, turizmi dhe agrobiznesi në Pejë). Profilizimi i institucioneve është i domosdoshëm. Ministria mund të përdor formulën e financimit për të riorientuar studimin në fusha deficitare. Kjo mund të arrihet duke eliminuar subvencionimin, futjen e kuotave apo mosakreditimin e programeve që nuk ofrojnë vlerë të shtuar.

- Të rritet kapaciteti për të mbështetur, mbledhur të dhënat dhe sigurim të cilësisë në kërkim shkencor*** - Institucionet e arsimit të lartë janë kryesisht të orientuara në mësimdhënie. Kosova ka shënuar disa hapa të vegjël përparimi në rritje të output shkencor, mirëpo ende mbetet krahasimisht i parëndësishëm krahasuar me numrin e stafit të punësuar në arsimin e lartë. Stafi mësimdhënës duket të jetë kryesisht i përqendruar në mësimdhënie. Nuk është dokumentuar ndonjë evidencë apo përpjekje për të ndryshuar këtë trend në institucionet publike të arsimit të lartë. Pothuajse të gjitha publikimet e indeksuara në Scopus burojnë nga Universiteti i Prishtinës. Gjatë vlerësimit nuk është dokumentuar ndonjë përpjekje serioze për të ndryshuar gjendjen e infrastrukturës së kërkimit shkencor. Ministria, përmes formulës së financimit, duhet të bëjë përpjekje të promovoj shtyllën e financimit për performancë shkencore dhe zhvillim të industrisë. Në këtë mënyrë do të inkurajohej rritja e financimit për hulumtim shkencor relevant për industrinë dhe vendin.
- Të rritet investimi kapital në infrastrukturë dhe mjedise mësimore në arsimin e lartë*** - Shkalla e financimit në arsimin e lartë është rritur gradualisht që nga viti 2011. Investimet më të theksuara janë drejtuar drejt financimit të Universitetit të Prishtinës në shkallën 70 % në raport me shumën e alokuar për institucionet publike universitare. Shpenzimet kryesore janë përkushtuar për financim të kompensimit për stafin mësimdhënës dhe, në raste më të kufizuara, rritje të numrit të stafit akademik dhe administrativ. Modeli i administrimit dhe financimit nuk është uniform për të gjitha institucionet.
- Të rritet mbështetja dhe financimi për ndërkombëtarizim të arsimit të lartë*** - Kosova ka shënuar hapa pozitiv në rritje të mobiliteteve të studentëve në drejtim të BE-së dhe vendeve tjera të OECD-së. Janë dokumentuar edhe hapa inkurajues për mobilitet të stafit akademik përmes Erasmus Plus. Megjithatë, shkalla e përgjithshme e ndërkombëtarizimit mbetet e ulët. Numri i programeve të përbashkëta të studimit, numri i projekteve të përbashkëta të hulumtimit apo pjesëmarrjes në Horizon 2020 vazhdojnë të jenë të kufizuara. MASHT, duhet të investoj në inkurajim të këtyre shkëmbimeve dhe zhvillim të stafit akademik shkencor duke rritur ndjeshëm financimin për projekte hulumtimi, shkëmbimi dhe bursa për studime doktorale.
- Të kompletobet legjislacioni sekondar dhe rritet kapaciteti për implementim të Ligjit për Profesionet e Rregulluara*** - MASHT duhet t'i kushtoj një vëmendje të posaçme zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizimit Asocimit dhe kërkesave që ndërlidhen me arsimin. Zbatimi i Ligjit për Profesionet e Rregulluara, legjislacioni sekondar dhe rritja e kapacitetit institucional për zbatim të kërkesave të Agjendës Evropiane.

## 7. Konkluzione dhe Rekomandime

- Si rezultat i zhvillimeve demografike numri i nxënësve pritet të bie në nivelin e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët dhe plani i ardhshëm duhet të përfshij objektiva rreth akomodimit të këtij zhvillimi përmes optimizimit të rrjetit të shkollave dhe optimizimit të numrit të mësimdhënësve të dhënat e projeksioneve të popullsisë nënvizojnë një trend në rënie të numrit të nxënësve në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar. Ky zhvillim vjen paralel me lëvizjet e brendshme të popullsisë nga fshati në qytet dhe nga njëra komunë në tjetrën. Rënia e numrit të nxënësve krijon parakushte për rritje të efikasitetit në sistem dhe kursime financiare. Objektivi i ardhshëm duhet të konsistoj në **optimizim** të numrit të mësimdhënësve dhe **optimizimit** të numrit të shkollave. Kursimet nga arsimit parauniversitar do të mund të shërbenin për rritje të kapacitetit për rritje të përfshirjes në edukimin parashkollor.
- **Përmirësimi i sistemit të të dhënave statistikore dhe ndërlidhja e tyre është esenciale për të ngritur kapacitetin për planifikim të bazuar në evidencë dhe për monitorim të performancës së sistemit arsimor.** Duhet përmirësuar kapaciteti për mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave, aspektet sociale dhe gjinore që ndikojnë në regjistrimin dhe arritshmërinë e nxënësve dhe studentëve – Kapaciteti për të vlerësuar ndikimin e aspekteve të barazisë në regjistrim dhe arritshmëri të nxënësve është ende i kufizuar. Strategjia në vazhdim duhet të trajtoj me rëndësi të veçantë mbledhjen dhe analizimin e të dhënave rreth mundësive të barabarta në shkollim dhe aspekteve gjinore në politikbërje arsimore.
- **Modernizimi i sistemeve të vlerësimit të jashtëm të nxënësve dhe zbatimi i vazhdueshëm i modeleve ndërkombëtare të ekzaminimit ofron një input të vazhdueshëm për të informuar politikbërjen dhe mundëson bashkërendimin e qasjeve me sistemet bashkëkohore arsimore** - rritja e kredibilitetit dhe integritetit të sistemit të ekzaminimit të jashtëm të studentëve duhet të jetë objektiv i veçantë në planin e ri. Palët e interesit duhet të mendojnë aktivitetet dhe masat e domosdoshme për të siguruar që matja e rezultateve të të mësuarit, jo vetëm të jetë në përputhje me standardet më të larta etike, por të sigurohen që ato të kontribuojnë në zhvillimin e politikave për ngritje të cilësisë në shkollë. Krahas analizës së përgjithshme, palët e interesit duhet të kujdesen që të ketë një mekanizëm periodik për analizim të rezultateve të arritshmërisë, faktorëve demografik, social, ekonomik dhe arsimor. Palët, po ashtu duhet të kujdesen që arsimit parauniversitar të inkorporoj rezultatet dhe konkludimet e analizës së rezultateve të PISA 2015.
- **Të avancohet kultura e sigurimit të cilësisë përmes vlerësimit të jashtëm të shkollave** – Kosova ka një proces sistematik për vlerësim të jashtëm të performancës së shkollave i cili bazohet në UA 4/2017 për vlerësimin e performancës së institucioneve arsimore të arsimit parauniversitar. Inspektorati i Arsimit ka mandat që të zgjeroj fushëveprimin e tij përtej aktiviteteve tradicionale të monitorimit të ligjshmërisë. Plani i veprimtimit duhet të parasheh ndërtimin e strukturës institucionale dhe praktikës së vlerësimit periodik dhe ad-hoc të shkollave në nivelin parauniversitar. Ky proces duhet të përfshij vlerësim sistematik të aspekteve të menaxhimit të shkollës, zbatimit të kurrikulës, metodave të mësimdhënies dhe mësimnxënies, kuadrit dhe kualifikimeve të mësimdhënësve, mjedisit mësimor dhe infrastrukturës, resurseve mësimore (teksteve dhe laboratorëve) dhe bashkëpunimit të shkollës me palët e interesit. Gjatë realizimit të këtij procesi duhet kujdesur që të tejkalohen ndeshjet e kompetencave me trupat përgjegjës për vlerësim të jashtëm të institucioneve të arsimit të lartë dhe institucioneve të arsimit profesional. Krahas vlerësimit të jashtëm, vëmendja duhet përqendruar edhe tek promovimi i praktikës së

menaxhimit të brendshëm të cilësisë dhe mbështetjes së shkollave në zbatimin e praktikës së vetëvlerësimit.

- **Zbatimi i sistemit të vlerësimit të performancës** së mësimdhënësve, licencimit dhe skemës së promovimit është tejet i rëndësishëm si masë për rritje të cilësisë dhe llogaridhënies në sistemin e arsimit *parauniversitar* -procesi i licencimit të mësimdhënësve është iniciuar qysh nga viti 2011, mirëpo i njëjti nuk është zbatuar në tërësi. Viteve të fundit janë përpiluar dhe miratuar udhëzimet administrative në lidhje me vlerësimin e performancës dhe zhvillimit profesional të mësimdhënësve dhe kanë filluar të zbatohen në të gjitha komunat. Zbatimi i sistemit të vlerësimit të performancës kërkon definimin e qartë të strukturës institucionale, eliminimin e praktikës së rritjes lineare të pagesave të mësimdhënësve dhe ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm për mbështetjen dhe matjen e zhvillimit profesional të mësimdhënësve.
- **MASHT duhet të zhvilloj dhe zbatoj një formulë financimi që promovon performancën** në arsimin profesional, arsim të *të rriturve, arsimin e lartë dhe shkencë* – ende nuk ka një strukturë të unifikuar dhe model të financimit për arsimin e lartë dhe arsimin profesional. Formula e financimit duhet të kategorizohet në atë mënyrë që akomodon nevojat e ndryshme të profileve të arsimit profesional dhe promovon performancën në arsim të lartë. Po ashtu, MASHT duhet të shqyrtoj formën adekuate të ndërlidhjes së financimit të kërkimit shkencor në kuadër të institucioneve të arsimit të lartë për të inkurajuar si kërkimin shkencor ashtu edhe ndërlidhjen e edukimit, kërkimit shkencor dhe inovacionit. Ende nuk ka provizione të qarta në lidhje me modalitetet e financimit publik të arsimit tërëjetësor. Plani i ardhshëm duhet ta konsideroj këtë prioritet dhe të promovoj mekanizmin e ko-financimit të arsimit tërëjetësor.
- **Të avancohet praktika e matjes, analizës dhe reflektimit mbi rezultatet e arritshmërisë** së nxënësve në nivel qendror, komunal dhe shkollor - Publikimi i rezultateve të arritshmërisë së PISA 2015, ka ndikuar në rritje të kërkesës së shoqërisë për arsim më cilësor. Në kuadër të rezultateve dokumentohen rezultate krahasimisht të ulëta në arritshmëri të përgjithshme, matematikë, shkencë dhe lexim. Vlerësime të ngjashme janë nxjerrë edhe nga vlerësimet e vazhdueshme të jashtme të arritshmërisë së nxënësve në Testin e Semimaturës dhe Maturës. Këto zhvillime kanë kushtëzuar ndryshime të theksuara në paradigmen e menaxhimit të sistemit arsimor. Kërkesa për rezultate dhe llogaridhënie, resurset e kufizuara dhe presioni i vazhdueshëm demografik e bëjnë të domosdoshme fuqizimin e një sistemi të integruar të planifikimit, raportimit dhe vlerësimit. MASHT ka ndërtuar kapacitete të theksuara në dokumentim të inputeve në sistemin arsimor. Sidoqoftë, kërkohet *ripërqëndrim* të vëmendjes në dokumentim të vazhdueshëm të *outputeve* të sistemit. Kjo e bën të nevojshme edhe ndërtimin e kapaciteteve organizative dhe njerëzore për planifikim, komunikim me komunat, komunikim me Agjencitë e pavaruara dhe Ministrinë tjetra të linjës për avancim të administrimit të sistemit.
- **Të zhvillohet dhe avancohet kapaciteti për ndërlidhje ndërmjet shkollimit dhe konkurrueshmërisë ekonomike** - Kosova është përkushtuar për avancim të konkurrueshmërisë si mjet drejt përmirësimit të standardit jetësor. Të njëjtat prioritete janë listuar edhe në kuadër të Agjendës së Reformës Evropiane, Planin për Zbatim të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, Planit për Zhvillim Kombëtar dhe Programit për Reforma Ekonomike. *Përfshirja në arsim, relevanca e programeve të studimit dhe cilësia e tyre janë input thelbësor në ndërtim të kapitalit njerëzor*. Përparimi në dimensionin e kapitalit njerëzor është tejet i rëndësishëm për të eksploruar potencialet tjera ekonomike të vendit në industri nxjerrëse, energji, bujqësi, prodhim dhe shërbime. Kjo është bërë edhe më urgjente në sajë të ekspozimit të ekonomisë së vendit ndaj presionit konkurrues global. Në kuadër të Raportit të OECD mbi Konkurrueshmërinë në Evropën Juglindore dhe Studimit të

Bankës Botërore mbi Mjedisin Biznesor dhe Performancën e Ndërmarrjeve nënvizohet shkallë e ulët e produktivitetit të fuqisë punëtore dhe mungesë e shkathtësive relevante për tregun e punës.

- Të përshpejtohet procesi i përmbushjes së prioriteteve që dalin nga Agjenda e Reformës Evropiane dhe Marrëveshjes për Stabilizim Asociim*** - Në kuadër të procesit të integritimit evropian, Kosova është përkushtuar për rritje të kapacitetit financiar, administrativ dhe njerëzor në adresim të prioriteteve që dalin në dimensionin e arsimit dhe shkencës. Viteve të fundit është rritur vetëdija mbi nevojën e luftimit të fenomenit të braktisjes së shkollimit. *Shkalla e braktisjes është në nivele të krahasueshme me vendet e avancuara.* Shkalla e pjesëmarrjes në arsim të obliguar është pothuajse universale. Sfidat e shkollimit dhe përfshirjes së femrës në arsim është tejkaluar duke arritur paritet gjinor. Megjithatë, *shkalla e përfshirjes së grupeve të ndjeshme shoqërore nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian është ende e ulët krahasuar me mesataren kombëtare.* Në anën tjetër, përmirësimi i cilësisë së arsimit është ngushtë i lidhur me vitet e ndjekjes së shkollimit dhe shkallës së përfshirjes në arsim parashkollor. Vitet mesatare të ndjekjes së shkollimit në Kosovë vazhdojnë të jenë nën mesataren e vendeve të avancuara. Shkalla e përfshirjes në edukim parashkollor vazhdon të jetë e ulët dhe nën mesataren e vendeve të OECD.
- Të zbatohet një sistem i binjakëzimit të modelit arsimor me vende simotra me sisteme të avancuara shkollore*** - Në bazë të analizave ekonometrike, shkalla e arritshmërisë dhe cilësisë në arsim është e ndërlidhur me nivelin e përfshirjes në edukim parashkollor, shkallën e financimit për kokë nxënësi, nivelin e përgjithshëm të të hyrave për kokë banori, shkallën e kualifikimit të mësimdhënësve, cilësia e kurrikulës dhe mësimdhënies, cilësia e resurseve arsimore dhe infrastrukturës dhe modeli i administrimit të shkollës. Përparimi në arsim është domosdoshmërisht i ndërlidhur me nivelin e përgjithshëm të përparimit politik, shoqëror dhe ekonomik. Një pjesë e faktorëve që ndikojnë në arritshmëri dhe cilësi arsimore varen nga politikbërja dhe administrimi. *Kapaciteti për të planifikuar politikën, monitoruar progresin dhe vlerësuar efektshmërinë duhet të rritet.* Duhet të bëhet analizë më e thellë për të dokumentuar modelet e suksesshme arsimore të vendeve me madhësi të ngjashme të administratës dhe popullsisë. Estonia dhe Letonia janë shembuj për t'u eksploruar për shkak të arritshmërisë së lartë të nxënësve me shpenzime më të kufizuara se vendet tjera të OECD.
- Të rritet niveli i shpenzimeve të përgjithshme në arsim së paku 4.6 % e BPV/GDP*** - Përgjithësisht, shkalla e shpenzimeve arsimore në arsim është ende e ulët. Shpenzimet kombëtare në arsim në raport me shpenzimet e përgjithshme qeveritare dhe në raport me bruto produktin kombëtar janë të krahasueshme me trendet botërore. Sidoqoftë, Kosova ka strukturë të ndryshme të popullsisë dhe pjesëmarrje të lartë të popullsisë së re. *Numri i nxënësve është pothuajse dyfishi i vendeve me numër të ngjashëm të popullsisë në Evropë.* Kjo e bën të domosdoshme rritjen e shpenzimit në sektor. Rritja e shpenzimeve në arsim vitet e fundit është destinuar kryesisht për të rritur barrën e financimit të rrogave të mësimdhënësve.
- Në bazë të projeksioneve të rritjes ekonomike (IMF, 2018) Kosova pritet të ketë një normë mesatare të rritjes ndërmjet 3.5- 4 % për qind deri në vitin 2021. MASHT duhet të insistoj të fiksohet shkalla e financimit vjetor për arsimin në së paku 4.6 % për qind të GDP. Përmes indeksimit të shpenzimeve të përgjithshme në arsim, Kosova jo vetëm do të jetë në gjendje të përafrohet me praktikën e vendeve me të ardhura të mesme, por edhe do të ketë mundësi të ndërtoj një politikë më afatgjatë të investimeve për cilësi.



- Të prioritetizohet investimi në përfshirje në edukim parashkollor, komuniteteve, nxënësve me nevoja të veçanta dhe resurse mësimore*** - Mësimdhënësit në Kosovë kanë arritur kompensim adekuat krahasuar me të ardhurat mesatare të popullsisë. Rritja e pagave duhet të ndërlihet me një sistem të verifikueshëm të rritjes së performancës së mësimdhënësve. Gjithashtu, *rritja e shpenzimeve në arsim duhet të prioritetizoj* përfshirjen e grupeve të ndjeshme shoqërore dhe nxënësve me nevoja të veçanta. Financimet shtesë në sektor duhet të orientohen edhe në rritje të kapacitetit absorbuës në edukim parashkollor. Arsimi profesional është tejet i rëndësishëm dhe kërkon investime shtesë në infrastrukturë dhe mjete të konkretizimit. Financimi i arsimit të lartë është i orientuar vetëm në mësimdhënie. Kjo duhet të ndryshoj përmes miratimit të një formule të re të financimit që shpërblen kërkimin shkencor dhe ofrimin e studimeve në sferat deficitare për ekonominë e vendit.
- Të avancohet praktika e Sistemit të Integruar të Planifikimit*** - Është nxjerrë rregullativa ligjore që sistematizon procesin e planifikimit dhe menaxhimit ndërmjet hallkave të qeverisjes në sistemin e arsimit parauniversitar, arsim profesional dhe arsim të lartë. Procesi është i modeluar sipas qasjes së bazuar në tërë sistemin. Megjithatë, ky mekanizëm është ende në fazat fillestare. Në kuadër të Planit të Veprimit nuk janë vendosur caqe apo objektiva tjera në lidhje me komunikimin lartë-poshtë, poshtë-lartë dhe komunikimi anësor me hisedarë të sistemit. Gjithashtu, nuk reflektohet ndonjë vëmendje e posaçme në modelin e administrimit të sistemit, shkallës së centralizimit dhe definimit të saktë të roleve dhe përgjegjësi. Në kuadër të Planit të Veprimit duhet të reflektohet përpjekja për institucionalizim të praktikës së planifikimit, monitorimit dhe raportimit të integruar. Në kuadër të aktiviteteve duhet të inkorporohen synimet për funksionalizim të Komisionit për Menaxhim Strategjik dhe Komisioneve Programore.
- Të sistematizohet praktika e menaxhimit arsimor në komuna dhe shkolla*** - Menaxhimi i sistemit duhet të reflektoj shërbimet kryesore në shkolla (edukim parashkollor, arsim profesional, arsim themelor dhe arsim i lartë) dhe shërbime mbështetëse (planifikim, legjislacion, infrastrukturë, IT, tekste mësimore, zhvillim të mësimdhënësve, financa, prokurim). Në model i tillë i administrimit duhet të vendoset si në nivel komune ashtu edhe në nivel qendror. Një sistematizim i vendeve të punës, përshkrim i kompetencave dhe përgjegjësi duhet të realizohet në të ardhmen e afërt. Në kuadër të Planit të Veprimit të PSAK, duhet të integrohet përpjekja për nxjerrjen e Udhëzuesve Standard të Menaxhimit të Drejtorive Komunale dhe Vendeve të Punës.
- Të avancohet praktika e analizës së të dhënave mbi rezultatet dhe impaktin e politikave*** - Është e rëndësishme të rritet kapaciteti për të mbledhur të dhënat mbi rezultatet e veprimeve, legjislacionit, destinacionit të nxënësve dhe studentëve. Gjithashtu, me reformën e procesit të planifikimit në nivel qendror është inkorporuar dimensionin e analizës së sensitivitetit dhe ndikimit. Këto procese kushtëzojnë analiza më të avancuara ekonometrike mbi impaktin e politikave. MASHT duhet të jetë në gjendje të përcaktoj efektshmërinë e investimeve dhe rregullimit në arritje të rezultateve të synuara.
- Të përshejtohen përpjekjet për miratim të formulës së re të financimit në arsimin parauniversitar*** - Reforma e formulës së financimit është në fazat e hershme. Janë ndërmarrë një seri e veprimeve drejt inkuadrimit të grupeve të caktuara në formulë të financimit dhe ndërlihdjes me rezultatet. Vendet e avancuara kryesisht zbatojnë formula të financimit me disa shtylla. Një nga shtyllat e formulës mund të jetë formula aktuale e bazuar në kokë nxënësi. Shtyllat tjera mund të vendosen varësisht nga prioritetet dhe grupet e synuara: mësimi për nxënës me nevoja të veçanta, mësimi për nxënës në distanca të caktuara, shtylla për nxënës më asistencë sociale, shtylla për nxënës të gjuhës joamtare, shtylla për zhvillim profesional të mësimdhënësve, shtylla për infrastrukturë dhe shtylla për performancë.

- ***Të rritet shkalla e investimeve kapitale në arsimin parauniversitar me qëllim të prioritizimit të infrastrukturës së brendshme dhe resurseve shkollore - Shkalla e investimeve kapitale në arsim ka rënë ndjeshëm. Kjo ka rezultuar nga rialokimi i mjeteve drejt rritjes së shkallës së kompensimit për mësimdhënës. Trendi aktual nuk lejon përmbushjen e cazeve të vendosura në Planin e Veprimit mbi renovimin, ndërtesat e reja dhe pajisjet shkollore. Vitet e fundit është prioritizuar nevoja e reduktimit të numrit të nxënësve në klasë dhe mësimin në ndërrime. Megjithatë, nuk ka ndonjë evidencë konkluzive që dëshmon ndërlikime të fortë ndërmjet proporcionit nxënës – klasë dhe arritshmërisë së nxënësve. Komunitet me arritshmëri të ulët të nxënësve në Testin e Semimaturës, kanë numër kryesisht të ulët të nxënësve në klasë, mirëpo kjo nuk ka adresuar kërkesën shoqërore për rezultate më të larta.***
- ***Të rishikohet Plani i investimeve në nivel qendror dhe komunal për të reflektuar revidimin e projeksioneve të popullsisë - Kjo e bën të domosdoshëm lansimin e një studimi mbi rizonimin kombëtar të shkollave konform Planit Kombëtar Hapësinor. Kapaciteti infrastrukturor dhe njerëzor i shkollës duhet të peshohet me projeksionet dhe variablat tjera siç janë lëvizjet e brendshme të popullsisë dhe rënies demografike. Themelimi i rrjetit të shkollave do të lehtësonte sfidat që dalin nga mobiliteti i brendshëm i nxënësve.***
- ***Të zbatohet plani për profilizim të mësimdhënësve - është e rëndësishme të zbatohet dhe inkorporohet në planifikim, synimi për profilizim të mësimdhënësve. Kjo ngase ekziston evidencë e gjerë shkencore mbi kthimin në investim. Në kuadër të profilizimit duhet të vështrohet me prioritet nevoja e rritjes së numrit dhe cilësisë së mësimdhënësve në sferat STEM – shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë. Në bazë të analizave krahasimore në PISA 2016, shkollat në Kosovë, kryesisht në viset rurale, ballafaqohen me mungesë të kuadrit të kualifikuar në këto fusha.***
- ***Të lansohet procesi i optimalizimit të shkollave - Shkollat në vendet e OECD kanë mesatarisht 769 nxënës dhe 34 mësimdhënës. Kosova ka mesatarisht 341 nxënës për shkollë. Kosova karakterizohet për nga modeli i shkollave të vogla. Rreth 60 % për qind të shkollave nën 250 nxënës. Mbi 200 shkolla (paralele të ndara) funksionojnë me nën 50 nxënës apo rreth 4 nxënës për klasë. Operimi i këtyre paraleleve duhet të shqyrtohet jo vetëm për shkak të jo-eficiencës së theksuar buxhetore, por edhe për shkak të cilësisë së dobët të mësimdhënies. Kosto mesatare vjetore për operim të një institucioni shkollos është rreth 196,532,371 euro. Shpenzimi mesatar vjetor i një shkolle me mbi 2000 nxënës është rreth 4 herë më i lartë se shpenzimi mesatar vjetor i një shkolle me rreth 100 nxënës. Prishtina ka mesatarisht rreth 610 nxënës për shkollë pasuar nga Mitrovica me 445 dhe Ferizaj 430. Shkollat që operojnë në zonën urbane të Prishtinës, Mitrovicës, Ferizaj, Fushë- Kosovës dhe Prizrenit kanë ngarkesë më të lartë. Kjo ofron indikacione mbi investimet potenciale në të ardhmen.***
- ***Të rishikohet modeli i menaxhimit të shkollës për të avancuar rolin e drejtorit dhe mësimdhënësve në proces mësimor - Shumica (73%) e vendeve të avancuara të OECD-së operojnë një model menaxhimi arsimor ku shkollat kanë autonomi të theksuar në përcaktim të resurseve, kurrikulës, teksteve mësimore, mësimdhënësve dhe metodave të mësimnxënies. Modeli i menaxhimit thekson rëndësinë e këshillit të shkollës, mësimdhënësve dhe prindërve në vendimmarrje. Shumica e prindërve (52 %) në vendet e OECD-së kanë marrë pjesë aktive në shkollë dhe në mbështetje të fëmijëve të tyre. Në rreth 32 % për qind të rasteve, shkollat janë mbështetur edhe nga komuniteti për zbatim të aktiviteteve shkollore dhe ekstrakurrikulare. Modeli i menaxhimit të shkollës në Kosovë ndryshon thelbësisht në krahasim me modelet e vendeve me arritshmëri të lartë të nxënësve në PISA të OECD. Përgjegjësia primare për administrimin, stafin, resurset dhe rezultatet e shkollës varet nga drejtori i shkollës. Komuna, Këshilli i Shkollës dhe në***



disa raste Ministria, përzgjedhin Drejtorin bashkërisht. Roli i Ministrisë është të mbështes shkollën duke përcaktuar kriteret fillestare të kompensimit të stafit dhe standardet bazë të kurrikulës. Komuna mbështet drejtorin në planifikim buxhetor dhe në disa raste, në bashkëpunim me Ministrinë, përcakton rrogën bazë dhe vendimet për rritje të rrogave të stafit.

- Drejtori i shkollës sipas modelit të vendeve me sisteme të avancuara arsimore ka përgjegjësinë për përzgjedhjen e mësimdhënësve, shkarkimin e tyre, rritjen e rrogës, planifikim buxhetor, masa disiplinore, përcaktimin e rregullave të pranimit dhe vlerësimit të nxënësve dhe përmbajtjen e lëndëve. Mësimdhënësi është përgjegjës për përcaktimin e përmbajtjes së lëndës, kurrikulës, rregullave të vlerësimit dhe teksteve mësimore. Këshilli i shkollës është më tepër i orientuar në përcaktim të kurrikulës, përmbajtje të lëndëve, rregullave të vlerësimit dhe masave disiplinore. ***Përgjithësisht, shkolla është përgjegjëse për gjithë procesin mësimor. Ministria dhe komuna ofrojnë mbështetje në aspekte më të kufizuara si përcaktimi i kriterëve minimale të kurrikulës, kriterëve të rrogës bazë, kriterëve për rritje të rrogës dhe planifikim buxhetor. Modeli i menaxhimit të shkollës është i ndërtuar në atë mënyrë që shfuqizon shkollën nga përgjegjësia për rezultatet.*** Mësimdhënësit dhe drejtorët e shkollës kanë perceptimin që përgjegjësia e tyre është e kufizuar në mësimdhënie, vlerësim të nxënësve dhe masave disiplinore. Për ndryshim nga vendet e avancuara të OECD, drejtori i shkollës dhe mësimdhënësit nuk kanë përgjegjësi në përcaktim të kurrikulës, përmbajtjes së lëndës dhe teksteve mësimore. Drejtorët e shkollave janë të kufizuar në administrim të shpenzimeve, pranim të nxënësve dhe masave disiplinore. Për dallim nga vendet e OECD, ata nuk perceptojnë se është përgjegjësi e tyre të angazhohen në përmbajtje të lëndëve, rregullat e vlerësimit të nxënësve, planifikim buxhetor, përzgjedhje të stafit, vlerësim të stafit apo shkarkim të tyre. Këshilli drejtues i shkollës, është më tepër i kufizuar në planifikim buxhetor, mbikëqyrje të shpenzimeve dhe masave disiplinore.
- Të ***prioritizohet investimi në infrastrukturë të brendshme dhe dhoma leximi*** - Vetëm 19 % për qind e nxënësve raportojnë se në shkollat e tyre ka hapësirë për lexim dhe punë shkollore. Kjo shifër është jashtëzakonisht e ulët në krahasim me mesataren e OECD-se ku rreth 75 % e nxënësve u ofrohet një mundësi e tillë.
- ***Të avancohet procesi dhe procedura e regjistrimit të individualizuar të zhvillimit profesional*** - Kosova ofron krahasimisht më pak orë trajnimi dhe zhvillimi profesional për mësimdhënësit krahasuar me vendet e avancuara të OECD. Në analizën ekonometrike dhe regresionit linear është dokumentuar *ndërlidhje dhe variabilitet i lartë në shkallë të arritshmërisë* së nxënësve ndërmjet vendeve që (nuk) investojnë në zhvillim profesional. Shkalla e financimit për zhvillim profesional të mësimdhënësve është më pak se 0.3 për qind e buxhetit të përgjithshëm në arsim. Alokimi i rreth 667,000 euro në vitin e kaluar është ende vetëm 74 % e nivelit të financimit të vitit 2011. Ulja e shkallës së investimit mund të ketë ndikuar në ulje të shkallës së përfshirjes dhe numrit mesatar të orëve të kaluara në zhvillim profesional.
- ***Të avancohet sistemi dhe cilësia e programeve të zhvillimit profesional*** - Rritja e shkallës së përfshirjes së mësimdhënësve në zhvillim profesional dhe ofrimi i trajnimeve nuk është domosdoshmërisht kontribut i drejtpërdrejtë në arritshmëri të nxënësve. Kërkohej që krahas rritjes së shkallës së përfshirjes të sigurohet që ato janë cilësore dhe të përshtatshme për profilin e mësimdhënësit. MASHT ka kompletuar bazën ligjore rreth sistematizimit të procesit të zhvillimit profesional të mësimdhënësve. Këto zhvillime kanë ofruar sqarime të theksuara mbi ndarjen e përgjegjësisve të hisedarëve në proces. Megjithatë, shkalla e kontributit financiar nga komunat për këtë prioritet ende mbetet e parëndësishme. Është e rëndësishme që të punohet me universitetet publike rajonale për të krijuar qendra hulumtimi dhe zhvillimi profesional të mësimdhënësve.

- ***Të definohet politika dhe sistemi i rritjes së pagave bazuar në performancë*** - Rritja e rrogave të mësimit duhet të bazohet të performanca gjatë shërbimit. Kosova ka bërë hapa të theksuar në përmirësim të standardit jetësor dhe kompensimit të mësimit. Të hyrat mesatare vjetore të kuadrin mësimit tejkalojnë ndjeshëm të hyrat mesatare për kokë banori. Këto hapa janë marrë në mënyrë lineare për të gjithë mësimit. Janë bërë pak përpjekje për të diferencuar kuadrin mësimit sipas parametrave të performancës. Gjatë vitit të kaluar është rishikuar dhe miratuar baza ligjore mbi kompetencat e mësimit dhe vlerësimit të performancës. Një pilot projekt me përfshirje të kufizuar është në përfundim e sipër. Rritja e kompensimit duhet të mbështetet në performancën e mësimit në shërbim. Vendimet për rritje të kompensimit duhet të mbështeten në procesin e vlerësimit të performancës dhe gradimit. Duhet të shmanget rritja lineare e rrogave të mësimit. Rritja e rrogave e indeksuar sipas nivelit të rritjes ekonomike duhet të përcillet edhe me përpjekje për të rritur normën e punës së mësimit. Kosova ka krahasimisht normë më të ulët të angazhimit të mësimit krahasuar me vendet e tjera të OECD.
- ***Të rritet kriteri për praninë në programet e kualifikimit të mësimit në favor të tërheqjes së nxënësve më të mirë në profesion*** - Është dokumentuar që ekziston një ndërlidhje e fortë ndërmjet nivelit të kualifikimit të mësimit dhe arritshmërisë së nxënësve. Kosova duhet të bëjë përpjekje të eliminojë praktikën e inkuadrimit të mësimit të paprofilizuar në mësimit. Një vëmendje e posaçme kërkohet në fuqizim të institucioneve dhe programeve të përgatitjes së mësimit para shërbimit. Shkalla aktuale e pranimit të studentëve në Fakultete të Edukimit është shumë më e lartë sesa kërkesa për mësimit në treg. Kosova ka në proces të natyrshëm të pensionit të rreth 650-700 mësimit brenda vitit. Vendet vjetore të studimit do të duhej të ishin të kufizuara në rreth 1000 apo 5000 për konkurruesit e ciklit master. Kërkohet zbatim i kriterëve më të larta në procesin e pranimit.
- ***Të sistematizohet përkrahja dhe trajnimi për mësimit për punë me nxënësit përtej instruksionit teorik*** - Vetëm 29 % për qind e nxënësve raportojnë të kenë pranuar ndihmë nga mësimit për kryerjen e detyrave të shtëpisë. Sipas OECD (2016), kjo përbën shkallën më të ulët në vendet e OECD dhe vendeve partnere. Në vendet e OECD rreth 70 % për qind e nxënësve raportojnë të jenë ndihmuar nga mësimit e tyre.
- ***Të organizohet provimi shtetëror për profesionin e mësimit*** – Në shumicën e vendeve të OECD, mësimit i nënshtrohen provimit kombëtar për hyrje në profesion. Ky provim shtetëror është i organizuar pas përfundimit të ciklit 5-7 vjeçar të studimeve mbi profesionin dhe teston shkallën e arritjes së kompetencave. Certifikata e provimit shtetëror është parakusht për të aplikuar për mësimit.
- ***Të sanksionohet nevoja e praktikës profesionale për mësimit si parakusht për hyrje në profesionin e mësimit*** – në shumicën e vendeve të OECD, mësimit duhet të nënshtrohen praktikës profesionale. Në disa raste praktika profesionale është pjesë integrale e kurrikulës së studimit. Zakonisht viti i fundit i studimit (60 ECTS), i dedikohen kompletimit të praktikës profesionale. Praktika profesionale është e obliguar dhe duhet të përfundohen në një nga shkollat që ofron profilin e specializimit të mësimit.
- ***Të organizohet vlerësim i vazhdueshëm për profesionin si parakusht i licencimit*** - licencimi periodik është parakusht në shumicën e vendeve me sisteme të avancuara arsimore. Në disa raste mësimit kërkohet të përfundojnë kurse me ekzaminim si parakusht i rilicencimit. Kjo mund të jetë mekanizëm i sigurimit të cilësisë në mësimit. Kjo është e nevojshme edhe për

të siguruar minimumin e kriterëve dhe cilësisë në një sistem të decentralizuar të përzgjedhjes së mësimdhënësve.

- ***Të rritet financimi për zhvillim profesional të mësimdhënësve*** - Ministria duhet të synoj që deri në vitin 2021 të rritet buxheti për zhvillim profesional të mësimdhënësve në 1% të shpenzimeve të përgjithshme për arsimin parauniversitar. Fondi për zhvillim profesional të mësimdhënësve duhet të inkurajoj pjesëmarrjen nga komuna dhe mësimdhënësi. Fondi aktual për zhvillim profesional të mësimdhënësve është tejet i ulët dhe me pjesëmarrje pothuajse inekzistente nga palët tjera të interesit.
- ***Të avancohen përpjekjet dhe resurset për zbatim të kurrikulës së re*** në të gjitha shkollat dhe nivelet - Ka filluar zbatimi i kurrikulës së re në të gjitha shkollat e Kosovës. Kjo ka ardhur pas një periudhe relativisht të gjatë të përgatitjes dhe pilotimit. Kurrikula nënkupton ndryshim të theksuar në paradigmen arsimore, duke vendosur theksin tek kompetencat e nxënësve. Sidoqoftë, zbatimi i suksesshëm i kurrikulës varet nga kapaciteti administrativ, njerëzor dhe infrastrukturor. Në aspektin strukturor nxënësit do të jenë në gjendje të përfitojnë të gjitha njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat e nevojshme. Sidoqoftë, kjo varet edhe nga pesha dhe normat e shpërndarjes së orëve mësimore.
- ***Të sigurohet trajnim i mësimdhënësve për metodat e reja të vlerësimit për të inkurajuar pjesëmarrjen dhe mësimnxënien*** - Kurrikula e re kushtëzon metoda të reja të mësimdhënies duke e bërë të nevojshëm trajnimin e vazhdueshëm të stafit mësimdhënës. Zbatimi në disa raste mund të ndeshet me mungesë të stafit adekuat dhe hendekun ndërmjet kualifikimeve të mësimdhënësve dhe lëndëve të studimit. Reforma kurrikulare kushtëzon edhe metoda të reja të vlerësimit dhe mësimnxënies. Këtu nënvizohet rëndësia e trajnimit të vazhdueshëm mbi metodat e vlerësimit të mësimnxënies së bazuar në kompetenca. Kërkohet mbështetje e vazhdueshme në formë të udhëzimeve standarde në ato fusha ku zbatohet mësim integruar i disa lëndëve.
- ***Të rishikohen metodat e vlerësimit në favor të inkurajimit të vlerësimit të vazhdueshëm të mësimnxënies*** - Mësimdhënësit në Kosovë zbatojnë vlerësime kryesisht të rralla të nxënësve. Sipas të dhënave të OECD (2016) një nxënës i nënshtrohet vlerësimit kryesisht një herë brenda semestrit. Kjo përbën një anomali në krahasim me vendet e avancuara të OECD ku nxënësi vlerësohet në mënyrë të vazhdueshme apo rreth 4-5 herë brenda semestrit. Rreth 90 % për qind e nxënësve në Estoni i nënshtrohen vlerësimit përmes testeve të zhvilluara nga mësimdhënësi çdo muaj. Vlerësimi i vazhdueshëm mund të promovoj pjesëmarrjen dhe stimuloj mësimnxënien
- ***Të rritet financimi për zbatim të kurrikulës së re*** - Procesi i zbatimit kërkon më shumë resurse arsimore duke përfshirë rritje të financimit për administrim, tekste mësimore dhe mjete të konkretizimit. Në bazë tëurvejimit të udhëheqësve të shkollave në Kosovë (2015), këto ngecje vazhdojnë të ndikojnë negativisht në procesin e mësimnxënies. Vëmendje e posaçme duhet kushtuar investimeve në teknologji të komunikimit dhe informimit si në administrim ashtu edhe në mësimdhënie/mësimnxënie. Kosova ka krahasimisht shkallë të ulët të integritit të TIK në mësimdhënie. Në vendet e OECD, pothuajse të gjitha klasat janë të pajisura me projektor dhe tabela smart.
- ***Të inkurajohet kontributi i shkollës dhe mësimdhënësve në përmbajtjen e kurrikulës dhe lëndëve*** - Shkollat dhe mësimdhënësit në Kosovë, përceptojnë se kanë përgjegjësi të kufizuara në përcaktim të përmbajtjes së kurrikulës dhe përmbajtjes së lëndëve. Megjithatë, kurrikula bërthamë inkurajon shkollat të avancojnë lëndë të reja zgjedhore që mund të avancojnë kompetencat e

nxënësve. Kjo praktikë korrespondon me zhvillimet në vendet me sisteme të avancuara arsimore të OECD. Shkolla ka përgjegjësi të theksuara në përcaktimin e kurrikulës dhe përmbajtjes së lëndëve.

- ***Të inkurajohen aktivitetet ekstrakurrikulare dhe të ofrohet infrastrukturë mbështetëse për shkollat*** – Kosova duhet të promovoj aktivitetet ekstrakurrikulare për të zhvilluar potencialin e nxënësve në orkestër, muzikë, gazetë shkollore, vullentarizëm, klubet e shkencës, garat shkollore, komunale dhe kombëtare, klubet e teknologjisë informative, klubet e artit, shahut dhe sporteve. Kosova ka një traditë të organizimit të aktiviteteve ekstrakurrikulare. Megjithatë, ajo duhet të shtrihet dhe mbështetet në të gjitha shkollat dhe posaçërisht në viset rurale ku dokumentohet një pjesëmarrje më e ulët (OECD, 2016).
- ***Të shtohen përpjekjet për monitorim të zbatimit të ngarkesës së nxënësve në shkollë*** - Kosova duhet të zbatoj një ngarkesë mesatare prej 28-30 orë për javë për t'u përafuar me vendet e OECD. Monitorimi nuk duhet të kufizohet vetëm në faktin nëse plani mësimor konsiston në këtë ngarkesë. Monitorimi duhet të shërbejë që secili nxënës të plotësojë një normë minimale prej 30 orë mësimi në shkollë dhe rreth 15-20 orë shtesë punë në shtëpi.
- ***Të shtohen përpjekjet për monitorim dhe harmonizim të ngarkesës mësimore në lëndët matematikë dhe shkencë*** - Kosova duhet të sigurojë një normë minimale javore prej 4 orë matematikë dhe 4 orë lëndë shkencore. Monitorimi nuk duhet të kufizohet në atë nëse plani mësimor përkushtohet për një minimum të tillë. Monitorimi duhet të përqendrohet që secili nxënës të ketë ndjekur një praktikë të tillë me rreth 8 orë javore në matematikë dhe shkencë dhe rreth 8 orë punë shtëpie.
- ***Të sigurohen tekste adekuate dhe të shqyrtohet liberalizimi i politikës së teksteve mësimore*** – zbatimi i kurrikulës së re kërkon tekste mësimore më të avancuara. Kosova duhet të shqyrtoj mundësinë e adaptimit të teksteve ndërkombëtare në fushat e shkencave ekzakte. Në kuadër të teksteve mësimore vëmendje të posaçme duhet përkushtuar edhe Teksteve Udhëzuese për Mësimdhënësit. Në krahasim me vendet e tjera të OECD-së, Kosova zbaton një politikë tejet konservative në tekste mësimore. Librat kryesisht përcaktohen nga niveli qendror dhe mësimdhënësit dhe shkollat përceptojnë që nuk është në domenin e kompetencave të tyre të angazhohen në këtë drejtim. Në shumicën e vendeve të OECD, mësimdhënësit, shkollat dhe këshilli i shkollës angazhohen aktivisht për të kontribuar në përzgjedhjen e teksteve mësimore dhe ofrimin e teksteve alternative.
- ***Të lansohet një studim mbi meritat e zgjatjes së orës mësimore*** në 60-90 minuta – Zgjatja e orëve mësimore është praktikë mjaft e përhapur në vende të ndryshme partnere dhe të OECD-së. Kjo vjen në sajë të gjetjeve shkencore që favorizojnë një qasje të tillë në kontekst të mësimin interaktiv. Zgjatja e orëve mësimore apo ofrimi modular mund të shmangin problemet ergonomike dhe shëndetësore që burojnë nga nevoja e nxënësve për çanta të mëdha. Kjo do të ishte sidomos e rekomandueshme për të eliminuar shpenzimet infrastrukturore në dollapë shkollor.
- ***Të shtohet përpjekjet për inkurajim të pjesëmarrjes së nxënësve në profesionet që ndërlidhen me bujqësinë, shërbimet, përpunimin dhe prodhimin industrial*** - Ekziston një baraspeshë e orientimit të nxënësve të shkollimit të mesëm të lartë në arsim profesional dhe gjimnaze të përgjithshëm. Nga analiza më e thellë e orientimit të nxënësve në bazë të profileve/fushave të studimit vërehet në tendencë në rritje e orientimit në sferat e mjekësisë (infermieri, teknologji mjekësore, farmaci, radiologji), administrim biznesi dhe shkenca kompjuterike. Këto profesione

kryesisht ndërlidhen me ekonominë e shërbimeve. Orientimi i përgjithshëm i nxënësve në prodhim/përpunim dhe bujqësi është tejet i ulët. Rritja e kapitalit njerëzor në industri dhe bujqësi është i domosdoshëm për të stimuluar rritjen e qëndrueshme ekonomike dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

- ***Të avancohet mekanizmi dhe procedura për ndërlidhje të ofertës arsimore me kërkesën e tregut të punës*** - Analiza e kërkesës dhe ofertës në arsimin profesional është në fazën e hershme të zhvillimit. Këto vështirësi në ndërlidhje sistematike të vendeve të studimit me kërkesën në treg mund të burojnë nga mungesa e familjarizimit dhe komunikimit ndërministror. Kosova filimisht duhet të përcaktoj fushat prioritare të zhvillimit ekonomik. Të njëjtat duhet të komunikohen dhe barten në Këshillin Ndërministror për implementim. Implementimi nuk mund të kufizohet vetëm në listimin e qëllimeve të mira. Kërkohet prioritizim i ndërlidhjes në formë të financimit dhe kapacitetit të shtuar administrativ dhe njerëzor.
- ***Të ndërlidhet profilet me Kornizën Kombëtare të Profesioneve*** - Profilet e arsimit profesional duhet të rishikohen në atë mënyrë që i inkorporon kompetencat e profesionit në kurrikulë mësimore, staf mësimdhënës dhe infrastrukturë. Profilet duhet të jenë të standardizuara sipas emërtimeve të Kornizës Kombëtare të Profesioneve dhe Kualifikimeve. Matja e ofertës dhe kërkesës do të duhej integruar disa metoda: Anketa e Fuqisë Punëtore të ASK mbi numrin e të punësuarve sipas profesioneve, LMIS i Ministrisë së Punës mbi dinamikën e vendeve të reja të punës dhe Eurostat mbi dinamikën e tregut evropian.
- ***Të miratohet formula e financimit në arsim profesional e diferencuar sipas fushave dhe profileve*** - Orientimi i nxënësve drejt profileve deficitare duke përfshirë edhe inkuadrimin e femrës, do të mund të realizohej përmes incentivizimit dhe formulës së financimit. Rishikimi i formulës së financimit është ende në fazën e hershme. Formula e financimit duhet të jetë e strukturuar në atë mënyrë që inkurajon studimin në profile deficitare, inkurajon përfshirjen e grupeve të ndjeshme shoqërore, diferencon profilet sipas kërkesave, shpërblen performancën dhe ndërlidhjen e profileve me tregun e punës. Themelimi i një zyre për bashkëpunim me industrinë do të mund të lehtësonte procesin.
- ***Të zhvillohet kapaciteti për orientim të nxënësve në karrierë*** - MASHT ka shënuar disa hapa pozitiv në përmirësim të orientimit të nxënësve në karrierë. Duhet kushtuar vëmendje e posaçme ofrimit të kapacitetit njerëzor për orientim dhe këshillim, ofrimit të dritareve për praktikë profesionale, ofrimit të shërbimeve në të gjitha shkollat dhe mbledhjes së informacionit mbi destinacionin e të diplomuarve.
- ***Të rritet investimi kapital në arsim profesional*** - Shkalla e financimit për arsimin profesional nuk ka pësuar ndonjë ndryshim të theksuar në 10 vitet e fundit. Ndryshimi i vetëm nënvizohet në rritje të shpenzimeve për kompensim të mësimdhënësve. Arsimi profesional kërkon investime shtesë dhe urgjente në punëtori, hapësira mësimi, teknologji të informimit dhe komunikimit dhe tekste bashkëkohore.
- ***Të monitorohet dhe rritet shkalla e diplomimit në arsim të lartë*** - Numri i studentëve dhe shkalla e përfshirjes ka arritur shifra shumë të larta. Rritja e shkallës së përfshirjes nuk do thotë domosdoshmërisht ndonjë kontribut të theksuar për rritje të produktivitetit të fuqisë punëtore. Ndikimi i shkollimit universitar në konkurrueshmërinë e vendit varet nga cilësia e ofertës, numri i të diplomuarve dhe fushat e diplomimit të tyre. Megjithatë numri i studentëve është rritur ndjeshëm, kjo nuk është përkthyer në ndonjë ndryshim thelbësor në rritje të numrit të



të diplomuarve. Numri i studentëve që mbarojnë studimet dhe diplomojnë në institucionet publike të arsimit të lartë vazhdon të jetë nën 20 përqind. Kjo sjell në sipërfaqe edhe sfida të tjera në sistem duke përfshirë numri dhe cilësia e stafit mësimdhënës, numri dhe cilësia e stafit administrativ dhe atraktiviteti i përgjithshëm i ofertës arsimore.

- ***Të rritet shkalla e orientimit dhe diplomimit të studentëve në fushat STEM (shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë) dhe fusha tjera deficitare*** - Në përgjithësi, rritja e numrit të studentëve ka ardhur në fusha të studimit që ndërlidhen me ekonominë e shërbimeve (juridik, administrim biznesi, shkenca shoqërore). Shkalla e studentëve të orientuar në fushat STEM (shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë) është ende tejet e ulët. Rritja e numrit të të diplomuarve në STEM, do të mund të favorizonte konkurrueshmërinë e vendit në prodhim dhe përpunim industrial. Edhe orientimi i studentëve në bujqësi dhe veterinari vazhdon të jetë i ulët. Studentët kanë një tendencë të orientohen në ato sfera të studimit që kanë pak vlerë të shtuar për ekonominë e vendit, por në të njëjtën kohë edhe me pak shanse për punësim.
- ***Të rishikohet dhe miratohen standarde të operimit mbi proporcionin staf- student në arsimin e lartë*** - Rritje e theksuar e numrit të studentëve në sfera me vlerë të kufizuar për ekonominë e vendit dhe pa rritje të kapacitetit të stafit mund të krijoj sfida në cilësi arsimore. Proporcioni student-staf mësimdhënës në studimet e juridikut dhe ekonomikut është shumë përtej praktikave të mira dhe kufizimit ligjor (1:20). Institucionet e sigurimit të cilësisë duhet të operojnë me standarde të qarta rreth proporcionit të lejuar staf-student. Ky standard mund të rregullohet dhe diferencohet sipas fushave të studimit. Është e rëndësishme që të krijohen norma mbi të cilat mund të kufizohet proporcioni 1:200 në fushat e juridikut dhe ekonomikut.
- ***Të bëhet profilizimi i institucioneve publike të arsimit të lartë*** - Kjo dinamikë në arsimin e lartë kërkon vëmendje të posaçme në profilizim të institucioneve arsimore dhe fuqizim të institucioneve përgjegjëse për sigurim të cilësisë. Oferta arsimore e Universitetit të Prishtinës është relativisht e diversifikuar sipas zhvillimeve ekonomike dhe shoqërore. Sidoqoftë, analiza më e thellë e orientimit të studentëve dhe disponueshmërisë së stafit nxjerr shumë pikëpyetje mbi vlerën e shtuar të institucioneve rajonale. Në shumë raste, institucionet universitare publike të themeluara rishtazi kanë ndjekur një model të zhvillimit të Universitetit të Prishtinës në miniaturë. Oferta nuk është e ndërlidhur me kërkesën në treg. Mungesa e një strategjie të qartë të zhvillimit për të avancuar interesat ekonomike dhe shoqërore të rajoneve ka kushtëzuar zhvillime që do të mund të rrezikojnë edhe përvojën e akumuluar më herët (p.sh. industria nxjerrëse në Mitrovicë, turizmi dhe agrobiznesi në Pejë). Profilizimi i institucioneve është i domosdoshëm. Ministria mund të përdor formulën e financimit për të riorientuar studimin në fusha deficitare. Kjo mund të arrihet duke eliminuar subvencionimin, futjen e kuotave apo mosakreditimin e programeve që nuk ofrojnë vlerë të shtuar.
- ***Të rritet kapaciteti për të mbështetur, mbledhur të dhënat dhe sigurim të cilësisë në kërkim shkencor*** - Institucionet e arsimit të lartë, janë kryesisht të orientuara në mësimdhënie. Kosova ka shënuar disa hapa të vegjël përparimi në rritje të output shkencor, mirëpo ende mbetet krahasimisht i parëndësishëm krahasuar me numrin e stafit të punësuar në arsimin e lartë. Stafi mësimdhënës duket të jetë kryesisht i përqendruar në mësimdhënie. Nuk është dokumentuar ndonjë evidencë apo përpjekje për të ndryshuar këtë trend në institucionet publike të arsimit të lartë. Pothuajse të gjitha publikimet e indeksuara në Scopus burojnë nga Universiteti i Prishtinës. Gjatë vlerësimit nuk është dokumentuar ndonjë përpjekje serioze për të ndryshuar gjendjen e infrastrukturës së kërkimit shkencor. Ministria, përmes formulës së financimit, duhet të bëjë përpjekje të promovoj shtyllën e financimit për performancë shkencore dhe zhvillim të industrisë.

Në këtë mënyrë do të inkurajohej rritja e financimit për hulumtim shkencor relevant për industrinë dhe vendin.

- ***Të rritet investimi kapital në infrastrukturë dhe mjedise mësimore në arsimin e lartë*** - Shkalla e financimit në arsimin e lartë është rritur gradualisht që nga viti 2011. Investimet më të theksuara janë drejtuar drejt financimit të Universitetit të Prishtinës në shkallën 70 % në raport me shumën e alokuar për institucionet publike universitare. Shpenzimet kryesore janë përkushtuar për financim të kompensimit për stafin mësimdhënës dhe në raste më të kufizuara, rritje të numrit të stafit akademik dhe administrativ. Modeli i administrimit dhe financimit nuk është uniform për të gjitha institucionet.
- ***Të rritet mbështetja dhe financimi për ndërkombëtarizim të arsimit të lartë*** - Kosova ka shënuar hapa pozitiv në rritje të mobiliteteve të studentëve në drejtim të BE-së dhe vendeve tjera të OECD-së. Janë dokumentuar edhe hapa inkurajues për mobilitet të stafit akademik përmes Erasmus Plus. Megjithatë, shkalla e përgjithshme e ndërkombëtarizimit mbetet e ulët. Numri i programeve të përbashkëta të studimit, numri i projekteve të përbashkëta të hulumtimit apo pjesëmarrjes në Horizon 2020, vazhdojnë të jenë të kufizuara. MASHT, duhet të investoj në inkurajim të këtyre shkëmbimeve dhe zhvillim të stafit akademik shkencor duke rritur ndjeshëm financimin për projekte hulumtimi, shkëmbimi dhe bursa për studime doktorale.
- ***Të kompletobet legjislacioni sekondar dhe rritet kapaciteti për implementim të Ligjit për Profesionet e Rregulluara*** - MASHT duhet t'i përkushtoj një vëmendje të posaçme zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim- Asociimit dhe kërkesave që ndërlidhen me arsimin. Zbatimi i Ligjit për Profesionet e Rregulluara, legjislacioni sekondar dhe rritja e kapacitetit institucional për zbatim të kërkesave të Agjendës Evropiane.

